

Dr. Nuhi Veselaj

**ÇËSHTJE TË SHQIPES STANDARDE RRETH  
VENDBANIMEVE (VI)**

Prishtinë, 2016

Recensues

Prof. Dr. Abdullah Zymberi

Prof. Dr. Begzad Baliu

**Përshëndetje,**

**Lexues i nderuar, mosndryshimi i një numri enorm të emërtimeve të vendbanimeve në trojet aktuale e historike shqiptare me prejardhje të huaj disa të mbetura që nga lashtësia (kryesisht të imponuara me intrigancë nga pushtuesit sllavë e grekë) konsiderohet:**

- 1) si një shenjë e kulturës së lashtë toleruese shqiptare,*
- 2) si një mentalitet përulësie kohësisht i thadruar thellë në shprehi,*
- 3) si një moszotësi zgjidhjeje konceptore të institucioneve tona të deritashme të larta kombëtare shtetërore,*

*apo*

- 4) si një reflektim i stërmoshuar i shndërruar kohësisht në funksion të një vlere normale simbioze tashmë të patjetërsueshme toponimike?*

**Krejt këto katër versione e ndonjë tjetër përftuese le të vlerësohen e komentohen. Ne, në këtë vepër “Çështje të shqipes standarde rreth vendbanimeve”, jemi përpjekur, jo aq që këtë problematikë t’ia bëjmë sa më transparente opinionit, ose të sfidojmë për zgjidhje institucionet tona kompetente studimore e vendimmarrëse, sa ta trajtojmë lëndën, sa më gjithanshëm e në hollësi nga ana e fjalëformimit.**

***Sidoqoftë, lexim e meditim, me tolerancë, duresë e shpresë të trashëguar!***

**Prishtinë, nëntor 2016**

**Me nderime,  
Autori**



**Pasqyra e lëndës**  
(ÇËSHTJE TË SHQIPES SIANDARDE  
RRETH VENDBANIMEVE)

Përs hëndet je 3

Për mbajtja 5

Parathënie 13

Pjesa e parë

ÇËSHTJE AKTUALE RRETH EMËRTIMIT TË  
VENDBANIMEVE NË GJUHËN SHQIPE

Vështrim hyrës 21

Nënpjesa e parë

GJENDJA AKTUALE OIKONIMIKE NË GJUHËN SHQIPE 25

Dy fjalë në gjurmë historike të onomastikës antike shqiptare dhe  
përgjithësisht 25

1) RRETH NDËRLIDHJES SË GJENDJES HISTORIKE DHE  
AKTUALE OIKONIMIKE NË KOSOVË 33

2) GJENDJA SHOQËRORE-POLITIKE E AKTUALE  
OIKONIMIKE NË SHQIPËRI 44

3) PROBLEME OIKONIMIKE GJITHANDEJ TROJEVE  
SHQIPTARE 55

Përmbyllje rreth nënpjesës së parë ose meditim si duhet vepruar 59

Nënpjesa e dytë

KONSULTIM OSE NJOHJE ME PËRMBAJTJEN E DISA  
BURIMEVE OIKONIMIKË LIDHUR ME TROJET SHQIPTARE

61

(I) NGA LISTA PËR NDRYSHIMIN E DISA EMËRTIMEVE  
TË VENDBANIMEVE TË PAPËRSHTASHME TË SHQIPNISË  
1938 63

Hyrje 63

1. Prefektura e Dibrës 65

2. Prefektura Kosovëas (Kukësit – Nënprefekturë e Qendrës 66
  3. Prefektura e Lumës 66
  4. Prefektura e Elbasanit 66
  5. Prefektura e Korçës 67
    - a) Nënprefektura e Leskovikut 68
    - b) Nënprefektura e Kolonjës 68
  6. Prefektura e Gjirokastrës 68
    - a) Nënprefektura e Delvinës 69
    - b) Nënprefektura e Tepelenës 69
  7. Prefektura e Beratit 69
  8. Prefektura e Vlorës 70
    - a) Nënprefektura e Himarës 70
    - b) Nënprefektura e Vorës 70
    - c) Nënprefektura e Sarandës 70
  9. Nga prefekturat e tjera 70
    - a) Nënprefektura e Burrelit 70
    - b) Nënprefektura e Mirditës 70
    - c) Nënprefektura e Pukës 71
    - ç) Nënprefektura e Lezhës 71
    - d) Nënprefektura e Malësisë së Madhe 71
- Nga sqarimi i autorit 71

(II) NGA LISTA E TOPONIMEVE (SLLAVE) NË TERRITORET  
E LIRUEME SHQIPTARE ME SHQIPËRIMET E  
PROPOZUARA (1942) 74

Hyrje 74

I. Lista e toponimeve në territoret shqiptare me shqipërimet e  
propozuara 77

1. Dibra dhe Struga 77
2. Prespa 77
- 3 Tetova 78
4. Kosova Qendrore 78
5. Metohija dhe ana e Prizrenit 78
- 6, Pellgu i Plavës 78
7. Zona e Ulqinit 78
8. Lumej dhe male 78
9. Rajonet 78
10. Stacionet hekurudhore 79
  - a) Ohër-Strugë 79

- b) Linja Shkup-Mitrovicë 79
- c) Linja Pejë-Fushëkosovë 79
- ç) Linja Fushë-Kosovë Prishtinë Podujeve – Kurshumlija 79
- d) Linja Rasha-Novipazar-Rozhajë-Kolashin 79

II. Venerime nga burimi i mësipërm 80

- a) Veçori të përgjithshme 80
  - b) Veçori formëzuese fjalëformuese 81
- Përfundim 82

(III). NGA FJALOR I EMRAVE GJEOGRAFIKË, Tiranë 2002 83

I. Konstatime të nevojshme 83

- 1) Nga “Parathënia” 83
- 2) Nga Ndërtimi i Fjalorit 84
- 3) Nga kriteret dhe rregullat e ndjekura 85
- 1) Shembuj me zanore e grup zanorësh 86
- 2) Shembuj me bashkëtingëllore e grupbashkëtingëlloresh 86

II. Disa rregulla drejtshkrimore!! 87

III. Disa rregulla gramatikore 88

Përfundim 88

(IV) NGA REGJISTRI I STANDARDIZUAR I EMËRVENDEVE TË KOSOVËS, PRISHTINË (2005) 90

Hyrje 90

- 1) Parime dhe detyra 91
- 2) Të dhëna me interes në raportin FEGJ/RSEK 93
- a) Pasqyra e numrit të emrave të përveçëm oikonimikë sipas shkronjave në këto dy burime 93
- b) Sqarime lidhur me të dhënat nga Pasqyra 94

Sipërfundim 95

(V) NGA REGJISTRI I EMRAVE TË QYTETEVE DHE FSHATRAVE TË KOSOVËS E METOHISË

-versioni serbisht 96

Hyrje 96

- 1) Qarqet dhe komunat (Okruzi i opštine) 96
- Vërejtje 97
- 2) Intervenimi nga hartuesit (në serbisht) bërë komplet kësaj liste rreth emrave përkatës 97
- 3) Disa shembuj serbisht dhe dy versionet e mëparshme të propozuara shqip 1942/2005 100
- a) Nga Kosova Qendrore 100

Shënim	100
b) Nga Metohia dhe zona e Prizrenit	101
4) Disa konstatime me pikëpyetje	101
5) Venerime të elementeve të shqipes në formëzimin e vendbanimeve përkatëse	104
a) Trajta në shqipe duket si parësore	104
b) Emërtime nga rrënja ose fjala e qartë shqipe	104
c) Trajta të përbashkëta ose ndërndikuese indirekt në trajtën e pashquar	105
ç) Trajta të përbashkëta të huazuara nga turqishtja	106
d) Raste që qëndrojnë si dyjare	106
(VI) NGA REGJISTRI AKTUAL I QYTETEVE DHE FSHATRAVE TË KOSOVËS SIPAS RAJONEVE	107
Hyrje	107
Ndarja e territorit të Kosovës sipas qarqeve (rajoneve) administrative	107
Vërejtje	108
2. Regjistri aktual dhe emrat e komunave sipas administratës tre gjuhësore: shqip-serbisht-anglisht	108
Sqarim	109
3. Numri dhe realizimi i ndryshim-risimeve të vendbanimeve të Kosovës sipas regjistrave 2005/2015	110
Sqarim	112
Përfundimi i pjesës së parë	113
Pjesa e dytë	119
RRETH FORMËZIMIT DHE FJALËFORMIMIT TË EMËRTIMEVETË VENDBANIMEVE NË GJUHËS SHQIPE –me theks emërtimet e propozuara në Kosovë	121
Hyrje	121
A. Vështrim i shkurtër rreth emërtimeve në funksion	117
1. Raporti i emërtimeve të vendbanimeve në funksion serbisht e shqip	121
2. Parimet dhe burimet mbështetëse në punën e Komisionit	127
3. Pasqyra e numrit të vendbanimeve të rishqyrtuara, përkatësisht të propozuara nëpër komunat e Kosovës, sipas Regjistrat	129
Sqarim	131



B. ANALIZA FORMËZUERE E FJALËFORMUESE E EMËRTIMEVE TË VENDBANIMEVE TË PROPOZUARA SIPAS REGJISTRIT E MË GJERË 133

(I) FORMËZIMET PA NDAJSHTESA 134

- a) Emra të përgjithshëm konkretë të formëzuar si vendbanime 134
- b) Emra të përgjithshëm abstraktë të formëzuar si vendbanime 135

(II) EMËRTIMET E VENDBANIMEVE ME PRAPASHTESIM  
137

A. EMËRTIMET ME FUNDORËT A PRAPASHTESAT E HUAJA TË IMPONUARA 138

- a) Emërtimet me formantet me origjinë sllave 138
  - 1. Emërtimet me -icë/-ica 138
  - 2. Emërtimet me -(v)iqi 139
  - 3. Emërtimet me -ovac/-ovci 140
  - 4. Emërtimet me -evac/-evci 141
  - 5. Emërtimet me -evo/-eva 142
  - 6. Emërtimet me -ovo/-ova 143
  - 7. Emërtimet me -avo/-ava 144
- Shënim 144
- b) Emërtimet me formante me origjinë greke e turke 145
  - 1. Emërtimet me -OS e -OT 145
    - a. Emërtimet me -OS 145
    - b. Emërtimet me -OT 146
  - 2. Emërtimet me prapashtesat -a/xhi, a/li, dhe -ije 146
    - a. Emërtimet me -a /xhi 146
    - b. Emërtimet me a/li (-lli) 147
    - c. Emërtimet me -i ose -ije 147

B. EMËRTIME VENDBANIMESH ME PRAPASHTESAT E PËRVETËSUARA MBI BAZË ORONIMESH 149

- 1) Emërtimet me -ishtë 149
- 2) Emërtimet me -n/ik 150
- 3) Emërtimet me -inë /-in 151
- 4) Emërtimet me -ore e -tore 152

Sipërfundim 153

C. EMËRTIMET MBI BAZË TË EMRAVE ME PRAPASHTESATE PËRVETËSUARA PËR KONCEPTE NGA VEPRIMTARIA E NJERIUT 154

1) Emërtimet me –aj 154

Sipërmbyllje ose sqarim i domosdoshëm 158

2) Emërtimet me prapashtesat etnonime: -as, -an, -ak 162

a) Emërtimet me –as 162

Raporti etnonim-patronim / vendbanim me prapashtesat

-AJ dhe –AS 166

Skema trirubrikashe 167

b) Emërtimet me –an (-j/an ose -i/an) 168

c) Emërtimet me –ak 170

#### Ç. EMËRTIMET ME PRAPASHTESAT E SPECIFIKUARA PËR EMËRTIMET E NJERËZVE SIPAS PROFESIONIT 171

a) Emërtimet me -ë/s 171

b) Emërtimet me –tar e –ar 172

1) Emërtimet me –tar 172

2) Emërtimet me –ar 172

c) Emërtimet me –or 174

#### D. FORMIMET MBI BAZË NGA VEPRIMTARITË E TJERA SEMANTIKE ME PRAPASHTESAT PËRKATËSE TË PËRVETËSUARA 176

1. Emërtimet nën ndikimin e sendeve apo të mjeteve të punës  
176

2. Emërtimet nën ndikimin e emrave nga fusha e nocioneve  
abstaktë 177

a) Emërtimet me –i 177

b) Emërtimet me emra të ndryshëm abstraktë dhe nga emra  
vetjakë (të modës) 178

1) Shembuj me –IM 178

2) Shembuj me fundore të tjera 178

3) Shembuj me –OJË 179

3. Emërtimet me prapashtesat a emocionuese - zvogëluese 180

a) Emërtimet me -ush/-ushë 181

b) Emërtimet me –osh 181

c) Emërtimet me –oz 181

ç) Emërtimet me prapashtesat zvogëluese –TH dhe –ZË/-ËZ  
182

1) Emërtimet me –TH 182

2) Emërtimet me –ZË/ËZ 182

Sipërfundim 184

Dh. EMËRTIMET ME PRAPASHTESAT E SIPRAPASHTESAT  
PËRKATËSE ME PRIRJE SPECIALIZIMI PËR EMËRTIMET E  
VENDBANIMEVE 185

Hyrje 185

- 1) Emërtimet me –ajë 186
- a) Identifikimi 186
- b) Raporti me simotrën –NAJË 187
- c) Raporti -AJ/-AJË 192
- 2) Emërtimet me isht 191
- 3) Emërtimet me -sh/ç, -ash e -esh 192
- a) Emërtimet me -sh/ç 192
- b) Emërtimet me –ash 193
- c) Emërtimet me –esh 193
- Sqarim 194
- 4) Emërtimet me -et e –at 195
- a) Emërtimet me –et 195
- b) Emërtimet me –at 195
- Sipërfundim 196
- Sqarim plotësues 197
- 5) Emërtimet me –arë 197
- 6) Emërtimet me –anë 200
- 7) Emërtimet me -i/onë 202

Përmbyllje rreth prapashtesave me prirje specifikimi lidhur me  
nënfushat semantike ose profilimet që mbulojnë 205

(III) FORMIMET ME KOMPOZIM E NË MËNYRË  
PERIFRASTIKE 209

Hyrje 209

- a) Emërtimet me kompozita të mirëfillta 209
- b) Emërtimet togfjalësha 211
- 1) Emërtimet me çiftat togfjalësh me epitetin:  
i epërm/ i poshtëm 211
- 2) Emërtimet me çiftat togfjklësh me epitetin:  
i vogël/ i madh 212
- 3) Emërtimet me mungesë çifti 212
- c) Emërtimet me togfjalësha të tjerë 212

(IV) RAPORTI I SHKALLSHMERISË KUPTIMORE SIPAS  
MËNYRAVE TË FJALËFORMIMIT TË VENDBANIMEVE NË  
GJUHËN SHQIPE 213

Skema e shkallshmërisë kuptimore 214

Përfundimi i pjesës së dytë 216

PËRMBYLLJE OSE CILAT JANË DISA NGA RISIMET  
KRYESORE SFIDUESE NGA KJO VEPËR 222

Nga pjesa e parë 223

Nga pjesa e dytë 227

Rezyme ose komenti ynë përmbyllës 229

Literatura kryesore 237

Të dhëna bio-bibliografike për autorin 239

## Parathënie

Fill pas Çlirimit të Kosovës nga pushteti serb, qershor 1999, pasi Qeveria e përkohshme e Kosovës, natyrisht, jo pa lejëmarrje me gojë nga kreu i Administratës Ndërkombëtare për Kosovën (UNMIK) kishte pranuar nismën e disa intelektualëve të Prishtinës (gusht 1999) që në Kosovën e Çliruar të rishikohen dhe rivendosen emërtimet e rrugëve si dhe të vendbanimeve (fshatrave e të qyteteve), ngase më parë dhe gjatë kësaj Lufte ishin bërë ndryshime të mëdha në dobi të emërtimeve zyrtare serbe, andaj lidhur me këtë ndërmarrje pa humbur kohë, gjithsesi mbi bazë vullnetare, edhe ishin formuar komisionet përkatëse në shkallë vendi si dhe në nivel komunash. Në **Komisionin rreth emërimit të rrugëve, shesheve e lagjeve të Prishtinës**, anëtar komisioni më kishin propozuar edhe mua. Pranova me kënaqësi, ku dhe dhashë kontributin tim modest, më tepër nga pikëpamja drejtshkrimo-fjalëformuese të emërtimeve. Me thënë të drejtën, kjo çështje imponohej si temë e ngutshme problemore shoqërore-politike në këto dy aspekte:

së pari, mbasi nga administrata e pakmëparshme serbe përqindja e emërtimeve të rrugëve, siç u cek më sipër, në favor të emërtimeve në serbisht, dilte mbi 80%, madje ishin favorizuar emërtime nga kombësitë e tjera, ndërkaq emërtimet në shqipe kishin mbetur në pakicë, edhe pse dihej përqindja shumicë e shqiptarëve 70-80%, që assesi s'mund të vihej në dyshim, dhe

së dyti, siç e kishim konstatuar ne, edhe më përpara në shqipe çështja drejtshkrimore e emërtimeve të rrugëve paraqitej siproblemore. Së këtejmi, pikërisht për çështjen e dytë, problemin drejtshkrimor të rrugëve, lagjeve, shesheve, në plan kombëtar, e kishim rrahur disa vite më parë në një artikull të botuar në gazetën *Rilindja*, ku konstatonim që kjo çështje nuk kishte gjetur zgjidhje të plotë e të kënaqshme as në *Drejtshkrimin e gjuhës shqipe* (1973) dhe as në burime të tjera normëzuese.

Sidoqoftë, pasi Komisioni ynë e kreu punën, duke e dorëzuar tek organi kompetent komunal, materialin me propozizimet për emërtimet e

reja të rrugëve, shesheve dhe lagjeve të kryeqytetit, nga shtypi morëm vesh që edhe **Komisioni Qendror për rishikimin e përshtatshmërisë ose për standardizimin e vendbanimeve të Kosovës** (formular, dhjetor 1999), kishte qenë në vazhde të punës së vet të suksesshme, madje pas harmonizimit të punës me komisionet pëkatëse të komunave, propozimi i tyre si version i parë, ishte publikuar në gazetën *Rilindja* (2000). Aty, në atë publikim, pata vërejtur, që disa emërtime të reja ishin farkëtuar disi pa respektuar disa kritere të rëndësishme rreth specifikimit të ndajshesave emërformuese të shqipes, të cilat, gjithsesi, për mendimin tonë, nuk ishin përdorur plotësisht në përputhje me rregullat ose prirjet rreth specifikimit apo specializimit të afikseve përkatëse të sistemit fjalëformuese nominal të shqipes. Këtë bindje e bazojmë në faktin se lidhur me këtë fushë studimore kisha fituar njëfarë përvojë teorike e praktike, sepse përveç temës së doktoratës *Rreth emërimit e formëzimit të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe*, kisha botuar edhe ndonjë artikull përkatës, ku kisha trajtuar pjesë të strukturës emërformuese të gjuhës shqipe brenda sistemit fjalëformues global, përkatësisht tashmë e kisha të botuar edhe veprën: **Çështje të shqipes standarde ...I**, - *Rreth konsolidimit të modeleve të caktuara emërformuese mbi bazë të disa prapashtesave të specifikuara*, Prishtinë, 1997, ku në vëshgimet e mia studimore kisha konstatuar disa rregulla aksiomativisht të qëndrueshme rreth specifikimit të prapashtesave përkatëse sipas nënfushave të caktuara semantike që mbulonin ose prireshin të mbulonin, të cilat, deri atëherë, nuk ishin vërejtur sa duhet ose fare nga standardologët përkatës, rregulla këto, që duhej t'i konstatonin dhe t'i rekomandonin pikërisht ata (standardologët) nga Qendra. Prandaj edhe vendosëm që përvojën tonë në këtë lëmë ta bëjmë të njohur publikisht, në mënyrë që jo vetëm opinioni i gjerë, por të jenë në dijeni lidhur me këtë së paku edhe anëtarët e Komisionit Qendror të Prishtinës.

Në të vërtetë, në veprën *Çështje të shqipes standarde...I* (1997), pas *hyrjes*, në temën e parë prirëse, në bazë të kontatim-vëzhgimeve të mëparshme, kishim konstatuar specifikimin e afikseve (prapashtesave autoktone) për disa nga nënfushat përkatëse semantike, të të dy sistemeve morfologjike–fjalëformuese të gjuhës shqipe, të sistemit **foljor** dhe atij **emëror**.

1. Lidhur me sistemin foljor konstatojmë që në *Gramatikën e Akademisë* paraqiteshin të trajtuara mirë vetëm katër prapashtesa foljore bazë: **-IS**, **-IT**, **-OS**, **-O**, që nuk kontestoheshin, por në realitetin tonë gjuhësor, siç argumentonim ne, mbi temë në bashkëtingëllore veç këtyre 4

prapashtesave të mirëfillta: -S, -IS, -IT dhe -OS ndeshen edhe 4 të tjera të identifikuar si ndërferkime: **-I/J, -E/J, -AS** dhe **-AT** – gjithsej **8** prapashtesa mbi temë konsonantike dhe një tip të njohur mbi temë foljore: formanti **-O– pa zgjerim**. Ndërkaq të foljet me -O me zgjerim, përveç: **-RO, -TO, -LLO, -SO** dhe **-ZO**, të cekura ose të trajtuara paksa në atë gramatikë, që ne i quajtmë si të mirëfillta, ndeshëm edhe **13** të tjera: 6 sivariante të prapashtesave të mirëfillta të -O-së me zgjerim: **-NO, -MO, -RRO, -LO, -IZO, -CO**, si dhe 7 formante të tjera të diskutueshme si zgjerim i prapashtesës -O: **-KO, -SHO, -SHTO, -ÇO, -ZHO, -HO** dhe **-JO**, të cilat aty vetëm sa i shoqëronim me ndonjë shembull ilustrues, por nuk u trajtuan në përimitësi, lëndë kjo që më në hollësi iu bë e njohur opinionit më vonë, me veprën: *Foljet më -O në gjuhën shqipe*, Prishtinë 2002, madje si punim i veçantë viteve të fundit është botuar edhe vëzhgimi ynë për foljet *me prapashtesën e pavarur -Avë*. Dhe së këndejmi, për rrjedhojë del që gjuha shqipe globale, sipas vëzhgimeve tona, ka **28 prapashtesa foljore** dhe që të gjitha këto kanë gjetur ose prirjen të gjejnë përdorim si formante të specifikuar ose të specializuara për nënfusha të caktuara semantike, pra edhe brenda shqipes standarde.

2. Ndërkaq për sistemin emëror në atë punim prirës, sipas nënfushave semantike që mbulojnë, po sipas vëzhgimeve tona, qenë identifikuar disa prapashtesa emërformuese, të cilat ndërkohë edhe janë trajtuar mjaft gjerësisht e në hollësi, qoftë aty (në veprën *Çështje të shqipes standarde ... I, 1997*), qoftë në punime të tjera të veçanta, si:

1) **-tar, -ar, -ës** dhe **-an** (*huazimet me -ik/ë fundore*)– të specifikuar për emërtimin e njerëzve sipas profesionit a veprimtarisë,

2) **-as, -j/an** - pothuaj të specializuara për emërtimin e njerëzve sipas vendbanimit a prejardhjes,

3) **-or, -ore, -(ë)s, (ë)se, -ue/se, -ue/s, -cë, -urina** etj. - shumë praktike për emërtimin e gjë-sendeve ose të mjeteve konkrete të punës,

4) **-tore** – me prirje specializimi për emërtimin e vendshërbesave, lokaleve të punës etj.,

5) **-i, -si, -shmëri, të + pjesore +t-**: -im, -on etj., praktikisht shquhen në përdorim për nocione abstrakte apo antroponime mode.

6) **-aj** – e specializuar kryesisht, për emërtimin e patronimeve,

7) **-atore, -eshë** dhe **-e** - praktikisht të njohura për emërtimin e grave sipas veprimtarisë etj.

Dhe, si me thënë, në këtë vazhdë, tashmë e kishim të gatuar idenë për të shtrirë hulumtimin në drejtim të konstatimit rreth specifikimit të

afikseve te mundshme fjalëformuese edhe për nënfusha të tjera semantike dhe pikërisht *për emërtimin e vendbanimeve (katundeve)*, në kuadër të toponimisë dhe lidhur me këtë sa pata filluar me grumbullue material. Për këtë qëllim sa për konsultim ndamë ndonjë hartë si provë dhe hulumtonin edhe burime të tjera dhe po atëherë, për ne, fatlumisht, piku materiali i grumbulluar, i sapobotuar në gazetën *Rilindja*, rreth emërtimeve të vendbanimeve të Kosovës (2000), material, ky që ishte, pra, shumë i mirëseardhur për ne, ngase ai material, vinte i përpunuar jo aq dosido, por i niveluar nga një dorë studiuesish tanë të njohur nga *Komisioni Qendror për Standardizimin e emërvendeve të Kosovës*, dhe kështu m'u rrit e ngrit motivi edhe më shumë për t'iu rrekur punës, pikërisht *rreth mënyrave formëzuese-fjalëformuese të emërtimeve të vendbanimeve në gjuhën shqipe*.

Natyrisht, puna e parë ishte me e shumue dhe me e grumbullue materialin dhe njëherazi me i seleksionue e konstatue zgjidhjet që ishin bërë më parë, qoftë si zgjidhje formëzuese të trashëguara, qoftë edhe të rishtkrijuara, spontanisht ose zyrtarisht.

Në këtë kontekst vumë re disa mbështjellime që kishin ndodhur, duke ngarkuar pa nevojë për mungesë përvoje konceptore disa ndajshitesa edhe për këtë fushë semantike, të cilat tashmë veç ishin të zëna, ose të specizuara mirë për nënfusha të tjera semantike. Kështu si rezultat i përpjekjes sonë në këtë drejtim doli asokohe edhe punimi me titull: **“Çështje rreth formëzimit dhe fjalëformimit të emërtimit të vendbanimeve në gjuhën shqipe” – me theks emërtimet e propozuara në Kosovë**, botuar në gazetën *Rilindja*, në vitin 2001, mars 19-31, në 12 vazhdime.

Mirëpo, meqë kjo temë, nga aspekti fjalëformues-formëzues, mesa dinim atëherë nuk ishte trajtuar gjëkund dhe, si duket, ashtu e pastudiuar në hollësi, ka mbetur deri në ditët e sotme, andaj lidhur me këtë, pa marrë parasysh vështirësitë, vendosëm ta rishikojmë dhe ta përplotësojmë sa është e mundur po atë temë, po tash si vepër të gatuar me titull: **Çështje të shqipes stanbdarde rreth vendbanimeve**.

Sidoqoftë, pra, ishim dhe jemi të vetëdëshëm për vështirësitë fillestare (pioniere) që ka çdo punë serioze, megjithatë, duke e pasur të qartë rëndësinë që ka, së pari, paraqitja dhe pastaj shqyrtimi, dhe ndërkohë zbardhja e zgjidhja e problemeve të tilla, patëm marrë dhe tash po e rimarrim guximin që së paku të vazhdojmë të rivënë e tiketave në këtë shtrimtraseje fjalëformimi, e pastaj ndërmarrësit, ekspertë më të përgatitur



e më me nge se ne, këtë stazë-ecjeje ligjërimi ta bëjnë më të lehtëkalueshme, më të mirështruar, madje edhe ta bëjnë objekt shembëll për të mirë, apo jo?!

Sa patëm arritur të shenjonim diçka nga tiketimi fillestar në këtë drejtim, edhe pse atëherë përpjekja jonë qe vlerësuar pozitivisht, sot nuk mund të jemi të kënaqur, prandaj duke e rimarrë në rishikim të njëjtën temë do të përpiqemi që atë punë ta bëjmë edhe më të qartë edhe më të plotë. Një nevojë e tillë fjalëformuese, si çështje hapur ndjehet aktualisht, jo vetëm në Kosovë, por edhe në Shqipri dhe në mbarë trojet shqiptare. Madje, zgjidhja i një problemi të tillë në mos qoftë edhe më i madh për të gjitha trojet shqiptare, është po aq aktual e më tepër sa ishte edhe atëherë, në fillimvitet e mijëvjeçarit të ri.

Në të vërtetë, tash sa vite, përveç materialit të mëparshëm na ra të njihemi edhe me material të ri kushtuar kësaj teme, prandaj e pamë të arsyeshme që punimin ta zgjerojmë në *përmasa të një vepre, duke e ndarë në dy pjesë*, punimin e atëhershëm, të rishikuar, po e lëmë **si pjesë të dytë**, ndërkaq materialin e ri oikonimik që po ofrohet përgjithësisht me fakte të reja të interpretuara sipas dokumentave përkatës, po e trajtojmë **si pjesë të parë të veprës**.

Ç'është e drejta, edhe pjesën e parë po e ndajmë në *dy nënpjesë*, në *nënpjesën e parë*, me pak fjalë paraqesim problemin aktual ekzistues në përgjithësi dhe konkretisht, në tri zona: *Kosovë, Shqipëri* e gjithasndej në *Trojet e tjera shqiptare* dhe njëherazi në *nënpjesën e dytë* do të njohim opinionin me përmbajtjen e disa burimeve ose të dokumentave përkatës që përmbajnë lëndë të grumbulluar ose pjesërisht të analizuar lidhur me këtë temë, që nuk i njihnim më parë, dokumenta këta, të cilët ofrohen si lëndë me një numër të konsiderueshëm të emërtimeve të formëzuara të vendbanimeve të trojeve shqiptare kryesisht, por në raste edhe me propozime për ndryshimin e tyre me emërtime të reja më të përshtatshme gjuhësisht e kombëtarisht.

Natyrisht në pjesën e parë të punimit do të vëmë theksin te problemi më i madh i trashëguar që i imponohet sot shqipes e që është: *raporti ndërghjuhësor sllavisht (bullgaro-serbisht) – shqip i emërtimeve oikonomike*. Në të vërtetë, ky problem ka nisën që nga mesjeta, po rëndon edhe më vonë deri në ditët tona sidomos në Kosovë, trashëgimi kjo e fryrë, e politizuar dhe e manipuluar nga pala sllave për qëllime makiaveliste, sidomos nga serbët. Meqë nga analiza ose ballafaqimi me lëndën nga këto burime edhe pritët të plotësohet çështja, madje edhe të zbardhet sadokudo raporti shqip-sllavisht të emërtimeve në trojet shqiptare, me theks serbisht(!), prandaj kërkojmë

nga lexuesi i nderuar që t'i bashkohet aktivisht përpjekjes sonë në mënyrë që së bashku të ndihmojmë sa të mundemi zgjidhjen e problemeve të diskutueshme, siç është, përveç tjerash së paku edhe vlerësimi ose ndryshimi i disa emërtimeve të çuditshme apo “me marre” në të dyja gjuhët, sepse kemi të bëjmë me një problematikë vërtet të hapur dhe shumë të gjerë e serioze të manipuluar edhe politikisht, dhe si të tillë jo të paprekur e të parrahur, nga aspekte të ndryshme, edhe nga studiues të tjerë.

Është vendi të falenderojmë botuesin dhe recensuesit: Prof. dr. Abdullah Zymberi dhe Prof. dr. Begzad Baliu. Në mënyrë të veçantë i jam mirënjohës profesor Begzad Baliut, i cili jo vetëm tash, por edhe atëherë, për dallim nga të tjerët punimin tonë të vitit 2001 e pati vlerësuar drejt, duke e përdorur edhe si referencë në veprën e tij *Gjendja e toponimisë shqiptare në Ballkan*, Era Prishtinë.2004.

Gjithsesi falenderoj edhe studiuesit, si: Shefki Sejdiu, Rexhep Doçi, Rami Memushaj, Sabit Uka, Emil Lafe, Fahri Xharra, Mustafa Ibrahim, Jusuf Buxhovi, Jusuf Osmani, Ilir Konushevc, Begzad Baliu, Reshat Avdiu e shumë e shumë të tjerë, sepse nga punimet e të cilëve kemi mësuar, por për hir të zgjidhjes përfundimtare të çështjes kërkojmë ndihmë e mirëkuptim, jo vetëm nga ata, por edhe nga studiues të tjerë, madje edhe nga joshqiptarë, specialistë të kësaj fushe studimore.

**Pjesa e parë**  
**Çështje aktuale rreth**  
**emërtimit të vendbanimeve**  
**në gjuhën shqipe**



## VËSHTRIM HYRËS I PJESËS SË PARË

Me qëllim që punimit t'i japim natyrë serioze shkencore që në fillim në këtë **vështrim hyrës** po shënojmë disa terma në kuadër të disiplinës ku përfshihet edhe dija rreth emërve ose vendbanimeve, të cilët i kemi objekt trajtimi në punimin tonë. Kështu menjëherë po përmendim **onomastikën**, si degë të linguistikës (gjuhësisë), e cila studion emrat e përveçëm dhe se në kuadër të saj bashkëveprojnë disa disiplina, si:

- **etnonimia** (që studion emrat e popujve, fiseve të kombeve e të kombësive),

- **antroponimia** (emrat e përveçëm vetjak të njerëzve),

- **toponimia**, e cila studion emrat gjeografikë, ndërkaq në kuadër të saj dallohen këto nëndisiplina:

a) **toponimia hidronimike ose hidronimia** (studion emrat e ujrave: përrojeve, lumejve e deteve),

b) **toponimia oronimike ose oronimia** (studion emrat e bjeshkave, maleve, arave etj.) dhe

c) **toponimia oikonimike ose oikonimia (urbane e rurale)**, e cila studion emrat e vendbanimeve (qyteteve, fshatrave, qendrave të banimit).

Së këtëjmi, siç po shihet nga titulli i punimit tonë, ne, kemi të bëjmë kryesisht rreth trajtimit të emrave të vendbanimeve të trojeve shqiptare, por pa përjashtuar ndonjë shembull ilustrimi që ndërlihet shkrimisht e prejardhjesisht edhe me nëndisiplinat a nëndegët e tjera të toponimisë, përkatësisht të **onomastikës**.

Ç'është e vërteta, ne për mos me humbë në kompleksin e problemeve të shumta onomastike që i imponohen shqipes, siç u sqarua paksa në *Parathënie*, si fill e bazë të parë mbështetës do ta kemi punimin tonë "*Çështje rreth formëzimit dhe fjalëformimit të emërimit të vendbanimeve në gjuhën shqipe*" – me theks emërtimet në Kosovë", i publikuar në gazetën *Rilindja* të Prishtinës, mars 2001, në 12 vazhdimë (mars 19-31,'1), i cili

atbotë edhe pse qe pritur mirë, edhe prej disa anëtarëve të **Komisionit Qendror për Standardizimin e Vendbanimeve të Kosovës (1999-2001)**, për shkaqe të ndryshme edhe objektive, nuk e pati jehonën e duhur gjithkëndej e gjithandej. Pse ndodhi kështu? Të tjerët mund të dinë e t'i shprehin shkaqet më mirë, por unë po i mëshoj arsytimit, sepse pikërisht në atë periudhë lënda për standardizimin e vendbanimeve të Kosovës ishte në përfundim e sipër nga ky Komision, sepse propozimet nga komisionet e komunave pothuaj kishin përfunduar. Megjithatë mund të thuhet që ndonjëri nga propozimet tona, edhe pse ishte atëherë në fazën e konstatim-supozimeve dhe binte paksa ndesh me praktikën e deriatëhershme lidhur me ngarkesat enorme të afikseve përkatëse me polisemantizim etj., nuk qe fare pa ndikim, së paku te ndonjë anëtar komisioni.

Në të vërtetë, siç e kemi cekur edhe më përpara, meqë punimi ynë kishte të bënte me një ide ose temë të veçantë, realisht të patrajtuar në hollësi më përpara në kuadër të shkencës sonë për gjuhën, sidomos nga aspekti i fjalëformimit, andaj, logjikisht mbeti që tashembastashti, duke u rishikuar, të vlerësohet më me nge, qoftë edhe nga opiniononi i gjerë intelektual, qoftë nga gramatikanët e standardologët e qendrave tona studimore gjuhësore, Tirana, Prishtina, Shkupi (Tetova), Podgorica (Ulqini), Presheva (Beogradi) etj. Mirëpo, e themi me keqardhje, nuk do të dëshiroja që edhe kjo temë si disa çështje të tjera gramatiko-ortologjike e pragmatike të nismuara prej nesh (*si paskajorja, shumësi dhe shquarsia e emrave, asnjansësi etj. etj.*), që edhe tash pas afro 20 vitesh, të mbesin të pavlerësuara seriozisht. Këtë e theksojmë në mënyrë të veçantë, sepse çështja e emërtimeve të vendbanimeve nga pikëpamja e qëndrueshmërisë drejtshkrimore e drejt-fjalëformuese si temë e hapur në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri dhe më gjerë, sot për sot, paraqitet edhe më aktuale se atëherë kur pata filluar me e shenjue këtë temë brenda kohëhapësirës përkatëse të terminologjisë shqiptare.

Sidoqoftë, pikërisht në pjesën e parë shtesë të këtij punimi i kemi vënë vetes për detyrë me përshpallë ose me i bë të njohura dhe dhe me i sqarue para opinonit këto dy çështje madhore, siç janë:

a) në nënpjesën e parë: **Gjendja aktuale oikonomike në gjuhën shqipe:** 1) në Kosovë, 2) në Shqipëri dhe 3) gjithandej në Trojet e tjera shqiptare dhe

b) në nënpjesën e dytë: **Konsultimi ose njohja me përmbajtjen e 6 burimeve oikonimike** ku dalin të shënuara dhe zgjojnë interes edhe formëzues e fjalëformues një numër i konsiderueshëm i emërtimeve të vendbanimeve në viset shqiptare, në *Shqipëri*, në *Kosovë* e paksa gjithandej në *Trojet* e tjera shqiptare.





## Nënpjesa e parë GJENDJA AKTUALE OIKONIMIKE NË GJUHËN SHQIPE

Në këtë nënpjesë të punimit në vend të hyrjes do të themi dy fjalë rreth historikut të onomastikës shqiptare përgjithësisht.

### Dy fjalë në gjurmë të historikut të onomastikës antike shqiptare e përgjithësisht

Edhe pse dihet që tek asnjë gjuhë nuk mund t'i fiksohet data e fillimit të formimit të saj, megjithatë secila gjuhë që është *tipar themelor filltar i një etnie (kombësie a kombi)* ka historikun e vet. Gjithsesi, secila gjuhë lidhet me emërtimin e një etnonimi, madje edhe me emërtimin e vendqendrimit të folësve përkatës të atij kombi a kombësie. Edhe emri i gjuhës shqipe ndërlidhet me etnonimin **shqiptar** dhe toponimin **Shqipri /Shqipni** e Shqypni (*Shqipëri*). Në të vërtetë, ky toponim me koncept gjeografik, njihej më herët, por del i emërtuar si emër shteti të mvetësishëm, i njohur ndërkombëtarisht, vetëm pas vitit 1912/'13, por që nuk mbulonte faktikisht si shtet të gjitha trojet e banuara me shumicë shqiptare, të cilët identifikohen gjeografikisht e historikisht me gjuhën e vet dhe me veti të tjera etnike e kulturore që nga koha e Dikliocionit sipas katër zonave përkatëse: *Provalitana, Dardania, Epiri i Vjetër dhe Epiri i Ri*. Por sidoqoftë, është e vërtetë se shtetet dhe popujt e tjerë sot na njohin, kryesisht me termat: **alban Albania**, pastaj **Arnaut Arnautllëk**, ndërkaq si komb (etni) na njihnin edhe me emër-termat etnonim e toponim: **Arbanas** (*Arbanashki*), **Arvanitas** (*Arvanites, Alvaniki*), **Albanes** (*Albanisch, Albanian, Albanez, Albaniez, Albanees*, pa përmendur *ngatërresa ose simbiozë emërtime*: *si epirot, dardan,(thrakas), maqedon, grek!, turq!, serb! etj.*

Kështu studiuesit, duke u bazuar në gjuhën e veçantë të trashëguar që e kemi dhe duke u nisur nga realiteti historik dhe faktet ekzistuese

gjeografike, ku sot jeton shumica e popullit shqiptar në këto vise na konstatojnë si popull autokton, por sa i përket prejardhjes ka disa hipoteza. Deri tash në dy qendrat albanologjike shqiptare: Tirana e Prishtina, mbrohet prejardhja e shqiptarëve dhe e gjuhës shqipe që ndërlidhet me Ilirinë, ilirët dhe ilirishten, por pa e përjashtuar njëfarë ndërlidhjeje me Thrakinë, thrakët e thrakishten.

Ç'është e drejta, pa e injoruar ilirishten e Ilirinë, në kohët e sotme është rilindur hipoteza (e veprimtarëve të Rilindjes shqiptare dhe jo vetëm e tyre) për prejardhjen e protoshqiptarëve dhe të protoshqipes nga pellazgishtja \**pellas* +*Ge* ose \**pellas*+*De* ose **P(j)ellas+dhe** që zberthehet: **pjellë nga dheu** ose **lindur nga dheu** dhe kështu, duke i ndërlidhur stërgjyshët e protoshqiptarëve si popull hyjnor para e pas *Noes* (Nauhut, Nuhut Nuh-it) ose si popull ndër më të vjetrit në botë, hipotezë kjo gjjithsesi aktuale dhe me ngjyrim përshkallëzues mbështetur edhe mbi bazë dokrinore fetare, sipas treshes: *adamo–nauho-abrahame!*...

Ne duke u uruar punë të mbarë studiuesve të tillë të sotëm, të cilët po i japin aq publicitet çështjes rreth: *pellazgëve, pellgasve, pellazgishtes*, përkatësisht *protoshqiptarëve* si *popull hyjnor, me gjuhë hyjnore të tyre*, po shtojmë edhe këtë se me prejardhje pellazge (pellgase) ose në simbiozë me ta, veç **ilirëve, thrakasve, dardanëve** nga studiuesit jepet pak haptë, të tillë quhen sot edhe shumë popuj të tjerë të lashtë, shumica të identifikuar edhe historikisht si:

*Atlantidët (Pellgasit e Det-Mesdheut), Egjiptasit e Vjetër, Hetitët, Shumerët, Persët, Amazonët, Frigasit, Mikenasit, Spartanët, Akilejtë, Etruskët, Frigidët, Mesapët, Latinët, Tirsënët, Keltët, Maqedonët e Moçëm, Epirotët, Romakët, Britanikët, Irlandezët, Gjermanikët, Frankët, "Grekët" e Lashtë etj.*

Sidoqoftë, edhe pse kam hasur në burime të caktuara që studiuesit e caktuar e ndërlidhin logjikisht e mjaft argumentisht protoshqipen e protoshqiptarët me atë periudhë, përkatësisht me fijet historike të shumicës së emrave të popujve të sipërshënuar, këtu unë po përmend sa për ilustrim, vetëm një fakt venerues vetjak. Si student pasuniversitar e kam pasë parë vetë në një burim që edhe te hetitishtja (gjuhë e lashtë e Azisë së Vogël) vëreheshin *përmrat grimcë* ngjashëm pothuaj si në gjuhën shqipe. Po ashtu, ndeshen edhe disa fjalë (konkordanca) etimologjikisht të ngjashme me gjuhë të tilla të vjetra mediterane, të gjalla ose të zhdukura, që zgjojnë interes, madje edhe me ato të Lindjes së Hershme, por e pranojmë se nuk kishim krahë specialë të pajisur me tejqyrë të instaluar teknikodigjitalisht në shtatin e mendjesisë

sonë të pashkëputur nga toka bazë për të fluturuar ose për të ecur e për të parë e gjurmuar më thellë në ato hapësira me plot mjegullnaja për ne të padëpërtueshme, ashtu si edhe për sytë tanë të rëndomtë, atëherë detyrimisht u ndalëm në dhe-tokën e gjuhës sonë që fatbardhësisht e kemi. Mirëpo, sa për kërshtëri, shfrytëzova praninë e prof. E. Çebejt, i cili atëbotë mbante një cikël ligjëratash për ne studentët pasuniversitarë në Prishtinë, të cilin e pata pyetur lidhur me ngjashmërinë e *përemrave grimcë* hetitisht-shqip, ai m'u përgjigj vetëm kaq:

**- Edhe një studiues gjerman ma ka bërë po këtë pyetje.**

Ndërkaq rreth konkordancave mediterane si *venë /vino...shumerë ...HLLH* (hellow /allah/hyll... dhe tezës *pellgase ose pellazgjike (pellazde)*, pasi i recitoi disa vargje të Fishtes që ndërlihdeshin me këtë hipotezë, shkurt më tha:

**-Ne duhet ta forcojmë punën me ilirishten.**

Së këtëjmi, studiuesve tanë dhe të huaj u uroj suksese në hulumtime të mëtejshme protoshqiptare për të na sjellë argumenta të rinj që flasin për raportin e gjurmëve të shqipes me pellazgishten, por gjithsesi do të dëshironim që mos t'i ndahen dhe mos të ndahemi edhe ne rreth përforcimit të hipotezës rrënjëzuese ose këshillës së prof. Çabejt: **Shqipja - bijë e ilishtes me disa komponente të thrakishtes.**

Sidoqoftë, sipas asaj që kemi mundur të shohim dhe të gjujkojmë kemi fituar bindje të plotë që vërtet shqipja që e kemi sot që në antikë e kishte të ravijëzuar qartë fizionominë e saj ligjërimore edhe në troje të Dardanisë Iliriane dhe kjo dëshmohet katërçipërisht edhe me disa fakte gjuhësore, siç janë ndërndikimet gjuhësore me greqishten e vjetër, latinishten, thrakishten, keltishten, e ndonjë gjuhë tjetër, dhe ndërkohë e më vonë edhe me sllavishten e arabo-turqishten dhe gjuhë të tjera. Në këtë kontekst si fakte ndeshim edhe elemente oikonomike, emërtime këto, gjurmë e të cilave hetohen në disa emërtime vendoikonomesh të vjetra në trojet historike të shqiptarëve e më gjerë si:

Naisus, Scodra, Duracium, Mathus, Vicianum, Ulpianë, Therandë, Livragonë, Vendenis, Siparant, Margus, Bardarium, Dalmacija, Helada, Buena, Scardus, Iliria, Dardania, Pindi, Athina, Butrinti, etj. të cilat të ruajtura në gojën e banuesve trashëgues sot thjesht-shqiptohen shqip:

*Nish, Shkodër, Durrës, Mat, Vushtrri etj.*

Sido që të jetë, në këtë hyrje nuk e shohim të arsyeshme të zgjatemi më tepër lidhur me këtë, ngase ndonjëra nga këto raste sadopak është prekur edhe prej nesh, qoftë rrëshqitazi këtu ose, më me nge, në punime të tjera.

Ç'është e drejta, kur është fjala tek oikonimet toponimike të vjetra që shkenca e re po i qet në dritë, mendoj që disa nga studiuesit tanë me profil gramatikanë apo standardologu, assesi nuk duhet ndjerë ndonjëfarë krenarie folklorike, duke u kënaqur me ndonjë konkordancë të përbashkët të shqipes me gjuhët e huaja (të mëdha ose fqinje), ku shqipja e sotme pa na u dhimbsur mund të shkrihet (!), gjëra këto shumë të rrezikshme, apo jo?! Në të vërtetë, vertetësia e tillë historike u përket ta vlerësojnë profesionisht studiuesit e profilit përkatës, linguistët e dijetarët me përgatitje lashtohistorike, ndërkaq, gramatikanët dhe standardologët tanë të sotëm, siç mendojmë ne, duhet t'i kthehen shqipes, gjuhës së sotme shqipe, përpunimit të saj, ta begatojnë atë, pos tjerash, duke pasur pikësynim: *zbulimin e modeleve fjalëformuese ose prirjet e shenjuara që i ka të trashëguara aksiomativisht shqipja globale sipas nënfushave të caktuara semantike, të cilat edhe pse ekzistuese, ende janë të pazbardhura e të konstatuara jo drejt nga shkenca jonë bashkëkohore* e si rrjedhojë edhe të papërvetësuara nga një numër i konsiderueshëm i intelektualëve albanologë, studiues të gjuhës së sotme shqipe.

Pra, gjuhësia shqiptare duhet ta kërkojë forcimin e vetvetes brenda vetvetes (shqipes globale), të cilën për mendimin tonë, ende nuk e ka të studiuar në përplotni. Me fjalë të tjera ne përshëndesim studiuesit e profileve të specializimeve të ndryshme teorike të gjuhësisë moderne si dhe ata që kanë krahë e sy me tejkëqyra imagjinative të udhëtojmë në parahistori, por prej standardologëve që nuk e kanë një mundësi e aftësi të tillë fluturimi, kërkojmë dhe i ftojme ta kryejnë punën e vet si ne në të mirë të qartësisë në strofullogun e përkapshëm të gjuhës sonë reale, qoftë në aspektin diakronik, qoftë aq më tepër në atë sinkronik. Ngase, pikërisht në sinkroni, për mendimin tonë kemi ngecje studimore të hetueshme, jo vetëm sa i përket normës drejtshkrimore standarde, por edhe aq më tepër kemi nevojë plotnie në fushën e gramatikës, semantikës etj., dhe sidomos në fushën e fjalëformimit, ligjësitë e gjedheve fjalëndërtuese e fjalëformuese që i kemi ende, qoftë të panjohura ose të papërvetësuara, qoftë të paverifikuara ose edhe të pazbardhura mirë ose fare, pra t'i njohim dhe t'i zbardhim e përpunojmë faktet për sofrën tonë ligjërimore të përditshme shqiptarishte.

Ne, në hyrje të kësaj vepre kemi cekur disa mënyra fjalëformimi të të dy sistemeve, por në veçanti në kuadër të emërformimit cekëm disa

prapashtesa të specializuara për nënfusha të caktuara semantike, të cilat me urti duhet të fuqizohen institucionalisht, duke i cilësuar si rregulla të qëndrueshme emërformuese, ngase në atë mënyrë do të ndihmonin shumë që edhe makineria jonë fjalëformuese të ndihmojë ligjërimin me prodhime serike të saj nga brenda, nga brendia e nëntokës e mbitokës, të nënqiellit të gjuhës sonë. Të veprojmë ashtu, siç ndodh edhe me makineritë përkatëse në kuadër të ndërmartjeve prodhuese të veglave e pajisjeve dhe në fushën digjitale të jetës të gjuhëve të zhvilluara të botës. Lidhur me këtë, mbase nuk e teprojmë, kur ua shohim për të madhe, jo vetëm gazetarëve, poetëve, shkrimtarëve, përkthyesve të profileve të ndryshme, por edhe disa standardologëve tanë që gëzojnë emër nga pozita ose vendi i punës, pse nuk reagojnë ose, aq më keq, pse nuk i respektojnë edhe vet rregullat e një makinerie të tillë ekzistuese standardikisht, siç i cekëm ne më sipër në disa pika. Më konkretisht. Pyesim, pse nuk i vënë në zbatim rregullat e tilla të verifikuara nga jeta dhe të sanksionuara edhe normativisht, duke filluar nga më të thjeshtat, apo jo!? Mos vallë, një shkelje të tillë e bëjnë nga mosdija apo nga pakujdesia?! Cila do qoftë, *mosdija ose pakujdesia*, si lajthitje ashtu si dhe arbitrariteti, janë të palejueshme për çdo intelektual të rëndomtë e jo më për *ekpertët, me* përgatitje ose thirrje *gramatikani ose standardologu*, apo jo?! Po i rikujtoj vetëm nja dy raste të tilla fare të thjeshta, qysh me kohë të pranuar dhe të sanksionuara normativisht:

**E para**, pse në vend të trajtës së normëzuar **rilindËS** lejohet ose i lejojnë vetes që të përdoret trajta *rilindAS*, në vend **burrështetËS** (burrë i shtetit) lejohet *burrështetAS*, kur dihet se prapashtesa **-ËS** në gjuhën tonë të sotme është e *specializuar për emërtimin e njerëzve sipas veprimtarisë*, ndërsa ajo me **-AS** për emërtimin e njerëzve sipas prejardhjes a vendbanimit, dhe së këndejmi pasi, siç dihet fakti se as *rilindësi* as *burrështetësi*, funksionalisht nuk përfaqësojnë koncept *banori(!)*, por **veprimtari**, apo jo, andaj pse mos të respektohen trajtat me **-ËS** **rilindës**, **burrështetës** (*burrë i shtetit jo burrë i shtetasve!*)?

**E dyta**, pse për emninin e vendbanimeve të reja lejojnë ose i lejojnë të pagëzohen ose i pagëzojnë vetë ato në mënyrë enorme me prapashtesën **-AS** ose **-AJ**, pa pasur arsye ndonjë motiv paraprak, d.m.th. pa pasur si fakt një emër njeriu sipas prejardhjes ose sipas patronimisë me një prapashtesë të tillë. Së këndejmi, pra pse, të pagëzohet (emnohet) fshati i njohur për frutin e mollave: *Mollas ose Mollaj*, kur, siç dihet, nga struktura aktuale fjalëformuese e shqipes, për këtë destinim (emërtim vendbanimi) konkretisht për emrin e përgjithshëm **mollë molla** (nënkupto trung-pemën

me frutin), ofrohen trajta të tjera më të specifikuar (të përligjura) për emrin e oikonimit përkatës, si b.f. *fshati* ose *katundi*:

*Mollë-a, Mollet-i, Mollëz-a, Mollajë-a, Mollush-i, Mollushë-a, Mollishtë-a, Mollisht-i, Molljonë-a, Mollanë-a, Mollarë-a, Mollak/e-ja, Mollor/e-ja...*,

apo ndonjë tjetër, pa hyrë në mundësinë e ndonjë fjalemri të përbërë ose togfjalësh, si:

*Temolla, Mollëkuq/e –ja ose Mollëkuq-i, Shpatmolla, Kodërmoll/ë-a, Ndërmollajë-a, Qafëmolla ...* etj.

Sidoqoftë, cilido nga emrat e mësipërm, edhe pse të shënuar arbitraisht prej nesh, nëse parapëlqehet si oikonim, pa mëdyshje, del më i pranueshëm në sistem si **emërtim vendbanimi** se ai me prapashtesë-fundoren: –AS **Mollas(!!)** ose ai me prapashtesën–AJ **Mollaj(!!)**, ngase, siç dihet, prapashtesa –AS *del e specializuar për emërtim banori ose të njeriut sipas prejardhjes*, ndërsa ajo –AJ **për emërtim patronimi (mbiemër familjar)**. Dhe së këndejmi, meqë emërtimet e tilla *Mollas* ose *Mollaj* (që ashtu i ndeshim si emërtime vendbanimesh) po ne i shënuam të shoqëruara me dypikëçuditje në kllapa, ngase, formalisht, sipas rregullsisë fjalëformuese parësorisht këtu nuk parqiten si emra njerëzish (po vendesh), atëherë ata emra sipas rregullit pragmatik-gjuhësor (gramatikor – fjalëformues), si emra vendi, janë futur në fushë të huaj semantike arbitrarisht pa nevojë fare.

Ja sa mirë këshillohej në Komisinë Letrare Shqipe në Shkodër, më 8 maj 1917, nën pikën 2:

**“Atyne qi nuk kanë emen familjeje të posaçme (të rrjedhun: ja prej ndonji ofiqi, ja prej katundit a qytetit nga ka ardhë familja, ja prej mjeshtrisë, ja prej emnit të veçantë të ndonjenit prej të parëve të familjes), mund t’u trajtohet emni i familjes prej rrajvet të sipërshenjueme, ose tue i shtue emnit të gjyshit shtimin (sufiksin) –aj ...”** (Shih Shekulli i Komisisë Letrare Shqipe në Shkodër, Tiranë 2016, f.395).

Po kështu, një rekomandim të tillë del për sufiksin –AS, i cili parësorisht nuk duhet me dalë si emërtim vendbanimi, po *si emërtim banori ose të njeriut sipas prejardhjes*, rregull ky që e ndeshim në të gjitha burimet normëzuese të gjuhës sonë standarde, prandaj është obligim yni t’i përdorim me vend të dyja këto prapashtesa **-AJ dhe –AS**, sipas specializimit që e kanë.

Por, ç'është e vërteta, emrat oikonimikë në formën e tillë me –AJ ose –AS përkatëse, mund të jenë të përligjur vetëm nëse janë krijuar pas emërimit paraprak të njeriut sipas prejardhjes ose patronimit e më pastaj të jenë transferuar nga funksioni antroponimik (emërtim patronimi ose banori) në funksion toponimi(!). Sidoqoftë, për të kuptuar më mirë këtë që e thamë, po japim një shembull më poshtë të improvizuar prej nesh, me–**AS** ose –**AJ**, andaj fill, shih sqarimin përkatës:

***Mollasit** (Mollushasit, Qafëmollasit ...) e fshatit **Mollë** (Mollushë, Qafëmollë ...) me mbiemrin **Mollaj** (Mollushaj, Qafëmollaj ...) na gostiten me molla të llojllojshme të prodhimit vendës.*

Prandaj trajtat:

- 1) me –AS: **mollasit, mollushasit ose qafëmollasit** ...(e kështu me radhë), kuptohen si emërtime **banorësh**),
- 2) **Mollë-a, Mollushë-a ose Qafëmollë-a...** (e kështu me radhë), kuptohen si **oikonime**, emra vandbanimi);
- 3) ndërkaq, emrat me –**AJ**: **Mollajt, Mollushajt ose Qafëmollajt** ... (e kështu me radhë) kuptohen si **patronime**, emra familjarë.

Andaj vetëm në këto trajta sipas rregullit në fuqi emrat e tillë me –AS ose –AJ kanë fituar rregullsi kuptimore me u përdorë në shqipen e sotme standarde, apo jo?!

*Mirëpo, nëse **mollasit** ose **mollajt** (ose një pjesë e tyre), shpërngulen diku tjetër, mund formojnë lagje ose vendbanim me atë emër. Pra vetëm në raste të tilla kuptimisht e gjuhësisht emërtimet e tilla janë të ligjshme si vendbanime.*

Së këtëjmi, gjithsesi paraprakisht, në kushte normale, nuk duhet lejuar që zyrtarisht (analogjikisht) të formohen vendbanime me –AS ose me –AJ që vështrirësojnë apo pengojnë menjëhershëmrisht zbatimin e modelit emërformues të emërimit të njeriut, qoftë sipas banimit a prejardhjes me –**AS**, qoftë sipas patronimit, mbiemrit familjar me –**AJ**.

Nuk po vazhdojmë me shembuj të tjerë, ngase besojmë se kjo si më sipër mjafton që lexuesi i nderuar ta ketë shumë lehtë për ta kuptuar mesazhin e kësaj vepre. Me fjalë të tjera, për dikë tërheqim vërejtje e për dikë tjetër zgjojmë vemendjen që të njihet e vërteta, ngase si pasojë mosnjohjeje për shkak të mungesës së studimeve përkatëse të derisotmenë

këtë fushë ose për shkaqe pakujdesie, me veprime të tilla, duke plasuar emërtime vendbanimesh arbitrarisht me –AS ose –AJ në numër enorm, përdoruesit tanë (intelektualët me në krye disa gramatikanë besa dhe standardologë!), jo vetëm nuk kanë bërë mirë në të kaluarën e nuk do të bëjnë mirë por shumë keq, nëse, tash e mbrapa, vazhdojnë me trajta emërtime të tilla, sepse me një veprim kësisoji po e shkatërrojmë ose më mirë me thënë, po e pamundësojnë operimin teknologjik të një njësie aktive të teknologjisë gjuhësore shqiptare të prodhimit serik, pikërisht të prodhimit të vegëlpajisjeve të gjuhës shqipe në përdorim normal të disa nënfushave semantike dhe kështu po e shkatërrojmë ose po e dëmtojnë shumë konsolidimin dhe zhvillimin normal të gjuhës sonë globale, situatore, letrare, sidomos atë standarde. Gjithsesi, duke mos ia respektuar rregullat e qëndrueshme të fjalëformimit në fuqi që atavikisht i ka krijuar vetë natyra e gjuhës sonë ndër shekuj, përkatësisht duke mosshfrytëzuar agregatat gjuhësore apo mjetet e makinerisë së tillë të gatshme gjuhësore, rreth prodhimit serik fjalëformues, siç u cek më sipër, të gjithë e sidomos mësuesit dhe e intelektualët tanë, me në krye me ndonjë gramatikan ose ndonjë standardolog pa koncepte të avancuara, pavetëdijshëm, bëjnë mëkat të pafalshëm ndaj mbarëvajtjes dhe konsolidimit të gjuhës sonë standarde, apo jo?!

Sidoqoftë, po e lëmë në ndërgjegjen e përdoruesve të tillë për emërtime të reja, ndërsa për ato emërtime të vendbanimeve të formuara ose të ngulitura më përpara me –AS ose –AJ fundore tashmë të rrënjosura thellë nuk mund të fajësohet askush, por gjithsesi edhe ato nëse vjen shtegu duhen rishikuar, apo jo?!

Kjo çështje del shumë më e nëpërdukshme përveç në nënpjesën e dytë të kësaj pjese, por aq më tepër, në pjesën e dytë të kësaj vepre. Në këtë vazhdë tashti, do të pasqyrojmë sadopak teorikisht gjendjen reale jo të kënaqshme të emërtimeve të vendbanimeve: së pari në Kosovë, së dyti, në Shqipëri dhe së treti, gjithandej në Trojet shqiptare, prandaj qysh tani kërkojmë nga lexuesi i nderuar, me sa u tha më sipër, të mbajë qëndrim kritik ndaj asaj që prish dhe të miratojë atë që ndreq punë në këtë proces teknologjik gjuhësor, apo jo?!



## 1) RRETH NDËRLIDHJES SË GJENDJES HISTORIKE DHE AKTUALE TË OIKONIMIVE NË KOSOVË

**Kosova**, si term gjeografik, edhe pse thuhet se është artikulluar më vonë nga ai i **Dardanisë**, ka histori më të përkapshme bashkëkohore se Dardania. Në të vërtetë, siç konstatojnë studiuesit, Kosova si trevë konsiderohet, pjesë e zonës së hershme të **Dardanisë Ilirike**, Edhe ne, sipas studiuesve e quajtmë **Dardani Ilirike**, ngase Iliria shtrihet së paku në pjesën më të madhe të Gadishullit Ballkanik (ilirik). Ne vetëm konstatojmë atë që e kemi lexuar ose atë që kanë konstatuar të tjerët që paska dokumentacion që emri Dardani paska pasur shtrirje më të gjerë se ai i Ilirisë, sidomos drejt Mesdheut e Lindjes së Hershme. Siç dihet përmendet në veprat e Homerit, por u përmendka dhe në anale të Egjiptit. Madje u flitka për tri Dardani etj.

Sidoqoftë, për ne ka rëndësi, fjala Dardani, jo vetëm si term gjeografik i trevës sonë, por zgjon interes edhe vetë prejardhja e kësaj fjale, e cila shpjegohet me fjalën **darda** të ilirishtes, përkatësisht **dardhë-dardha** të shqipës. Ndërkaq, ndërkohë kjo fjalë Dardani (darda/në+NI) si emërtim i lashtë treve, edhe pse nuk u zhduk, pësoi pasivizim përdorimi, përkatësisht u mbulua me emërtime të tjera, sidomos në kohën tonë ato vise të Dardanisë Ilirike dalin të shtrira në tri shtete me emra të ndryshëm: Kosovë, Serbi, Maqedoni, që edhe sot mund të simbolizohen me emërtimin e tri qyteteve të lashta: Naissus (*Nishi Serbi*), *Ulpiana (Lipiani Kosovë)* dhe *Uscupe (Shkupi Maqedoni)*. Edhe pse thuhet se Dardania gjeografikisht kalonte edhe kufijtë e këtyre tri shteteve të sotme, për ne është shumë i rëndësishëm fakti që në trevën e **Dardanisë ILIRIKE** u përdor në kontinuitet e pandryshuar: *gjuha pellazgo-iliro-dardane-arbnore*, e cila del e trashëguar nga banorët e kësaj zone, madje edhe u formëzua, d.m.th., mori formë koineje, në Dardani. Kështu, si gjuhë e rinuar (koine autentike) ligjëron aktualisht gjuha shqipe, e cila, edhe sot e gjithë ditën, ruhet e kultivohet në të njëjtat treva e më gjerë. Së këtejmi, siç e arsyeton logjika ajo gjuhë pellazgo-ilire-dardane-arbnore, pikërisht që para takimit me grekët e latinët e vjetër kishte marrë fizionomi e

sforcim në sistem, pra jo vetëm në *Dardaninë e ngushtë*, por edhe në *Maqedoni, Epir, Diokle, Albani* e më gjerë, treva këto, në të cilat edhe sot gjallon, pra, si **gjuhë shqipe**. I mëshojmë logjikës se kjo gjuhë, po të mos kishte qenë e tillë me autonomi të qartë brendapërbrenda një sistemi të gjerë që në atë kohë, me struktura të veçanta të ravijëzuara, strukturat e saj nuk do të mund të qëndronin pa u shpërberë tërësisht gjatë turbulacioneve e krahurave që ka pësuar vendi e folësit e këtyre trevave, gjatë atyre periudhave të gjata disa qinda e mija vjeçare, qoftë nën administrim të Perandorisë Romake, qoftë, pastaj nën trysni të tjerëve, kur pasuan invadime apo dyndjet e barbarëve etj., fakte këto që domosdo do të kenë lënë gjurmë edhe në gjuhën e banorëve autoktonë të shpërndarë në treva të ndryshme, siç e vërtetojnë edhe historianët e gjuhës shqipe, por nuk mundën me tjetërsue atë sistemin gjuhësor autentik të kësaj gjuhe, ngase sistemisht më parë ishte e ravijëzuar thellë. Por natyrisht, po në këtë kontekst mund të kenë pësuar edhe toponimet pellazgo-ilire-(proto)shqiptare, prandaj gjurmët e tilla në kohën tonë mund të dëshifrohen më fort pjesërisht nga studiuesit që mund t'i vërejnë si fosile a gjurmë të mbetura brenda formave shumështrësore. S'ka dyshim, që edhe Kosova si dhe mbarë trojet albano-shqiptare më parë kishin edhe emërtimet e veta toponimike, por gjatë administratës në gjuhën latino-greke e të sunduesve të tjerë ato do të jenë prekur detyrimisht, madje edhe do të jenë përqaftuar edhe emërtime të reja toponimike. Nuk përjashtohet që edhe nën presionin e gjuhëve si dhe të popujve të tjerë, sidomos pas dobësimit dhe zhbërjes ose shkërmoqjes së Perandorisë Bizantine, ku pothuaj mbizotëronin elemente të ndikimit albano-helen, kanë ndodhur ndryshime. Është e vërtetë, që kur në skenë shfaqen perandoritë sllave (bullgare e serbe) ndodhën edhe ndryshime të mëdha të kufijve gjeografikë edhe të Dardanisë. Kështu edhe Kosova pothuaj me shekuj bie nën ndikimin administrimit bullgar e pastaj edhe të astij serb, të cilat si gjuhë administrative (kishtare) përdorën sllavishten. Është konstatuar që gjatë këtij administrimi në mënyrë të organizuar gjuhësisht u sllavizuan shumë toponime ilire e romake, qoftë rrënjësisht, qoftë pjesërisht, por shumica morën afikse kohësisht tashmë të përvetësuara nga sllavishtja. Ky sllavizim nuk u ndryshua as pas rënies së këtyre trojeve nën sundimin e Perandorisë Osmane. Që në fillim të sundimit osman elita intelektuale kishtare ortodokse serbe shfrytëzon rastin dhe u prezentonte dhe u sugjeronte pushtetarëve dhe regjistruerëve turq emërtimet toponimike në trajtat në gjuhën sllave. Ky fakt, sipas studiuesve, ishte keqveprimi më i madh filltar bërë kundër gjuhës dhe faktologjisë së ekzistencës së

toponimeve iliro-dardane-shqiptare dhe të vetë shqiptarëve në këto troje. Megjithatë, meqë, pa marrë parasysh si t'i quajmë feudokracinë kishtarë serbe (sllave) pasi shumica e banorëve mbeti arbanfolëse, trajtat e tilla domosdo hynë në sistemin gjuhësor të arbnorëve në trevat ku ata ishin shumicë folëse, atëherë edhe vetë ndryshimet që pasuan emrat e tillë u bënë sipas ligjeve fonetike gjuhësore dhe me këtë verifikohet e vërteta, që u tha, se masa shumicë e përdoruesve të emërtimeve të tilla të përvetësuara në trevat përkatëse gjithsesi pa mëdyshje ishte arbnore (shqiptare).

Sidoqoftë, ka fakte që tregojnë që në këtë periudhë popujt jetonin të përzier në simbioza, ndërkaq shqiptarët ishin më të përqendruar në pjesën perëndimore të ish-Dardanisë (Kosovë e Maqedoni, Zetë (Mal të zi) si dhe në Albani, Epir e më tutje nga jugu, por gjuha arbërore-shqipe kishte përhapje edhe më të gjerë. Kuptohet shqipja nuk vërtetohet se ishte gjuhë zyrtare, por pamëdyshje shërbente si gjuhë komunikimi e masës së gjerë dhe si e tillë, thuhet se ajo ishte gjuhë mbizotëruese në mbarë Siujdhesën Ilirike (Ballkanike) të atëhershme. Dhe ky zgjerim hapsinor zgjati, pak a shumë, deri në shek. XIX, kur u plandos rëndë me shfaqjen e *preporodit pravosllav* (rilindjes ortodokse ose nacionalizmit të shfrenuar sllav) nën ndikimin dhe orkestrimin e Rusisë cariste dhe jo vetëm të saj, ngase tashti, veç tjerash ortodoksët në përgjithësi (sllav e grek) nën sundimin turk të nxitur jo vetëm nga ndërsimi rus, por edhe nga qarqe europiane përveç sforcimit të së drejtës fetare e gjuhësore që e kishin që nga themelimi i Perandorisë Osmane, filluan të kërkonin edhe autonomi e pavarësi politike e shtetërore, ku përveç trojeve ku mbizotëronin fetarisht e paksa gjuhësisht, zgjeruan oreksin edhe për trojet ku mbizotëronin komuniteti shumicë shqiptar me gjuhën e tij bazë. Pikërisht për këto qëllime ndaj botës perëndimore dhe popullatës naive vendëse kryesisht muslimane (që i besonte mbrojtjes turko-osmane), tash u shfrytëzuan dhe elemeti ortodoks shqiptar bashkë me toponimet me prejardhje të dikurshme të ashtuquajtura sllave të regjistruara, para e pas invazionit turk, për të arsyetuar hegjemoninë se gjoja sipas të drejtës historike e fetare atyre serbëve u takojnë këto treva, pa marrë parasysh se kush banonte aty momentalisht e në vazhdimësi dhe çfarë gjuhe fliste. Pra, mbi bazë të atyre toponimeve dhe të fesë së dikurshme të përbashkët mbarë popullore të trashëguar kryesisht ortodokse, në njërën anë, kisha greke sipas **megaliidesë** turrej rreth trojeve shqiptare, ashtu edhe kisha serbe, në anën tjetër sipas **naçrtanjes**, me nacionalizmin serb vringëllonte shpatat dhe mprehte oreksin për trevat e Kosovës, Maqedonisë, deri edhe të Albanisë dhe më gjerë, të cilat edhe i emërtoi *Serbi e Vjetër* (Stara Srbija).

Është e vërtetë se nga një propagandë e tillë e sforcuar politikisht për qëllime ekspansioniste, Greqia e sidomos Serbia, në dy shekujt e fundit e përkrahur jo vetëm nga Rusia cariste, por edhe nga Franca dhe përgjithësisht Europa (kundërshtarë e Perandorisë Osmane), si rrjedhojë u arsyetua pushtimi i viseve shqiptare të Shqipnisë gjeografike që nga Nishi, Shkupi, Dibra deri edhe pjesë të Malësive shqiptare. Kështu shteteve të saposhkëputura nga Turqia u dhuruan toka shqiptare, si: **Malit të Zi** - pjesë të Malësisë dhe të bregdetit shqiptar, **Serbisë**—pjesë e Kosovës që nga Nishi, Vraja e Kushumlia pastaj edhe tërë Kosova, me Sanxhak e pjesë të Maqedonisë. Po ashtu edhe Greqisë vazhduan t’i dhuronin vise të reja të tëra shqiptare si Çameria etj.

Po kjo, nuk mbeti me kaq dhe pa rrjedhoja. Në të vërtetë, pushtimet më të mëdha që ndodhën gjatë LPB vazhduan me mbajtjen nën influencë Shqiprinë dhe sidomos pushtimin e plotë të Kosovës që zgjati, deri në qershor të vitit 1999, ku me luftën UÇK dhe ndihmën e NATO-s, u hoq pushtimi serb, andaj po në këtë faze frymëmarrjeje të re, nga populli, përkatësisht nga intelektualët shqiptarë menjëhëhershëmrisht u shtrua çështja e standardizimit të emërtimeve të Kosovës. Qeveria e Përkoshme e Kosovës, nuk ia la këtë punë stihisë, po formoi Komisionin kompetent shtetëror dhe si rezultat doli *Regjistri i propozimeve të oikonimeve të Kosovës* të publikuara nga **Komisioni Qendror** (2000).

Është e vërtetë se shumica prej emërtimeve përkatëse, duke qenë të pranuar dhe të përqafuara nga opinioni, sidomos nga pjesa entuziaste që sapo ndjente një frymim lirie pas Çlirimit (1999) filluan të implementoheshin, kryesisht nga “banorët lokalë”, dhe nuk qortoheshin as nga pushteti vendor dhe as nga ai qendror. Por, ç’është vërteta, edhe pse pritej sforcimi i këtij implementimi, jo vetëm nga administrata komunale e më lartë, në plan vendi dhe sidomos pas dorëzimit të Regjistrimit organeve kompetente të Qeverisë së Kosovës (2004), i cili qe shumë i mirëpritur nga qeveria e përkohshme, kryesisht shqiptare mirëpo organi ndërkombëtar mori parasysh “reagim-kërkesën e *Këshillit Nacional Serb* dhe e bëri revokimin (stopimin) e vendimeve të marra nga *Komisioni i Qendror* për “ndërrim-ndryshimin e emrave të vendbanimeve”.

Kështu, pasi Kosova ishte nën protektoratin e KB, mbi bazë të Rezoluta 1244 të KB-së, patjetër për një ndërmarrje të tillë lypsej vepruar sipas urdhër-udhëzimeve të UNMIK-ut. Madje, siç shpjegohet në burimet përkatëse, përveç UNMIK-ut, organ i KB-së edhe më vonë në bazë të Kornizës Kushtetuese të Kosovës (2001), u vazhdua një ndërhyrje e tillë,

përkatësisht edhe sipas Pakos së Ahtisarit (pako kjo që u plasua në Prishtinë, më 02.02.2007). Në të vërtetë, Ahtisari ishte faktor ndërkombëtar i autorizuar nga BE për Kosovën deri në pavarësimin e saj legjitim. Pra me *Kornizën* përkatëse për Kosovën (2001), sipas komentimit të analitikanëve, ndër të tjera u stopua çështja e ndryshimit të emërtimeve të propozuara, sidomos pas vitit 2004, kur regjistri kishte marrë formë të prerë nga Komisioni, ngase tashti organet ndërkombëtare më shumë iu përkushtuan, siç konstatojnë analitikanët, çështjes rreth të drejtave të komunitetit serb, madje, duke i dhënë këtij komuniteti (ndoshta) më tepër privilegje se që i kanë pakicat e tjera në shtete europiane si dhe vetë popullit shqiptar(!) për këtë punë.

Për rrjedhojë gjuha serbishte vazhdoi të njihej si gjuhë zyrtare shtetërore, krahas shqipes e anglishtes. Ndërkohë u bë formimi i disa komunave të reja me shumicë serbe etj. Kështu, me fjalë të tjera, u pamundësua zbatimi normal nga organet kompetente të kohës në Kosovë, andaj emërtimet e propozuara të vendbanimeve ende nuk u trajtuan në organet e larta të Kosovës dhe si pasojë nuk u lejua të implementoheshin edhe pse, sipas ndonjë interpretimi, ishin në harmoni me të drejtën që jepej me *Kornizës Kushtetuese* (2001), e cila që nga hyrja në fuqi obligonte të gjitha institucionet e Kosovës, që të zbatonin drejtpëdrejt edhe me përparësi Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut (Shih *Rregullorja* 1999/1, pika 3, për. *Kushtetuta* neni 22/1), e cila lejon ndryshimet ose përmirësimet përkatëse edhe të emërtimeve të kësaj natyre. Në të vërtetë, me këtë stopim, i cili mbase ndodhi edhe për shkak se nuk pati kush ta interpretonte si duhet të drejtën universale që kanë banorët për ndryshimin dhe zgjedhjen e emrit më të përshtatshëm të qendrës së vet të banimit, qoftë edhe si dyshor (dualizëm), emërtime paralele, u krijua një laramani edhe më e madhe se përpara në përdorim jozyrtar e zyrtar të emërtimeve në fjalë.

Sido që të ketë qenë, mbështjellimi i tillë i dualizmave që ishte i pranishëm edhe më përpara tashti u bë edhe më alarmant, sepse emërtimet e reja ende pa u rrënjosur mbeten të pezulluara, ndërkaq të vjetrat, edhe pse jo të gjitha të dëshiruara, ngase numër i konsiderueshëm i tyre nuk ishin për zemër të masës (opinionit) shumicë, patjetër lypsej rikthyer e respektuar zyrtarisht. E thamë që kishte edhe pa qartësi, siç paksa u cek edhe më parë, ngase në këtë kontekst, edhe më përpara, kishte trajta joplotësisht të stabilizuara, jo vetëm në të dyja gjuhët (serbisht e shqip), po edhe në gjuhët e kombësive si turqisht, boshnjakisht etj. Kështu bashkë me ndonjë zhgënjim tjetër për një masë, jo aq të papeshë, mbeti çështje e pazgjidhur e

oikonimformimeve të propozuara në gjuhën shqipe nga Komisioni, problem ky që shpresohej se do të rregullohej fill pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës më **17 shkurt 2007**, po që në të vërtetë ende kjo nuk ndodhi.

Ç'është e vërteta, para pakos së Ahtisarit, siç e lexuam në *faqe interneti*, përveç kërkesës së Këshillit Nacional Serb, të sipërcekur, doli një reagim nga ana e palës serbe, pikërisht lidhur me emërtimet në shqyrtim, me titull: *Ndërrimi i emërvendeve në Kosovë (Menjanje naziva mesta na Kosovu i Metohiji* (12.04.2006), me këtë përmbajtje (përkthimi ynë n. v.):

*Në Qendrën koordinuese thuhet se është fjala për një ndër shkeljet më të vrazhda të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB, ngase me një veprim të tillë është bërë goditje jo vetëm në praninë fizike të ekzistimit të popullit serb në ato treva, por edhe në historinë dhe kulturën e tij.*

*Emërtimet e qyteteve të formuara sipas proceseve historike që datojnë që nga shek. 16 e 17 janë ndryshuar me farkëtime shqipe. Kështu veç tjerash Podujevo është bërë Besijana, Istok-Burim, Kosovska Kamenica-Dardanë, Glogovac–Drenas, deri edhe emërtimi mesjetar i qytetëzës Novo Brdo është ndryshuar në Artanë! Qendra koordinuese shpjegon se normat ndërkombëtare që rregullojnë këtë materie janë shumë të qarta, lejojnë përkthime, por assesi ndryshime emërtime, sepse kjo paraqet një formë të re dhune mbi kombësinë përkatëse etnike. Përgjegjësia për një formë të tillë dhune bie mbi përfaqësuesit e administratës ndërkombëtare në Kosovë e Metohi.*

Sigurisht kjo akuzë fajsimi, për mendimin tonë, ishte e njëanshme dhe gjithsesi e paqëndrueshme, sidomos pjesa ku thuhet që:

*“kjo paraqet një formë të re dhune mbi kombësinë përkatëse etnike”* (serbe),

sepse në këtë gjykim nuk është dëgjuar fare arsyetim-përgjigjja nga pala tjetër, andaj ky fakt fiktiv do të ketë rindikuar për moszbatimin ose anashkalimin enblov të propozimeve të Komisionit Qendror, apo jo?!

Ndërkaq, më 27 shtator 2012, d.m.th. 6 vjet pas reagimit të mësipërm nga pala serbe, përkatësisht 5 vjet pas Pakos së Ahtisarit, publicisti Shkëlzen Maliqi në një artikull shkruar serbisht lidhur me këtë çështje në *masmedia shpjegon*:

*Ndryshimi i emërtimeve të vendbanimeve dhe të rrugëve në Kosovë është bërë fill pas vitit 1999 nga Komisioni Qendror, të cilin pohohet*

*se e ka formuar Qeveria e Përkohshme e Kosovës me Hashim Thaçin në krye. Ajo që është më qenësore, procesi i ndryshimeve, formalisht asnjëherë nuk është zbatuar, sepse administrata e UNMIK-ut ka refuzuar jetësimin, sidomos për vendbanimet. Për këtë, edhe pas shpalljes së Pavarsisë së Kosovës nuk është nxjerrë ligj apo akt nënligjor përkatës për rregullimin e kësaj çështjeje. Sidoqoftë, rreth emërtimit të qyteteve dhe fshatrave edhe në ligjërimin e përditshëm dhe zyrtarisht deri më sot ka **dualizëm**...por në këtë proces... pati edhe skajshmëri...*

Dhe kështu, veç tjerash, autorit jep për të kuptuar që përpara nga ish regjimi sebo-sllav ka pasur **teprime** në këtë proces, por edhe tashti në *këtë proces të riemërtimeve pas vitit 1999* (nga Komisioni) *pati gjithashtu skajshmëri.*

Për çudi, edhe pse ky sqarim i Shkëlzenit nuk është tërësisht i drejtë, nuk pati reagime plotësim-sqarime as nga Komisioni në fjalë as nga ana e organizmave të Qeveverisë së Kosovës. Për rrjedhojë vazhduan reagime të tjera nga ana serbëve që unë po e dalloj vetëm këtë të botuar më 27.03.2013:

*Shqiptarët dhe administrata e Prishtinës në Kosovë e Metohi, po përgatiten me të madhe për ndryshimin e krejt asaj që është ose çka ka ekzistuar serbe në krahinën tone jugore -Kosovë e Metohi. Në të vërtetë, tashmë shumica është realizuar, sepse pothuaj të gjitha qytetet dhe fshatrat kanë marrë emra të rinj në shqipe.*

Edhe lidhur me këto konstatime shumica plotësisht të përvetëta askush nga pala shqiptare, as nga ajo ndërkombëtare nuk pati reagues.

Sidoqoftë, siç del nga reagimet e mësipërme, personat e caktuar faktikisht ose ishin të frustruar ose nuk ishin të informuar sa duhet me realitetin sa u përket tentimeve rreth **ndryshimeve toponimike të Kosovës si dhe për vendbanimet e propozuara të stopuara**, andaj pritej të kishte reagime të tjera nga ajo anë, madje edhe më shumë të fryra politikisht. E thamë se edhe nga sqarimi ose “përgjigjja”, e Shkëlzen Maliqit, i cili nuk përjashtonte edhe *teprime të skajshme*, për mendimin tone, nuk është bërë sqarimi i plotë rreth punës së Komisionit, ngase, në procesin pas vitit 1999, si reaguesit ashtu edhe nga përgjigjedhënesi nuk i dinin ose nuk i kishin parasysh këto fakt-arsye:

E para, Komisioni nuk i ka ndërruar, përkatësisht as që i ka prekur fare trajtat në gjuhën serbe, ato si përpara edhe gjatë periudhës pas Çlirimit të Kosovës (1999), si dhe pas shpalljes së Pavarsisë së Republikës së

Kosovës (2007) kanë tagër që të gjitha zyrtarisht të përdoren të pandryshuara si përpara në atë gjuhë.

E dyta, Komisioni ka përpunuar ose është përpjekur t'i stabilizojë vetëm trajtat në gjuhën shqipe me *synim standardizimi*, ngase ato edhe më përpara në krahasim me tekstin në serbishte paraqiteshin si dualizma të zyrtarizuar, por tash (pas Çlirimit) imponoheshin jo si problem në raportin serbisht–shqip, por më tepër ose vetëm *si problem brendapërbrenda shqipes*, pra si problem: **shqip/shqip**, sepse sipas opinionit aktualisht trajtat e mëparshme nuk kënaqnin, pasi ato ishin të paqarta ose preknin si reflekse me dhembje nga gjuha e pushtuesit etj., prandaj me të drejtë u kërkua nga Qeveria që Komisioni të trajtojë këtë çështje dhe të intervenojë, duke propozuar zgjidhje sa më të drejta me qëllim standardizimi.

E treta, ç'është e vërteta, mbase zyrtarët e UNMIKU-t dhe tash të EULEKS-it nuk e njihnin problematikën rreth kësaj çështjeje, sepse edhe më përpara (para Çlirimit 1999) pothuaj asnjë emërtim vendbanimi në raportin serbisht/shqip zyrtarisht nuk ishte identik sa i përket shkrim-shqiptimit në administratën zyrtare ekzistuese dygjuhësore, sepse serbishtja në përdorim zyrtar ka dy sisteme shkronjash: azbukën *cirilice* dhe alfabetin *latinice*, ndërkaq shqipja ka vetëm sistemin shkronjor *latin*, por përveç veçorive të tjera shqipja ka tinguj që nuk i ka serbishtja as latinishtja dhe përveç kësaj shqipja e ka si tipar të veçantë dallues ndryshimin e emrit sipas trajtës së shquarsinë dhe të pashquarsisë, andaj nga kjo pikëpamje për të kënaqur të drejtën e administrates dygjuhësore, ndryshimet në raportin shqip-serbisht, ishin, siç janë edhe sot, të pashmangshme. Po japim vetëm një shembull emërtimi i qytezës: *Zubin Potok* edhe pse, i papërkthyer (*Prroni Dhëmb/ç-!*), i shënuar me alfabetin latin, në shqip del i njëfjalëzuar *Zubinpotoke-u*, ndërkaq të gjithë shembujt e tjerë dalin edhe më me shumë ndryshime. S' domend, se ndryshimet brendapërbrenda shqipes, aspak, në asnjë mënyrë, nuk i prekin emërtimet serbe.

E katërta, është e vërtetë, se në Jugosllavinë e pas L2B ky problem i hapur, kishte njëfarë arsyetim-zgjidhjeje për dysorët në raport me të drejtën rreth barabarësisë së gjuhëve të kombeve e të kombësive. Me sa dime, që nga viti 1969 edhe më përpara, por që nga viti 1971 dualizmat e emërvendeve sipas gjuhëve përkatëse, si për kombet e kombësitë, si në tërë Europën e botën e civilizuar, ishin të lejuara ligjërisht. Të kujtojmë vetëm emrin e qytetit të Zvicrës që në shqipe shënohet Cyrih: *gjerm, Zurich, it. Zurigo, rus. Cjurih, serb. Cirih* ose kryeqytetin e Austrisë që në shqipe shënohet: *Vjenë-a, angl. Wien, tur, Beç, hung. Bees, serb. Beč* etj. Së



këtejmi, në raportin shqip/serbisht, siç u cek më sipër, pothuajse asnjë emër-  
emërtim vendbanimi nuk ishte i njëjtë, qoftë shkrimisht, qoftë shqiptimisht,  
dhe kjo nuk ishte as nuk është kurrfarë shkeljeje e të drejtës gjuhësore të  
asnjërës gjuhë, apo jo?!

E pesta, është e vërtetë, se disa emërtime tejet të dhunshme serbe, të  
mbetura nga Jugosllavia e *Kralevinës SKS*, që kishin përmbajtje me natyrë  
të ndryshme (irituese asimiluese etj.) për palën shqiptare, fill pas L2B  
dysoret ishin të lejuara, si p.sh: **Skënderaj (Srbica), Ferizaj (Uroševac),  
Hani i Elezit (General Janković)** etj., prandaj veprimi i Komisionit në këtë  
drejtim kishte mbështetje edhe nga praktika implementuese ashtu edhe nga  
ana ligjore e së drejtës universale europiane, apo jo?!

E gjashta, së këtejmi, puna e Komisionit ishte në funksion të  
mbarësisë shkencore e kombëtare për palën shqiptare e në përgjithësi, madje  
synimi ishte human dhe në raport me palën tjetër, të kombit e shtetit serb,  
sepse duke paraqitur të vërtetën e mohuar historikisht, si të thuash, pa fajin e  
popullit serb, por me fajin e politikës hegjemoniste që e konservonte dhe e  
plasonte shteti dhe kisha serbe, veprimi dyshorëve në gjuhën shqipe tërhiqte  
vërejtje që kjo çështje të normalizohej (rishikohej) edhe në serbishte, me  
qëllim që mos të bëhen edhe mëtej shkelje tejet të vrazhda kundër popullit  
shqiptar dhe gjuhës së tij.

E shtata, si përforcim rreth pikës së mësipërme po shtojmë faktin, se  
politika e tillë hegjemoniste serbe në të kaluarën dhe sidomos në periudhën  
gjatë dy shekujve të fundit lidhur me toponiminë e viseve shqiptare ishte  
bërë strategji kolonialiste shtypëse ndaj shqiptarëve, sidomos në trojet e  
Dardanisë e viseve të tjera të hershme arbanase e më gjerë, të quajtur sipas  
tyre Serbi e Vjetër (Stara Srbija), vetëm pse identifikoheshin ndonjë element  
emërtimi me prejardhje sllave, ku gjithsesi synimi kryesor ishte kolonizimi i  
truallit të Kosovës dhe i viseve të tjera të populluara kryesisht ose tërësisht  
nga shqiptarët, të cilët, edhe pse autoktonë, sipas tyre duhej shtypur, *milom  
ili silom*, qoftë me asimilim, shkombëtarizim, qoftë me shpërngulje e dëbim,  
apo me zhdukje, asgjësim. Dihet që kjo strategji shtetërore serbe (duke  
mohuar deri bullgarizimin toponimeve përkatëse emërtuar para serbve) e  
ndërsyer sidomos nga kisha ortodokse (pravosllave) e tyre, vazhdoi me  
shekuj dhe për fat të keq vazhdon pandërprerë, deri në ditët e sotme, me të  
njëjtin avaz.

E teta, andaj edhe propozimet e ndyshimit duale lidhur me qytetet  
Podujevë – Besianë, Istok – Burim, Kosovska Kamenica - Dardanë,  
Glogovac - Drenas, si dhe Novo Brdo – Artanë dhe propozime të tjera,

sigurisht kishin arsye e motive që i di Komisioni dhe banorët përkatës që i kishin propozuar, përkatësisht i kishin pranuar si emërtime të reja, pa i prishur komoditetin emërtimit të mëparshëm në gjuhën zyrtare (serbe), por kjo nuk do të thotë që këto dhe propozime të tjera në kuadër të gjuhën shqipe, me qëllim persosshmërie nuk mund të ridiskutohen cilësisht e përmbajtësisht në organizmat përkatës studimorë, shoqërorë e shtetërorë.

Sidoqoftë, përveç arsyeve nga pikat e mësipërme që nuk janë shterruese, ka edhe argumenta të tjerë në mbështetje të punës së Komisionit në fjalë, prova këto që disa prej tyre lexuesi ka mundësi t'i vërtetojë edhe gjatë analizës së më poshtme që do të vazhdojë po në këtë punim.

Prandaj, mesa u tha pak më sipër, kemi plotësisht të drejtë të gjykojmë që stopimi i punës së Komisionit Qendror për Emërtimet që gjoja ishte kundër kulturës e historisë së popullit serb, ose kundër ndonjë Rezolute etj, ishte krejtësisht e pabazë. Së këtejmi, moszbatimi i propozimeve ose stopim edhe nëqoftë i përkohshëm, ne, në parim nuk e quajmë të drejtë. Është tjetër gjë, nëse ka kërkesa si jona, që emërtimet e tilla duhet të rishikohen patjetër së paku edhe njëherë, duke respektuar ligjshmërinë e brendshme fjalëformuese të shqipes, sepse, lidhur me këtë logjika na bind që si të stabilizohet gjendja, kjo lëndë patjetër do të rikthehet në rishqyrtim edhe më serioz dhe pa kurrfarë euforie e teprie. Kështu rishikimi duhet të bëhet jo vetëm nëpër komuna, por edhe në institucionet tona përkatëse shkencore shtetërore e ndërshtetërore dhe pastaj të dalë për miratim para Parlamentit të shtetit sovran Republikës së Kosovës.

E thamë që tema e tillë, mbeti aktuale dhe e pazgjidhur, andaj ftojme, përveç atyre shqiptarë e të huaj edhe studiuesit e vërtetë serbologë ta japin kontributin e tyre në këtë drejtim, ngase qëllimi i shkencës është që e vërteta të dalë në dritë si e tillë, jo gënjeshtat ose ekzagjerimet e çastit, apo jo?!

Së këtejmi, mirëpresim konsultime edhe me homologët në Shqipëri e Maqedoni duke nëpërkaluar shqyrtimin e lëndës edhe në ekspertizë akademike.

Kështu në rrethana më të volitshme do të bëhet zbatimi ose zgjidhja sipas interesit të përgjithshëm kombëtar. Gjithsesi çështja rreth formëzimit dhe fjalëformimit të emërtimeve të vendbanimeve në gjuhën shqipe duhet të jetë objekt trajtimi edhe nga studiues të tjerë më eminentë nga të gjitha trevat shqiptare e më gjerë, sidomos edhe nga Tirana, sepse edhe në Shqipëri si në Kosovë e gjetiu imponohet si shumë aktuale pikërisht çështja

e ndryshimit, rikthimit, modifikimit ose të vërtetësimit të emërimit të vendbanimeve të reja, por edhe atyre ekzistuese, apo jo?!

Së këtejmi, duhet të kuptohet gjithandej sikurse edhe këndeje se çështja e emërtimeve të vendbanimeve në gjuhën shqipe është e hapur dhe zgjidhja e kësaj teme i takon mbarë shqiptarisë, por në veçanti institucioneve, organeve e organizmave të shtetit të njohur mbiqindvjeçar shqiptar, Shqiprisë.

## 2) GJENDJA SHOQËRORE-POLITIKE E AKTUALE OIKONIMIKE NË SHQIPRI

Prof. Begzad Baliu në veprën *Gjendja e toponimive shqiptare në Ballkan (2004)*, veç tjerash pasi përmend faktin se në Shqipëri në periudhën e Pavarësisë, përkundër vështirësive rreth konsolidimit të shtetit që kishin, u bë përpjekje në shqipërimin e toponimisë dhe për këtë përmend hartën e prof. Ahmet Gashit 1935, mirëpo siç do të argumentohet edhe prej nesh atbotë pikërisht gjatë veprimit të Komisionit Shqiptar në Shkodër (1916-1918), është inicuar paksa ky problem, ndërsa në fundvitet e '30-a, nga Shteti i Mbretnisë shqiptare, ishte vepruar në mënyrë edhe më të organizuar rreth kësaj teme.

Kështu siç mësojmë nga materialet e Komisionit Letrar Shqiptar në Shkodër, më 02.07.1917, është pranuar për shqyrtim letër-kërkesa e Komandës austro-hungareze:

*Mbi ndërrimin e emnavet të katundevet të Grykës së Madhe e të Grykës së Vogël (Dibër)...*

ndërsa më 11.07.1917 nga ana Komisionit:

*Vendohet me iu përgjegjë letrës... mbi emnat e katundevet të Grykës së Vogël e të Grykës së Madhe, tue i diftue ata qi s'janë shqip e tue thënë e tue qenë se edhe të tjerët s'kanë një tingllim shqip etimologjin e tyne nuk mund t'ua diktojmë, pra të ndiqet dishiri i katundevet e t'u kthehen emnat kutundevet ashtu si dishirojnë këta.*  
(T. Osmani., *Shekulli i KLSH në Shkodër*, Tiranë, 2016, f. 4003.)

Pra Komisioni zyrtar (KLSH) jep pëlqimin për ndryshimin e emërtimeve të vendbanimeve nga gjuha e huaj (zakonisht sllave) në atë shqipe sipas propozimit të vetë banorëve, por ne, ç'është e vërteta, nuk dimë se si është vepruar më pastaj konkretisht në atë kohë lufte. Në të vërtetë, e dimë se edhe në 20 vite më vonë, më 1937, me dekretin e Mbretit Zog ishte formuar Këshilli përkatës dhe më 1938, nga organet më të larta të shtetit ishte miratuar *Lista e emrave të përshtatshëm*, pothuaj i të gjitha vendbanimeve në Shqipëri dhe pikërisht për Qarkun e Dibrës ishin ndërruar 80% të

emërtimeve të papërshtatshme të vendbanimeve, të cilat fatkeqësisht mbeten vetëm si përpjekje, ngase pa kaluar një vit nga ky miratim, Shqipëria u pushtua nga Italia fashiste. Jo vetëm kjo, por zgjon interes fakti tjetër se edhe në kohën Mbretërisë Italo-Shqiptare 1939 -1943, pati përpjekje për shqipërimin e toponimeve të Viseve të Lirueve Shqiptare, por edhe kjo mbeti vetëm si përpjekje, megjithatë, mund të themi, se krejt kjo punë nuk ka kaluar krejtësisht pa gjurmë, gjë që dëshmon edhe përpjekja e të tjerëve në vazhdimësi, deri edhe puna jonë me këtë vepër.

Edhe pas L2B, 1944/45 e në vijim deri në fillimvitet e '90-a, kur në Shqipëri mbretëroi regjimi komunist, pati ndryshime emërtimesh të vendbanimeve, por jo aq të asaj natyre, rreth ndryshimit të emërtimeve sllave, siç ishin dy-tri përpjekjet e mëparshme të sapocekura. Edhe pse në atë drejtim nuk u vazhdua me atë entuziazëm në raportin e ndryshimeve sllavisht/shqip, megjithatë nuk mbetën pa u bërë ndryshime të disa vendbanimeve (toponimeve), por kryesisht ato u bënë mbi bazë të parimeve klasore, politike e fetare të shtetit komunist, por jo në përmasa aq të gjera. Fare pak shembuj u prekën rreth shqipërimit të emërtimeve me prejardhje sllave. Ndërkaq pas rënies së atij sistemi, tash 20 e sa vite, në këtë kohë tranzicioni, siç konstaton profesori i nderuar Begzad Baliu (2004), nuk është bërë pothuaj asgjë në këtë drejtim, përkundrazi ka rikthime të emrave shqip në gjuhën e pakicave.

Në të vërtetë, mesa kemi vërejtur ne, edhe në Shqipëri në kohë të fundit, sipas publikimeve që ndeshëm në masmediat përkatëse, lidhur me këtë temë, ka mjaft fjalë edhe shqetësuese edhe premtuese rreth këtyre ndryshimeve.

Madje, pikërisht rreth kësaj teme janë implikuar, përveç personave të caktuar, jo aq të njohur nga fusha e kulturës toponimike, edhe persona të njohur të klasës shoqërore politike e kulturo-arsimore që ishin ose janë në organet a organizmat e pushtetit dhe të shtetit shqiptar. Së këtejmi këtë gjendje aktuale, duke shfrytëzuar *faqe-interneti*, do të përpiqemi që këtë realitet ta paraqitim objektivisht më poshtë, në disa pika:

**Së pari**, po fillojmë me faktin se z. **Bamir Topi**, i cili, deri sa ishte, në postin e Presidentit të RP të Shqipërisë, gjatë një vizite në Korçë, i bie në sy njëfarë mosdisipline në përdorimin e emërtimeve të vendbanimeve, të cilat, siç vëren ai, po kthehen në trajtat e vjetra sllave dhe ky këshillon, jo vetëm të mos kthehen, por edhe ato të trashëguarat të zëvendësohen me emërtime toponimesh tona të hershme ilire apo të tjera që mund të

sugjerohen dhe nga institucionet përkatëse që merren me ruajtjen e traditave të kulturës sonë gjuhësore shqiptare. Kështu, siç duam ta kuptojmë ne, ky duke shpjeguar se një kompetence e tillë u takon pikë së pari organeve të pushtetit vendor, kërkon që problematikat e tilla të zgjidhen sa më shpejt. Madje, ky në listën e emërtimeve pati thënë që duhet të rikthehen ndoshta edhe emërtimet e viteteve të '90-a, siç janë emrat: *Sheqeras, Mollas* etj.

**Së dyti**, prof. dr. **Sali Berisha**, edhe ky deri sa ishte, në detyrën e kryeministrit të RSH-së shkon edhe më tej. Në një mbledhje të qeverisë, pikërisht për çështje emërtimesh ose riemërtimesh të vendbanimeve që shprehur mjaft bombastikisht:

*Të bëhet një ndërrim masiv i emërtimeve në mbarë vendin të mbetura që kur ushtritë sllave pushtonin territoret shqiptare.*

Përkatësisht ato:

*Do të duhet që në një të ardhme të afërt të nisin e të ambientohen me toponime tërësisht shqiptare... si p.sh.: Banimet e fshatrave apo të krahinave të ndryshme shqiptare që deri tani thirren me emërtime serbe.*

**Së treti**, lidhur me këtë nismë reagon prof. **Shezai Rrokaj**, i cili mbështet mendimin e kryeministrit të atëhershëm, Sali Berisha, por shton se zgjidhja shumë e mirë do të ishte që këto vendbanime të merren me referendum popullor. Pra, me të drejtë gjykon ai, që duhet të merret edhe mendimi i qytetarëve përkatës dhe njëherazi më në fund zgjidhja ose *zëvendësimi* duhet bërë **me ekspertiza akademike**.

**Së katërti**, gjithashtu edhe pushtetari i atëhershëm dhe i tashëm **Illir Meta**, aktualisht kryetar i Kuvendit të Shqipërisë, ka deklaruar:

*Të korrigjohen emërtimet sllave të vendbanimeve si dhe ato komuniste...*

Në të vërtetë, kjo e thënë gati-gati me gjysmë zëri, nuk dimë se për cilët ka menduar më tepër që duhen ndryshuar: nga sllavishtja në shqipe apo prej shqipes në sllavishte. Por një gjë e kemi të qartë se pas ndryshimit të emrit të komunës Liqenas në Pustec (Shretinë!) dhe të 7 fshatrave të kësaj komune që kanë rimarrë emra maqedonisht, z. Iir Meta, si politikan në pozitë këtë ndërmarrje e miraton me këto fjalë:

*Ky është një akt tolerance, mirëkuptimi dhe respekti ndaj pakicës...*

Nuk dimë në raste të tilla a vazhdojnë të ruhetsi dualizma, ku mbetet në përdorim edhe emri zyrtar paralel shqip që ne nuk na dukej se ishte *komunist (!)* siç ishte b.f. edhe emri i një fshati tjetër *Lajthizë*, i cili i rikthyer në *Leska*, ruan po të njëjtin kuptim, apo jo?

**Së pesti**, ndërkohë në portalin “*Alben*” lexuam një artikull mjaft cilësor shkruar nga **Valon Kurteshi**, ku veç tjerash thekson se prania e emërvendeve sllave, greke dhe turke në territorin nën sovranitetin politik të Shqipërisë është një çështje themelore që prek në palcën kombëtare, pra në identitet, andaj propozimi i kryeministrit Sali Berisha për shqiptarëzimin e emërtimeve të emërvendeve në shkallë vendi i duket i drejtë, i natyrshëm dhe plotësisht europian, sepse:

**asnjë popull i botës, pas çlirimit të tij, nuk toleron vazhdimësinë e emërtimeve të emërvendeve të ish okupatorëve të vet,**

ngase me një tolerim të tillë:

*okupatorët u thonë shqiptarëve se jemi prezent brenda jush, si shpirt nga e kaluara, andaj: Pyetja është si duhet vepruar dhe sa më shpejt?*

Nuk dimë kjo pyetje pati farë jehonë atëbotë, apo jo?

**Së gjashti**, po në këtë kontekst përfshihet edhe politikani historian, ish ministri i punëve të jashtme të RP të Shqipërisë, **Paskal Milo**, i cili këtë çështje e politizon shumë keqas, ngase këtë nismë të kryeministrit, Sali Berisha, e konsideron si tentativë që gjoja, me fjalët e tilla, **Sali Berisha po u kthyeka në diktaturë si Enver Hoxha**, ngase, kinse vetëm në kohën e sundimit të E. Hoxhës qenkan bërë disa ndryshime të emërtimeve të vendbanimeve (!), të cilat, me sa dihet, vërtet janë bërë, por më tepër mbi bazë klasore partiake, por mbase nuk kanë munguar raste edhe të kësaj natyre me interes kombëtar-shtetëror, apo jo?

**Së shtati**, edhe publicisti **Ardian Vehbiu** në një artikull me titull *Donkishotët e toponimeve* (02.08.2011), reagon shumë ashpër e paksa me nënçmim kundër Lëvizjes qytetare mbarëkombëtare: **Aleanca Kuqezi**, ngase nuk dimë sa u pëgjigjet atributi *donkishotë* pjesëtarëve ose kryesisë së këtij asociacioni politik, vetëm pse paska shpallur nismën për *shqiptarëzimin e toponimeve të huaja*, por që ende pa i nxjerr shpatat t’u fringëllojnë në erë, mori “epitetin” donkishtesk?! Kështu sipas tij një nismë

e tillë, që nuk është pa *precedent* sikurse nismat e tjera të mëparshme *do të mbetet në nivelin e kuriozitetit politiko-gjuhësor...*, sepse:

*Toponimet sa kohë që ekzistojnë dhe përdoren janë fjalë në gjuhën shqipe.*

Konstatim ky që në njëfarë mënyre nuk qortohet, por megjithatë, bën mirë autori që na e mëson të vërtetën, që një emërvendi, përkatësisht:

*Një toponim mund të ndryshohet nëse nuk e kryen funksionin e vet, kur përdoruesi nuk e pëlqen, sepse u shoqërohet me diçka të papëlqyeshme, të papërshtatshme dhe të pakëndshme... po kjo është punë për gjuhëtarët e historianë që t'i shpjegojnë(!)...*

Sidoqoftë, po sipas tij:

Nisma për të ndryshuar emrat e vendeve “*me prejradhje të huaj*”, ka efekt anësor të padëshiruar: *mbjelljen e vetëdijes se trojet ku banojmë nuk qenkan tamam “shqip”, prandaj dashkan shqiptarizuar.*

Meqë Ardianin e vlerësoj shumë edhe si studiues, do të dëshironim që mos të kishte nxituar, me hedhjen e ndonjë konstatimi pa e peshuar e sqaruar mirë, ngase ka gjëra në atë artikull edhe kundërthënëse që nuk do t’ia lejonte vetes si studiues. Diçka nga ajo që nuk po ia themi ne, ia kanë cekur shumë me vend tre reaguesit ndaj artikullit të tij, sepse:

Së pari, nuk është donkishotizëm vetëm pse inicohet çështja problemore e shqipërimit të disa oikonimeve të imponuara të papërshtatshme sllave në trojet shqiptare të pandryshuara nga lashtësia, të mbetura, qoftë si shprehi përulësie, qoftë nga naiviteti apo nga moszotësia e të parëve tanë që s’kishin “*shkrim e këndim*”, por që sot *nuk pëlqehen*, sepse *shoqërohen me diçka të pakëndshme...*, apo jo?!

Së dyti, sa i përket asaj *ndjenje* që përmendet nga z. Adrian, atë nuk e *zgjon ngjyra kuqezi*, përkundrazi. Madje, nuk dimë pse disa intelektualë tanë për këtë dukuri, këshillojnë që masa, politika, t’i mbajë vesh e sy mbyllur, pikërisht atëherë kur të tjerët në vazhdimësi arbitrarisht po na zhurmojnë kryet me ata *emra-tapi(!)*, dhe gjithsesi po na i hapin sytë e ndërgjegjës së përgjumur me gishtat e vrazhdë të makiavelizmit të tyre, deri sa disa njerëzve tanë në trojet e veta aktuale e historike, po ua shkërmoqin vetëdijen atdhetare me proçka, apo jo?! Presim që z. Ardian me shokë të ndihmojnë pikërisht zgjidhjen ose zbutjen e kësaj problematike, pasi mbase nuk e ditka se jo pak emra të tillë, veç pasojave të tjera, si *Sericë, Seran, Gomnaselë* ! etj. kuptimisht janë tejet banalë, janë “me marre”.



**Së teti**, ndeshim në masmedia dhe reagues të tjerë, që nuk kanë vetëm fjalë politikanësh e publicistësh, sa me thënë, por shprehin dëshirë të singertë atdhedashurie. Natyrisht, dashtë e pa dashtë, ne po përmendim kërkesën e zotit **Rexhep Torta** (te *Zhurnal*, 20.06.2012.), i cili me rastin e 100 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë (1912 -2012) veç tjerash theksonte:

*Të paktën (në këtë përvjetor) të krijojmë mundësitë që të fillojë procesi i zëvendësimit të toponimeve serbo-sllave me emërtime shqiptare, në të kundërtën, do t'u mbetemi borxh për jetë të jetëve qindra mija trimave..., do të mbetet për ne njollë e zezë në këtë jubile madhështor kombëtar...*

Dhe i mëshon së vërtetës që të gjitha vendet tona fqinje kanë bërë një punë të tillë më herët, madje duke vepruar edhe në dëm të visarit kulturo-historik shqiptar, kurse Shqipëria ka ngecur në këtë drejtim. Është e vërtetë, siç konstaton autori, vendasit (shqiptarët) këtë barrë e kanë bartur mbi kurriz dhe e kanë vuajtur shpirtërisht që nga mesjeta kur Car Dushani me Kanonizmën e tij me popat urdhëroi shënimin e emërvendeve, duke bërë dinakërisht sllavizimin e toponimeve iliro-shqipe dhe si të tilla nuk u ndryshuan me shekuj, andaj këto fakte i bëjnë serbët të kompleksuar, të cilëve po ua “shtojnë oreksin të punojnë në mënyrë sistematike dhe agresive për propagandimin e pranisë së tyre në këto troje” ...dhe kështu po shtojmë ne: të mobilizohen për ta ripushtuar e robëruar jo vetëm Kosovën, por të vazhdojnë më serbez t'i mbajnë të robëruara, viset siç është: Sanxhaku, Kosova Lindore, madje me synim edhe disa vise të Maqedonisë e të Malit të Zi, e së andejmi ta robërojnë edhe tërë Shqipërinë Veriore e më shumë, përshtirë edhe Elbasanin, sepse sipas tyre ato emërtime sllave nga mesjeta në Shqipëri janë **tapi** që i japin Serbisë të drejtën historike, mbi tërë territorin e Shqipërisë së sotme, vise këto që i quajnë Serbi e Vjetër (Stara Srbija).

Është interesant, siç del nga burimet serbe se vetëm ata e kanë këtë të drejtë historike, jo bullgarët me maqedonë as malazezët, sepse ata bullgarë-maqedonët e sotëm, qenkan serbë të bullgarizuar, përkatësisht serbë të maqedonizuar, ashtu si edhe malazezët të cilët janë *serbë të pastër të vërtetë*, por u denacionalizuan, më fort për interesa karrieriste(!) etj. Madje, në burimet e caktuara serbe mbahet ndezur gjithnjë propaganda se edhe një shumicë shqiptarësh ishin serbë, por u albanizuan, qoftë duke u islamizuar, qoftë duke u katolikëzuar. Ndërkaq, të gjithë ortodoksët shqiptarë e një pjesë e grekëve si dhe pak muslimanë e ndoshta edhe familje katolike në ndërrijen e tyre anembanë Shqipërisë: *Stara Serbisë*(!) ruajnë me nostalgji prejardhjen e tyre serbe (!?), andaj të tillët si fakt edhe sot janë

pengesë e fortë për mosndryshimin ose ruajtjen së paku të emërtimeve të vendbanimeve sllave të të parëve të tyre, *që ishin vërtetë serbë të pastër(!!!)*.

**Së nënti**, që është e gjallë ajo që thamë më sipër nga shumica e opinionit të manipuluar serb, po e përmend faktin që kur një shkrimtar – politikan, atëherë në postin e Ministrit të punëve të jashtme të Serbojugosllavisë (Vuk Drashković), ia kujtoi **Ismail Kadaresë** të vërtetën se Shqipëria është e vërshuar nga toponime në gjuhën sllave (serbe), I. Kadare nuk paska pasur përgjigje tjetër, pos shprehjes: **Ato duhen studiuar(!)**.

Pra, ato nga shqiptarët duhet vetëm të studiohen, të konstatohen, ndërkaq, a duhen ndryshuar, apo jo, mbetet çështje e hapur vetëm *për të frustruarit* : historianë e gjuhëtarë, përkatësisht për studiuesit, apo jo?!

**Së dhjeti**, ndeshëm një artikull në internet (më 01.12.2015), me titull *Të ndryshohen toponimet joshqiptare të Shqipërisë* ku autori që nuk i mësuam emrin, prek këtë temë duke u shprehur:

*Ka edhe Shqiptarë të tjerë që duan të bëjnë një gjë të tillë (të ndryshojnë toponimet joshqiptare), sepse ca toponime që nuk mund të shqiten me një Kujtesë Shqiptare dhe për këtë shënon emrat e dy qyteteve Berat dhe Elbasan, emërtimi i parë vjen nga bullgarishtja (beligrad –qyteti i bardhë) dhe i dyti nga arabishtja El Basan (ai që shtyp).*

Pastaj shton konstatimin tjetër që ka qindra fshatra që kanë prapashtesën sllave me –**ova** Grahova, Libohova etj. si dhe me shtesën –**ec**: si Lipovec, Rahovec etj.

Në fund, për çka e përgëzojmë, propozon që prapashtesa fundore sllave të zëvendësohet me prapashtesën ilire –**ONA (-i/onë-a!)**, siç janë shembujt: **Apollona, Didiona, Paliona, Panona, Denastion, Enhalon/a** (Struga).

Edhe pse duket se autori i ka dhënë tepër hapët, siç thuhet me një zekosë do të kosisë tërë barnishtat e livadhit, sepse përmend emrat e dy qyteteve historike që as Bullgaria, as Arabia nuk shprehin pretendime pushtuese, sikurse bëjnë serbët, por pajtohemi pjesërisht me mendimin e tij dhe të një reaguesi tjetër, i cili lidhur me këtë propozim, thotë që kjo që ka shtruar autori, për ne i paidentifikuar:

*Nuk është ide e keqe, vetëm se kërkon tepër punë dhe prandaj mund të jetë diçka utopi.*

Madje shton, me të drejtë, se në këto ndryshime duhet përfshirë edhe emërtimet greke dhe solidarizohet me propozuesin me këto fjalë:

*Le të jetë ky mendimi yt gurë i parë në themelin e një ndërtese të fortë e të shëndoshë që duam ta ngremë.*

Dhe përfundon, duke theksuar të vërtetën, e cila gjithnjë thumbon dhe të gjithë studiueve e shtetarëve ua bën rëndë:

*Më vjen rëndë që disa qytete dhe sidomos fshatra, kanë emërtime sllave të mbetura që nga pushtimet bullgare dhe serbe të mesjetës. Kjo gjë, u jep shkas sidomos serbëve të kenë pretendime mbi territorin tonë deri në Shkumbin.*

Përveç këtyre që përmendëm ka edhe reagues të tjerë që gjykojnë pak ters, siç e thotë njëri prej tyre:

*Për emërtimet e reja historianë e gjuhëtarë mund ose duhet të gjejnë emrat e vjetër dhe të përshtaten ose të hedhen ide të ndryshme për emërtimet dhe të bëhet një zgjedhje nga populli edhe me referendum po qe nevoja.*

Ose një tjetër:

*Me të vërtetë, ka ardhur koha që vendbanimet t'i emërtojnë banuesit e tyre,*

natyrisht (po shtojmë ne), banuesit, nëse kanë vetëdije të lartë shqiptarie.

**Së njëmbëdhjeti**, po e përmend, në vijim edhe një rast tejet të veçantë që zgjon edhe interes të veçantë. E kemi fjalën për reaguesin **Fatos Daci**, historian publicist, i cili në punimin me mbititull *Shqipëria duhet të flasë shqip* (albaniapress, 24.08.2011) bën të njohur opinionin me një material, për ne shumë interesant që ne e konsideruam dokument shumë të rëndësishëm, të cilin dhe do ta trajtojmë veçantisht, nën titullin **Lista e ndryshimit të disa emërtimeve të papërshtatshme të toponimeve të Shqipërisë (1938)** nga Qeveria e Ahmet Zogut, ku autori shpreh dhe disa mendime shumë me vlerë dhe me interes për të kuptuar e rikuptuar aktualitetin e sotëm lidhur me këtë çështje në Shqipëri:

E para, edhe pse ne s' duam të besojmë që në Shqipëri, fatkeqësisht ende *emërvendet e Lindjes, Verilindjes* dhe të *Veriut*, siç konstaton zoti Daci, në numër të konsiderueshëm, *janë me prejardhje sllavo-maqedonase-bullgare*, të *Veriperëndimit* me prejardhje malazeze, pjesa bregdetare perëndimore me prejardhje romake, të *Jugut e Juglindjes* me prejardhje greke dhe lidhur me këtë studiuesit shqiptarë flenë rehat – rehat mbi këtë

shtratim, edhe pse mbase vetë nuk dyshojnë në autoktoninë shqiptare, apo jo?!

E dyta, të gjithë pushtuesit, siç konstaton autori, *me po aq zell sa punuan për të përpunuar mendjet e shqiptarëve, veç tjerash (me fe, ideologji, kuzhinë, etnokulturë, zakone, gjuhë) si element më të rëndësishmin konsideruan emrat e vendeve në gjuhën e tyre*, të cilat në planin afatgjatë ishin për ta *piramida të vërteta territoriale* në brendësi të vendit tonë.

E treta, të gjithë (duhet) t'i shohim rrjedhojat se këto piramida (*banka komerciale mashtruese*) të vëna prej tyre në kohë pushtimesh shovinistët po i përdorin sot, si alibi *në luftën e ethshme të tyre për të ndryshuar raportet etnike në Shqipëri*, me synimin e vetëm për ta kthyer vendin tonë, ashtu si nuk është, **në një shtet multi-etnik**.

E katërta, të gjitha ato shtete e kombe që janë patriotë të mëdhenj për vendin e tyre, janë në ballë të zhvillimit, mirëqenies e të politikës botërore, andaj i mëshon autori:

*Mendojmë se ka ardhur koha, që kjo punë shkencore rreth ndryshimit të emërve me origjinë të huaj e nisur në kohën e mbretërisë së Zogut të zyrtarizohet(!) nga qeveria e sotme **shqiptare**.*

E pesta, kjo jo vetëm të zyrtarizohet e të lihet në letër, sa me thënë, por të zbatohet me rreptësi, fjala e tij:

**Është kohë e fundit, që kjo çështje duhet cilësuar si një problem shumë serioz dhe shqetësues për kombin tonë.**

Ne lidhur me këtë shtrojmë dy pyetje:

e para, meqë ky artikull-punim qenka publikuar në vitin 2011, pse nuk përmendet bile si reference nga reaguesit e tjerë përkatës si kontribut dhe

e dyta, **pati kush vesh me ndi e me kuptue, qoftë nga politikologët, qoftë nga standardologët tanë gjuhësorë (në Shqipëri e më gjerë) këtë shqetësim dhe me marrë masa të duhura, për të angazhuar mjekë-studiuues standardologë për ta shpëtuar e shëruar njëhëherë e përgjithmonë, së paku Nënë e Kombit (Shqipërinë e Pavarur) nga shqiptarofobët, *virusët* e përkrahësve të piramidave gangrenëse, nga të cilët nuk po i ndahen dot së brejturi të kujtesës historike të të rinjve tanë, ashtu siç bënë edhe në të kaluarën, në vazhdimësi që nga mesjeta, dhe s'ka kush të marrë masa parandalimi lidhur me këtë, apo jo?!?!**

Sidoqoftë, ne pajtohemi me autorin dhe me të tjerët, por kemi bindjen që kjo barrë e imponuar, mjerisht ka mbetur *siproblem shumë serioz dhe shqetësues për kombin tonë*, jo vetëm nga virusët e huaj e nga virusët e brendshëm, por edhe nga moszotësia pushtetarëve dhe e studiuesve tanë që ende jetojnë nën hijen e gërmadhave të piramidave të tilla dhe kemi bindjen që këto gërmadha, këtë barrë me virusë të gjallë, mund ta heqin nga kurrizi i kombit, në radhë të parë vetëm punonjësit që vërtet me shpirt e zemër e duan shkencën dhe shqiptarinë, duke vepruar bashkërisht me vullnet pa hile dhe duke hedhur tejprtej ndërkambsat e politikave ditore në shërbim të të huajve dhe duke mobilizuar e kërkuar përgjegjësi nga kuadri profesional në detyrë, me detyrim që në institucionet tona më të larta ndër të tjera duhet të kuptojnë që:

E para, është detyrë e ngutshme me përgjegjësi që profesionalisht këtë çështje ta vënë në tryezën e shqyrtimit. Shqyrtimi me sinqeritet mund të nxjerrë të vërtetën se të gjitha trajtat, madje edhe prapashtesat që deri tash janë konsideruar sllave, mbase mund të dalë sheshit e vërteta se ato më tepër janë përvetësime të përbashkëta sllave-shqipe ose kanë origjinë nga ndonjë gjuhë tjetër, mbase edhe ilire (thrakase), apo jo?

E dyta, me kuadro të sinqertë atdhetarë duhet filluar menjëherë shërimi me bllokimin e veprimit të virusëve të tillë vendës e të huaj që të mos e gangrenizojnë edhe më shtatin e gjuhës dhe të vetëdijes së popullit tonë me metoda paksa të kamufluara makiaveliste me naçërtanie e megaliaide.

E treta, duhet vlerësuar në mënyrë kritike materiali përkatës i Tiranës, i viteve 1938, 1941 dhe 2002, si dhe ai i Prishtinës 2004, por duke grumbulluar e trajtuar edhe material tjetër shtesë nga viset e tjera shqiptare.

E katërta, nuk duhet zyrtarizuar e zbatuar symbyllazi çdo propozim ngado që të ketë ardhur, por duhet të shqyrtohen dhe të vlerësohen rigorozisht të gjitha propozimet, por edhe e sugjerimet dhënë nga ekspertët e të gjitha profileve të fushave përkatëse (që sot nuk na mungojnë), ngase tashti kanë ndryshuar raportet edhe sa i përket praktikës formëzuese e fjalëformuese të emrave ose të emërtimeve toponimike etj., por lidhur me këtë lypset punë e organizim i duhur shoqëror institucional shtetëror e ndërshtetëror.

E pesta, lidhur me këtë problematikë, këtu nuk po ndalem më gjatë, pasi këto materiale, d.m.th. përmbajtja e 6 regjistrave (listave) të emërtimeve të emërvendeve të trojeve shqiptare, do t'i kemi paksa në analizë përmbajtësore e formëzuese tash në nëpjesën e dytë, ndërkaq nga

pikëpamja e fjalëformuese rastet e veçanta do të trajtohen më në hollësi në pjesën e dytë të kësaj vepre.

Së këtejmi, nuk mund ta kuptojmë, pse në Shqipëri, siç e konstatojnë studiuesit përkatës as në sistemin komunist, as tash mbi 20 vjet të lirisë që duket paksa si me qenë e përqafuar jo aq me dashje edhe shtetërisht (pluralizëm demokraci, tranzicion, aq më tepër shqiptari), andaj edhe raporti i ndryshimeve krahasuese i toponimisë sllavisht/shqip ose gjuhë e huaj/shqip e emërve, nuk po gjen trajtim të duhur serioz shkencor dhe si rrjedhojë as zgjidhja institucionale nuk duket as në horizont.

### **3) PROBLEME OIKONIMIKE GJITHANDEJ TROJEVE TË TJERA SHQIPTARE**

Pas njohjes me realitetin aktual rreth emërtimeve të vendbanimeve në Kosovë dhe në Shqipëri që u konstatua si gjendje jo e mirë, punohet pa vigjilencë, vetinisativë e atdhetarizëm të duhur, edhe pse vendet udhëhiqen nga qeveritë *sovrane* shqiptare, e pamë të arsyeshme që të shohim paksa si qëndron ky realitet dhe në viset e tjera shqiptare, edhe pse dihet se gjendja në ato vise gjithsesi del edhe më e rëndë, edhe më e komplikuar.

Sidoqoftë, në rrethana kohore, kur flitet për demokraci, për administratën dygjuhësore të proklamuar, për të drejta e barabarta të kombëve e kombësive, të etnive etj., në botën demokratike, imponohet nevoja të mendohet rreth mundësisë për ndryshime në të mirë edhe në të gjitha trojet shqiptare e më gjerë, pra edhe në Maqedoni, Kosovën Lindore, Malin e Zi, të shpresohet deri edhe në Greqi(!), pa harruar edhe Arbëreshët (Itali), ndoshta edhe arnautët në Turqi, Siri e Egjipt, ku shihet njëfarë ringjalljeje shqiptarie nën hije, gjithandej e kudo në mërgata e diaspora shqiptare nëpër Europë, Amerikë, Azi e Australi, Skandinavi, e kudo. Është e vërtetë, se gjurmë të komunitetit tonë, po identifikohen edhe në ato vende, që nuk ishin të njohura më parë, deri edhe në Amerikën Latine, Zelandën e Re etj. Një veprim i tillë njohjeje është me rëndësi të njihet, të regjistrohet, të ndihmohet që mos të zhduket, madje edhe të ndihmohet gjallimi i tij. Nuk përjashtohet të dalë në shesh e të shfrytëzohet edhe ndonjë fosil a risim apo mënyrë formëzimi toponimo-etniko-patrimonik që mund të jetë bartur nëpër shekuj dhe të ketë mbetur ende gjallues. Aktualisht, përveç objekteve nderi nëpër botë, kushtuar b.f. emrit Albania, pastaj Skënderbeut, Nanës Tereze e ndonjë tjetër, lypset evidencuar e nxitur edhe ndonjë emërtim lokaliteti, vendshërbese, hoteli, gjellëtore-pitetore, emërtim firmash të biznesmenëve të suksesshëm shqiptarë që nuk janë të rrallë, anembanë vendeve të ndryshme të botës.

Edhe pse siç del nga konstatimet tona në nëntitullin e mësipërm për mosfunksionimin si duhet të institucioneve ekzistuese kulturo-shkencore

(akademike) të përhershme në shtetet tona Shqipëri e Kosovë, jashtë ndikimeve të fryra momentale politike-pushtetore, faji bie edhe në vetë kuadrot e punësuar në ato institucione, të cilët duhet të kenë programe të avancuara strategjike me interes kombëtar që i shërbejnë interesit të përgjithshëm shoqëror kombëtar e ndërkombëtar, siç është edhe zgjidhja e problematikës që po trajtohet këtu.

Sidoqoftë, ç'është e vërteta, çështje e ruajtjes ose e emërimit të vendbanimeve në gjuhën shqipe nuk është temë e patrajtuar në gjuhën tonë, e kemi të freskët trajtimin që i kushtoi prof. Begzad Baliu kësaj teme në veprën që e cekëm më parë, por jemi të vetëdijshëm që krejt lënda problemore nga ai punim dhe nga punime të tjera nuk ka mundësi ta përthekohet as pjesërisht në këtë vështrim tonin, por ndonjë vënerim të kësaj natyre do të përpiqem ta inkorporojmë së paku si ndajngjijtje lënde në harmoni me lëndën e trajtuar ose të grumbulluar më parë.

Sido që të jetë, po t'i hedhim një sy të kaluarës, mesa jemi të njohur, sa here që në trojet shqiptare është stabilizuar ose ka pasur ndonjë hije stabilizimi nga ndonjë autoritet ose qeveri vendëse, janë shprehur synime për ndreqjen e padrejtësive rreth toponimeve ekzistuese të vendbanimeve. Kështu edhe pse nuk kemi hasur tema që rrahin ekskluzivisht këtë çështje jemi të sigurt se përpjekje për emërtime të reja të vendbanimeve ka pasur edhe në periudhën 1912-1920, duke filluar nga Qeveria e Ismail Qemalit e të tjerëve, në kohën e Komisionit Letrare të Shkodrës (gjatë administrimit austrohungarez), dhe në veçanti në periudhën e ekzistimit të shtetit të brishtë shqiptar në Periudhën e Pavarësë 1924-1939, sidomos gjatë regjimit të Mbretit Zog, ku si dihet në fundvitet e '30-a u propozuan emërtime të reja për tërë territorin brenda Shqipërisë londineze. Madje edhe gjatë gjallimit të shkurtër të Mbretërisë italo-shqiptare 1939-1943, pati nismë të mbarë për ndryshimin e disa emërtimeve sllave në viset shqiptare që iu aneksuan kësaj mbretërie. Gjithsesi edhe në periudhën gjatë viteve 1945-1992 gjatë qeverisjes komuniste, e dimë se pati ndryshime të vendbanimeve, por më tepër të natyrës politike sesa patriotiko-historike, prandaj mund të thuhet se deri në vitin 1992, kur ra ai sistem, nuk pati punë të organizuar për ndryshimin e emërtimeve të tilla në raportin shqip/sllavisht ose shqip/greqisht, por kjo atmosferë mjerisht u pasua edhe gjatë periudhës vijuese të sistemit politik pluralist. Është e vërtetë, pra, që për një temë të tillë mund të thuhet se është folur, por nuk është bërë kurrfarë trajtimi serioz institucional. edhe pse nuk përjashtohen reagime individësh, Sidoqoftë, në anën tjetër gëzon fakte që edhe në viset e mbetura jashtë Shqipërisë e



Kosovës varësisht nga situatat që imponohen nga shqiptarët janë dëgjuar (Ulqin, Tetovë) dhe po dëgjohej zëra për rishikimin ose për standardizimin e toponimeve të vendbanimeve të trevave shqiptare në gjuhën e tyre, si në Mal të Zi, Serbi (Kosovë Lindore), madje më me forcë ligjore në Maqedoni. Ka reagime për mos-harrimin e emrave toponimikë edhe në Greqi. Në të vërtetë, nuk është çështja që të mos-harrohen emërtimet e vendbanimeve të asaj popullate që është dëbuar si muslimane ose që edhe që brezat e rinj të vendasve arvanitas mos ta harrojnë prejardhjen e tyre arbno-re, por aq më tepër për të paraqitur të vërtetën shkencore historike para botës, para opinionit shkencor vendës, evropian e botëror, apo jo?

Lidhur me këtë, edhe pse kam lexuar e konsultuar punime shumë cilësore e serioze për viset shqiptare në Greqi, Maqedoni, Serbi, Sanxhak (Pazari i Ri), Preshevë e Mal të Zi, këtu po mjaftohem me konstatimet e dy studuesve dhe intelektualëve tanë të njohur nga Maqedonia: Mustafa Ibrahimimi dhe Avzi Mustafa.

Studiuesi **Mustafa Ibrahimimi** në veprën *Gjuhë dhe kulturë*, Shkup, 2016, në punimin *Emërtimet shumëgjuhësore të toponimeve*, veç tjerash pasi arsyeton që në botë e sidomos në Europë si dhe kudo, por edhe në Ballkan nën kushte të ndryshme historike pothuaj është dukuri normale që toponimet e caktuara të kenë dy ose më shumë emërtime, kuptohet nga gjuhë të ndryshme, si p.sh.: qyteti **Gjeneva** e Zvicrës, në gjermanisht quhet Genf, në italisht Xhineva dhe nuk paraqet kurrfarë problemi, ashtu si edhe qyteti *Shkupi*, i cili në trajtën latino-dardane shënohej *Scupis*, trajtë kjo të cilës i ka mbetur me afër trajta e shqipes *Shkup-i*, ngase në greqishte quhet: *Skopoi*, turqisht *Uskup* (*Yskyp*), maq. *Skopje*, serb *Skoplje* dhe së këtejmi autori kërkon që kjo e drejtë dyshore e ndryshimit të emrave sipas gjuhëve përkatëse, jo të stopohet, por duhet të shtrihet edhe në shqipërimin e trajtave të vendbanimeve në të gjitha trojet shqiptare, ngase trajtat sllave e greke në trojet shqiptare:

*janë imponuar me anë të masave represive dhe pushtuese...*

gjë që shqiptari përherë e ka dëshiruar të çlirohet edhe nga kjo barrë, mirëpo:

*E keqja është se jo gjithnjë dhe jo me kohë është reaguar në përmirësimin ose në emërtimin e drejtë...*

Andaj po ky veprim duhet shtrirë në të gjitha trojet shqiptare dhe se:

*ky duhet të jetë edhe synimi ynë për riemërtimin e toponimeve e në veçanti të oikonimeve...*

dhe përfundon duke ia parë për të madhe pushtetit në Shqipëri pse nuk ka vepruar dhe nuk po vepron si duhet si shtetet fqinje, në këtë drejtim:

*Nëse për pushtetin shqiptar kjo është vështirë të realizohet, le të shikojë fqinjët maqedos e mos të flasim për ata grekë.... (Aty f.27)*

dhe së fundi ngulmon:

***Nëse lufta është vazhdim i politikës me mjete të tjera, atëherë politika gjuhësore paraqet formën më të butë të luftës midia dy popujve.***

Sidoqoftë edhe për ne këto nuk janë mendime të shprehura pa vend, kurse ...*luftën midis dy popujve...*, do të doja ta shpreh edhe *më butë*, ngase kërkohet që lufta për ndryshimin e toponimeve të papërshtatshme shqipe të imponuara nga zaptuesit, duhet të vazhdojë, por kuptohet me masa demokratike, me luftën politike gjuhësore, me shkencë, me forcën e arsyes të bindjes e të së drejtës.

Po ashtu e quajmë shumë me vend edhe propozimin e profesorit të nderuar, **Avzi Mustafa**, i cili duke trajtuar toponimet e Rekës së Epërme (zsh, 21.11.2015), veç tjerash thekson:

**...Duket se ka ardhur koha që toponimet të gjejnë zgjidhje të drejtë që ato të përdoren ashtu siç i emërtojnë banorët e vendit dhe të standardizohen...**

Lexuesi mund ta dijë se, ndër të tjera, këtu është fjala për Rekën e Epërme (Maqedoni), atë trevë, ku mbizotëron popullata ortodokse shqiptare, të cilës me dhunë nga administrata serbe-maqedone dhe naiviteti i vëllezërve muslimanë shqiptarë fqinj, i është mohuar kombësia shqiptare pothuaj tash 100 e sa vite.

Së fundi, flas përgjithësisht, ne kuptojmë që në çdo vend mund të ndodhin ndryshime a ndërime politike pushtetore, por në ato raste mbesin të paprekura institucionet hulumtuese shkencore, të cilat duhet t'i fuqizojë dhe t'i shfrytëzojë secila qeveri, madje edhe të kërkojë përgjegjësi realizimi, andaj nuk kuptojmë pse kjo nuk po ndodh me organet a institucionet shkencore-kulturore (akademike) kombëtare, të cilat duhet të kenë programe afatgjata strategjike jashtë ndikimeve momentale të ndërimeve politike, andaj pyesim pse organizmat e tillë nuk i kryejnë ose nuk angazhohen me i krye punët me interes kombëtar e ndërkombëtar që janë të obliguara jo vetëm zyrtarisht,. Por edhe ndërgjegjësisht t'i kryejnë mbi bazë vullnetare, siç po bëjmë edhe ne në vazhdë të *Komisionit për standardizimin e emërvendeve të Kosovës 1999-2004*.

Pra, po kësaj natyre serioze me interes kombëtar e ndërkombëtar i takon edhe çështja e vlerësimit të qëndrueshmërisë së emërtimeve toponimike në trojet shqiptare: Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e më gjerë, apo jo? Nëse deri para 20 vitesh nuk e kanë pasur mundësi ta hartojnë pa drojë një program pune të miratuar bashkërisht, tash dhjetë vitet e fundit duhet ta kenë tashmë, të miratuar një program-platformë të tillë, mundësi kjo që nuk e pengon kush, përkundrazi. Gjithsesi në këtë program strategjik do të përfshihej doemos edhe çështja e qëndrueshmërisë fjalëformuese të emërtimeve toponimike (vendbanimeve), madje duke e kuptuar edhe si obligim e përgjegjësi morale, përveç asaj shoqërore - shtetërore edhe obligim me interes kombëtar e ndërkombëtar, apo jo?!

### **Përmbyllje rreth nënpjesës së parë ose meditimi: si duhet vepruar?**

Pasi nxorëm konstatime rreth aktualitetit të tillë nga Kosova, ku u fol së pari, për punën e organizuar lavdëruese të *Komisionit Qendror për standardizimin e emërtimeve të vendbanimeve*, në periudhën 1999-2002/2004 dhe për arsyet pse çështja e tillë mbeti e pazgjidhur, së dyti, gjithashtu u dha njëfarë pasqyrimi si qëndron kjo çështje aktualisht në Shqipëri, ku vetëm flitet, por nuk ndërmirret asgjë e organizuar në mënyrë institucionale për rishikimin dhe zgjidhjen e problemeve të kësaj fushe dhe së treti, u përmend gjendja edhe më e pafavorshme gjithandej në trevat shqiptare në shtete të tjera, ku problemet terminologjike vendëse vlerësohen në gjendje edhe më të vështitrë se në dy shtetet shqiptare të njohura ndërkombëtarisht: Kosovë e Shqipëri, atëherë për të ndihmuar sadopak zbutjen ose për të futur sadopak nën kontroll këtë problematikë mendojmë që urgjentisht duhet ndërmarrë këto veprime:

E para, kërkohet nga organet shtetërore dhe intelektuale akademike që pas grumbullimit të materialit, këtë problematikë me interes kombëtar e ndërkombëtar ta vlerësojnë e trajtojnë me seriozitetin e duhur.

E dyta, gjithsesi duke mos e hequr këtë temë nga tryeza e studiuesve të intitucioneve të larta shtetërore, nga të cilët duhet kërkuar lidhur me këtë përgjegjësi morale e materiale.

E treta, shkencërisht e politikisht menjëherë duhet filluar me bllokimin e veprimit të virusëve të tillë vendës e të huaj përçmues që të mos

e gangrenizojnë edhe më shtatin e gjuhës dhe të popullit tonë me manipulime albanofobe se gjoja qenia shqiptare për shkak të formimit të tij historik të paqartë(!) qenka e paaftë për t'u ballafaquar për të zgjidhur çështjet e tilla me interes kombëtar e ndërkombëtar.

Së katërti, pa humbur kohë duhet vlerësuar materialin përkatës të Tiranës: 1917, 1938, 1941, 2002 dhe atë të Prishtinës 2004, por duke grumbulluar edhe material tjetër, por pa u dhënë vizë implementimi symbyllazi.

Së pesti, me fjalë të tjera, nuk duhet përçmuar çdo nismë rrugëzgjdhjeje, por njëherazi nuk duhet zyrtarizuar e zbatuar, pa pëlqimin e ekspertëve, çdo propozim ngado që të ketë ardhur, qoftë edhe nga bashkësitë lokale. Gjithsesi duhet të shqyrtohen dhe të vlerësohen rigorozisht të gjitha propozimet e sugjerimet e arritura, madje nga ekspertët e të gjitha profileve të fushave përkatëse (që sot nuk na mungojnë), ngase tashti kanë ndryshuar raportet edhe sa i përket praktikës formëzuese e fjalëformuese të emrave ose të emërtimeve toponimike etj., por lidhur me këtë lypset punë e organizim i duhur shoqëror-shtetëror.

Së gjashti, lidhur me këtë problematikë, këtu nuk po ndalemi më gjatë, pasi në vijim kemi materiale konkrete nga gjashtë (6) regjistra (lista) të emërtimeve të emërvendeve të trojeve shqiptare, dhe si rrjedhojë do të kemi mundësi ta perceptojmë realien si nga ana përmbajtësore dhe ajo formëzuese dhe të përcaktojmë qëndrueshmërinë e tyre, dhe pastaj të marrim pjesë aktive në analizën që pason më në hollësi në pjesën e dytë të kësaj vepre.

Së këtejmi, kërkojmë nga lexuesit dhe studiuesit e nderuar që materialin në vijim ta shikojmë së bashku, me vemendje të shtuar, ngase shumica e këtij materiali për këtë qëllim del për here të parë para opinionit të gjerë, siç janë dokumentat e mëposhtëm, të cilët meritojnë të trajtohen më me nge, veç e veç, por edhe së bashku, sigurisht më gjerësisht e më në hollësi e thellësi, seç do të përpiqemi të bëjmë ne në vijim të kësaj nënpjesë dhe do ta vijojmë, në pjesën e dytë. po atë trajtim me theks të veçantat nga pikëpamja fjalëformuese.

**Nënpjesa e dytë**  
**KONSULTIM OSE NJOHJE ME PËRMBAJTJEN E DISA**  
**BURIMEVE**  
**OIKONIMIKE LIDHUR ME TROJET SHQIPTARE**

Nga sa e thamë e nuk e thamë duhet kuptuar e vërteta se të gjitha emërtimet e propozuara dhe të tjera me qasje potenciale mund të konsiderohen, sot për sot, që mbesin në fazën e diskutimeve sa i përket formëzimit e fjalëformimit të tyre ose zëvendësimit të tyre dhe si të tilla pritet që nga studiuesit të trajtohen menjëherë, ndërkaq në situata më të qeta, siç u tha më sipër, të rimerren në shqyrtim edhe nga organet e institucionet shoqërore shtetërore, andaj ne po bëjmë vetëm përpjekje parapërgatitëse, që kuadri përkatës ta ketë më lehtë të ballfaqohet me seriozitetin që e pret rreth trajtimit të tyre. Pra këtu, në këtë nënpjesë do të njohim lexuesin me përmbajtjen e disa dokument-materialeve, më konkretisht me lëndën e 6 regjistrave (listave), ku dalin të shënuar emërtimet e vendbanimeve të trevave shqiptare gjithandej e këndeje, siç janë:

1. Lista e ndryshimit të disa vendbanimeve të papërshtatshme të Shqipnisë... 1938.
2. Lista e toponimeve sllave në territoret e lirueme shqiptare me shqipërimet e propozuara (1942).
3. Fjalor i emrave gjeografikë të Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2002.
4. Regjistri i standardizuar i emërvendeve të Kosovës (2004), Prishtinë, 2005.
5. Regjistri: Okruzi, gradovi (opštine) i sela Kosova i Metohije (Internet, 13.08.2015 – botim i Beogradit) dhe.
6. Regjistri: Rajonet, komunat (selitë) dhe fshatrat e Kosovës (portali Gjigand, 14.10.2015) – botim i Prishtinës.

Në fund pas analizës me të dhëna pëcjellëse (edhe pse joshteruese) për secilin dokument do të japim përmbylljen e dy nënpjesëve, përkatësisht të pjesës së parë të këtij punimi.

# (I) NGA LISTA PËR NDRYSHIMIN E DISA EMËRTIMEVE TË VENDBANIMEVE TË PAPËRSHTATSHME TË SHQIPNISË 1938

(Publikuar nga z. Fatos Daci, më 24 gusht 2011 në *Albaniapress.com*)

## Hy r j e

Edhe pse në këtë publikim thuhet se “Ahmet Zogu, i *shqipëroi për herë të parë e të vetme të gjithë emërvendet për të gjithë Shqipërinë*, del e vërteta se jo të gjitha ishin përfshirë në atë shqipërim, por kjo nuk e mohon aspak atë ndërmarrje aq të madhe me interes të lartë historik e aktual kombëtar e ndërkombëtar nga ana e asaj Qeverie. Është tjetër gjë fakti sa ishin pjekur kushtet dhe si qëndronin rrethanat shoqërore politike të brendshme e të jashtme që një ndërmarrje e tillë kaq e rëndësishme të dalë e sukseshme.

Sidoqoftë, siç na bëhet e ditur në atë artikull që në pranverë të vitit 1937 Parlamenti Shqiptar paska shprehur shqetësim për emërvendet me prejardhje nga gjuhët dhe ndikimet gjuhësore të pushtuesve të imponuara në Shqipëri, andaj për zgjidhjen e kësaj çështjeje, Mbreti i Shqiptarëve, Zogu I, me dekretin e datës 05.05.1937, lëshon autorizimin që të formohet organizma e pushtetit për të zëvendësuar me emra të përshtatshëm disa *prej qyteteve, katundeve, lagjeve, lumenjve të Mbretërisë*, të këthejë *sa është e mundur ata emra origjinalë, të cilët kanë humbur në kohën e shkeljeve dhe okupacioneve të huaja, duke marrë emra të imponuar nga të huajt*. Në këtë drejtim ndërkohë, ishte formuar **Komisioni Qendror** me në krye **z. Ajet Libohova**, por njëherazi edhe në të gjitha prefekturat, nënprefekturat, përkatësisht në çdo komunë apo bashki ishin ngritur komisione përkatëse vendore. Pas 14 muajsh pune intensive komisionet shtetërore, vendore të komunave, të bashkive dhe të prefekturave të vendit pasi kishin kryer studimet e duhura, vendimet e marra përkatëse ia paraqesin Komisionit

Qendror. Ndërsa Komisioni Qendror, në gusht të vitit 1938 ia paraqet Komisionit të posaçëm të qeverisë për miratim.

Kështu miratimi përfundimtar i kësaj Liste u bë në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, në këtë përbërje:

- 1) **Faik Shatku**, zv-kryeministër e ministër i Drejtësisë (që drejtoi edhe mbledhjen),
- 2) **Ekrem Libohova**, ministër i Jashtëm,
- 3) **Musa Juka**, ministër i Brendshëm,
- 4) **Kolë Thaçi**-ministër i Financave,
- 5) **Abdurrahman Dibra**-ministër i Arsimit dhe
- 6) **Rrok Gera**-ministër i Ekonomisë.

Në përfundim të shqyrtimit, ku u arrit miratimi i formës së prerë, Këshilli i Ministrave me një vendim të posaçëm vendosi që **emrat e katundeve, qyteteve, lagjeve e lumenjve të ndryshohen...** Zbatimi të bëhej, sipas **Listës** që pasonte.

Në të vërtetë, autori i kësaj paraqitjeje, nuk e publikon tërë tekstin, por, bën mirë që përparësi u jep prefekturave në kufi me vend-shtetet e sotme fqinje, sepse, siç thekson ai:

*pretendimet shoviniste sllavo-maqedono-bullgare janë ngritur në sistem nëpërmjet shoqatave dhe të partive të tyre antishqiptare të ngritura mbi baza të pretendimeve etnike "të pakicave" të tyre kombëtare.*

Publikuesi i këtij materiali, pra, bën mirë që tërheq vërejtjen sesi shtetet fqinje aktualisht, duke shfrytëzuar politikën ditore të shteteve *demokratike(!)* më me përvojë se Shqipëria, pikërisht nëpërmjet shoqatave përkatëse të minoriteteve, duke shfrytëzuar plogështinë ose shkrihtërinë e organeve shtetërore në detyrë të shtetit shqiptar, të nivelit lokal deri në atë më të lartë shtetëror, po ndërhyjnë jo për të mirë, në shoqërinë e padjallëzuar, politikisht ende adoleshente, të masës shqiptare dhe të vetë pushtet-shtetit në Shqipëri.

Mirëpo, nuk dimë pse autori nuk i përmend edhe pretendimet serbe e malazeze, që për ne në Kosovë e përgjithësisht në Veri janë edhe shumë të njohura, madje edhe më gangrenëse se ato që përmenden aty, të cilët (serbët) janë duke e shtrirë ndikimin jo vetëm në Veri, por po e shtrijnë edhe deri edhe në Jug të Shqipërisë (Fier).



Sidoqoftë, duke kërkuar nga lexuesi të vë re përqindjen e ndryshimeve dhe krahasimin e shembujve konkretë të mëparshëm dhe të propozuar, po japim tërë listën e emrave të publikuar nga autori:

## **1.Prefektura e Dibrës:**

Nga 153 fshatra (pa nënprefekturën e Burrelit) nuk ndryshuan emrat e 34 fshatrave, por ndryshuan 119 emrat ose 80 % e të gjithë fshatrave, si më poshtë:

*Bellovë-Bardhushe, Cerjan-Kërrabaj, Çetush-Bregasi, Dohoshisht-Hysenaj, Grevë-Grindushë, Ilnicë-Kreshtë, Melan-Miellaj, Pejke-Bishtore, Pjeçë-Kurrizaj, Pollozhan-Kuqelinë, Rabdishti-Lugina, Rrashnapojë-Rrafshinë, Staravec-Shëngjergj, Tomin-Dëshmoraj, Trepça-Vjeshta, Ushtelenza-Begata, Zagradi-Qytetëza, Zimuri-Dimnori, Hoteshi-Tejdrini, Lishani-Ledhaj, Luznia-Petritaj, Allajbegi-Draguoni, Bllata e Epërme-Burimi i Epër, Bllata e Poshtme-Burimi i Poshtëm, Çernena-Zheshkorja, Dovolani-Lëndina, Grazhdani-Moisiu, Kërçisht i Epër-Gur i Epër, Kërçisht i Poshtëm-Gur i Poshtëm, Kllobçisht-Lisi i Madh, Kovashica-Farkëtorja, Oboku-Bujkaj, Pesjaka-Rranxa, Pocesti-Ujmira, Popinara-Pjeshkorja, Vojnika-Brrakaj, Bahutaj-Mallasi, Bulaçi-Kulaçi, Bllaçaj-Shalësi, Borovjani-Përpkjeksi, Brest i Epër-Brezi i Epër, Brest i Poshtëm-Brez i Poshtëm, Berzhdani-Karahasanaj, Deshati-Gjylaj, Kishavec-Kishaj, Limjani-Lymaj, Sohodolli-Thatina, Shimshani-Shëmria, Vranjt-Pishaj, Kalla-Kallëza, Sllatina-Floriri, Shumbati-Dushkaj, Venishti-Vëneshta, Ratkaj-Rrathaj, Selishta-Shpatinaj, Bulqiza-Bylmetaj, Dushaj-Njomëza, Vajkal-Vrapkali, Krajka-Krekëza, Lubaleshi-Pjellorja, Safraçani-Tryezgjana, Strikçani-Thatushi, Zerqani-Arta, Boçeva-Kuqlashi, Çereneci-Sukthi, Gjorica e Epër-Bukuroshi i Epër, Gjorica e Poshtme-Bukuroshi i Poshtëm, Homeshi-Skënderaj, Kovashica-Guramira, Mazhica-Kështenjasi, Okshatina-Miroshi, Stushaj-Dushkaja, Topojani-Ura, Borova-Brinjasi, Gjinoveci-Gjinaj, Klenja-Theknore, Sebishti-Trimaj, Strebleva-Shllinëza, Trebisht Çelep-Treanas i Mesëm, Trebisht i Epër-Treanas i Epër, Trebisht Muçinë-Treanas i Poshtëm, Zabzun-Ushtima, Lejçani-Gurakuqi, Lladomerica-Djegas, Okshatuni-Hoxhëmuglli, Ostren i Madh- Plakasi i Madh, Ostren i Vogël-Plakasi i Vogël, Radoveshi-Ranga, Smolliku-Shkoza,*

*Tërbaçi-Thakas, Tuçepi-Kumbulla, Golevishti-Shpatllasi, Izvira-Bushaj, Sepetova-Gropaj, Mireshti-Miraj etj.*

## **2. Prefektura e Kosovës (Kukësit) -Nënfrefektura e Qendrës**

Për nënprefekturën e Qendrës nga 28 fshatra gjithsej, nuk ndryshuan 9, por ndryshuan emrat e 19 fshatrave (rreth 70 % e tyre), si më poshtë:

*Brruti-Thupra, Gostili-Gushtaj, Myçi-Rrasa e Lekës, Dobruca-Ujmira, Peraj-Bardhoshaj, Perollaj-Lugina, Vranishta-Malishta, Zaharishta-Trojëza, Nikoliqi-Nikolaj.*

## **3. Prefektura e Lumës**

Në prefekturën e Lumës, nga 76 fshatra gjithsej, nuk ndryshuan 29 dhe ndryshuan emrat e 47 fshatrave (ose 60 % e tyre), si më poshtë:

*Bardhoc-Bardhoshi, Bela-Bardhaj, Borja-Lulëzimi, Brekinja-Bregina, Cernaleva-Pyllishta, Kollovozi-Kodraj, Kasharishta-Kepaj, Novosej-Katund i Ri, Oreshka-Rreshka, Orgjosta-Burimaj, Shishtavec-Fushaj, Zapodi-Pikllimaj, Bushtrica-Ranishte, Kllasi-Kalisi, Ploshtani-Plotaj, Radomira-Bukuroshi.*

-Për nënprefekturën e Malësisë së Gjakovës, nga 145 fshatra gjithsej nuk ndërruan emër 41 dhe i ndërruan emrat 104 fshatrave (70 % e tyre), si më poshtë:

*Myhejani-Mehaj, Vladi-Fusha, Leniçi-Lendishti, Zharka-Brezdaja, Bratoshnica-Vllaznija, Koçanaj-Kallishta, Tepla-Pla, Peraj-Bjeshka, Raja-Shkambi, Dushaj-Dushkaja, Dojane-Kuvendi, Resuj-Rreth Uji, Viliq-Leka i Zi, Radogosh-Dëshira, Visoç-Sukthi, Vatoc Vidric-Fangu i Vogël etj.etj.*

## **4) Prefektura e Elbasanit:**

Nga 180 fshatra, nuk ndryshuan emrat e tyre 92 fshatra dhe i ndryshuan 88 fshatra, pra, rreth 50 % e tyre, si më poshtë:

*Bradasheshi-Bregsheshi, Godoleshi-Pemëza, Jagodina-Oriza, Jateshi-Trashi, Karakullaku-Mbikusha, Kozani-Edhëza, Kuqani-Arrasi, Meliza-Mbleta, Murriqani-Uriqaj, Petreshi-Gjurmasi, Reçani-Lisaj,*

*Shushica-Rraza, Martaneshi-Kaptina, Fenarsi-Flaka, Kostenja-Gështenja, Zdrajsha-Muzhagja, Biçakaj-Briskaj, Broshka-Shkumiza, Kajani-Shkëmbi, Budini-Bletëza, Dushkani-Dushkaja, Koçani-Koçaj, Isufmuçani-Muçani, Terbsaçi-Rrushnaja, Viskiqi-Vendkeqi, Babja-Shulorja, Dragostunja-Melqiza, Gizaveshi-Lajthiza, Hotolishti-Balldrethi, Kokreva-Kokrraj, Letmi-Verasi, Vulçani-Gjemthi, Bezeshita-Qyteta, Oraka-Uraka, Rashtani-Ballkuqi, Raica-Suta, Somotina-Bardhaj, Skroska-Shtresa, Straniku-Shqiponja, Vehçani-Shpatza, Jeronishti-Lana, Zavalina-Maskartha, Bejluku-Prona, Bizhdeni-Dafinëza, Gostima-Ujza, Shtermeri-Shkozeti Terepsenishti - Bliza, Serica-Verriza etj.*

### **5) Prefektura e Korçës:(konstatohen ndikime maqedone e greke)**

Nga 137 fshatra gjithsej nuk ndryshuan emrat e 35 fshatrave dhe ndryshuan emrat e 102 fshatrave (ose 75% e tyre), si më poshtë:

*Barçi-Bardhi, Belartoja-Mesi, Biranji-Niraj, Boboshtica-Manëza, Bellovoda-Ujë i Bardhë, Bulgareci-Arbëri, Çiflik Shemoll-Fushëkuqi, Dersniku-Lakthi, Dishnica-Mullias, Drenova-Thanëza, Dvorani-Kurtaj, Kamenica-Mulçija, Orman Çiflik-Gjashtë Dëshmorët, Polena-Pullazi, Porodina-Rushaj, Pulaha-Pulaj, Ravoniku-Rafshaj, Rembosi-Drithas, Vashtemija-Vashëza, Vinçani-Vinjolli, Voskopi-Vreshtëza, Nikolica-Nikaj, Sinica-Mollëza, Kolaneci-Kalaji, Liboniku-Shelgasi, Pirku-Prika, Plovishti-Plepaj, Pocesta-Prita, Vloçishti-Reza, Zvirina-Burimasi, Brozdoveci-Degaj, Peshtani-Brinjari, Rosoveri-Rosaj, Toroveci-Koroziu, Varvara-Varrëza, Vrepcka-Harabeli, Xerja-Kryebardha, Doberçani-Shkrepaj, Copeli-Kopshti, Moglica-Liresi, Zemblaku-Zembraj, Podgorija-Temali, Zvezda-Gelqerasi, Posteci-Shen Pali, Gjergjevica-Gjergjaj, Kushova-Pishaj, Lozhani-Vreshtari, Osoje-Bredhasi, Tresova-Hijëza, Grabocka-Kueba, Leshnje-Lathias, Lubonja-Dashasi, Panariti-Dashamiri, Stratoberdha-Ushtriza, Treska-Arishta, Trebicka-Tribigasi etj. etj.*

Pastaj vijohet me Jugun e Shqipërisë, ku hasen ndikime greke:

**a) Nënprefektura e Leskovikut:**

Nga 32 fshatra, nuk i ndryshuan emrat e mëparshëm 12 prej tyre, ndërsa i ndryshuan emrat 20 fshatra, si:

*Cerca-Bukëz, Çarshova-Mazaraku, Hosecka-Shpati, Leshova-Ripas, Pobickë-Vashëza, Postenan-Morriza, Radanj-Rradha, Radat-Rrodhëza, Rodohova-Punmira, Sarandopori-Vehaj, Vrepcka-Pjeshkëza, Izgar-Shkoza, Kovaçisht-Farkaj, Kreshova-Dardhas, Melani-At Stathaj, Mbreshtani-Breshta, Toranik-Ahishta, Zguraleci-Guraleci.*

**b) Nënprefektura e Kolonjës:**

Nga 50 fshatra gjithsej, 22 nuk i ndryshuan emrat, ndërsa 28 fshatra po:

*Bejkova-Bujarasi, Borova-Pishaj, Gostivishti-Rrushkaj, Kodra-Kreshniku, Mesiçka-Mshikza, Psari-Peshkasi, Rehova-Bubullina, Vodica-Shenkolli, Zharkanji-Zezaka, Gozhdarazhde-Çmershi, Kamniku-Gurishtë, Leshnja-Lajthia, Radimishti-Gurëza, Bezhani-Grykaj, Koseli-Kedhasi, Skorovoti-Shendelli, Mileci-Kroj i Madh, Lencka-Gurë i Bardhë, Orgocka-Pendari, Selinicë e Pishës-Pyllasi.*

**6) Prefektura e Gjirokastrës**

Në komunën e Qendrës, nga 80 fshatra, nuk ndryshojnë emër vetëm 22 ndërsa ndryshojnë 58 fshatra (75 %), si më poshtë:

*Derviçan-Kukel, Dhoksat-Dushka, Dhuvjan-Pronjat, Frashtan-Arbëri, Goranxi-Gur i Zi, Gorice-Bregu, Grapshi-Gravë, Hashova-Drague, Kakozi-Miraj, Nokova-Visi, Palokastra-Kështjella, Sofratika-Shufrati, Saraqinishta-Gjerni, Tranoshishta-Trandaj, Vanista-Vëneshta, Cepuna-Çepaj, Zhulat-Shulaj, Dropull-Fusha e Drinit, Deshnica-Dërrasa, Hoshtova-Kodra, Nivani-Nënmali, Sheperi-Sipër, Topova-Lajthiza, Konispoli-Çamëria, Çuçat-Cuca, Aligat-Trilagje, Dishat-Vishëza, Ninat-Nënëza, Perdhihor-Fëllenza, Çiflik-Fushaj, Grave-Lajthizë, Grazhdan-Drizë, Kakat-Kalaj, Kullurice-Kulperi, Qeburja-Rinia, Soponiku-Botkuqi, Zmineci-Dimnori, Theollogo-Rapëza, Vagalati-Vlaga, Vrina-Vrima.*

**a) Nënprefektura e Delvinës:**

Nga 41 fshatra gjithsej, nuk ndryshuan emrat 3 fshatra dhe i ndryshuan 38, si më poshtë:

*Brailat-Brrylaj, Kokodhiq-Merinoti, Kardhikaq-Kërthias, Kalase-Rebesh, Karakaxh-Pemza, Kopaçe-Ferras, Kongoc-Kungaj, Lefterhor-Liria, Mavropulli-Zezar, Mesopotam i Poshtëm-Meslumaj i Poshtëm, Mesopotam i Sipërm-Meslumaj i Sipërm, Palavli-Pallati, Senica-Kullosaj, Vergo-Purteka, Dhrovjani i Sipërm-Kastrioti i Sipërm, Dhrovjani i Poshtëm-Kastrioti i Poshtëm, Leshnica e Sipërme-Lajthiza e Sipërme, Leshnica e Poshtme-Lajthiza e Poshtme, Çerkovica-Rrethina, Valahove-Vllazeri, Ardhosova-Ardhas, Dhivri-Dibri, Ymer Efendi-Omertaj etj.*

**b) Nënprefektura e Tepelenës:** nga 54 fshatra gjithsej, nuk ndryshuan emrin e mëparshëm 18 dhe 36 fshatra (60 % e tyre) e ndryshuan emrin e mëparshëm, si më poshtë:

*Breçishta-Fatosi, Berça-Grykëza, Hormova-Hardhija, Kashishta-Zallishta, Labovë e Madhe-Laborë e Madhe, Labovë e Vogël-Laborë e Vogël, Memaliaj-Sharkaj, Mexhgorani-Merguraj, Peshtani-Qyteza, Veliqoti-Veliaj, Kalivaçi-Donije, Kamshishti-Mesari, Koshtani-Gershtanizi, Levani-Luani, Qesarati-Qeshaj, Lapmartallozi-Qafëza, Mahmut Gjinaj-Gjinaj, Matoha Sanaj-Mataj, Salariaj-Shpati, Gllava-Çukëza, Zvori-Burimi, Komari-Kodrina, Maricaj-Merjani, Rabije-Lisi, Selcka-Kopshtina, Zhabotika-Majasi etj.*

**7) Prefektura e Beratit:**

Nga 137 fshatra gjithsej, nuk ndryshuan emrat e 84 fshatrave dhe ndryshuan emrat e 53 fshatrave, si më poshtë:

*Bistovica-Kështjellëz, Dobroniku-Bukuranje, Gjoroveni-Mali Plak, Kulalakut-Lahut, Mbolan-Bajames, Uznova-Fushgjata, Velobishti-Defrimi, Vetoniku-Dardhanj, Kuçova-Vajguri, Qereshniku-Qershajn, Çoragjaf-Qafaj, Plashnik-Kreshnik, Drenovica-Drithas, Sllanica-Shenjas, Velmishti-Fatmiri, Malishova-Karaflanj, Poliçani-Rosanjë, Hallvaxha-Kodras, Polozhani-Pëllumbas, Skrevani-Shkrepaj, Vokopola-Kryegregas etj.*

## **8) Prefektura e Vlorës:**

**a) Nënprefektura e Himarës:** nga 7 fshatra, nuk ndryshuan emrat 4 prej tyre dhe i ndryshuan emrat 3 fshatra, si më poshtë:

*Qiparo-Gjinovleshi, Dhërmi-Gjolekaj, Vuno-Malaj,*  
ndërsa Himara, Palasa, Kudhësi dhe Piluri nuk ndryshuan nga forma e parë.

**b) Nënprefektura e Vorës:** Nga 91 fshatra gjithsej, nuk ndryshuan emrat për 56 fshatra dhe ndryshuan emrat e 35 fshatrave si më poshtë:

*Tophana-Lagjja e Flamurit, Varosh-Kaçanik, Drashovicë-Drangaj, Kropisht-Fjerza, Movrovë-Fitorja, Budina-Verri, Golimbaspellambas, Ploça-Amantina, Sevaster-Kunorë, Velçe-Shpellaj, Brataj-Shkambi i Kuq, Gumenicë-Bigaj, Vranishtë-Zallishtë, Ramicë-Ramaj, Smokthinë-Zhgabaj, Brusja-Limaj, Gerneci-Arza, Karbunari-Thengjillas, Treshovë-Kështjellë, Bestrovë-Plepaj, Hoshtimë-Ushitimë, Kerkove-Shkrepaj, Zvernec-Rrethujëza, Bunavi-Verore, Aliban-Aliases, Grabian-Gropaj, Novoselë-Katund i Ri, Sofratinë-Sopi.*

### **c) Nënprefektura e Sarandës:**

Nga 24 fshatra gjithsej, nuk ndryshuan emrat e 10 fshatrave dhe ndryshuan emrat e 14 fshatrave (60 % e fshatrave), si më poshtë:

*Saranda-Zogaj, Metoq-Metaj, Trembull-Tremburi, Gjiashte-Gjashte, Karalibaj-Likaj, Kalive Shushi-Sheshi, Bredan-Brija, Çaushrreshteri, Vermero-Kalina, Çiflik Vana-Vena, Ksamili-Mulliri, Hundecovë-Hundaj.*

## **8) Nga prefektura të tjera**

### **a) Nënprefektura e Burrelit:**

Nga 164 fshatra gjithsej (se atëherë Burreli kishte në juridiksion edhe fshatrat komunave Lurë dhe Selishtë, si dhe disa fshatra të Mirditës) ndryshime përmbajtësore pësuan vetëm 10 fshatra, si:

*Bishkashi-Pishkashi, Klosi-Dullinjasi, Bejni-Shkreptima, Derjani-Derëgjani, Boshiqi-Krismajt, Kome-Këmbaj, Midha-Millëz, Karica-Karriza, Fsheti-Fshati, Shlliu-Shenllija.*

### **b) Nënprefektura e Mirditës:**

Nga 45 fshatra gjithsej asnjërit nuk i ndryshoi emri.

**c) Nënprefektura e Pukës:**

Nga 50 fshatra gjithsej, ndryshuan formën e parë vetëm dy fshatra:  
*Spasi-Shpëtimi dhe Vau i Spasit-Vau i Shpëtimt.*

**ç) Nënprefektura e Lezhës:**

Nga 83 fshatra gjithsej, ndryshoi emri i vetëm një fshati:  
*Krajmi-Skaj.*

**d) Nënprefektura e Malësisë së Madhe:**

Nga 94 fshatra gjithsej, vetëm 14 fshatra morën emra të rinj, si:  
*Dobre-Nënkodër, Potgore-Rranxë, Bogiq-Trojë, Kamice-Vau, Llazan-Vneshtë, Zhupa-Tregu, Okol-Rrethi, Stare-Katund i Vjetër, Goraj-Malishhtë, Gradec-Qytezë, Bratosh-Vllaznia, Rahovica-Kodra, Vermoshi-Orajt, Vrata-Grykë.*

**Nga sqarimi i autorit:**

a) Nga 436 fshatra të këtyre 5 nënprefekturave morën emra të rinj vetëm 27, ndërsa 409 fshatra ruajtën emrat e mëparshëm. Pra, ndryshuan emrat e mëparshëm ,vetëm 7 % e fshatrave të tyre.

b) Ndërkaq për lëndën e paraqitur deri në pikën 8 autori jep këtë sqarim:

Emrat e këtyre njësive vendore të marra në analizë ... nga gjithsej 1233 fshatra, nuk i ndryshuan emrat e mëparshëm vetëm 471, ndërsa 762 fshatra (62 % e totalit) i ndryshuan emrat e mëparshëm... Por kemi dhe nënprefektura, ku ndikimet qenë më të vogla dhe për rrjedhojë edhe ndryshime pati fare pak. Këto nënprefektura, në brendësi të vendit dhe në periferi, pothuajse nuk kanë rënë nën pushtim, ndaj dhe kanë pasur dhe ndikime më të pakta nga gjuhët e huaja.

c) Në fund paksa në mënyrë kritike autori jep disa konstatime jo pa interes, që ne po i përmendim më poshtë:

1) Për disa fshatra bëhet shqiptimi i drejtpërdrejt i emrit të huaj në *shqip*, andaj ndodh që përkthimi i drejtpërdrejt me dhënë një emër jo fort të këndshëm e të dëshirueshëm dhe për këtë shkak, duhet menduar për të gjetur një formë tjetër më të pranueshme. (Në të vërtetë, për këtë konstatim autori nuk jep shembuj konkretë.)

2) Disa fshatra i morën emrat e rinj duke pasur parasysh pamjen fizike të tyre, relievin dhe pozicionin gjeografik, si p.sh.:

*Pishaj, Kërrabaj, Bregasi, Kreshta, Rrafshorja, Bishtorja, Kurrizaj, Lëndina, Lisi i Madh, Lisi, Shkoza, Gropaj, Lugina, Kodraj, Bregorja, Shkambi, Shpatinaj, Shpati, Zallishta, Verriza, Driza, Shkrepaj, Dimnori, Hijëza, Qyteza, Lajthia, Fushgjata, Mali Plak, Qafaj, Kodras, Verri, Shkamb i Kuq, Plepaj, , Ahishta, Pyllasi etj.*

3) Fshatra të tjerë morën emrat e rinj duke pasur parasysh vlerat prodhuese të fshatit, si p.sh.:

*Pjellorja, Burimi, Thatina, Thatushi, Kumbulla, Gështenja, Vreshtëza, Vëneshta, Kullosaj, Kopshti, Kungaj, Bajamas, Drithas, Arza, Pjeshkëza, Dardhas, Hardhija etj.*

4) Disa fshatra të tjerë duke pasur parasysh vlerat etiko-qytetare të tyre e dhe të banorëve të tyre, morën emrat, si p.sh.:

*Shqiponja, Trimaj, Tryezëgjana, Dashamiri, Dëshira, Dafinëza, Ushtima, Ujmira, Bukuranje, Vashëza, Defrimi, Morrina, Pellumbas, Lagjeja e Flamurit, Fitojra, Kreshniku, Kështjellë, Verore, Bukëz, Punmira, Rrodhëza, Mshkiza, Pendarit etj.*

5) Sigurisht, në të gjithë këtë mori emrash, sipas autorit, ka edhe gjetje jo të përshtatshme, si p.sh.:

*Bukuroshi, Floriri, Bukuroshi i Epër e Bukuroshi i Poshtëm, Miroshi, Thëllenza, Miraj, Vashëza, Defrimi, Morrina, Mshikza, Punmira, Rrodhëza, Rreshteri, apo Kastriot dhe Kastriot i Epër në Gjirokastër, kur ishte dhe u listua përsëri fshati Kastriot i Dibrës etj.*

Dhe përfundon autori:

*Edhe pse mangësi të tilla janë të pashmangshme, por të korrigjueshme, ... megjithatë kjo ishte një punë shkencore e vërtetë e serioze, që duhet konsideruar si bazë nisjeje. Ndaj, pikërisht këtu duhet mbështetur edhe starti i sotëm.*

Edhe ne, siç e cekëm më përpara, pajtohemi që materiali i tillë mund të shërbejë si *bazë nisjeje*, por jo të miratohet symbyllazi, ngase siç del nga përfundimet e punimit tonë, sa i përket formëzimit e fjalëformimit të emërtimeve në fjalë disa nga zgjidhjet e propozuara nuk përputhen me kriteret fjalëformuese që mendojmë ne dhe të tjerët se duhen mbështetur në kohën tonë për rastet përkatëse.

Në të vërtetë, ne mendojmë se formimet e propozuara me prapasheshesën –AJ që kapin shumën mbi 80, ato –AS afro 30 raste, janë të diskutueshme, ndërkaq ato me –ËZ me afro 30 raste, si dhe ato pa ndajshitesa, jo të gjitha janë të qëndrueshme, pastaj shembujt me –IN(ë)



11/-5, -J/AN 42 /-39, -ISHTË 12/-6, -ISHT 20/-19 e raste të tjera duhen rishikuar, por nuk është vepruar qortueshëm kur është propozuar ndryshimi i i shembujve me prapashtesat sllave: –OV (17), -ICË (17), –IQ (7), e raste të tjera, të cilat do të kihen parasysh prej nesh gjatë analizës në pjesën e dytë të punimit

Së këtejmi, mendojmë që gjithsesi urgjentisht duhet të (ri)botohet dokumenti integral (i plotë), në mënyrë që studiuesit e të interesuarit dhe mbarë opinionin mund ta shfrytëzojnë edhe këtë material për qellime të caktuara shkencore ose për të pasur në dijeni, një punë të tillë vërtet për lakmi që qenka ndërmarrë në vitin 1938 nga Qeveria shqiptare rreth ndryshimit të emërtimeve të toponimeve të papërshtatshme me prejardhje të huaj në Shqipëri.

Mjerisht ajo qeveri nuk ka pasur mundësi të bejë zbatimin administrativisht, sepse pa kaluar as gjysmë viti shiheshin gjasat se Shqipëria do të jetë pre e invazionit të fashizmit Italian ose edhe nga pushtues të tjerë potencialë, siç ishte Jugosllavia SKS.

Në fund shpreh keqardhje pse Komisioni i Prishtinës nuk ië pati për konsultim edhe këtë burim, ngase mesa pam ë, hiq shembujt me –AJ dhe –AS dhe disa shembujt të tjerë, mëse 50 shembuj sipas mendimit mund të shfrytëzoheshin si zgjidhje të përshtatshme edhe për emërtimet e fshatrave tanë, ngase sipas kushteve të caktuara plotësisht i plotësojnë kriteret sio emra të përshtatshëm dhe bashkëkohorë. Disa nga rastet që i konsiderojmë të përshtatshme do t'i cekim në pjesën e dytë të këtij punimi.

## (II) NGA LISTA E TOPONIMEVE (SLLAVE) NË TERRITORET E LIRUEME SHQIPTARE ME SHQIPËRIMET E PROPOZUARA (1942)

### H y r j e

Meqë për fazën e parë (1912-1924) nuk kemi të dhëna që kishin filluar, apo jo, ndryshimet e emërtimeve të papërshtatshme të venbanimeve dhe për fazën e dytë (nga fundi i regjimit të Mbretit Zog) 1924-1939, siç e pamë në pikën e mësipërme, u bë një punë e mirë vetëm viteve të fundit të atij regjimi, por që mbeti vetëm si tentativë, sepse në pranverën e vitit 1939, Shqipëria ra nën pushtimin italian. Mirëpo, ç'është e vërteta, siç dihet, Italia fashiste (musoliniane), pas parapërgatitjeve ilegale–legale që i intensifikoi në atë fillim të L2B, pa shumë mund e pushtoi Shqipërinë më 8 prill 1939 dhe pas një jave gjoja me dëshirë të vet shqiptarëve, Albania (Shqipnia) u fut në *“personaunion”* me Italinë dhe pas 2 muajsh, më 3 qershor 1939, gjithashtu gjoja me *pëlqimin*, përkatësisht me nënshkrimin e Viktor Emanuelli III dhe Shefqet Verlacit, në emër të Shqipërisë, u themelua e ashtuquajtura *Mbretëria italo-shqiptare*. Kështu, tash Viktor Emanuelli III quhej: *Mbret i Italisë e i Shqipnisë dhe Perandor i Etiopisë*, andaj perandori kishte tagër dhe detyrim të formonte e drejtonte edhe qeverinë shqiptare, po në të vërtetë, krejt pushtetin ekzekutiv të kësaj Perandorie e kishte në dorë, kryefashisti Benito Musolini, i ashtuquajturi Duçe, aleat besnik i kryenazistit gjerman Adolf Hitler.

Është e vërtetë se në këtë kohë në Qeverinë e Tiranës, nga përfaqësuesi i Italisë **Qiano**, qenë pranuar në Qeverinë e Shqipnisë, mjaft patriotë të njohur iredentistë të bindur shqiptarë, të cilët jo vetëm ishin të lejuar, por qenë edhe të ngarkuar, në njëfarë mënyre, të propagandonin për bashkimin e tokave shqiptare që kishin mbetur jashtë kufijve të Shqipërisë Londineze. Kuptohet që një punë e tillë prekte Greqinë e sidomos Mbretërinë Jugosllave SKS. Kështu që atë propagandë të ligjshme aq hapur kundër Jugosllavisë e Greqisë nuk mund ta bënte më përpara Zogu **si mbret i shqiptarëve** as ilegalisht me qeverinë e tij, prandaj tash veprimtarët e

caktuar nën ombrellën e Mbretnisë italo-shqiptare, mund ta bënin legalisht dhe me plotgojë, si Mustafa Kruja, Bedri Pejani, Ernest Koliqi, e shumë të tjerë, si dhe një plejadë e tërë intelektualësh të njohur jo vetëm katolikë, por edhe atdhetarë të tjerë të sprovuar shqiptarë nga Veriu e Jugu, që nuk kishin vetëm fjalë, por edhe punë për të mirën e popullit shqiptar. Në të vërtetë, ashtu siç e kishin parashikuar politikanët italianë pas dy vitesh Mbretëria Jugosllave SKS u zhbë dhe tash duhej të bëhej e përgëzohej, siç ishte premtuar: *Grande Albania* (Shqipëria e Madhe), duke iu bashkangjitur asaj viset e okupuara shqiptare, të cilat më përpara e gjatë LPB nga ish-Jugosllavia e Greqia i ishin aneksuar me dhunë, prandaj tokat e tilla duhej kthyer Shqipërisë Nanë. Mirëpo po kjo ide s'mundi të realizohej as njëhershëmrisht, madje tërësisht asnjëherë e plotë as në proces, as nga ajo *Mbretëri shqiptaro-italiane*, as më vonë. Shkaqet qenë të shumta, por do të përmendim këto dy:

E para, edhe pse, ushtria italiane u fut në Kosovë e në Mal të Zi, ajo e mbajti mbyllur kufirin e Kosovës me Shqipërinë për një periudhë 3-4 mujore, ngase siç thuhej edhe për arsye se V. Emanuelli kishte në (ha)mendje ta përtërijë dinastinë K. Nikollës dhe kështu edhe Kosovën t'ia bashkangjiste Malit të Zi, për të kënaqur zonjën mbretëreshë, që ishte me origjinë malazeze. Në të vërtetë, gruaja e Viktor Emanuellit ishte vajza e Kral Nikollës, i cili me formimin e Mbretnisë SKS e humbi pushtetin në Mal të Zi, edhe pse një vajzë e tij që martuar me mbretin serb. Në këto rrethana, siç flitej atëbotë, ithtarët e *Shqipërisë së Madhe*, më drejt: **Shqipërisë Etnike**, me politikanët patriotë shqiptarë të implikuar në Qeverinë shqiptare të asaj perandorie, nuk e kanë pasur lehtë për t'i mbushur mendjen Perandorit për të realizuar sadopak *një Shqipëri Etnike* që t'ia aneksonin (rikthenin) Shqipërisë viset shqiptare që tash hynë nën juridiksionin e Mbretnisë shqiptaro-italiane.

Sidoqoftë, në këtë drejtim pas qeverisë njëvjeçare kolaboracioniste kuislinge të Shefqet Verlaci (29.11.1939 – 03.12.1941) qeveria e Mustafa Merlika - Krujës (04.12.1941- 19.01.1943), që shumë më punëmbarë, sepse nuk i mungoi përpjekja dhe suksesi i përgjithshëm në frymën kombëtare, andaj shikuar nga prizmi i sotëm neutral, së paku duke pasur parasysh efektin arsimo-kulturor të arritur *në viset e lirueme* etj., kjo qeveri nuk mund të quhej krejtësisht kuislinge, sepse në atë periudhë shfrytëzoi disa privilegje në të mirë të çështjes kombëtare, si: të drejtën e përdorimit të flamurit shqiptar, përzgjedhjen e personelit të ministrive, jetësimin e zgjerimin e administratës e të shkollës shqipe e privilegje të tjera, apo jo?!

E dyta, duhet sqaruar fakti se jo të gjitha trojet shqiptare nga zhbërja e Jugosllavisë, Mbretnia e tillë italo-shqiptare, siç propagandohej, mundi t'ia ribashkonte Shqipnisë, por megjithatë propaganda si shpresë entuziazmonte dhe nuk u shua edhe për ato vise që mbeten jashtë. Nuk u shua as propaganda për lirimin e bashkimin e tokave shqiptare nga *Follorino e Gjiu i Artës* në Greqi deri në Ulqin e Tivar në Mal të Zi, si edhe për ato vise të Kosovës që Italia u detyrua t'i ndante me aleatët: **Bullgarinë** e cila mori nën administrimin e saj disa vise shqiptare në Maqedoni dhe një pjesë të Kosovës, dhe **Gjermaninë**, e cila po ashtu mori nën administrim Mitrovicën me një rrethinë bukur të gjerë, të cilën ia bashkangjiti Serbisë, nën administratën e qeverinë kuislinge të Nediqit.

Së këtejmi, shqiptarët jo vetëm në *Shqipërinë e Madhe*, por edhe në viset e tjera në kuadër të Gjermanisë fituan më shumë të drejta se ato nën Bullgarinë okupuese, mirëpo duke u falenderuar patriotëve të devotçëm me veprimtarinë e tyre atdhetare, politike e arsimo-kulturor të pakursyer, shqiptarët, kudo, morën frymëmarrje më të lirë dhe shihnin një perspektivë që premtonte, pra, edhe në ato vise jashtë asaj Shqipërie, sidomos pas shpartallimit të Italisë fashiste, kur disa patriotë shqiptar, me në krye Imzot Harapin, shfrytëzuan tolerancën gjermane në dobi të bashkimit simbolik të trojeve shqiptare.

Sidoqoftë, duke shfrytëzuar parapërgatitjet dhe entuziazmin e shqiptarëve idealistë, sidomos në këto vise, që iu bashkangjiten **Shqipnisë Nanë**, edhe pse për një kohë të shkurtër, filloi një rilindje e vërtetë me administratën shqipe, me hapjen e shkollave në gjuhën amtare, me një fjalë, u mundësua, si me thënë, një shfaqje e lire e kulturës dhe e identitetit kombëtar. Madje në këtë kontekst, çka është me shumë rëndësi për temën tonë nga **Mbretnia Shqiptare (Mëkëmbësja e Përgjithshme**, në Qeverinë e saj, përveç ministrive ekzistuese kishte formuar edhe **Ministrinë e Tokave të Lirue**, ku veç detyrave të tjera kjo ministri, përkatësisht *Mëkëmbësia e Përgjithshme*, duke mos qenë shumë e kënaqur me ritmin e punës, nëpërmjet Kabinetit diplomatik, njoftonte se Ministria e Punëve të Jashtme “*kishte ba me dijë se asht e nevojshme që çështjet e toponimastikës shqiptare (në viset e lirue)*... të rregullohen sa më parë, edhe për asye se **qëndrimi i mbiemnimeve në gjuhën serbo-kroate mase një vit pas aneksimit të tokave Shqipnisë mund të interpretohet si një shenjë pasigurie të gjendjes n'ato krahina**”.

Në fakt pasi qeveria bullgare tash sa kohë ishte kujdesur me i zëvendësue *mbiemnimet e tilla*, andaj tërhiqej vërejtje që edhe pala shqiptare

sa më parë duhej me ndërmarrë masa për zgjidhjen e çështjes në fjalë...

Në të vërtetë përgjegjësit nga *Ministria e Tokave të Lirume*, duke qenë të vetëdijshëm se “*kishin të bënë me një problem delikat e që padyshim kishte rëndësi kombëtare tejte të madhe*” e kishte ndjerë të nevojshme “*me i ngarkue me studimin e çështjes persona të rrahun në lamë gjeografike e historike si të Shqipnisë së Vjetër e tash të Re e përgjithësisht...* Kështu për këtë qëllim ishte formuar Komisioni përkatës në këtë përbërje:

**At Zef Valentini, kryesues  
dhe profesorët:**

**1. Ahmet Gashi, 2. Ndue Paluca dhe 3. Filip Fishta, anëtarë,**  
Ky Komision kishte për detyrë me i rikthye në shqipe:

*Toponimet sllave në këto krahina shqiptare që ishin vendosur dekada dhe shekuj më parë nga pushtuesit serb, malazez dhe bullgar...*

Madje për realizimin e kësaj detyre, ishin angazhuar zyrtarisht jo vetëm këto personalitete të shquara të fushave përkatëse, por edhe të tjerë duke punuar ngushtë me funksionarët e **Ministrisë së Tokave të Liruar**a, por edhe me **Institutin Shtetëror të Studimeve Shqiptare**.

Nga teksti që patëm në dorë për këtë punë ekzistonte dokumentacioni i plotë, prej nga ne në këtë punim shkëputëm:

***Listën e emërtimeve serbe me shqipërimet e propozuara,***  
të botuar tash së voni në *Gazetën shqiptare* portal *Farumi shqiptar*, nën komentimin e studiuesit **Veli Haklaj**, nën titullin **Mbretëria italo-shqiptare si i riktheu emërtimet sllave në shqipe**.

Ja teksti origjinal i propozimeve por me boldimin dhe pikat e radhitjes (si numra e shkronja) të vëna prej nesh:

## **I. Lista e toponimeve në territorin shqiptar me shqipërimet e propozuara**

### **1. Dibra dhe Struga:**

*Podmolje –Rranxa, Meševiste – Meshevistja, Novosela – Fshati i Ri, Drugovo – Drugova, Srbica –Koshëza, Veleste–Naltësija, Labunište–Labi, Jablanica – Jablanica, Kodzadzik–Koxhaxhiku, Lazaro Polje–Kastrioti, Galičnik - Galiçniku, Žiromica–Zhirovnica, Rostuša–*

*Rostusha, Volkovija –Valkalija???, Mavrovo –Mavraj, Niciforvo – Niqifori.*

## **2. Prespa:**

*Leskovec–Laskaj, Otesevo–Babaj, Perovo-Peraj, Carev Dvor–Pallati, Podmočane–Moçala, Krani–Krani, Nakolec–Nekolaj, Ljubojna – Miqesija, Lajmos (Lemos)-Qafa, Pisoderian–Pisha, Vatokhorian-Ferra, Katokhori-Fshati i Poshtën, Moskhokhori–Mosku.*

## **3.Tetova**

*Zeljino–Blerimi, Strmnica-Shpati, Miletino–Miraj, Neprosteno-Neproshteni, Dzepeiste-?, Brdoc–Kodra, Sevce-Sevcja, Brvenica-Brevenica, Tumeviste–Tumça, Volkovija-Valkalija??, Srbino-Donika, Trnovo-Ferra, Simnica-Simna Vogël.*

## **4. Kosova Qendrore**

*Stari Kacanik-Kaçaniku i Vjetër, Grlica–Qafza, Varos–Varoshi, Jazine-Jazhincja, Sevce-Sevcja, Urosec-Ferizaj, Pozarane–Flakadani, Gnjilane-Gjilani, Podgradnje-Rranxa, Babus-Babushi, Stimlje-Shtimla, Nerodimlje-Shtërporja, Staro Selo- Fshati i Vjetër, Belogradec-Bardheci, Laplje Selo-Lapi, Gračanica–Gjyteza, Dobrev-Miraj, Belačevac-Bardhaj, Caglavica-Çagla. Milosevo-Bajram Curri ose Milo Shini. Lebane-Majta, Slovinje-Arëni, Obilic-Abdul Frashëri, Kosovopolje –Fushë e Kosovës, Dobri Dub-Lisi, Priluzje-Prelushi.*

## **5. Metohija dhe ana e Prizrenit**

*Deçani-Deçani, Crmjan-Cërmniani, Gorazdevac-Malsija, Ratkovac-Luftari, Orahovac-Orahova, Zrze-Zerze, Rogovo-Rugova, Suva-Reka-Lumi, Movlane–Mavlana, Bijelo Polje–Fusha e Bardhë, Dobruša-Mireza, Djurakovac-Gjergjaj, Vrelo-Vrella, Belica-Bardhëza, Rožaj-Rozhaj, Ribarica- Peshkatari, Pridvorica-Kepallati, Srbica-Kosëza, Obrinje-Abaraj,*

## **6. Pellgu i Plavës**

*Krušev-Dardha, Martinović–Martinaj, Vojno Selo–Ushtrija, Novsiçi-Djelmnija, Velika-Plaka.*

## **7. Zona e Ulqinit**

*Vladimir-Vladimiri, Pelinkovići – Pelinku.*

## **8. Lumej dhe male**

*Shar Planina–Bjeshka e Sharrit, Stogova Planina-Bjeshka e Stogovës, Milanovac Planina - Bjeshka e Milanit, Crna Gora-Mali i Zi,*

*Ljuboten-Lubotini, Nerodimka-Shkretija, Lepenac-Bukurija, Bistrica-Bistrica, Pečka Bistrica-Bistrica e Pejës.*

## **9. Rajonet**

*Krajina-Kraja, Metohija-Metohija, Podgor-Rranxa, Podrima-Bregdrini, Kosovo Polje – Fusha e Kosovës, Prekorupjle-Prekorupi, Gornja Morava- Morava e Malit, Donji Polog- Fusha e Poshtme, Gornji Polog- Fusha e Epër, Mavrovo Polje- Fusha e Mavrajvet, Gornja Debrca- Malsija e Dibrës.*

## **10. Stacionet Hekurudhore**

### **a. Ohër- Strugë:**

*Skopje-Shkupi, Ohrid-Ohri, Podmolje-Rranxa, Struga-Struga, Vranište-Vranja, Tasmuroniste-?, Trebeniste-Trebenishti, Meseviste-Mesevishta, Botun-Botuni, Novo Selo Ohridsko-Fshati i Ri i Ohrit, Izdeglava-?, Arbinovo- Arbëni, Slivovo-?, Presek-Preseku, Klenovac-Klena, Malkovac-Malku, Izvor Ohridski-Gurra e Ohrit, Podvis Ohridski-Rranxa e Ohrit, Kiçevo-Kërçova, Sveti Nikola-Shën Kolli, Oslomeni-Besa, Srbica-Kosëza, Tunjo-Tunja, Dolenaka Rampa-Rampa e Lugut, Berikovo-Ganija, Bukojçani-Ashta, Bukovik Ohridski- Bukoviki i Ohrit, Zrkjlje-Zeqra, Donovica-Dona, Tajmište-Tajmishta, Stekovo-Mesi, Zimnica-Dimri, Zvezda-Hylli, Kunovo-Kunova, Gostivar-Gostivari, Vranovci-Vranti, Badovine-Badovina, Palačište-Palçi, Tetovo- Tetova, Saracilce-Saraçi, Glumçin-Glumçini, Novo Selo Tetovsko- Fshati i Ri i Tetovës, Laskarci- Laskaj, Semeniste-Faraj, Glumovo-Gluma, Djeneral Hanri-?, Gornje Skopje-Malsija e Shkupit, Zipce- Gardhi.*

### **b. Linja Shkup-Mitrovicë:**

*Skopje-Shkupi, Gornje Skopje-Malësia e Shkupit, Djeneral Hanri-?, Djeneral Jankovic-?, Kačanik-Kaçaniku, Grlica-Qafëza, Uroševac-Ferizaj, Babljak-Bablaku, Lipjan-Lipjani ose Ulpiana, Priluzhje-Prelushi, Samodreza- Besabesa, Vucitrn-Vuçiterna, Kosovska Mitrovica- Mitrovica.*

### **c. Linja Pejë-Fushë Kosovë:**

*Pec-Peja, Hvosno-?, Budisavic- Budi, Metohija- Metohija, Pogradec-Rranxa, Dobro Voda-Ujmiri, Cerovik-Bajram Curri, Banjic-Baja, Drenica-Dreni, Dobrosevci-Augusta, Belacevac-Bardhaj, Kosovo Polje- Fusha e Kosovës.*

### **ç. Linja Fushë Kosovë- Prishtinë- Podujevë-Kurshumli:**

*Kosovo Polje-Fusha e Kosovës, Priština- Prishtina, Devet Jugovica-Nanda, Vrani Do-Vrana, Put-Rruga, Podujevo-?, Kuršumlja-Kurshumlja.*

**d. Linja Rasha-Novipazari-Rozhaj-Kolashin:**

*Raska-Rasha, Pilareta-Pilareta, Novipazar-Novipazari ose Pazar i Ri, Bajevica-? Zunjevci- Zhunji, Ribarice-Peshkatari, Botrage-Botruga, Spiljane-Shpellani, Kolapare-Kolapara, Rožaj- Rozhaj, Zupanica-Zhupanza, Turjak-Turri, Trpeza-Treveza, Gidocelje-?, Ravna Reka, Mojkovac-?, Kolasin- Kolashini.*

## **II.VENERIME NGA BURIMI I MËSIPËRM**

Siç mund të shihet Komisioni nuk është ndalë vetëm në viset që momentalisht i ishin bashkuar Shqipërisë, por edhe në vise të tjera nën administrimin, qoftë të Bullgarisë, si b.f Kaçaniku i Vjetër etj., qoftë Serbisë së Nediqit, si b. f. Mitrovica, Podujeva etj., deri edhe Rasha me Pazarin e Ri etj., të cilat më vonë për pak kohë 1943-1944 bashkë me Shkupin edhe qenë përfshirë sa më thënë me entuziazëm në kuadrin e **Shqipnisë së Re** ose **Shqipnisë Etnike**, terma këta, siç dalin nga burimi në konsultim, në vend të ashtuquaturit term italian **Shqipnia e Madhe (Grande Albania)**.

Sidoqoftë, nga dokumenti i mësipërm, do të dallojmë dy karakteristika:

- a) veçori të përgjithshme dhe
- b) veçoritë formëzuese fjalëformuese.

### **a) Veçori të përgjithsme**

Si veçori të përgjithshme nga dokumenti në fjalë dallojmë:

E para, lënda nuk përfshin vetëm Tokat e Lirume, në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi, por kalon edhe në rajonin e Novipazarit e Rashës (Rashkës) në Serbi.

E dyta, barasvlerësit e disa emërtimeve në shqipe dalin me pikëpyetje, d.m.th në shqipe ende nuk ishte gjetur barasvlerësi përkatës. Në këtë grup bën pjesë edhe edhe emri i qytetit Podujevë-a.

E treta, emëvendet e trevave shqiptare në Greqi nuk u preken fare (ngase ishin ende të *palirume*), por disa shembuj te Prespa, si të themi të asaj natyre greko-vllahe barasvlerësisht shqipërohen, si: Pisoderion–Pisha,



Ljamos (Lemos)–Qafa, Vatokvorfion -Ferra, Katorhori -Fshati i *Poshtën*, Maskhorkhori-Mosku.

E katërta, para Institutit Alabanologjik të atëhershëm e faktorëve përkatës jo vetëm gjuhësor, por edhe atyre të historisë dhe të gjeografisë mbetjesh detyrë që të vazhdonin trajtimin e qëndrueshmërisë së toponimeve edhe në vetë Shqipërinë e Vjetër (londineze).

### b) Veçori formëzuese fjalëformuese

Rreth veçorive formëzuese e fjalëformuese, këtu nuk do të ndalemi gjatë, ngase ndonjëri nga shembujt do të ceket edhe në pjesën e dytë të kësaj vepre, ku temë e fjalëformimit trajtohet më në hollësi, megjithatë nga kjo fushë po përmendim këtu, jo vetëm sa për kërshëri, por për më tepër se aq, ndonjë fakt si:

E para, të emrat e propozuar në shqipe janë shënuar në trajtën e shquar, veç emrit Zërze, por kjo nuk ndodhë në ndonjë rast me gjymtyrën e parë me emrat tofjalësha: Fusha e Poshtme, Fshati i Ri i Tetovës etj.

E dyta, vihet re prapashtesa shqipe –AJ edhe pse e specializuar për patronime, të përdoret si zëvendësim në vend të disa prapashtesave sllave të toponimeve përkatëse të venbanimeve me *-(v)es*, *-ovo*, *-evo* –*e/vac*, por asnjëherë në vend të prapashtesës *-viq* ose *-ica* të serbishtes(!).

E treta, lë pështypje emërtimi i stacionit serb *Arbinove* që nga Komisioni shqipërohet **Arbënia**, andaj po e shënoj si pikë më vete.

E katërta, zgjojnë intereres përkthimet *Pridvoric* (pri+dvor) me **Kepallati**: *ke* (te tek)+*pallati*, *Nerodimlje*- **Shtërporja** (ne rodi’ –shtërp), ndërkaq *Nerodimka* (lumi)– **Shkretija**(!!).

E pesta, shikuar nga raporti barasvlerës serbisht-shqip, për mendimnin tonë kërkon sqarim, p.sh. rasti: *Gornje Skoplje* –**Malsia e Shkupit** dhe *Gornja Debrca*–**Malësia e Dibrës**, ngase emri **gora e serbishtes** në shqipe ka barasvlerës **mal** ose **malësi** varësisht nga konteksti, ndërkaq mbiemri *gornji gornja gornje* është mbiemër ka kuptimin i **sipërm**, e **sipërme** apo i **epërm e epërme**, varësisht nga gjinia e emrit. Me sa pamë emërtimi i tillë në sllavisht kishte të bënte me konceptin *vend-vakëf*.

E gjashta, mesa pamë, emri *polog* në serbishte aktualisht mbulon këto dy koncepte: të parin *furrik* dhe të dytin *drith*, *drithnajë*, andaj emërtimi shqip **fushë** nga Komisioni mund të jetë jo i qortueshëm. Krahaso: *Gornji Polog* – **Fusha e Epër** (sot e Epërme) dhe *Donji Polog* –**Fusha e Poshtme**.

E shtata, zgjon interes rasti te Prespa: Katakthori - *Fshati i Poshtën*. Pikërisht e kam fjalën me *N*-në fundore të mbiemrit **i poshtëN**, Siç dihet ky mbiemër në letrarishte përdoret me kuptim neutral *i poshtëm* (*Fshati i Poshtëm*), ndërkaq me kuptim pejorativ *i poshtër*. Në Kosovë sipas traditës trajta *i poshtër / e poshtër* është pëdorur me -r fundore, gjë edhe sot dëgjohej në stilin ligjërimor me kuptim jo-pejorativ edhe në toponime si *Katundi i Poshtër, Vorret e Poshttra, Mahalla e Poshtër, Lluka e Poshtër, Lluka e Sipër, Katundi i Poshtër etj.*, prandaj për ne ka domethënie neutralizimi i kuptimit pejorativ i shënuar aty me elementin -N (nazal), i cili në toskërishte që në lashtësi u shëndërrua në R: *i poshtër / e poshtër*, çka nënkupton se trajta më e hershme, siç supozohet ishte me -\*N (intervokalike), prej nga doli trajtë e rotacizuar në mbarë trevat e Kosovës?!. Gjithsesi kjo dukuri kërkon sqarim, apo jo?!

E teta, të vihen re disa përkthime si Koshëza për *Srbica*, përkatësisht Kosëza (afër me konceptin *srp*-drapër të serbishtes).

E nënta, lypset përshëndetur emërtimet si risime mbi bazë shqipe ose si krijime bashkëhore: Blerimi, Bardhëza, Bardhaj, Hylli, Qafëza, Gurra etj.

E dhjeta, dy raste Komisioni i ka lënë në alternativë: *Lipljan* - **Lipiani** ose **Ulpiana** dhe *Obiliq-Bajram Curri* apo **Milo Shini**.

## Përfundim

Sidoqoftë, meqë ky material i vitit 1942 si dhe ai i vitit 1938 nuk ishin publikuar më përpara e si rrjedhojë nuk i kishim të njohur, as ne, as hartuesit e regjistrave të hartuar te ne, prandaj ne i paraqitëm të shoqëruara me ndonjë hollësi jo vetëm sa për kërshëri, por që njëherazi mendojmë se duhet me i pasë parasysh studiuesit tanë, sa here shqyrtohet kjo lëndë, si në kohën e sotme ashtu dhe në të ardhmen.

Sigurisht edhe lënda nga ky burim si dhe ai i vitit 1938, edhe pse nuk e ka peshën e burimit 1938, do të konsultohet prej nesh edhe nga pikëpamja formëzuese dhe sidomos nga ajo fjalëformuese në pjesën e dytë të kësaj vepre.

### (III) NGA FJALOR I EMRAVE GJEOGRAFIKË TIRANË 2002

Si ndihmesë e mirëpritur për ne erdhi burimi **Fjalor i emrave gjeografikë të RSH (2002)**, ku përveç materialit (tekstit përmbajtësor të emërtimeve konkrete) për ne zgjojnë interes të veçantë edhe që të tre këta tituj shoqërues të kësaj vepre: *Parathënia, Ndërtimi i Fjalorit* dhe sidomos shtesa mbasthënëse me titull: *Disa kritere e rregulla të ndjekura për vendosjen e trajtës normative të emrave gjeografikë në këtë Fjalor*, punim i shkruar nga studiuesi i mirënjohur për ne prof. Emil Lafe. Po i shënojmë me pak fjalë disa konstatime si ndihmesa mësimore që morëm ose i përforcuam njohuritë tona nga titujt shoqërues të kësaj vepre, të këto, që përveç meje mund t'u hyjnë në punë edhe studiuesve e të interesuarve të tjerë.

#### I. Konstatime të nevojshme

##### 1) Nga Parathënia

Nga *Parathënia* e këtij burimi veç tjerash kuptojmë këto gjëra tejet të rëndësishme për lexuesin si dhe për plotësimin e disa gjërave profesionale lidhur me punimin tonë.

E para, ky Fjalor është përmbledhja e parë e emrave më të njohur gjeografikë të RSH-së, ku, ndër të tjera, janë përfshirë emrat e qyteteve, të fshatrave, por edhe disa prej qendrave të rëndësishme të banuara.

E dyta, synimi i kësaj pune ishte edhe të përcaktojë trajtën normative të shkrimit e të shqiptimit të tyre.

E treta, Fjalori pasqyron të gjitha ndryshimet e emërtimeve gjeografike që janë bërë pas Çlirimit (pas L2B).

E katërta, gjithë lënda e nxjerrë nga burimet përkatëse është diskutuar, siç njofton autori, në çdo rreth me komisione të posaçme të përbëra nga njohës të mirë të gjeografisë e të të folmeve të rrethit përkatës.

E pesta, edhe pse gjatë redaktimit, për të saktësuar një varg emrash janë bërë diskutime plotësuese me njohës të mirë të zonave përkatës edhe

pse të gjithë emrat gjeografikë të përfshirë në këtë Fjalor janë shqyrtuar, një për një, dhe është përcaktuar **trajta normative e tyre**, megjithatë, duke e pasur parasysh faktin që përcaktimi i trajtës normative të emrave gjeografikë është një çështje shkencore shumë e ndërlikuar dhe së këtejmi, për këtë në Kongresin e Drejtshkrimit (1972) si dhe në Fjalorin drejtshkrimor (1973), u përcaktua qartë se shkrimi i emrave gjeografikë nuk mund t'u nënshtrohet tërësisht rregullave drejtshkrimore të leksikut të përgjithshëm, andaj shumë emra gjeografikë të njohur në mbarë vendin dalin në një trajtë të caktuar dialektore, e cila, megjithatë konsidertohet normative, si p.sh. **Rranxë** (Kukës, Shkodër), **Shullan** (Dibër, Kukës), **Truen** (Pukë), **Kaluer** (Lezhë) etj.

E gjashta, edhe pse hartuesit e këtij Fjalori janë të vetëdijshëm se vendosja e një trajte sa më të drejtë normative të emrave gjeografikë do të arrihet nëpërmjet kërkimesh e diskutimesh të reja, megjithatë me të drejtë shprehin bindje që ky fjalor edhe drejtshkrimisht përbën një bazë të nevojshme për punën e mëtejshme në këtë fushë.

## 2) Nga Ndërtimi i Fjalorit

Edhe nga *Ndërtimi i Fjalorit* konsiderojmë si ndihmesë këto mësimkonstatime:

E para, emrat gjeografikë që janë dhënë sipas rendit alfabetik, ata të thjeshtit janë shënuar në trajtën e pashquar, pa shënuar gjininë e cila kuptohet lehtë nga mbaresat a fundoret përkatëse, ndërkaq tek emërtimet e pathjeshta (emër+mbiemër, emër+emër në gjinore, emër+parafjalë+emër gjymtyra e parë është dhënë në trajtën e shquar, si: Qafa e Thanës, Shtegu i Dhenve, Mali me Gropa; Karbunara e Poshtme, Katundi i Vogël, Katundi i Vjetër, Katundi i Ri, Lumi i Bardhë, Vau i Shkjezës, Vela e Vendit, Vodëza e Sipërme Curraj i Epërm etj.

E dyta, emrat gjeografikë me –AJ me theks në rrokjen e parafundit nuk marrin mbaresë shquarsie në rasën emërore, si: Brataj, Memaliaj, Sinanaj, Ferraj, Kapaj, Kukaj etj.

E treta, emrat gjeografikë të përbërë nga një emër në rasën emërore dhe një emër në rasën gjinore, kur janë pjesë përbërëse të një emërtimi të përveçën gjeografikë që të dyja gjymtyrët shënohen me shkronjë të madhe, si: Bregu i Detit, Bregu i Lumit (qendër banimi), Mali i Jushit (fshat), Ranza e Shnikut (fshat) etj.

E katërta, në rastet kur një emër gjeografik është zëvendësuar me një emër të ri, në Fjalor jepen të dy emrat, secili në vendin përkatës, p.sh. Pëllumbas (*ish* Samuraj), ndërkaq te Samuraj (*sot* Pëllumbas) etj.

### 3) Nga kriteret dhe rregullat e ndjekura...

Pjesa e fundit me titull *Disa kriteret e rregulla të ndjekura për vendosjen e trajtës normative të emrave gjeografikë në këtë Fjalor*, të shkruar nga prof. Emil Lafe, sqarohen, përforcohen, përplotësohen, por edhe shtohen disa të dhëna me interes që kanë të bëjnë me ndërtimin e kuptimin e këtij fjalori. Profesor Lafe, këtë analizë e ka ndarë, si me thënë në katër tituj (sinënkapituj):

I. Kriteret e përgjithshme, ku nën 1.1. përmend 8 kriteret ose pika të ndara me:

- Vizë lidhëse, ku në pikë të veçanta cek disa diftongime të caktuara dialektore që nuk janë reflektuar në emra gjeografikë, si: Luznoj, Radomarj, Shutrej, Sllatajn, në vend **Luzni, Radomirë, Shutri, Sllatinë**, por si emërtim e të ngulitura në gjuhën e shkruar kanë gjetur vend trajtat si: **Kraj-Reç, Krej Reç**. E veçanta, te këto raste del se prapashtesat –Oj dhe –EJ (Luznoj, Shutrej) nuk parapëlqehen, andaj ato dalin të nomëzuara në trajtën e pashquar me fundoren –I.

-Edhe palatalizmi e ndërferkimet e bashkëtingëlloreve dialektore si: Bulgjër, Diqakë, Gjur-Lurë, Gjurra e Madhe, Përbregj, Qoshtan, Vigj –janë korrigjuar në **Bulgër, Dipjakë, Gur-Lurë, Gurra e Madhe, Përbeg, Ploshtan, Vig...**, por janë pranuar (*gj/g*): **Gjoricë, Lugjaj, Zogjaj**, por edhe toponimet (*gj/q*): **Rrasa e Gjytetit, Kodra e Gjytetzës...**

-Zëshmimi ose shurdhimi i bahkëtingëlloreve fundore është stabilizuar në gjuhën e shkrimit: te rastet: Çiflig-u (*g/k*), Liqeth-i ( *th/dh*, Patos (*s/z*), Rubik (*k/g*) ...

-Në pikë të veçantë sqarohet ndërrimi *nj/j* sidomos në toponimet, ku autori i jep cilësinë e normës trajtën me –NJ: Gështenjë etj.

-Bjerrja e h-së nuk del e lejueshme, kështu trajtë e drejtë: Buhal, Sohodoll, Perhondi, Vinjah..., ashtu si edhe për moslëvizjen e theksit në zanoren e parë: Fier, Fierzë, madje nuk arsyetohen ndërrimet fonetike, si: Lobonjë (*o/u*) Novoselë (*o/a*), Maja e Lajthizës (*a/e*), Dëllinjë (*ë:e*) etj

Mirëpo, nën pikën 1.2., theksohet se jo rrallë veçori dialektore kanë shërbyer për të njëjtësuar toponimin përkatës homonimik dhe lidhur me këtë shembujt u ndanë në dy grupe:

- a. me zanore e grupe zanoresh dhe
- b. me bashkëtingëllore e grupe bashkëtingëlloresh.

### **Shembuj me zanore e grupe zanoresh**

1.2.1: Banjë/Bënjë, Frankth/Frëngth, Gramsh/Grëmsh, Llangë/Llëngë, Por Shkëmb/Shkambi, ndërkaq po Rranxa e Shniku, Shullani i Shtrembët etj...

1.2.2. Kaluer Truen (ue), por Gjoli i Buajve, Qafa e Buallit etj.

1.2.3. Vorri i Hanës, Vorri i Bamit, Vorri i Fratit...

1.2.4. Maja e Korrilës (a/o); Ripa e Shëllirës (i/y). Tanda/Tenda; Vakuf/Vakëf; Lejthizë/Lajthizë, Lubinjë/Lubonjë, Maja e Gremit/ Maja e Grëmit; Peshkopi/Peshkëpi (o/ë), Dishnicë/Dëshnicë, Shijak/Shijan/Shojhon; Boks/Baks (o/a) deri edhe Këlcyrë/Krisurë etj

### **b) Shembuj me bashkëtingëllore e grupe bashkëtingëlloresh**

1.2.5. Edhe lidhur me bashkëtingëlloret është pasur parasysh që ruajtja në shkrim e veçorive dialektore të shërbejë për të individualizuar e për të njëjtësuar toponimin përkatës, si:

a) n-ja e parotacizuar: Qafa e Blinit, Maja e Drenit, Druni i Martalozëve, Maja e Frashnit, Përroi i Gjarpnit, Mali i Kunorës, Bregu i Ranës, Thekër /Thekna !!! etj.

b) zëshmimi i bashkëtingëlloreve të shurdhëta: Cfakë, Cfrat, Cupi i Madh; Hingë ; Rrasa e Gjytetit; Maja e Badrave, Badhër/Batër (d/t)

c) z-ja e kthyer në afrikate: Zalli i Rranxës,

ç) Po kështu janë ruajtur një varg rastesh trajtash dialektore: Qafa e Gjalit/Qafa e djalit, Novosejë/Novoselë, Shuri i Kuçit, Përroi i Zhurit (sh/zh), Toshkëz/Toshkës (z/s), Çardak /Çardhak, Tërovë/Tërovë (r/rr), Leshicë/Leshnicë, Kreshpan/Kreshpanj, Barbullej/ Barbullojë/ Barbullinjë etj.

1.3: Është vendosur trajta origjinale e disa emërtimeve (Fushë-Arës jo Fushë-Arrëz, (qytetet e fshat në Pukë), ndërsa Fusharë fshat në Kukës, pastaj: Razën jo Razëm, Patog jo Patok etj.

2. Emërtimi toponimik togfjalësh, dy gjymtyrët shkruhen me shkronjë të madhe: Përroi i Zi, Përroi i Thatë etj.

3. Në pikën 3, tekstualisht thuhet kështu: Në pajtim me traditën e përdorimit zyrtar janë shkruar me –AJ emra fshatrash Arapaj, Demarkaj, Hamallaj, Haziraj, Lakaj etj. (Në Shqipërinë e Mesme, të cilët në viset përkatëse përdoren në trajtën me –JE si Arapje... por është pranuar si normative trajta Këçukje e ngulitur (Durrës), por edhe Mukje, Zhurje, e ndonjë tjetër...

Gjithashtu në pajtim me traditën zyrtare janë normative shembujt: Barakaj, Sallmonaj, Kukaj, Mustafaj, të cilët në vise përkatëse dalin me /e; Barake, Sallmone, Kuke, Mustafe... Mbiemrat që përdoren si përcaktues toponimesh janë njësuar te shembujt: Curraj i Epërm, Curraj i Poshtëm, Gomsiqja e Epërme, Gomsiqja e Poshtme etj.

## II. Disa rregulla drejtshkrimore:

- 1) Shkrimi i -Ë-së së patheksuar
  - a) –ë-ja fundore: Brojë, Lezhë, Tropojë ; Buzë-Madh, Ujëbardhë, Lumëzi; Kamzë, Manzë, por Manëz etj.
  - b) –ë-ja e patheksuar te emrat me –ës, –ësh, –ëz: Bathës-i, Kukës-i; Grykësh-i, Gurrëz-i, por Ballsh, Belsh.
  - c) - ë-ja e patheksuar: Cërrujë, Gëlleshtë, Mëgullë, Komësi, Vërrin, por Kapshticë, Srriqe, Rrgjina-t (v. sh.).
- 2) Shënimi me –ë ose me –e: Blëzenkë, Çërravë; Gërmenj, Golem
- 3) Shkrimi me –i ose –y: Gryka e Madhe, Kodra e Gjytezës (me –i asnjë).
- 4) Shkrimi i grupit –ue: Kaluer, Truen, por Rrashbull Mlcu-oi,
- 5) Shkrimi i bashkëtingëlloreve nj/ j: Mazhanj e Mazhaj, Gërmenj e Gërmej, Gështenjë, Brinja e Lisit, por Mali i Shejtit, Kroi i Zojës, Vajmëdhej.
- 6) Shkrimi i bashkëtingëllores rr: Arrëz, Rrëzë,
- 7) Shkrimi i grupeve mb, nd: Ndërfushaz, Mbishkodër, por Fani i Vogël, Rremull.
- 8) Shkrimi njësh e ndaras të emrave gjeografikë: Fushëkuqe, Fushëlumë, Kodërmajë; Qafëmollë e Qafa e Mollës, Shëngjergj, por Qafë-Kërrabë /qafa e Kërrabës (!),
- 9) Përdorimi i vizës lidhëse: Nikaj – Mërtur, Gur –Reç, Gurëshqipe (!)

10) Përdorimi i shkronjave të mëdha: Përroi i Farkës, Qafa e Kumbullës, Qafa e Gurit.

### III. Disa rregulla gramatikore:

- 1) Trajta e shquar: Barçalla-i (jo Barçallaja), Mëlçu-oi (jo Mëlçuja);
- 2) Prirja me –n fundore: Balldren-i (jo Balldre-ni).
- 3) Emrat e pëgjithshëm e trajta e pashquar: Gjiri (jo gjiu), Kroi (jo prroni, përroni)
- 4) Trajta e shquar me –k, -g, -h fundore: Koritnik-u, Laku i Thive.
- 5) Gjinia e emrave gjeografikë: Shënkollë-a, Spasathor-i, Spatharë –a, Pylla e Vogël, Qafa e Pyllës, Ujët e Ftohtë, Ujët e Zi.
- 6) Rasti emrave me –AJ: Ballaj (jo Ballaji), Brataj (jo Brataji), shkolla e Bratajt (jo e Bratajve). Është fjala për emërtim vendi.
- 7) Përdorimi i rasteve në shumës (formë e fosilizuar): Bregu i Ahmate, Buza e Dede, Maja e Keke, Mëgjulla e Hote, Shpella e Hyse, Kërshi i Kocaje, Shuri i Kuçe
- 8) Disa veçori të ruajtura morfologjike dialektore për të njëjtësuar toponimin si Maja e Strehave, Gurët e Ngulë, Maja e Shpueme, Maja e Lartër, Përroi i Thanëve.

### Përfundim

Kështu vetëm në ndonjë rast përdorimi i theksit hyn në përdorim, i cili përdoret për të dalluar emërtimet homonimike Pojan/ Pojanë !!! S’do mend që edhe nga rregullat e tjera që sjell punimi i mësipërm përforcuam dijen edhe për gjëra që njihen si të zgjidhura, por edhe për gjëra të hapura. Së këtëjmi kjo ishte arsyeja që ne e konsultuam këtë punim mjaft në hollësi, prej nga nxorëm të dhëna që e ngrejnë më në nivel temën tonë, për mos me thënë se qenka trajtuar disi shkel e shko, apo jo? Por vlera më e madhe e kësaj vepre (Fjalorit) është grumbullimi dhe paraqitjen e materailit, i cili prej nesh është konsultuar e shfrytëzuar nga disa aspekte, por më fort rreth formëzimit dhe fjalëformimit të emërtimeve në shqyrtim dhe lidhur me këtë meqë nuk dimë që dikush tjetër ka bërë ndonjë studim model, morëm guximin të shprehnim disa mendime tona, edhe pse nuk janë të gjitha në harmoni me zgjidhjet fjalëformuese që ofrohen në këtë burim. Fundi i fundit pothuaj të gjitha emërtimet janë regjistruar nga terreni, por vetëm me ndonjë adaptim.



Sidoqoftë, edhe pse Komisioni nuk e ka vra mendjen për të saktësuar mënyrat e modelet e fjalëformimit të vendbanimeve në gjuhën shqipe, megjithatë nga vetë materiali i regjistruar del që edhe në këtë drejtim kontributi nga puna e bërë në këtë vepër nuk mund të mohohet.

## (IV) NGA REGJISTRI I STANDARDIZUAR I EMËRVENDEVE TË KOSOVËS (PRISHTINË 2005)

### H y r j e

**Regjistri i standardizuar i emërvendeve të Kosovës**, si broshurë u botua nga shtypshkronja *Era, Prishtinë 2005*, por puna kryesore numerikisht pothuaj ishte kryer në vitin 2000-2001, edhe pse e dorëzuar si e përfunduar në vitin 2004. Në këtë burim që në fillim shënohen emrat e studiuesve veprimtarë, anëtare të Komisionit Qendror që janë 15 emra të njohur studiuesish në fushat përkatëse të ne (Kosovë), madje shënohen edhe 50 emra aktivistësh ... si dhe disa intelektualë veprimtarë të njohur tek ne, po nuk shënohen komisionet lokale nëpër komuna.

Sidoqoftë, tekstin përfundimtar e ka hartuar **redaksia** në këtë përbërje:

- 1) **Prof. dr. Shefki Sejdiu (kryeredaktor),**
- 2) **Dr. Mehmet Halimi, Dr. Rexhep Doçi, Mr. Isa Bajçinca,  
Dr. Jusuf Osmani - anëtarë, dhe**
- 3) **Prof. Dr. Begzad Baliu (sekretar).**

Ndërkaq nga parathënia e kësaj broshure të shkruar nga sekretari, prof. dr. Begzad Baliu, si me thënë në bashkautorësi me kryeredaktorin, thuhet se:

*... Edhe Lufta e Kosovës 1998 – 1999 "solli ndryshime të thella në historinë e Kosovës", solli një realitet të ri sidomos në aspektin e zhvillimeve të brendshme, por edhe më gjerë".*

Me fjalë të tjera, pas kësaj Luftë, siç pohohet aty:

*filloi një frymëmarrje e re edhe nga pikëpamja e mendimit sociohistorik.*

Sidoqoftë, si rezultat i Luftës edhe nën presionin e aleatëve, forcave ndërkombëtare të NATOS, ushtria okupuese serbe u largua nga shumica e

trojeve shqiptare të Kosovës, por njëherazi në këtë frymë u shpreh dëshirë e ligjshme që duhej larguar edhe ndikimi i administratës serbe e ndër to ende qëndronin si barrë e rëndë e asaj atmosfere edhe *emërtimet e emërvendeve, ku bëjnë pjesë edhe emërtimet e venbanimeve*, randim shpirtëror ky, të cilin e ndjente thellë masa e gjerë shqiptare. Kjo masë donte që bashkë me robërinë shekullore të ndryshohen edhe disa nga emërtimet e tilla të huaja, andaj në mënyrë stikike filluan të ndryshoheshin disa emra toponimikë, sidomos të vendbanimeve që iritonin. Duke e parë këtë situatë, pothuaj konfuze, nga Qeveria e Përkohshme e Kosovës që në gusht të vitit 1999 u miratua nisma e disa intelektualëve që të rishikohet toponimia, sidomos ajo e vendbanimeve të Kosovës dhe pas njëfarë përgatitjeje në fillim të dhjetorit 1999 Ministria e Arsimit pas një kontakti me studiuesit kërkoi nga ata që të punonin rreth standardizimit të emërtimeve të venbanimeve të Kosovës.

## 1) Parime dhe detyra

Andaj si rrjedhojë, u caktua **Komisioni Qendror për Standardizimin e Emërvendeve të Kosovës** dhe në harmoni me kërkesat shoqërore e shkencore fillimisht u hartuan këto parime si detyra:

### 1. Të hetohen e të ruhen elemente toponimike:

- a) paraindoeuropiane): si *Llap, Gallap* etj,
- b) indoevropiane si: *Ulpianum, Theranda*,
- c) ilire: *Dardani, Scardus, Bederiana*,
- ç) protoshqiptare e shqiptare: *Brad, Brod, Bard /Bardh* etj.

### 2. Të hetohen dhe të ruhen, përkatësisht të kihen parasysh ose të konstatohen elementet toponimike të lashta të trashëguara:

- a) latine, si: *Pollatë, Kostërc*,
- b) romano-vllahe: *Surdull, Magurë, Makresh*,
- c) greko-bizantine: *Lypenon, Lypian, Mavriq, Metohi*
- ç) gjermanike: *Shashkofc, Shashar*,
- d) turko-orientale: *Çifllak, Qystendil*,
- dh) sllave të vjetra: *Polluzhë, Reçak, Suharekë, Suhogërlë*.

### 3. Të bëhet punë rreth rikonstruktimit rikthimit të srukturave autoktone, sjellja e emrave të vjetër shqip që me qëllim zhdukjeje të çdo gjurme shqipe ishin zëvendësuar me emra sllavë, si:

- Nova Shumadija, Velikareka* etj. *Devet Jugoviq, Lazarevo, Miloshevo* etj.

#### 4. Të trajtohet çështja e afikseve sllave, me përparësi venia e atyre shqipe etj.

Së këtejmi lidhur me të gjitha këto nga **Parathënia** e prof. dr. Begzad Baliut, sekretar i redaksisë, që në të vërtetë, siç u tha, ishte edhe zëri i kryeredaktorit dhe i Redaksisë, mund të themi se dalin të sqaruara këto çështje:

E para, Komisioni ishte që mos të prekeshin fare ojkonimet në vendbanimet kryesisht me popullsi joshqiptare, madje edhe ato me kombësi të përzier të standardizoheshin më tepër në aspektin fonetik, duke iu përshtatur të folmes lokale dhe rrafshit afiksial.

E dyta, të kihet parasysh e vërteta se fondi sllav i rindërtimit të disa monumenteve toponimike në Kosovë nuk ishte veçse relikty kryesisht i romantizmit serb i fundshekullit XIX dhe i fillimit të shek. XX. Ishte, pra vazhdim i një përpjekjeje të hershme që kisha serbe, duke shfrytëzuar autonominë e saj gjatë pesë shekujve nga Perandorisë Osmane, ngase ishte e lirë që ritet fetare ortodokse t'i ushtronte në gjuhën sllave dhe kështu bënte asimilimin e popullsisë vendëse ortodokse iliro-shqiptare e thrako-shqiptare. Së këtejmi edhe kishte ndërmarrë veprime për mbishtresimin e toponimisë vendore me toponime me prejardhje sllave.

E treta, në të vërtetë me një punë të tillë Komisioni ka “kryer një akt të shumëfishtë, ndër të tjera ka çmitizuar njërin prej miteve më të rëndishme të serbëve si kolektivitet dhe i ka çliruar ata si kolektivitet nga prangat më raciste të qindvjetëshit të fundit”... Është fjala të mitit ndaj Kosovë-Metohisë, ku goja ka pasur vetëm terminologji sllave (serbe) e jo shqipe dhe të tjera, të shqiptuara nga goja e shqiptarëve.

E katërta, ky regjistër i emrave të vendbanimeve i hartuar nga Komisionit është version përfundimtar që iu dorëzua si i tillë institucioneve shtetërore të vendit, më 2004.

Sidoqoftë, edhe pse mesa pamë ndërkohë në botimet përfundimtare nëpër Komuna është bërë edhe ndonjë ndryshim tjetër, ky version prej 1484 toponimesh edhe pse iu paraqit organeve shtetërore të Kosovës, mbeti i pazbatuar ose pa u trajtuar në shkallë të ministrive përkatëse, tashti për shkak të intervenimit të administratës ndërkombëtare, por edhe për shkak ngjarjeve politike jostabile në nivel vendi e në raport me ndërkombëtarët si dhe mbase edhe për shkak të paaftësisë së faktorëve administrativo-politikë

vendorë për arsyetimin për zbatimin e një të drejte të tillë universale, të garantuar edhe ligjërisht, sipas kodeve europiane, apo jo?!

Në të vërtetë, edhe pse, ky Regjistër ishte dorëzuar më vonë (2004) ai praktikisht ishte hartuar ose e kishte marrë pothuaj formën e prerë, para se të jetë publikuar *Regjistri i emrave gjeografikë të RSH (2002)* që e trajtuam më sipër pasi ne patëm si kriter vitin e botimit, në vijim po japim disa të dhëna me interes në këtë raport në mes të këtyre dy burimeve.

## 2) Të dhëna me interes në raportin FEGJ/RSEJK

Në këtë shtojcë, së pari po shënojmë raportin numerik të shembujve sipas alfabetit dhe pastaj do të bëjmë dhe krahasime të tjera, pa harruar edhe të dhëna në aspektin fjalëformues FEGJ/ RSEKe burime të tjera.

### a) Pasqyra e numrit të emrave të përveçëm oikonimikë, sipas shkronjave në këto dy burimeve

Shkronja	FEGJ	RSEK	Gjithsej	Diferenca +/-
1	2	3	4	5
A	82	39	121	+ 43
B	355	191	546	+164
C	33	16	49	+17
Ç	86	23	109	+63
D	152	106	258	+46
Dh	8	-	8	+8
E	12	3	15	+9
Ë	-	-	-	-
F	95	32	127	+ 63
G	217	92	309	+125
GJ	71	20	91	+51
H	93	22	115	+71
I	20	12	32	+8
J	23	19	42	+4
K	432	162	594	+270
L	205	85	290	+120
LI	4	31	35	- 27
M	293	111	404	+182

N	63	28	91	+35
Nj	1	-	1	+1
O	40	6	46	+34
P	276	96	372	+180
Q	64	17	81	+47
R	88	54	142	+34
Rr	60	6	66	+54
S	211	66	277	+145
Sh	182	50	232	+132
T	117	65	182	+52
Th	11	5	16	+6
U	27	17	44	+10
V	177	59	236	+118
X	12	2	14	+10
Xh	12	-	12	+12
Y	2	-	2	+2
Z	82	32	114	+50
Zh	30	11	41	+19

---

Totali      3636                      1457                      5093      +2152/-27

## b) Sqarime lidhur me të dhënat nga Pasqyra e mësipërme

Siç po shihet numrin më të madh të emrave të përveçëm gjeografikë e ndeshim në FEGJ, gjithsej 3636 shembuj. Në të vërtetë aty numruam vetëm vendbanimet (qytetet, fshatrat, qendrat e banimit) ekzistuese sipas regjistrimit në Shqipëri, ndërkaj në Kosovë RSEK numruam vetëm vendbanimet (fshatra e qytete) që kapin shumën 1457 shembuj.

Sa i përket numrit sipas shkronjave ndeshëm këto shifra më të larta dhe më të vogla:

### 1. Në FEGJ:

a) K 432, B 355, M 293, P 276, G 217, Sh 182, D 152 e kështu me radhë.

b) Ë zero, Nj 1, Y 2, Ll 4, Dh 8, Th 11 e kështu me radhë.

### 2. Në RSEK:

a) B 191, K 162, M 111, D 105 e kështu me radhë.

b) Ë, Dh, Nj zero, X 2, E 3 Th 5 O 6 Zh 11 e kështu me radhë.

Mund të vërehen edhe veçori të ndryshme të tjera, sidomos brenda lëndës së çdo numri. Po tash do të përmendim gjëra të tjera.

c) Meqë nga krahasimi i shembujve nga pikëpamja fjalëformuese nuk dalin shembuj konkretë, atëherë njoftojmë lexuesin se çështja fjalëformuese e emërtimeve përkatëse do të jepet në pjesën e dytë të kësaj vepre, prandaj atje do të shënojmë si plotësim vetëm ndonjë veçori me interes në krahasim edhe me burime të tjera, prandaj këtu nuk do të ndalemi më gjatë

### **Si përfundim**

Procesi i hartimit të këtij regjistri ka motivuar dhe motivon studiuesit e të gjitha profileve që të hulumtojnë më tej dhe të botojnë lëndë tejet me vlerë rreth toponimeve të shqipësisë, me anë të të cilave vërtetohen të gjitha faktet që paksa janë cekur në parathënien e RSEK shkruar nga sekretari i Komisionit Prof. dr. Begzad Baliu.

Sidoqoftë, po kaloj në konsultimin e burimit tjetër, në versionin serbisht të Regjistrit të emërtimeve të vendbanimeve të Kosovës.

## (V) NGA REGJISTRI I EMRAVE TË QYTETEVE DHE FSHATRAVE TË KOSOVËS

- versioni serbisht

### H y r j e

Nga ky burim vërejmë disa çështje, me interes, sidomos shembuj me trajta të diskutueshme të vendbanimeve dhe përgjithësisht do të shfrytëzohen në fund të këtij kapitulli në krahasim me burimet e shqipes, ndërkaq këtu fillimisht na bie në sy:

së pari, ndarja në qarqe e komuna që nuk e kishim te burimi 2005,  
së dyti, intervenime rreth ndryshimeve përkatëse drejtshkrimore e drejt-fjalëformuese në serbishte të emrave brenda këtij regjistri,  
së treti, disa shembuj serbisht dhe 2 versionet e propozuara në shqip për ndryshimin e tyre 1942 /2001,  
së katërti, disa konstatime me pikëpyetje? dhe  
së pesti, venerime të elementeve të shqipes në formëzimin e vendbanimeve përkatëse.

#### 1) Qarqet dhe komunat /Okruzi, gradovi (opština) Kosova i Metohije/ (nga wikipedia 2012 -2015)/

Nga Regjistri (alfabeti qirilik) që e nxora nga *wikipedia* me titull “**Okruzi, gradovi i sela Kosova i Metohije**”(Qarqet, qytetet dhe fshatrat e KM), Kosova del ndarë në 5 qarqe (okruzi) dhe pastaj vijojnë komunat (opštine) dhe fshatrat emër për emër në përbërje të secilës komunë (opštine) brenda qarkut (okrug) përkatës.

Kështu:

- a) **Kosovski okrug** (*Qarku i Kosovës*) përfshin 10 opština (komuna);  
*Priština, Glogovac, Kačanik, Kosovo Polje, Lipljan, Obilić, Podujevo, Uroševac, Shtimlje, Štrpce* .
- b) **Pečki okrug** (*Qarku i Pejës*), 5 opština (komuna):



*Dečani, Dakovica, Istok, Klina, Peć.*

**c) Prizrenski okrug** (*Qarku i Prizrenit*): 4 opština (komuna);

*Gora(!?), Orahovac, Prizren, Suva Reka.*

**ç) Kosovskomitrovački okrug** (*Qarku i Mitrovicës*): 6 opština: (komuna):

*Vučitrn, Zvečan, Zubin Potok, Kosovska Mitrovica, Leposavić, Srbica dhe*

**d) Kosovskimoravski okrug** (*Qarku i Anamoravës*): 4 opština (komuna):

*Vitina, Gnjilane, Kosovska Kamenica, Novo Brdo.*

### **Vërejtje:**

Në këtë dokument dalin gjithsej 29 komuna, një më pak se në RSEK, ngase *Malisheva* nga administrate serbe nuk pranohej e konstituuar si komunë më vete. Vërehet si risi komuna e re **Gora**, sipas këtij versioni, kjo komunë përfshin vetëm fshatrat e komunitetit goran, ndërkaq fshatrat e Opojes (shqipfolëse i janë ngjitur (fuzionuar) Prizrenit.

Kuptohet këto dy krahinëza, Gora ku mbizotëron gjuha sllavo-gorane dhe Opoja kraninëz shqipfolëse përbënin, siç e përbëjnë edhe tani një komunë: Komunën e Dragashit (Sharrit).

Siç mund të shihet në *Kosovski okrug* (*Qarkun e Prishtinës*), nuk përfshihet Novo Brdo etj., ndërsa përfshihet Shtërpce etj., që, siç do të shohim në ndarjen aktuale të Kosovës u takojnë qarqeve ose rajoneve të tjera të Republikës së Kosovës.

## **2) Intervenime nga hartuesit (në serbisht) bërë komplet kësaj liste rreth emrave përkatës**

Edhe pse në Kosovë administrata serbe jo vetëm ka dominuar mëse 100 vjet, përkatësisht tash afro 60 vjet pa ndërprerë që nga viti 1944 e deri më 1999, kur përherë ka pasur kompetencë zyrtare në duart e veta, në Regjistrin në fjalë, si duket i hartuar ose i rishikuar pas vitit 2007 janë paraqitur disa intervenime: sqarim korrigjime rreth emërtimeve të caktuara të vendbanimeve të Kosovës në atë gjuhë, që ne po i japim në vijim: sipas komunave:

1. Prishtinë: Novo Selo (na Gračanki), - si duket fshat i ri, i sajuar në prag ose gjatë Luftës së fundit (!, nuk figuron në regjistrin aktual shqip.

2. Kaçanik: Vrtomica (Vrtolnica), Drenoglava (Drenova Glava), 1) ndërshtëmbim m/ln, parapëlqehet e dyta, 2) nuk parapëlqehet njëfjalëzimi karakteristikë e shqipes te ne (Drenogllava).

3. Shtimje: Štimlje dhe Štimlja – me variante të zanores fundore të lejueshme, apo jo? – në shqipe Shtime Shtimja.

4. Vushtrri: Miroce (deri '75 Mirace), Novo Selo Madjunsko (deri '75 Novo Selo), Slakovce ('75-'91 Slavkovce). – 1) ndërshkëmbimi o/a, parapëlqehet –O-ja, 2) shtohet përcaktimi Madjunsko (I Maxhunit) dhe 3) përtheksohet rrënjëzimi Slavkov me –V-në shtesë.

5. Zveçan: Meki Do (nga 2007 Keqi Do) – zgjon interes fakti pse më 2007 korrigohej emri në Keqi Do?

6. Zubin Potok: Banja ('75 Banje), Gornje Varage (deri '59 Varage), Dragalica (deri '80 Dragalice nga 2007 Vragalica), Drainovice (2007 Drajinovice), Zagradje (deri '75 pjesë Burgata), Junake (deri 1980 Junaci), Kijevce (deri '75 Zečevica), Klečke (deri '75 pjesë Banja), Kopilovice (deri 1987 pjesë Medjedjeg Potoka), Krligate (deri 1975-1983) Krljigate, Ledenik (deri '75 pjesë Čišanovića), Prelez nga 2007 Prelaz), Rančiče (1975 -1987 Raičiče), Češaniviće (deri '75 Češenoviće), Sipovo ('75 Šipova) Štuoce (deri '75 pjesë Veljeg Brega).- raporti a/e.

7. Mitrovica: Brabonjić (deri '75 Brabonić), Vlahinje (deri '75 Vlahinja), Gušavac (deri 1980 Guševac, Zasela (deri '75 Zaselja, Kačandol (deri '78 Kačan Dol) Kosovska Mitrovica (1981-1991 Titova Mitrovica), Lisica (deri '65 Lisca), Madjare (deri 92 Madjera nga 2007 Madjera), Stari Trg deri '75 Rudarsko Naselje), Stari Trg (selo) deri '75 Stari Trg).

8. Leposavić: Donje Isevo (deri '75 Isevo), Ibarsko Postenje (deri '75 Postenje), Koporiće (deri '65 Kopuriće), Košutica (deri '75 pjesë Jarinja), Lazine (deri '80 Lazina), Mekiniće (deri '75 Mekinjić), Mioliće (deri '75 Miolić), Potkomlje (deri '75 Potkomnje), Tvdjan (deri '75 Trdjane), Ćirkoviće (deri '75 Ćirkovići).

9. Srbica: Poljance (më '75 formuar nga Staro dhe Novo Poljance), Ćirez (deri '75 Ćirez, Ćubrel (Kraljica shpërngulur 1975).

10. Vitina: Veliki Goden (deri '75 Goden, Vrnavokolo (deri '75 Vrna Kolo), Gornja Budrika (deri '75 Budriga), Grnčar (deri '75 Grnčare, Požaranje (deri '75 Požeranje).

11. Gnjilane: Bilince (deri '75 Bilinca), Bresaljce (deri '59 i ndarë në Gornje dhe Donje Bresalce), Stančić ('75-91 Staničić).

12. Kosovska Kamenica: Bušinca (1975-1991 Vušince), Veljeglava (deri '75 Velja Glava, më 2007 e ndarë në Gornju Veljeglavu dhe Donju Veljeglavu), Grizime (deri '78 Grizine), Zajčevce (deri '75 Zajčevac), Kosovska Kamenica (deri '52 Kamenica), Krajnidel (deri 1980 Krajni Del),

Lisocka (1980-1992) Lisacka, nga 2007 Lisacka), Firićeja (deri '74 Firićeje), Šaiq (deri '80 Šajiq, nga 2007 Šajiq).

I shënuam këto ndryshime për të treguar faktin se edhe në serbishte edhe pse tash mbi 100 vjet ishte gjuhë shtetërore, ndërkohë për motive të caktuara janë bërë ndryshime e korrigjime përkatëse të emërtimeve të caktuara dhe ato, siç e pamë, ishin në numër të konsoderueshëm.

Intervenime më tepër janë bërë në vitin 1975 afro 40 raste (35), janë vite kur Kosova pati fituar njëfarë autonomie më të zgjeruar administrative etj. Në të vërtetë, intervenime pati edhe më herët para këtij viti, por si me thënë ato ishin interevenime simbolike: në vitin 1952, 1 rast, 1959 3, 1965 2 raste dhe pas vitit 1975: më 1980 6 raste, më 1983 1 rast, më 1987 2, me 1991 1 rast dhe më 1992 2 raste. Bie sy fakti se në periudhën gjatë ose pas Luftës UÇK nuk paska pasur intervenime, por në vitin 2007, kur Kosova e shpalli Pavarësinë kemi 8 raste intervenimi në emërtimet e vendbanimeve të Kosovës dhe kjo në këto komuna:

a) Kamenicë 3 raste:1) Fshati Velja Glava ndahet në Gornju Veleglavu dhe Donju Veleglavu, 2) emri i fshatit Shaiq korrigjohet në Shajiq, dhe 3) emri i fshatit Lisocka korrigjohet në Lisacka.

b) Në Mitrovicë: emri Madjare korrigjohet në Madjera.

c) Në Zubin Potok është interevenuar në 3 raste: 1) Vragalica në vend Dragolica, 2) Prelaz në vend Prelez dhe 3) Drajinovice në vend Drainovice , ndërkaq

ç) Në Zveçan: në vend Meki Do del Keqi Do.

Këto ishin interevenimet e regjistruara në Regjistrin e vendbanimeve të Kosovës, në versionin serbisht që ende Serbia e mban si regjistër zyrtar, duke kundërshtuar ndryshimet e bëra ndërkohë në Republikën e Pavarur të Kosovës, të cilën Serbia ende nuk e njeh si shtete më vete.

**3) Disa shembuj serbisht dhe 2 versionet e propozuara për  
ndryshim në shqip 1942 / 2001**

Nr. rendor	serbisht	shqip 1942	Vërejtje 2001/2004
<b>a) Nga Kosova Qendrore</b>			
1)	Grlica	Qafëza	Gur-i
2)	Varoš	Varoshi	Varosh-i
3)	Jažince	Jazhincja	Jazhincë-a
4)	Sevce	Sevcja	Sevcë-a
5)	Uroševac	Ferizaj	Ferizaj
6)	Nerodimlje	Shterpore	Nerodime (Poshtme / Epërme)
7)	Staro Selo	Fshati i Vjetër	Fshat i Vjetër
8)	Požarane	Flakadan	(Pozheran) Poshtan-i /a/e/
9)	Gnjilane	Gjilani	Gjilan-i / shqiptimi ll/l!/?
10)	Podgradnje	Rranxa	(Pograxhë?) Gurgat-i
11)	Babush	Babush	Babush i
12)	Shtimlje	Shtimla	Shtim/e-ja /l/j
13)	Lipljan	Ljipljani ose Ulpiana	Lypian-i
14)	Laplje Selo	Lapi	Laplje Selo
15)	Gračanica	Qyteza	Gračanica
16)	Dobrevo	Miraj	Miradi (E P.)
17)	Belačevac	Bardhaj	Bardhi (M./V/)
18)	Čaglavica	Çagla	Çagllavica
19)	Miloševo	B. Curri ose Milo Shini	Muzakaj
20)	Lebanje /Lebane/	Majta	Lebanë-a
21)	Slovinje	Arëni	( Sllovi) Manastir
22)	Obilić	Abdyl Frashëri	Kastrioti
23)	Metohija (Pod.)	Metohija (Rr. D.!)	Metehi-a (Bes.)
24)	Priluzje	Prelushi	Prelluzhë-a
25)	Samodreža	BesaBesa	(Samadrexhë-a) Lumkuq-i
26)	Vučitrn	Vuçiterna	Vushtrria
27)	Babljak	Bablaku	Bablak-u

**Shënim:**Metohija sipas L 1942 kupton Rrafshin e Dukagjinit, ndërsa sipas Ls dhe R 2004 kuptohet një vendbanim i Besianës (Podujevë).

**b) Nga Metohija dhe Zona e Prizrenit**

- |                |                |   |
|----------------|----------------|---|
| 1) Crmjan      | Cerminiani     | Cërmjan-i   |
| 2) Garaždevac  | Malësija       | Gorazhdec-i   |
| 3) Ratkovac    | Luftari        | (Ratkoc-i) Drinas   |
| 4) Orahovac    | Orahova        | Rahovec-i   |
| 5) Zrze        | Zërze          | Xërxë-a   |
| 6) Rogovo      | Rugova         | Rogovë-a  |
| 7) Suva Reka   | Lumi           | (Suharekë-a) Theranda   |
| 8) Movljane    | Movlana        | (Muhlan-i) Malas-i  |
| 9) Bjelo Polje | Fusha e Bardhë | (Bellopojë) Dardhishtë-a                                      |
| 10) Dobrusha   | Mireza         | Drenushë-a  |
| 11) Gjurakovac | Gjergjaj       | (Gurakoc-i) Gurrakoc-i  |
| 12) Vrelo      | Vrella         | Tedel-i   |
| 13) Belica     | Bardhëza       | (Belincë-a) Belaj   |
| 14) Srbica     | Kosëza         | (Sërbica e Epërme) Arbnor-i<br>(Sërbica e Poshtme) Arbnesh-i) |
| 15) Obrinje    | Avaraj         | Abri (e Poshtme)  |
| 16) Drenica    | Dreni-a        | Drenica   |
| 17) Budisavić  | Budi,          | Budisals (Kl.)  |
| 18) Dobra Voda | Ujmiri         | Ujëmir-i  |
| 19) Vrani Do   | Vrana          | Vranesh !   |
| 20) Cerovik    | Bajram Curri,  |   |
| 30) Banjić     | Baja           | Bajëz (Baica)   |
| 31) Dobriševac | Augusta        | Dobrosh!  |

Listen më sipër me propozimet përkatëse ne po e lëmë pa koment.

**4) Disa konstatime me pikëpyetje**

Ne do të përmendim ndonë shembull nga secili rajon që studiuesi i vëmendshëm të ketë mundësi të bëjë krahasime e konstatime të tjera me interes shkencor, duke krahasuar gjurmët brenda emërtimeve në raportin *shqip-serbisht-gjuhë tjetër* në të dyja zonat e Kosovës 1) *Rrafshin e Dukagjinit* me rrethinë dhe 2) *Rrafshin e Kosovës* me rrethinë, të cekura nga dy dokumentat e sipërkonsultuar ai i vitit 1942 dhe teksti aktual në serbisht.

E para, këto dy zona që e përbëjnë sot Kosovën shikuar historikisht nga pikëpamja e emërtimeve të vendbanimeve nga të dyja gjuhët shqip-serbisht nuk paraqesin ndryshime të mëdha, apo jo? Studiuesit konstatojnë që nga paramesjeta e mesjeta edhe në këto dy zona protoshqiptarët si autoktonë priten veç ardhacakëve të tjerë edhe ardhacakët sllavë me të cilët ndërkohë domosdo bënë njëfarë simbioze bashkëjetese. Që të dyja këto gjuhë, shqipja e sllavishtja, e sidomos serbishtja, nuk e kanë lehtë të dallojnë ndikimin e vet gjuhësor në emërtimet e vjetra të qyteteve të sotme të Kosovës. Jo vetëm Prishtina, Prizreni, Peja, por edhe Vushtrria, Mitrovica, kanë shpjegime të ndryshme jo të qarta në gjuhët përkatëse. Po ashtu edhe emrat Gjakova (Djakovica), Podujeva (Besiana), ka mosputhje shpjegimi ndërgjuhësor. Ndërkaq, për ndryshimet Ferizaj (Urosevac), Serbica (Skënderaj), të cilat veç dihen, ngase pala serbe në administratën pas L2B ka pasur rast t'i dëgjojë dhe faktikisht t'i pranojë, ndërsa, për propozimet më të reja: Novo Brdo/Novobërdë (Artana), Suva Reka /Suhareka (Theranda), Dragash (Sharri), Glogovce/Gllogoci (Drenasi) mund të kërkohen sqarime nga Komisioni përkatës. Mirëpo është e vërtetë se disa emërtime sllave dalin të shënuara në mënyrë të organizuar nga pushtetet bullgare e serbe që nga mesjeta, por edhe këto pasi dalin të shqiptuara nga goja e shqiptarëve që nga fillimishtja e deri në ditët e sotme dalim njëtrajtshëm të deformuara (të pranuar) në shqipe dhe nga kjo dukuri dëshmohet prania shqiptare, të ngulitur, që më parë e pa shkëputje në këto troje. Sidoqoftë këto dy të vërteta nga të dyja palët nuk duhen keqpëdorë si mosmarrëveshje. Është fjala për këto dy konstatime me rëndësi, e para nuk mund të mohohet në mjaft raste emërtimi bazë nga gjuha sllave dhe e dyta nuk mund të mohohet përdorimi i emrave të tillë nga goja e shqipfolësve që nga fillimi e në vazhdimësi, ngase trajtat e tilla tek të gjithë shqipfolësit dalin të konsoliduara pikërisht sipas ligjeve të brendshme fonetike e morfologjike të gjuhës shqipe, apo jo?

E dyta, duhet mirëkuptuar e vërteta, se në këto vise: Rrafshi i Kosovës dhe Rrafshi i Metohisë (Dukagjinit) në periudha të caktuara, elita e pushtetit qendror sundues si gjuhë administrative praktikonte sllavishten, ndërkaq sundimtarët vendorë mund të ishin edhe shqiptarë e vllahë, por që domosdo respektonin pushtetin superior, andaj pse mos të pranohet e vërteta se shumica e banorëve ishte përherë shqiptare, e cila vërtetohet edhe nga fakti se gjuha vllahë ndërkohë u shkri në shqipe. Pra, edhe pse edhe ata ishin nën pushtetin serb dhe më vonë edhe nën pushtetin turk, vllahët gjuhësisht nuk iu bashkuan gjuhës së sundimtarit ose asaj kishtarë, por gjuhës së

shumicës folëse shqiptare dhe kështu shqipen e bënë gjuhë të veten. Kjo mbështetje logjike si e vërtetë e verifikueshme s'mund të mohohet dot.

E treta, pse mos të pranohet gjithashtu e vërteta tjetër se qysh para ardhjes së sllavëve banorët paganë të këtyre viseve (shqiptarë e vllahë) e kishin pranuar fenë kristiane, e cila u trashëguua edhe tek ardhësit. Madje me ndarjen e perandorisë romake, përkatësisht të fesë Lindore ortodokse dhe Perëndimore (katolike) shumica e banorëve të këtyre vendbanimeve ranë nën Bizant dhe liturgjia kryesisht bëhej sipas rritit fetar që respektonin sundimtarët, kështu vepronin domosdo edhe serbët edhe shqiptarët të së njëjtës bashkësi. Pra kështu ishte para se serbët ta fitonin autoqefalinë, prandaj serbët duhet pranuar se si ortodoks kristian para tyre ishin shqiptarët dhe vazhduan jetën e përbasahkët edhe pas autoqefalisë serbe, qoftë si ortodoksë, qoftë në raste bashkëjetese edhe sipas variantit greko-bizantin, madje edhe si katolikë ose kriptokatolikë.

E katërta, është e vërtetë se me rënien e vendit nën Perandorinë Osmane, kisha ortodokse serbe doli më e organizuar, ngase edhe më e pranuar se ajo katolike nga pushteti osman. Edhe në këtë rast në Kishën serbe u gjenden shumica e banorëve shqiptarë të viseve tona, pa përjashtuar edhe variantin romejbizantin, madje edhe rrymën kriptokatolike.

E pesta, gjithashtu duhet kuptuar e vërteta tjetër që edhe shqiptarët edhe vllahët ortodoksë në këto treva si gjuhë kishtare e kishin serbishten gjuhën e trashëguar të sundimtarit edhe në kohën e sundimit osman, andaj nuk përjashtohet as sllavizimi i një pjese dërmuese e tyre (vllahëve dhe e shqiptarëve) në sllavë (bullgarë e serbë).

E gjashta, është e vërtetë, se po gjatë asaj periudhe për shkak gjuhe dhe për interesa disa krenë shqiptarë kryesisht respektues të rritit ortodoks, përqaftuan islamizmin, fe e re kjo e cila u fuqizua ndërkohë, edhe si reaktion ndaj pravosllavës serbe, të fuqizuar nga nacionalizmi pansllavist serb nën ndikimin e Rusisë cariste, kur kërkohet me çdo kusht serbizimi i elementit shqiptar, apo jo?!

E shtata, është e vërtetë se tek emërtimet e vendbanimeve shihen gjurmë të dy gjuhëve, zakonisht trajta zyrtare tregohet më me qartësi sllave, të mveshura me disa prapashtesa të përvetësuara, ndërkaq, përveç disa fjalëve me origjinë josllave pothuaj të gjithë shembujt aktual të serbishtes në gjuhën shqipe të mbarë shqifolësit dalin të deformatuara (pranuara) njësoj ose të përshtatura sipas sistemit të gjuhës së vet dhe kjo vërteton që shqipja dilte mjaft e konsoliduar nga kjo pikëpamje, sepse i kishte të ravijëzuara thellë

ligjet strukturore brenda sistemit fonetik e morfologjik autokton, siç ishin prapashtesat –OJË, -AJË, -ARË, -ONË e ndonjë tjetër.

Sidoqoftë ne për hir vendi nuk po i sjellim në analizë të gjithë shembujt, por megjithatë do të japim kalimthi ndonjë vërejtje vetëm për disa nga shembujt më karakteristikë, sa për të treguar pos tjerash se jogjithherë elementet e serbishtes ishin parësore në emërtimet përkatëse.

### **5) Vërejtje të elementeve të shqipes në formëzimin e vendbanimeve përkatëse**

Ne në këtë kontekst nuk vërejtëm elemente të pakta të shqipes në raport me serbishten (lëndë kjo paksa e trajtuar edhe në pjesën e dytë, f. 120), andaj lidhur me këtë, vërejtjet tona po i japim në disa pika:

#### **a) Trajta në shqipe duket si parësore**

Ja pse themi se në krahasim me shqipen trajta e serbishtes duket si përkthim:

E para, meqë gjuhës vendçe sllave këndeje i mungon **H-ja** disa emrave vendesh në serbishte janë shënuar pa këtë nistore si Ajvalija, Ajkobila, Arilaça, Enc, Ereç, Alabak, trajta e shqipes del me përparësi, ngase më mire e tregon realitetin, si: Hajvalia, Hajkobilla, Harilaça, Henci, Hallashi, Hereçi, Halabaku etj.

E dyta, meqë serbishtes i mungon bashkëtingullorja **DH** emrat e shqipes si Palabardhë, Lumibardhë, Ibar(dh) Bardh, Badhoshan, Shurdhan etj. në atë gjuhë janë shënuar me d ose ll, si: Palabarda, Lumbarda, Ibar, Bardoniq, Bardosan, Shurlane.

E treta, bien në sy rastet si Zym, Çyçyl, Dyz, Syleviqi, Çyshku Qypevë që në serbishte del Zjum, Çuçul/aga, Duz, Suljeviq Qushka, Qupevo etj., sepse asaj gjuhe i mungon tingulli **Y**.

E katërta rasti me X, del me Z si Zrze për Xërxë.

E pesta, rasti me RR që i ka përvetësuar edhe disa trajta të serbishtesh me r/rn Rrenc për Rence, pastaj Čërrnicë /Crnice Carralevë, Crnolevo, Carrallukë Crnillug, Carravranë Crna Vrana etj, etj.



## b) Emërtimi nga rrënja ose fjala e qartë shqipe:

Emërtimi i vendbanimit nga rrënja ose fjala shqipe vërtetohet në disa raste, si:

E para, siç janë shembujt: *Zabel, Lug, Kodër, Keq,*

E dyta, vihen re disa emra venbanimesh pa prapashtesën e zakonshme serbe (-E) po me atë -A, si trajtë e shquarsisë përfaqësuese shqipe, si: *Nika, Eleza, Vata, Raça, Viça, Shkoza, Dren-i, Hilja, Firza* etj.

E treta, rastet e fiseve shqiptare: *Berisha, Kabash, Gash, Shalë, Morinë, Krasniqe* etj.

E katërta, emra me prapashtesën shqipe -AJ, si: *Hulaj, Miraj, Lukenaj, Rapaj, Racaj, Pacaj, Gjonaj* etj.

E pesta, paraqitja e termave në serbishte me fundore prapashtesën OC në shqipe e asimiluar nga ajo e serbishtes -OVAC, ose OVCE, si p.sh. :

*Rakoc, Grkoc, Ramoc, Rashkoc* – prirje kjo që në shqipe mbizotëron edhe për shembuj të tjerë si:

*Glogoc për Glogovac, Davidoc Davidovac, Gjinoc Gjinovce, Drenoc Drenovce* etj.

E gjashta, në shqipe (te ne) asnjë emëtim me fundoren -O të sllavishtes si :

*Maçitevë - Maçitevo. Novobërdë Novo Brdo, Novaselë Novo Selo, Gracka e Vogël Malo Gracko, Vranakollë Vrnakolo, Popovë Popovo, Minjera Kosova Rudnik Kosovo, Çikatovë e Vjetër, Staro Çikatovo, Çikatovë e Re Novo Çikatovo, Dobëdol Dobri Do, Suhagërlë Suvo Grlo, Glanasellë Gladno Selo, Krajkovë Krajkovo* etj.,

ngase tingulli fundor O në shqipen tonë zhduket duke marrë emri i shqipes fundoren përkatëse -Ë të zakonshme sipas pashquarsisë.

E shtata, zanorja O e serbishtes në shqipe në trup të fjalës rëndomë në emërtimet e vjetra shqiptohet A, si: *Obrinje Abrij, Motiçane Matiçan* etj.

E teta, mosrespektimi i eptimit në kategorinë e rasave të serbishtes standarde, veç tjerash edhe te ky rast, në vend: *rodjen u Reçanima, Deçanima...*, në serbishten *nashke* del: ***rodjen u Reçane, Deçane...*** Krahaso shqip: ***Lindur në Reçan, Deçan...***, e kështu me radhë.

**c) Trajta të përbashkëta ose të ndërndikuara indirekt në trajtën e pashquar:**

E para, parapashtesa –AJË/AJA e shqipes te rastet: Firajë, Blagajë, Devajë, Romajë, Sinajë, Cerajë që në serbishte dalin: Firaja, Blagaje, Devaja, Romaja, Sinaje, Ceranja,

E dyta, me prapashtesën –ANË/ANA, si: *Peranë, Bërçanë, Brodosanë, Berçanë, Režhanë, Labjanë, Bleçanë, Glodzanë*, që në serbishte del me –A ose –E fundore, por *Muzhiçane* në shqipe del fundorja –inë: *Muzeqinë*.

E treta, rastet me: –AVË/AVA: Batllava, Morava, Duližava, Dubrava.

E katërta, rastet me –EVË/EVA: *Barileva, Glareva, Milosheva, Meçiteva*, që në serbishte marrin fundoren –O, si Maçitevo, Miloshevo etj.

**ç) Trajta të përbashkëta të huazuara nga turqishtja:**

E para, me mbaresën –IJE: *Sofalije, Hamidije, Bakshije*, që në shqipe dalin zakonisht me –I fundore ose të shquara me –A fundore si *Sofali-a, Hamidi-a, Hajvali-a Hajvalia*, në serbishte me –IJA fundore zakonisht.

E dyta, trajta të pandryshuara në trajtën e pashquar, por në të shquarën ndryshon raporti, si *Halabak-u Qerim-I, Çifllak-u, Kullë-a* etj.

**d) Raste që qëndrojnë si dyjare:**

E para, rastet shqipe që ishin në përdorim zyrtar në këtë Regjistër (spisak) nuk janë shënuar fare, si: si Suharekë për Suva Reka, Suhogërlë për Suvo Grlo, Gjakovë për Djakovica, Rahovec Orahovac, Vushtrri Vuçitrn, Veçitrn etj.

E dyta, edhe trajta shqipe si dyjare nuk është e shënuar në këtë burim, siç janë rastet: ***Ferizaj*** për *Uroshevac dhe Skënderaj* për *Srbica, Rrafshi Dukagjinit* për *Metohija* etj.

Sidoqoftë, për studiuesit, edhe në këtë aspekt mbesin shumë çështje të hapura që kërkojnë trajtime shkencore.

## **(VI) NGA REGJISTRI AKTUAL I QYTETEVE DHE FSHATRAVE TË KOSOVËS SIPAS RAJONEVE**

(version i rikthyer ose i ribërë pas Pakos së Ahtisarit, 2007-2013)

### **H y r j e**

Këtë Regjistër, i cili aktualisht është në përdorim zyrtar po e vështrojmë nga këto pikëpamje:

e para, si është bërë ndarja e re në qarqe (rajone administrative) territori i Republikës së Kosovës,

e dyta, si janë shënuar emërtimet e komunave në këtë Regjistër duke respektuar administratën 3 gjuhësore: shqip-sebisht-anglisht dhe

e treta, si qëndron raporti i numrit të risimeve të propozuara sipas Regjistrit të Komisionit (2005), kundrejt këtij për secilën komunë, duke theksuar ndonjë vërejtje edhe në raport me versionin serbisht.

#### **1) Ndarja e re e territorit të Kosovës sipas qarqeve (rajoneve) administrative**

Sipas këtij regjistri Republika e Kosovës është e ndarë në shtatë rajone (qarqe) dhe secili qark përfshin komunat si vijon:

**1. Rajoni i Prishtinës:** *Fushë Kosovë, Gllogoc, Çraçanicë, Lipjan, Novobërdë, Podujevë, Prishtinë* - 7 komuna;

**2. Rajoni i Pejës:** *Istog, Klinë, Pejë* – 3 komuna;

**3. Rajoni i Prizrenit:** *Dragash, Malishevë, Mamushë, Suharekë, Prizren* – 5 komuna ;

**4. Rajoni i Mitrovicës:** *Leposaviq, /Mitrovicë /J+V/, Skënderaj, Vushtri, Zubin Potok, Zveçan* – 6 komuna;

**5. Rajoni i Gjilanit:** *Gjilan, Kamenicë, Kllokot, Partesh, Ranillug, Viti* – 6 komuna;

**6. Rajoni i Gjakovës:** *Deçan, Gjakovë, Junik, Rahovec* – 4 komuna;

**7. Rajoni i Ferizajt:** *Ferizaj, Hani i Elezit, Kaçanik, Shtërpçë, Shtime* – 5 komuna.

**Vërejtje:**

Siç po shihet, Republika e Kosovës momentalisht ka 7 qarqe (rajone) me 37 komuna. Janë themeluar 8 komuna më shumë në krahasim me Regjistrin nga versioni serbisht, përkatësisht 7 në krahasim me RSEK. Ndërkaq sa u përket qarqeve administrative ndërkohë janë inkorporuar dy regjione: Qarku i Ferizajt dhe Qarku i Gjakovës.

**2. Regjistri aktual dhe emrat e komunave të Kosovës sipas administratës tregjuhësore shqip-serbisht-anglisht**

Ja si dalin të shënuara aktualisht në administratën tregjuhësore (shqip, serbisht, anglisht) në Kosovë emrat e 37 komunave:

Shqip	Serbisht	Anglisht
Deçan	Dečane	Decan
Gjakovë	Djakovica	Gjakova
Glllogoc (Drenas)	Glogovac	Glogovac
Gjilan	Gnjilane	Gjilan
Dragash (Shar)	Dragaš	Dragash
Istog (Burim)	Istok	Istog
Kaçanik	Kaçanik	Kacanik
Klinë	Klina	Klina
Fushë Kosovë	Kosovo Polje	Fushe Kosove
Kamenicë (Dardanë)	(Kosovska) Kamenica	Kamenica
Mitrovicë	(Kosovska) Mitrovica	Mitrovica
Leposaviq	Leposavić	Leposaviq
Lipjan (Lypjan)	Lipljan	Lipjan
Novobërdë (Artanë)	Novo Brdo	Novo Brdo
Obiliq (Kastriot)	Obilić	Obilic
Rahovec	Orahovac	Rahovec
Pejë	Peć	Peja
Podujevë (Besianë)	Podujevo	Podujevo

Prishtinë	Priština	Pristina
Prizren	Prizren	Prizren
Skënderaj	Srbica	Skenderaj
Shtime	Štimlje	Stimlje
Shtërpçë	Štrpce	Shtpce
Suharekë (Therandë)	Suva Reka	Suva Reka
Ferizaj	Uroševac	Ferizaj
Viti	Vitina	Viti
Vushtrri	Vučitrn	Vushtrri
Zubin Potok	Zubin Potok	Zubin Potok
Zveçan	Zvečan	Zvecan
Malishevë	Mališevo	Malisheve
Hani i Elezit	General Janković	Hani i Elezit
Mamushë	Mamuša	Mamush
Junik	Junik	Junik
Klokot	Klokot	Klokot
Graçanicë	Gračanica	Gracanice
Ranillug	Ranilug	Ranilug
Partesh	Parteš	Partesh

---

## Sqarim

Në krahasim me tekstin serbisht ku vetëm Gora ndahej nga Opoja, e cila i mvishej komunës së Prizrenit, e cila në të vërtetë sipas ligjeve të Kosovës as që ishte e ndarë nga Opoja dhe që të dyja, **Gora** dhe **Opoja i** takojnë komunës së **Dragashit (Sharrit)**, por janë krijuar edhe 7 komuna të reja, ndër to me shumicë shqiptare, tri: **Malisheva**, **Juniku** e **Hani i Elezit**, pastaj 1 fshat me shumicë turke: **Mamusha**, si dhe katër komuna me shumicë serbe: **Klokoti**, **Graçanica**, **Ranillugu** e **Parteshi**. Gjithashtu është krijuar edhe një komunë binare **Mitrovica e Veriut** (me shumicë serbe në njërin anë dhe **Mitrovica e Jugut** me shumicë shqiptare në anën tjetër.

Në të vërtetë, **Mitrovica e Jugut dhe Mitrovica e Veriut** e formojnë një bord të përbashkët funksional që përfaqëson një komunë, Bordi do të zhvillojë bashkëpunim funksional në sferat e kompetencave vetjake komunale. Bordi përbëhet nga 11 anëtarë, me nga pesë përfaqësues

të zgjedhur nga secila komunë dhe një përfaqësues ndërkombëtar i zgjedhur nga PCN, i cili e kryeson bordin.

Sipas të dhënave, selitë e të gjitha komunave përkojnë me emërtimin e vetë komunës për veç komunës së Novobërdës, selia e të cilës është në **Bostan** (fshat afërt Novobërdës).

Për ne gjithashtu zgjon interes fakti, se si dalin të shënuara emrat e komunave në tri versionet shqip, serbisht dhe anglisht. Të vihet re se si në versionin anglisht shënohen ortografikisht shkronjat e veçanta dhe cili version pëlqehet më shumë ai shqip apo serbisht? Nuk dime a ka pasur ndonjë kriter apo është bërë zgjidhje spontane?!

Sipas Pakos së Ahtisarit me shumicë serbe u formuan këto komuna të reja (5+1) **Graçanica, Klokot-Vërbas, Partesh, Ranillug dhe Mitrovica e Veriut**. Gjithashtu **Nëvobërda** u bë Komunë e zgjeruar me oikonime të reja me popullatë kryesisht serbe, ashtu siç ishte edhe **Shtërpca** dhe **Gora** kryesisht sllavishtfolëse, e cila, siç u tha, bashkë me Opojën shqipfolëse e formojnë komunën e **Sharrit** (Dragashit). Kështu bashkë me tri komunat e Veriut: **Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq**, po zyrtarizohen 10 Komuna ose lokalitete me shumicë serbe, dhe së këtejmi bashkë me Gorën si komunë potenciale po bëhen 11 komuna sllavishtfolëse.

Me sa pamë, në Regjistrin e versionit serbisht asnjë emër nuk vihet në versionin shqip si dyshor që ishte i legalizuar edhe para Çlirimit, ndërkaq në Regjistrin e Komisionit Qendror (emërtimet sllave, vihen paralelisht (qytetet në Kllapa), ndërsa në Regjistrin më të ri pas Paketës së Ahtisarit del e kundërta në kllapa vihet emri i ri i qytetit të propozuar shqip, parësor mbetet ai i mëparshmi, i zyrtarizuari serbisht.

### 3) Numri dhe realizimi i ndryshim-risimeve të propozuara të vendbanimeve për secilën komunë sipas regjistrave 2005/2015

Nr. r.	Komuna	Risimet 2005	2013	Vërejtje
--------	--------	-----------------	------	----------

#### 1. Rajoni i Prishtinës

1) Prishtinë                      20/18 ndaj 47                      0/41

2) Podujevë (Besiana)	55/46	‘76	2/76	Besiana, Livadhia
3) Obiliq (Kastrioti)	10/11	‘19	5/19	Kastrioti, Dardhishta, Muzakaj, Mirashi, Lulegjaku
4) Novobërdë (Artana)	1/1	‘13	1/24	Artana
5) Lipian	34/3168		3/70	Bregzi, Krojmiri, Shala
6) Graçanicë	-		0 16	
7) Glogoc (Drenas)	20/1836		0/37	
8) Fushëkosova	11/11	18	4/15	Bardhi (i Madh/i Vogël), Lismiri, Miradia (e Epërme/e Poshtme), Fushëkosova

## 2. Rajoni i Gjilanit

1) Kamenica (Drdania)	29/1774		1/58	Dardania
2) Gjilan	25/2160		0/54	
3) Klllokot	-		0/3	
4) Partesh	-		0/4	
5) Ranillug	-		0/13	
6) Viti	14/10/	44	0/39	

## 3. Rajoni i Mitrovicës

1) Zveçan	3/2	35	1/35	Keqi Dol?
2) Zubin Potok	2/0	63	2/29	Përroi i Megjës, Bregu i Madh?! (i Veles)
3) Vushtrri	34/29	67	4/67	Liqej, Maxhunaj, Begaj, Shalë, Studime (e Epërme /e Poshtme! /serb. Sudimlja
4) Skënderaj (Srbica)	22/1652		4/52	Skënderaj, Pemishta, Syriganë
5) Mitrovicë	26/1648		2/45	Frashëri, Kodra
6) Leposaviq	2/172		0/42	

## 4. Rajoni i Pejës

1) Pejë	48/39	91	2/14	Stakaj ?, Llazdrelaj?
2) Klinë	33/25	58	0/54	
3) Istog	34/24	52	1/50	Burimi.

## 5. Rajoni i Gjakovës

1) Rahovec	13/1035	3/35	Drinas, Fortesë, Guri i Kuq
2) Junik	-	0/3	
3) Gjakovë	13/8	86	1/86 Fshajë-a ?
4) Deçan	13/6	40	1/37 Rrafshi (i Epërm//i Ulët!!!)

## 6. Rajoni i Prizrenit

1) Suharekë (Therandë)	24/23	42	0/42 Therandë
2) Prizren	20/19	76	2/74 Breg-Drini, Malësia e Re!!!
3) Mamushë	-	0/1	
4) Malishevë	22/15	44	4/43 Burimi, Fshati i Ri, Gurëbardhi, Gurishta
5) Dragash (Sharri)	6/3	36	2/36 Sharri, Buzezi ?

## 7. Rajoni i Ferizajt

1) Shtime	10/1	21	0/23
2) Shtërpçë	1/0	16	0/16
3) Kaçanik	26/20	46	0/31
4) Hani i Elezit	-	1/21	Hani i Elezit
5) Ferizaj	17/84	3/46	Ferizaj, Balaj, Dardan-i

**Sqarim.**- Numri i parë i risimeve është marrë nga vepra e Begzad Baliut, e dyta nga Regjistri të Komisionit, shihen mospërputhje sa i përket numrit të vendbanimeve në raport *Regjistri i Komisionit ndaj Regjistrit aktual*.

Përveç numrit të ndryshim-risimeve të propozuara të vendbanimeve në të dy regjistrat në pëmbyllje- përfundim të pjesës së parë do të jepet edhe ndonjë sqarim me interes.



## Përfundimi i pjesës së parë

Para se të japim përfundimin e pjesës së parë e shohim të arsyeshme të cekim një çështje që i ka përcjellë të gjithë dokumentat, përkatësisht realitetin rreth emrave toponimikë, por që më e tejpushëm del në oikonime. E kemi fjalën për disa emra që janë të papërshtatshëm për shoqërinë normale. Ne, këtë dukuri e kemi vërejtur në të dyja gjuhët: serbish e shqip. Kështu janë disa emra të *çuditshëm*, jo vetëm qesharakë, por edhe pejorativë ose “*me marre*” siç quhen te ne, sepse përbëhen nga fjalë banale.

Në një tekst wikopedie në serbishte lexova se për ndonjë shembull të tillë faji i hedhet kohës së Turqisë, por jo vetëm asaj, ngase kjo dukuri është e pranishme edhe sot, siç cekën edhe këta shembujt:

*Brlog, Kurici, Smrdica, Zlakuqan, Svinjishte, Zlodol, Zlokuqa, Kuruçina, Poganovo, Sisevac, Donje Brijanje etj.*

Shumica të cilëve ndërkohë janë ndryshuar nga banorët, ose ndryshimi është në proces e sipër. Sidoqoftë, edhe te ne ndeshim emërtime të tilla banale, deri tani pa i hedhur fajin kohës së administrimit sllave, po te ne nuk duket se ka filloi procesi i ndryshimeve.

Në vijim po i përmendim disa emërtime venbanimesh kryesisht në Shqipëri me prejardhje sllave të mbetura që nga lashtësia, pa u prishur kush komoditetin, ndoshta pse popullsia shqipfolëse nuk ua dija përmbajtjen, apo jo?! Ja disa shembuj:

*Mërdicë, Jericë, Kërpicë, Greshicë, Grobovicë, Babicë, Gllavë , Lapardhicë, Gomnasellë, Cërrnillë, Gërdec, Seran Sericë etj.*

Të gjitha këto emërtime fshattrash, por ka edhe emërtime të tjera që në shqipe kanë kuptime fjalësh tejet banale, për turp e marre. Pa u zgjatur po ia kujtoj lexuesit (edhe banorëve që e bartin) se b.f. emri i fundit me prejardhje sllave **Seran** ose **Sericë** në shqipe ka kuptimin: **I dhier, E dhier** (*poserem, userem-dhiej, me dhie, sernica - nevojtoje*), kuptim të ngjashëm vulgar kanë edhe shembujt e tjerë.

Pse kanë mbetur emrat e tillë? Na merr mendja që më fort kanë mbetur pa u trazuar fare, për shkak se banorët shqipfolës, nuk ia kanë ditur

përmbajtjen e emrit përkatës në origjinal, andaj emrat e tillë janë trashëguar nga vendasit mbase edhe me ndjenja krenarie (!), duke i konsideruar si emra të lavdishëm, apo jo?! Së këtejmi, shtrohet pyetja tash e mbas do t'i ndryshojnë shqiptarët emërtimet e tilla banale sllave të vendbanimeve të tyre, apo jo?

Po nuk është vetëm kjo e pamirë në emërtimet në gjuhën shqipe. Është e vërtetë se edhe brenda emërtimeve të tjera me fjalë shqipe në përdorim, qoftë në Shqipri, qoftë në Kosovë kanë mbetur emërtime të çuditshme vendbanimesh, aspak të përshtatshme për një shoqëri normale, si b.f. në Shqipri:

*Vithkuq, Gopesh, Karicë, Qinam, Kardhiq, Symizë, Hundëkeq, Kerth., Lapërdha, Macuk, Kryevindh, Bishqen, Kakërdhiq, Karkovc deri edhe Bithuq, Mutravë, Prapapanicë, Kaçinar, etj.*

Edhe në Kosovë ndeshim disa emra të tillë, si:

*Muçibaba, Muçivërci, Gjylekari, Nëpërbishti, Skarrabishti, Qyqylaga, Kaçibegi, Karaqeva, Karaçica, Llukari etj.*

Sigurisht kjo çështje nuk duhet lënë stihisë. Komisionet ose institucionet duhet të japin ndihmën profesionale si është më së mirë që emrat e tillë, aty ku është e domosdoshme për një shoqëri normale patjetër të ndryshohen.

Sidoqoftë, pra, edhe kjo dukuri mund dhe duhet të zgjidhet me respektimin e rregullave të specifikimit ose specializimit të tëmëformave më të përshtatshme të emërformimit, duke futur në veprim edhe afikset përkatëse fjalëformuese të specifikuara për nënfusha të caktuara semantike, e rëndësishme kjo edhe për konsolidimin e drejtformëzimit dhe drejt-fjalëformimit të të gjitha toponimeve oikionimike në gjuhën shqipe: në Kosovë, Shqipri dhe gjithandej Trojeve shqiptare.

Në punimin tonë, veç tjerash u konstatua e vërteta se një numër të konsiderueshëm emërtimesh të vjetra të vendbanimeve të regjistruara aktualisht në funksion i kishim të trashëguara ose të propaganduara si të tilla nga gjuhët e huaja, por nuk përjashtohen raste që edhe te emërtimet e tilla, kryesisht të qyteteve të vjetra dhe të maleve e lумеjve të mëdhenj, por edhe disa vendbanimeve vërehen edhe gjurmë të gjuhës origjinale të shqipes së lashtë (protoshqipes). Sidoqoftë, në këtë kontekst paraqiten vështirësi, sepse ç'është e vërtetë, shqiptarët që nga mesjeta e vonë nuk patën fatin historik të kenë një shtet qendror të vetin, ku do të dominonte zyrtarisht gjuha shqipe me fjalë kuptimplota të pranueshme, atëherë si shumë çështje të tjera, edhe, çështja e oikonomisë shqiptare del jo vetëm e paqartë, por aq më tepër e

politizuar dhe keqpëdorur nga grekët dhe nga sllavët (serbët, bullgarët e malazezët), por më vonë edhe nga turqit. Ky politizim dhe keqpërdorim ka ndodhur edhe për faktin se studimet e kësaj fushe më fort për shkaqe objektive se subjektive kanë munguar nga vetë shqiptarët, pasi për ne, për historinë tonë kanë shkruar më shumë të tjerët sesa ne për vete. Një mungesë ose pamundësi e tillë nga pala shqiptare është shfrytëzuar, sidomos nga serbët, të cilët edhe e kanë keqpërdorur për qëllime makiaveliste albanofobe, andaj sa herë që shqiptarëve u shkoi për dore që sadopak të konsolidoheshin me dije e si me pushtet e shihnin të nevojshme dhe të domosdoshme që emërtimet e tilla me prejardhje sllave të përpiqeshin me i rishikue ose t'i rikthenin ose edhe t'i zëvendësonin me emërtime më të përshtatshme, sepse ato janë keqpërdorur dhe ende po vazhdojnë të keqpëdoren në kurriz të popullit tonë. Kjo është arsyeja që ne në nënpjesën e parë të kësaj pjese të punimit, duke pasqyruar realitetin e sotëm u dhamë përparësi përpjekjeve të tilla që së paku me fjalë të pasqyrohen problemet e shprehura me të cilat janë duke u ballafaquar të gjitha qendrat përkatëse shqipfolëse, së pari trajtuam gjendjen në Kosovë, së dyti, në Shqipëri dhe së treti, gjithandej në Trojet e tjera shqiptare.

Mjerisht mund të thuhet se njëherëpërnjëherë çështjet e tilla janë ose kanë mbetur në fazën e diskutimeve dhe assesi nuk mund të bëhet fjalë për zgjidhje ose implementimin e ndryshimeve masive të tyre, edhe pse disa ecje përpara lidhur me të kuptuarit e çështjes dhe ndonjë zgjidhje parciale e sukseshme nuk mund të mohohen.

Si do që të jetë, po këtë gjendje jo të lavdueshme lidhur me oikonomet, siç e konstatoam në nënpjesën e parë e konstatojmë edhe në nënpjesën e dytë, ku patëm për konsultim gjashtë regjistra (lista) me emërtime vendbanimesh të shënuara nga trojet shqiptare. Kështu, duke respektuar përparësinë e kohës së publikimit, për secilin burim veç e veç, pas trajtim-konsultimit nxorëm disa konstatime:

Së pari, nga krejt kjo kemi fituar bindjen, siç u cek, që shqiptarëve, sa here që u është dhënë mundësia kanë bërë përpjekje të tregojnë të vërtetën që ata si autoktonë që janë këtu në këto troje që nga parahistoria dhe historia, përherë ishin shumicë dhe i kishin edhe emërtimet e veta toponimike, por ndërkohë romakët, keltët, pastaj bullgarët, serbët, grekët e të tjerë duke shfrytëzuar epërsinë pushtetore ushtarake administrative, manipulonin me emërtimet e vendbanimeve, duke i shënuar me hile në gjuhët e tyre, andaj shqiptarët edhe janë përpjekur me i rikthye ose me i zëvendësue ato, por deri më sot nuk patën suksesin e duhur. Gëzon fakti se

një përpjekje të tillë të organizuar për ndryshimin e emërtimeve të tilla të papërshtatshme në masë të gjerë e kishte ndërmarrë Qeveria e Zogut me 1937/1938, që ne e trajtuam në titullin: *Lista për ndryshimin e emërtimeve të vendbanimeve të papërshtatshme në Shqipëri (1938)*, por për shkak të pushtimit italian vendimi i tillë, me s a dimë, ka mbetur pa u implementuar. Për ne ka rëndësi fakti se propozimet e tilla si material i gatshëm mund të shfrytëzohen edhe sot, qoftë për të nxitur procedurë të mëtejshme sistimore, qoftë për trajtime shkencore ndërdisiplinore.

Së dyti, po ashtu pati përpjekje të organizuar edhe nga Qeveria e Mbretisë Italo-shqiptare (1942), që ne e trajtuam nën titullin: *Lista e toponimeve (sllave) në territoret e lirue me shqipërimet e propozuara (1942)*. Por edhe kjo punë mbeti vetëm si përpjekje, por sidoqoftë edhe ky material mund të shfrytëzohet për të njëjtin qëllim si ai i pikës së mëparshme.

Së treti, të dy ndërmarrjet shtetërore 1938 dhe 1942 për zëvendësimin e emërtimeve të vendbanimeve mbeten të paimplementuara, pra për shkak të L2B, por ashtu mbeten edhe pas asaj lufte botërore, sepse qeveria komuniste e Shqipërisë nuk deshi ose nuk pati fuqi të konfrontohej me aleatin e saj dominues Jugosollavinë, ngase sipas Listës së vitit 1938 ndryshoheshin një shumicë emërtimesh pikërisht me origjinë sllave, ndërsa Lista e vitit 1942, kishte të bënte me vise që përsëri u kthyen nën administrimin e Jugosllavisë II, prandaj emërtime e propozuara deri atëherë as që ishin publikuar, mirëpo kjo nuk do të thotë se gjatë pushtetit komunist 1945-1990 në Shqipëri nuk pati fare ndryshime emërtimesh të vendbanimeve. Për këto ndryshime mësojmë nga burimi i tretë : *Fjalor i emrave gjeografikë të RP-se, Tiranë (2002)*, ku vërejtëm mbi 200 emra vendbanimesh të ndryshuar gjatë këtij regjimi, madje edhe të implementuar. Kjo zbatueshmëri e qëndrueshmëri e emërtimeve të ndryshuara dhe atyre të reja flet për qëndrueshmërinë e administratës shtetërore të regjimit përkatës. Është tjetër gjë që ndryshime ndodhën më tepër sipas natyrës klasore partiake. Sidoqoftë, ky burim (fjalor) është shumë i rëndësishëm, ngase aty i ndeshim të regjistruara pothuaj të gjitha vendbanimet e sotme në Shqipëri. Kështu tash studiuesit kanë në dorë një material të grumbulluar, i cili mund të studiohet nga aspekte të ndryshme. Ne shfrytëzuam fillimisht për çështja drejtshkrimo-fjalëformuese dhe formëzuese dhe paksa mësuam nga praktika e tillë shkrimore, por hetuam edhe mbi 200 ndryshimet e oikonimeve përkatëse.

Së katërti, në vitin 1999, fill pas Çlirimit të Kosovës, po ashtu në mënyrë të organizuar u ndërmorën masa për standardizimin (ndryshimin ose vlerësimin e përshtatshmërisë) e një morie të emërtimeve të tilla në Kosovë. Nga analiza që i bëme Regjistrin të Komisionit Qendror me titull *Regjistri i standardizuar i emërtimeve të Kosovës* (2005), i përgatitur pothuaj në vitin 2000-2001, por i përplotësuar derisa iu dorëzua Qeverisë më 2004. Mirëpo edhe pse ky tekst u vlerësua lartë, edhe ky mbeti ende pa u shqyrtuar dhe implementuar nga organet përkatëse të shtetit të Kosovës, më fort për arsye ndërhyrjeje kompetencash, por edhe për disa arsye të tjera.

Së pesti, në përveç këtyre katër burimeve, të cilat në njëfarë dore mund t'i quajmë sadokudo të trajtuara, konsultuam edhe burimin paralel versionin serbisht për emërtimet në Kosovë me titull *Okruzi, gradovi i sela Kosova i Metohije* (2015), (Qarqet, qytetet dhe fshatrat e KM-së), ku konstatuam raportin e ndryshimeve ndaj Regjistrin të Komisionit Qendror për Standardizimin e Emërtimeve të Vendbanimeve të Kosovës (2005).

Së gjashti, meqë Regjistri i Komisionit 2005 siç u cek ende nuk është trajtuar në krahasim me versionin paralel në serbisht, ndërkohë u rikthye në përdorim, si me thënë, “i vjetri”, por paksa i përpunuar dhe i përplotësuar, që tashpërtash është në përdorim e sipër në tri gjuhë: *shqip, serbisht, anglisht*, i cili nuk përkon me asnjërin nga burimet e mëparshme as me atë serbisht as me atë shqip para vitit 1999, por ka elemente të teksteve të mëparshme. Në të vërtetë ky Regjistër që ne e trajtuam nën titullin *Regjistri i qyteteve dhe fshatrave të Kosovës sipas rajoneve*, mund të quhet version zyrtar i përkohshëm i vendbanimeve të Kosovës, i rikthyer për nevoja zyrtare, edhe pas Pakos së Ahtisarit (2016). Sa do të vazhdojë të qëndrojë *i përkohshëm* dhe kur do të marrë formën e prerë dhe çfarë ndryshimesh do të pësojë do të shihet në të ardhshmen.

Së këtejmi, nuk mund ta kuptojmë, pse në Shqipëri, si e thotë njëri nga reaguesit as në sistemin komunist, as tash pas mbi 20 vjet të lirisë (pluralizëm demokraci, tranzicion) kjo çështje, raporti i ndryshimeve krahasuese sllavisht/shqip, nuk po gjen trajtim të duhur e si rrjedhojë as zgjidhje institucionale. Për këtë çështje problemore vetëm flitet e nuk ndërmerret asgjë serioze.

Ne jemi të vetëdijshëm që tema rreth rishikimit të qëndrueshmërisë së emërtimeve toponimike në të gjitha trojet shqiptare: Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e më gjerë ka specifikat e veta dhe zgjidhja e tyre është me interes kombëtar e ndërkombëtar, andaj veç karakterit të përgjithshëm shoqëror etj., ka edhe karakter politik shtetëror e ndërshtetëror. Me këtë

duam të themi se ne e kuptojmë seriozitetin e kësaj problematike në mbarë botën shqiptare e më gjerë, kuptojmë edhe shqetësimet që po shprehen, por nuk mund ta kuptojmë pse aty ku ka pasur dhe ka mundësi si në Shqipëri, kjo çështje nuk del mjaft e studiuar. Në të vërtetë, për prejardhjen sllave të toponimeve në trojet shqiptare më shumë mësojmë nga burimet studimore sllave se nga ato shqiptare(!). Pse institucionet tona ngelin nga kjo pikëpamje?! Është edhe kjo detyrë e tyre apo jo?!

Me fjalë të tjera, meditojmë, në çdo vend mund të ndodhin ndryshime a ndërrime politike pushtetore, por edhe në ato raste mbesin të paprekura institucionet hulumtuese shkencore kombëtare shtetërore, sidomos edhe ato të kulturës e të shkencës gjuhësore, të cilat duhet t'i fuqizojë dhe t'i shfrytëzojë çdo qeveri, andaj nuk kuptojmë pse kjo nuk ndodh me organet a institucionet tona shkencore-kulturore hulumtuese (akademike) ekzistuese kombëtare, të cilat duhet të kenë programe strategjike afatgjata jashtë ndikimeve momentale të ndërrimeve politike, ku krahas përpunimit të shqipes zyrtare ndaj asaj globale etj., duhet të ketë vend edhe rreth përshtatshmërisë së emërtimeve të vendbanimeve të trojeve tona.

Së këtejmi, pyesim me habi, organizmat e tillë institucionalë shtetërorë aktualë e kuptojnë seriozitetin e kësaj teme, apo jo?! Mendojmë se kjo temë gjithsesi duhet kuptuar, ashtu siç edhe është, si shumë serioze. Andaj, duhet kuptuar se edhe obligimi zyrtar duhet të jetë në nivel, apo jo?! Konkretisht në emërtimet e vendbanimeve të trashëguara etj. në trevat përkatëse shqiptare të rikonstatohet prejardhja, qoftë e fjalëve, qoftë e afikseve, disa prej të cilave arbitrarisht janë konsideruar me prejardhje sllave, ato mbase mund të kenë qenë krijime ose përvetësime të përbashkëta nga ndonjë gjuhë e tretë (ilirishtja, thrakishtja) e ku ta dimë. Sidoqoftë, si kjo e ndërlidhur me këtë temë ka edhe shumë çështje të tjera të kësaj natyre, siç është edhe mënyra formëzuese e fjalëformuese e emërtimeve në përgjithësi, por edhe të emërtimeve të vendbanimeve në veçanti.

Së fundi po cekim faktin që lexuesi ka mundur të vërejë sesi ne gjatë trajtimit të regjistrave përkatës u ballafaquam pikërisht edhe me raste jo të pakta fjalëformuese, por, siç kemi paralajmëruar më në hollësi lidhur me procesin e fjalëformimit oikonimik në gjuhën shqipe do të bëhet fjalë në pjesën e dytë të kësaj vepre.

**Pjesa e dytë**  
**ÇËSHTJE TË FORMËZIMIT E TË**  
**FJALËFORMIMI TË VENDBANIMEVE**  
**NË SHQIPEN E SOTME**





# ÇËSHITJE TË FORMËZIMIT E TË FJALËFORMIMIT TË EMËRTIMEVE TË VENDBANIMEVE NË GJUHËM SHQIPE

(me theks emërtimet e propozuara në Kosovë, viti 2000)

## H y r j e

Është një e vërtetë që nuk thuhet kot se ndër emrat më të dashur të njeriut përveç treshës: emrit vetjak, patronimit (emrit familjar) dhe emrit të kombit (atdheut) është edhe emri i vendlindjes apo ai i vendbanimit. Gjithashtu është i drejtë gjykimi se emrin e hijeshon personi a personat që e bartin, mirëpo janë edhe disa vlera të tjera që ndikojnë dhe shtrojnë nevojën që emri i imponuar mund dhe duhet të ndryshojë dhe kjo varet, qoftë nga ideologjizma, qoftë nga idealizma që ka lidhshmëri me edukatën, rrethin shoqëror dhe nga mbrumimi me ideal i personit a i masës së caktuar. Natyrisht, ndryshimet e tilla dalin në sipërfaqe më tepër në kthesa të rëndësishme historike, siç ndodhi edhe te ne, sidomos me rastin e Luftës Çlirimtare të fundit, UÇK. Edhe në Shqipëri ende janë të freskëta disa ndërrime emërtimeve si p.sh. Shmëri e Gollobërdë *Burimas*, Shiqan *Blerimas*, Shelegar *Çlirim*, Karaalibegaj *Dritas*, Dvoran *Mollaj*, Vromen *Bregas*, Mavropopull *Buronjë*, Shefasia e Mahmutaga *Përparim*, Bellovoda *Ujëbardhë*, Novoselë *Fshati i Ri*, Varvarë *Shpatmal* etj., pa përmendur rastin Kuçovë/ *Qyteti Stalin / Kuçovë*, Pustec - *Liqenas – Pustec* (tash të rikthyer). Fundja, jemi edhe vetë dëshmitarë që dita ditës me shtimin e popullsisë po formohen lagje a vendbanime të reja, të cilat domosdo kushtëzojnë edhe emërtime përkatëse të reja, të cilat ekspertët ka në për detyrë që t'i udhëzojnë që të jenë sa më të pështatshme gjuhësisht e përmbajtësisht.

Sidoqoftë, ne, në këtë punim, do të përqendrohemi në emërtimet e vendbanimeve të Kosovës, temë kjo aktuale sot e gjithë ditën, ngase ka afro dy vjet që kjo kategori emërtimeve ndodhej në tryezën e diskutimit publik te ne, e drejtuar nga *Komisioni Qendror për standardizimin e vendbanimeve të*

*Kosovës*, por edhe të komisioneve përkatëse nëpër komuna, formimin e të cilave e pati inicuar për këtë qëllim, me të drejtë, ish-Qeveria e Përkohshme e Kosovës, që në korrik - gusht të vitit 1999. Ky interesim për rishikimin e emërtimeve të vendbanimeve arsyetohet fare lehtë me faktin se të gjithë popujt kur çlirohen nga robëria kolonialiste a çfarëdo pushtimi tjetër qoftë ai, bëjnë rivlerësime të tilla. Në të vërtetë, populli ynë (i prirë nga kuadra intelektualësh) sa herë që ka pasur mundësi të frymojë pak më lirshëm e ka prekur ndër të tjera edhe çështjen e rivlerësimit të emërtimeve të toponimeve, një shumicë e të cilave, siç dihet mbajnë gjurmë imponimi me intrigancë nga sunduesit përkatës dhe sidomos të ne e më gjerë nga ai serb, i cili, aq më keq, këtë element “*si të drejtë historike!*” e ka shfrytëzuar dhe po e shfrytëzon edhe sot për të arsyetuar vazhdimin e gllabërimit të viseve tona kombëtare, fakt ky që nxiti dhe që i shton edhe sot arsye Komisionit për t’u marrë me rishikimin e emërtimeve në fjalë si dhe të arsyetojë propozimet për ndryshimin e tyre me emërtime të reja më të përshtatshme.

Në të vërtetë, *Komisioni Qendror për Standardizimin e Vendbanimeve të Kosovës*, pas 8 muaj pune intensive, në gazetën *Rilindja*, në 6 vazhdime, në muajin mars 2000, publikoi *Regjistrin e emrave të vendbanimeve të Kosovës*, duke e përcjellë me një konsultim (shkencor) që u mbajt në Institutin Albanologjik të Prishtinës, më 23 të atij muaji. Po këtë tekst (paksa më të kompletuar) e ribotoi po në gazetën *Rilindja*, më 18 prill 2000, duke theksuar, së pari, qëllimin se një ndërmarrje e tillë ka synim të evitohet anarkinë dhe stihinë e krijuar në këtë fushë, ngase në këtë periudhë si edhe pak më përpara, vërtet, që më të larguar të forcave serbe, pothuaj spontanisht *lindnin* ose zbuloheshin, krijesa vendbanimesh me kriter e pa kriter, siç janë b.f. kalkëzimet, *Sopata* për *Sekiraça*, *Malësia e Re* për *Nova Shumadija*, *Shkabë* për *Obiliq* etj., por edhe të tjera si *Gurakoci* Gjurakovac, *Bardhi* Bellaçevac, *Krojmiri* Krajmirovce etj., pa ditur rrjedhojat se me një *shërbim* të tillë spontan me të drejtë hapej, po në mjaft raste nuk ndihmohej si duhet zgjidhja zyrtarisht e çështjes ngase menjëherë në raste edhe fillonte implementimi me të shënuar në tabela dhe njëherazi dhe në mënyrë të vetorganizuar familjare ose grupe u imponoheshin organeve lokale, jo vetëm me kërkesa për pranimin e propagandimit që emërtimet e reja të propozuara të miratoheshin sa më parë, por njëherazi edhe të jetësoheshin *si norma të standardizuara*, menjëhershëmrisht, nga organet e pushtetit më të lartë të *Kosovës së Lirë*.

Kështu, në të vërtetë, siç thuhej në gazetë, ato emërtime, edhe sipas Komisionit Qendror, tashmë *zyrtarisht* kishin përfunduar së diskutuari

(sepse të gjitha vërejtjet që i ishin drejtuar deri atëherë Komisionit si dhe komisioneve të komunave, ishin shqyrtuar dhe se ato të arsyeshmet ishin marrë parasysh), mirëpo, megjithatë, në një mbledhje tjetër konsultuese që u mbajt, po në lokalet e Institutit Albanologjik të Prishtinës, më 21.IX.2000, si dhe nga *Tryeza* e mbajtur më 07.02.2001, po aty, doli se puna e Komisionit ende nuk mund të quhej e përfunduar, por, siç thuhej, ajo *është në përfundim e sipër* dhe së këtejmi, u ripërsëriti apeli i publikuar nëpërmjet gazetës *Rilindja*, më 22.IX.2000, që për finalizimin sa më me sukses të kësaj ndërmarrjeje madhore, gjithsesi me interes të shumanshëm shkencor-gjuhësor e politik-kombëtar, duhej të angazhohej gjithë potenciali intelektual shqiptar që nga kuadrot dhe organet e rangut më të ulët e deri te kuadri i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Ç'është e vërteta, me sa kam vërejtur, edhe sot e kësaj dite, siç shihet edhe nga ndonjë reagim në shtyp, procesi i përpunimit dhe i konsultimeve ende vazhdon, qoftë brendapërbrenda komisioneve përkatëse të komunave, qoftë në nivel të atij Qendror, i cili po u takuaka së paku një herë në javë për të shqyrtuar vërejtjet eventuale, ngado që vijnë ato dhe njëherazi, për të nxitur, ndihmuar e përshpejtuar institucionalizimin e çështjes në kuadër të organeve përkatëse kompetente. Dhe, vërtet, kjo veprimtari në proces e sipër, nga poshtë lartë e nga lartë-poshtë, d.m.th., nga veprimtarët e vendbanimit përkatës e deri te organet më të larta profesionale e të tjera gjithandej, me duket punë shumë me mend, me rend e me vend dhe duhet të vazhdojë edhe më, për derisa zgjidhjet të jenë sa më të mbështetura dhe të pranueshme nga çdo pikëpamje, sepse emri i një vendbanimi i përshtatshëm do të ketë moshë pothuaj të pakufizuar ndër brezat e ardhshëm.

Ndërkohë në shtyp në njërën anë, (ende e kemi fjalën për vitin 2001 n.v.) dolën vlerësime tejet pozitive lidhur me punën e Komisionit që u quajt si punë *me kompetencë e profesionalizëm*, por në anën tjetër dolën edhe shkrime përçmuese, saqë dikush punën në fjalë e quajti, jo vetëm si një *trajtim joshkencor*, por edhe me ndonjë fjalëvlerësim tjetër tejet nënçmues. Ne, duke mbajtur anën e miratuesve, ndonëse me ndonjë rezervë për ndonjë pikë, sepse kur kemi parasysh interesin madhor shoqëror e kombëtar të çështjes, nuk duhet të na i vrasë sytë e mendjes aq shumë ndonjë e palarë e parëndësishme që mund të jetë si rast që mund t'i ndodhi çdo lindjeje të re në fillim të saj. Në këtë drejtim ne do të përpiqemi me këtë vështrim tonin ta ndihmojmë punën e Komisionit, t'i bëjmë jehonë po kësaj vepre madhore, por edhe të vëmë në spikamë ndonjë *lëshim* eventual, dhe krey kjo bëhet me

qëllim që zgjidhja e çështjes në shqyrtim të jetë sa më e pranueshme dhe më cilësore edhe nga pikëpamja e fjalëformimit.

Sidoqoftë, ndonëse në praktikë, siç vërejmë, ende kemi raste të ndeshim emërtime të tjera të *reja* që nuk ishin përfshirë në **Regjistër**, por që ndërkohë, duket se kanë kaluar edhe nëpër duart e Komisionit, pikërisht lënda e **Regjistrimit** të datës 18 prill 2000, neve na shërbeu si material strumbullar për të trajtuar veçoritë formëzuese e fjalëformuese të emërtimeve të vendbanimeve të ne në veçanti dhe këtë e bëmë, së pari, duke krahasuar emërtimet në funksion në të dyja versionet serbisht e shqip dhe së dyti, duke bërë analizën formëzuese e fjalëformuese të materialit në veçanti, paksa, në krahasim me emërtimet zyrtare në Shqipërinë e sotme administrative, bazuar në një hartë dhe në tekstin: *Fjalori enciklopedik shqiptar* (1985), por me rastin e përgatitjes së kësaj vepre, d.m.th., me rastin rishikimit të dorëshkrimit të vitit 2001 u konsultuan përveç ndonjë artikulli nga interneti, edhe të gjashtë burimet e trajtuara në pjesën e parë, por konstatime nga këto pasi të bëjmë një vështrim të shkurtër rreth emërtimeve në funksion, siç patëm kontaktuar në versionin e parë që e patëm shqyrtuar.

## **A. VËSHTRIM I SHKURTËR RRETH EMËRTIMEVE NË FUNKSION**

Në vazhdim shkurtimisht fare do të bëhet fjalë rreth raportit të emërtimeve në funksion (është fjala për periudhën deri në vitin 2001 n.v.), sipas dy versioneve shqip e serbisht, pastaj rreth parimeve dhe burimeve mbështetëse, të cilat i ka shfrytëzuar Komisioni në punën e vet dhe do të jepen të dhëna nga numri i vendbanimeve si dhe numri i emërtimeve të reja të propozuara me përqindje sipas komunave.

### **1. Raporti i emërtimeve të vendbanimeve në funksion serbisht e shqip**

Nga konsultimi i tekstit në funksion nga Regjistri, d.m.th., në versionin shqip dhe tekstit zyrtar të serbishtes (d.m.th. para vitit 1999 n.v.), arritëm në përfundimin se puna e Komisionit, jo vetëm arsyetohej, por ajo dilte si diçka e domosdoshme që patjetër duhej të merrej me konstatimin dhe harmonizimin e emërtimeve në fjalë. Sa për të dëshmuar këtë, që e thashë, pa hyrë në analizë mbi të drejtën e përparësisë, ndonëse dihet se serbishtja si gjuhë e pushtuesit, institucionalisht ishte gjuhë sipëriore, në vazhdim po i paraqit disa shembuj ilustrues problemor që dalin në raportin: krahasues të këtyre dy versioneve, material ky i klasifikuar sipas natyrës së ndryshimeve, në këto tetë grupe:

*a) Uroshevac/Ferizaj, Serbica/Skënderaj, Gjeneral Jankoviq /Hani i Elezit, Dobra Voda /Ujmir;*

*b) Belo Polje /Bellopojë, Peć/Pejë, Crkvena Vodica /Caravadë, Crno Brdo/Orröbërdë, Banin Most /Babimoc, Gladno Selo /Gllanasellë, Dobar Dub/Dobërdup, Vlashki Drenovac/Llashkadrenoc, Kishno Polje/Kishnapolë, Stari Trg / Stantërg, Djurgjev Del /Gjurgjedel, Pusto Selo/*

*Pastasellë, Stara Vuçina/ Stravçinë, Suva Reka /Sufrekë (Suharekë), Vrnovo Kolo/Vrnakollë;*

*c) Ojnovce/Hajnoc, Odovce/Hodofc (Hodoc), Alaç /Hallaç, Krpimej / Kërpimeh, Ajvalija / Hajvali, Movljane / Muhlan, Androvac / Hanrofc (Hanroc);*

*ç) Shurlane/Shurdhan, Silevica/Sylevicë, Çupevo /Çypevë, Zulfaj/ Zylfaj, Lipljane /Lypian, Bardaniqi/Bardhaniq;*

*d) Vitine/Viti-a, Sopine/Sopi-a, Lepina/Lepi-a, Polatna/Pollata, Tomance /Tomoc, Tudjence/Tugjec, Majnance/Majac, Burince/Buricë, Letance/Letan; Broçna /Brojë, Polance/Polac, Ceranja/Cerajë, Retimjlje/ Reti-a, Romuna/Romajë, Trudna/Trudë;*

*dh) Bubovac/Bubavec), Orahovac/Rahovec, Kushavac/Kushavec (Krushec), Lipovac/Lipovec, Ljubovac /Lubovec;*

*e) Glavnik/Gllamnik, Koprivnica/Kopërnice, Smolice/Smonicë, Drobnjak/Dramjak), Budisavce /Budisalc, Muzhiçane/Muzeqinë, Goraçevo/ Gajrak etj.*

*ë) Gjïnovce/Gjïnoc, Grejkovce/Grekoc; Grejçevce/Grejçec, Vrshevce / Vërshec, Duganjiva /Dugajivë, Shisharka/Shisharë, Shalinovica (Shalinoc) etj.*

Të vihen re ndryshimet e llojllojshme dhe sa qëndron larg forma e përdorimit zyrtar nga pikëpamja shqiptimore e shkrimore e shqipes në funksion nga ajo e serbishtes zyrtare, forma këto që ishin të pranishme dhe sadokudo të *pranueshme* më përpara edhe, në të ashtuaquajturën administratën tonë zyrtare dygjuhësore. Sigurisht, një dukuri e tillë vinte edhe si pasojë e natyrave të ndryshme strukturore të gjuhëve përkatëse, ndonëse në bashkëjetesë //sllavishte e vjetër serbishte e re// shqipja (popullore) në anën tjetër, për një periudhë të gjatë kohore, rrethana këto që pa mëdyshje ishin më të volitshme për gjuhën serbe, e cila domosdo mbizotëronte administrativisht. Mund të thuhet me plotgojë se edhe po të mos kishte kurrnjë arsye tjetër (që ka të bëjë me vetëdijësimin politik-kombëtar rreth riemërtimit të vendbanimit me një kriter të pranueshëm dhe më të përshtatshëm gjuhësisht e kombëtarisht), vetëm harmonizimi i rasteve të saposhënuara në aspektin praktik të sotëm **“zyrtar”** do të mjaftonte për t’u arsyetuar dhe për t’u përshëndetur puna e Komisionit në fjalë.

Mirëpo Komisioni nuk u ndal vetëm në konstatime të tilla, por ai bëri shumë më shumë punë. Ai, i hyri një veprimi të vështirë, por edhe shumë dobiprurës, pra i hyri rishqyrtimit të gjithanshëm të emërtimeve në

fjalë në të gjitha trevat shqiptare të ne dhe për këtë, së pari hartoi parimet dhe përkufizoi metodën e punës. E shoh me interes t'i rikujtojmë ose t'i ri theksojmë, edhe pse pa shembuj ilustrues, parimet e sajara nga Komisioni, sepse ato do të ndihmojnë, jo vetëm për ta kuptuar më mirë çështjen, por edhe për ta kuptuar edhe analizën e temës që do ta shtjellojmë në vazhdim.

## 2. Parimet dhe burimet mbështetëse në punën e Komisionit

Komisioni, për punën e vet, në konceptualizimin, kodifikimin, riemërtimin dhe emërtimin e shumë toponimeve të Kosovës, duke u përthelluar konkretisht, hartoi këto parime:

1) hetimi dhe ruajtja e elementeve toponimike autoktone (parailire, ilire, protoshqiptare e shqiptare), që deshmojnë kontinuitetin tonë në këto anë;

2) hetimi dhe ruajtja e elementeve toponimike latine, romane, vllahe, gjermanike, dhe orientale e sllave, që paraqitin vlera historike e kulturore për Kosovën;

3) hetimi, rikonstruktimi dhe rikthimi i strukturave autoktone të eliminuara nga administratat shtetërore dhe kishtarë të pushtuesve, që për arsye të kursimit të mundit apo për mungesë imagjinatë emërtuese ardhësit i kishin adaptuar apo përkthyer emërtimet e mëparshme;

4) eliminimi i emrave të vendeve të vëna arbitrarisht sipas modeleve të gjuhëve të huaja konceptualizuese e kodifikuese dhe, që, më së shpeshti, ishin bartur nga rajonet nga kishin ardhur; kishte edhe modele të mbështetura në mite e mitologji, duke krijuar paradigma emërtuese të bazuara, sidomos me mitin për Betejën e Kosovës;

5) eliminimi i mikrostrukturave afiksale (prefiksale e sufiksale) sllave, që ishin krijesë e administrimit dhe të tendencave sllavëzuese të toponimisë autoktone dhe të akceptueshme për vendësit, si p.sh. sufiksati: **-aj** për toponimet e burimit patronimik, **-as** që përdoret për toponizimin e shumë apelativave (!), **-et**, **-isht**, **-ishtë** etj. për toponimet me bazë fitonimike etj.

Prandaj ne, duke qenë të interesuar që sadopak të japim kontributin tonë në zgjidhjen e çështjeve të caktuara fjalëformuese në kuadër të shqipes standarde nga aspekti gjuhësor-shkencor, s'kemi si të mos i jemi mirënjohës Komisionit:

së pari, për vetë grumbullimin dhe paraqitjen e materialit,

së dyti, jo vetëm për formulimin e parimeve, por edhe për respektimin e tyre sipas kriterëve të qasjes;

së treti, për propozim - zgjidhjet konkrete të bëra mbi bazë të atyre kriterëve,

së katërti, për guximin intelektual e profesional për t'i hyrë një pune kaq me përgjegjësi politike, shoqërore e shkencore, ngase janë çaste kur njeriu mund të shklasë nën presionin e emocioneve, por edhe nga njohja e pamjaftueshme e ligjeve dhe të prirjeve fjalëformuese të gjuhës që vepronin në të kaluarën, por që veprojnë edhe sot, në rrethana të reja dhe

së pesti, për pretekstin që na u dha që ne t'i publikojmë mendimet tona lidhur me këtë temë me shumë interes për gjuhën dhe gjuhësinë tonë, e cila deri më tash, me sa dimë, nuk del e trajtuar *si temë e veçantë*, me theks në aspektin formëzues e fjalëformues të vendbanimeve në gjuhën shqipe.

E nënvizuar më sipër togun *si temë e veçantë*, sepse si lëndë, në kuadër të temave të tjera, kjo nuk del fare e paprekur. Së këtejmi, vlen të përmenden burimet me vlerë të konsultuara që sadokudo dalin lidhur me trajtimin e kësaj teme, të cilat, veç atyre të fushave të ndryshme shkencore, domosdo do të jenë shfrytëzuar nga Komisioni edhe këto nga fusha e gjuhësisë, siç janë: veprat e klasikësve të albanologjisë e më gjerë. Këtë rast s'mund të anashkalohen të dhënat teorike nga gramatikat, revistat e publikimet e tjera normative të gjuhës sonë, siç është edhe vepra e **Xhuvani-Çabejt** *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, ku për emërtimin e vendbanimeve ceken si aktive afro 20 prapashtesa; *Onomastika e Kosovës* 1979, ku ndër të tjera do të veçonim punimin e **prof. Sulejman Drinit**, "*Derivatet semantiko-strukturore në onomastikën shqipe të Kosovës*", ku dalin 40 prapashtesa të shfrytëzuara për këtë destinim; shtojcën: "*Emra gjeografikë, emërtime të njerëzve sipas vendbanimit a prejardhjes*", të botuar në *Fjalorin e shqipes së sotme* (1984), ku jepen shembuj përfaqësues normativë karakteristikë të oikonimeve, pastaj punimin mjaft cilësor të dr. **Ragip Mulakut** me titull "*Parashtesat e prapashtesat e gjuhës shqipe në shkrime të vjetra*" (shek XV - XVIII), IAP, Prishtinë 1998 si dhe punime të tjera të **L. Mulakut**, **R. Doçit**, **M. Halimit** etj., por që, për mendimin tim, në punimet e sipërpërmendura, si dhe në të tjera të derisotme, toponimet e vendbanimeve nga aspekti formëzues e fjalëformues nuk dalin të trajtuara me thellësinë dhe gjerësinë që lypset. Ato, si me thënë, mbesin, më fort, në rrafshin e konstatimeve. Pra, jepen të dhëna, si të themi, ashtu, si janë gjetur a gjenden emërtimet e tilla në burimet përkatëse e pak ose aspak bëhet fjalë rreth specifikimit të



formanteve të caktuara, kryesisht a vetëm për këtë nënfushë semantike, në kuadër të oikonimisë. Po të kishte pasur punime të natyrës së tillë, veçan rreth emërtimit të vendbanimeve sigurisht Komisionit do t'i ndihmonin shumë, së paku sa për orientim më me lehtësi rreth përzgjedhjes së formës përkatëse parapëlqyese drejtshkrimore për emërvendet e reja përkatëse të propozuara. Po them, *të përzgjedhjes*, sepse, siç del nga materiali i Regjistrit, Komisionit iu desh të rindërtonte, por edhe të krijonte ose të lejonte disa propozime si emra të rinj të fshatrave e të qyteteve tona në numër të konsiderueshëm apo mesa pamë këto mënyra kapin një përqindje relativisht të madhe, në krahasim me numrin e përgjithshëm të emrave të vendbanimeve të Kosovës.

Ja, si del pasqyra e numrit të emërtimeve të reja, sipas komunave, ndaj emërtimeve të përgjithshme në funksion:

### 3. Pasqyra e numrit të vendbanimeve të rishqyrtuara të propozuara nëpër komunat e Kosovës sipas *Regjistrit*

N.r.	Kom	Nr.p.	Em.r	Përqindja	Disa shembuj ilustrues
1	2	3	4	5	6
1.	Artana	12	3	16.66	Shpatar, Artanë; Labian;
2.	Besiana	74	54	72,97	Villasaj, Bunjak. Izvori, Kreshtë, Batllavë Plepas, Ballëz, Llapias, Anallap;
3.	Burimi	51	38	74.50	Gash, Mollëz, Krasniqaj, Temal, Grunajë, Kodërbardh;
4.	Dardana	74	29	39.18	Qarr, Lisor, Lugës, Shalëz, Drinoc, Dardanë, Gmizë;
5.	Deçani	40	11	27.50	Voksh, Strall, Lumishtë, Isnik, Shaptej, Lumbardh;
6.	Drenasi	37	27	72.97	Shkabë, Vashë, Bletar, Drenar, Gurras, Kruembret;
7.	Ferizaj	44	12	27.27	Trim, Zgatar, Muhos, Kodrion, Rakaj; Micsokol,
8.	F. Kosova	18	7	38.88	Bardh E/P, Nakër, Albanë, Mesbardh, Gurshkabë
9.	Gjakova	85	15	17.64	Devë, Sopot, Gushaj, Batus, Mullishtë, Messukash;

10. Gjilani	58	27	46.55	Kullë, Tunaj, Mrizaj, Idrizaj, Lahtizë, Meslum,
11. Kaçaniku	43	24	55.81	Bob, Bajëz, Gjegjaj, Korbaj, Trina, Trimor, Gurian,
12. Klina	58	35	60.64	Lug, Topiaj, Martiras, Luftar, Bregas, Boksh, Qarret;
13. Leposaviqi	72	3	4.16	Dreni, Kreshbardh, Kodrabardh, Çirkoviqi, Lumbardh;
14. Lypiani	69	33	47.82	Bajë, Gurrë, Kronas, Bujar, Bjeshkas, Qarr, Kruebardh;
15. Malasi b)	43	27	62.79	Lisan, Pleqnor, Drenar, Rrezor, Tryezë, Gurak;
16. Mitrovica	85	28	32.94	Prronas, Frashër, Barbanik, Bugariqi, Tejibri;
17. Obiliqi	19	11	57.89	Tryezë, Mjekaj, Shegëz, Balshaj, Muzakaj, Burabardh;
18. Peja	91	48	52.74	Alba, Plakan, Siparant, Drinisht, Kryedri, Haxhizekaj;
19. Prishtina	47	24	51.06	Shkabë, Kalajas, Murrizaj, Drenush, Brezare, Gurkuq;
20. Prizreni	76	32	42.10	Ashtë, Berishaj, Prronjas, Flokësh, Livadhi, Pusat;
21. Rahoveci	34	17	50.00	Xërxë, Kromnik, Bajrakaj, Vneshtar, Drenësh, Balldrin;
22. Skënderaj	50	21	42.00	Murgë, Gofile, Shqiponjas, Burojë, Dashes, Kruebardh;
23. Sharri	36	9	26.47	Sharr, Prronaj, Bardhaj, Zgatar, Borajë, Kuklibeg;
24. Shterpësi	16	5	31.25	Shterpës, Beroc, Kashtanet, Viçaj, Vorbesh, Shushicë;
25. Shtimja	24	16	66.66	Rrafsh; Krenajë, Zotaj, Lugas, Davidon, Kryedren;
26. Vitia	43	13	37.20	Mjek, Delmer, Gashaj, Grunor, Mirak, Buzëmal;
27. Vushtrria	67	45	67.16	Bajë, Druar, Krasniqaj, Trimor, Lajthizë, Gurkuq;
28. Theranda	42	27	64.28	Pllajë, Dardhë, Lumar, Gurras, Vranik, Gurmadh;

29. Z. Potok 63 2 3.17 Drena, Prroni i Arushës, Bregas,  
Babiqi, Varraga E/P;

-----  
Gjithsej : 1471 645 43.84 175 shembuj ilustrues

**Sqarim:**

- a) 1. n.r. - numri rendor.  
2. kom.– Komuna.  
3. nr. p. - numri i përgjithsëm i vendbanimeve.  
4. em. r. - emërtime të reja (të propozuara).  
5. disa shembuj ilustrues.
- b) Malasi për Malishevë (Mališevo), u rikthye në Malishevë (tash komunë *e re*).

Pra, siç po shihet nga Pasqyra, gjendja në rubrikat, pos numrit rendor, numrit të komunave dhe numrit të vendbanimeve që mund të mbesin, apo jo, të pandryshuara, në të ardhshmen mund të pësojë ndryshim sigurisht gjendja e shifrave sa i përket emërtimeve të reja (me përqindje) sipas komunave, sepse çështja është në proces e sipër. Sa për kërshtëri po shënoj se sotpërsot, siç po shihet nga pasqyra, për nga numri i propozimit të emërtimeve të reja të vendbanimeve vendin e parë e zë Peja me 91 vendbanime, pastaj vjen Mitrovica me 85, Prizreni 76, Dardana 74, e kështu me radhë, ndërsa sa i përket rubrikës së emërtimeve të reja prijnë Besiana 54, Peja 48, Vushtrria 45, Burimi 38, Klina 35, Lypiani 33, Prizreni 32 e kështu me radhë, kurse sa i përket përqindjes radha ndryshon, prin Burimi me 74.50%, Besiana 72.97%, Vushtrria 67.16%, Shtimja 66.66%, Theranda 64.28%, Klina 60.34%, ndërsa përqindje më të vogël kemi te Zubin Potoku 3.17%, Leposaviqi 4.16%, Artana 16.66%, Gjakova 17.64%, Ferizaj 27.50%, Shtërpësi 31.25%, e kështu me radhë. Sidoqoftë, sipas propozimit përqindja e emërtimeve të reja del e ndryshuar mbi 40%, në krahasim me numrin e përgjithshëm, por nëse merren në konsideratë edhe korrigjimet e modifikimet e veçanta me semantikë kuptimdalluese, atëherë ndryshimi del edhe më i madh. Me fjalë të tjera, kur kemi parasysh natyrën e gjuhës shqipe (ortografinë, shquarsinë e emrave etj.) me atë të serbishtes, ndryshimi është i qindpërqindtë.

Sa i përket qëndrueshmërisë drejtshkrimore a drejt-fjalëformuese të shembujve ilustrues, që u dhanë më sipër, këtu nuk do të ndalemi, por, sidoqoftë, edhe sa i përket vetë formëzimit (fjalëformimit) brendapërbrenda

shqipes, siç del nga *Pasqyra*, çështja është mjaft komplekse, sigurisht vihen re edhe çështje të diskutueshme nga kjo fushë.

Sidoqoftë, në punimin tonë çështja do të trajtohet kryesisht në aspektin sinkronik, ndërsa ai diakronik mbetet për t'u dëshiruar, sepse interesi e do që rrafshi horizontal tash për tash, duhet të jetë sa më i qartësuar, pa e mohuar edhe rëndësinë e anës tjetër, vertikales, e cila, në të vërtetë, ka të drejtë të kërkojë nga dijetarët tanë që edhe më mos me mbetë *të kënaqur* me gjendjen inferiore të shkencës sonë mbi këtë çështje, por të përpiqen ta sqarojnë më mirë hisen ndërndikuese që kishte dhe që ka gjuha jonë, qoftë në raport me gjuhët e vjetra simotra greke, latine (sidomos të latinishtes vulgare), qoftë edhe ndaj gjuhëve të tjera, sidomos atyre të vjetra e të reja sllave.

Në këtë drejtim, veç qëmtimeve, shkencës sonë mbi gjuhën i nevojitet edhe një njohuri më e thellë e strukturës së sotme fjalëformuese në kuadër të sistemit tonë të pëgjithshëm nominal si dhe atij verbal.

## B. ANALIZA FORMËZUESE E FJALËFORMUESE TË EMËRTIMEVE TË VENDBANIMEVE TË PROPOZUARA SIPAS REGJISTRIT E MË GJERË

Nga pikëpamja fjalëformuese (e prejardhjes) të gjitha emërtimet mund t'i analizojmë në tri mënyra:

- I. emërtimet pa ndajshtesa,
- II. emërtimet me prapashtesim dhe
- III. emërtimet me kompozim a togfjalësja.

Mirëpo para se t'i shtrohem analizës sipas pikave të mësipërme e shohim të nevojshme të sqarojm; dy gjëra: e para, çfarë kuptojmë ose si qëndron në këtë punim raporti kuptimor i fjalëtermave *formëzim* ndaj atij *fjalëformim* i emërtimeve përkatëse dhe e dyta, çfarë kuptojmë ose si përkufizohet kuptimi i fjalës *vendbanim* si term gjeografik.

Kështu, me fjalë-termin **formëzim** në raport me atë **fjalëformim** kuptojmë se emërtimi i caktuar del i formuar në nënfushë tjetër semantike dhe pastaj transferohet po në atë formë po tash me koncept oikonimi, ndërsa me **fjalëformim** kuptojmë, kur emërtimi i caktuar formohet drejtpërdrejt në nënfushën semantike të vendbanimit, duke marrë elemente përkatëse fjalëformuese mbi temën prodhuese. Ndërkaq me fjalë-termin **vendbanim**, në këtë punim, përfshihen vetëm emërtimet e qyteteve (urbane) dhe të fshatrave (rurale) të Kosovës, duke i përjashtuar në hollësi emërtimet e lagjeve, e të komplekseve të tjera të caktuara të banimit (mikrooikonimet) si dhe emërtimet e krahinave e të viseve të caktuara shtetërore (makrotoponimet).

Andaj së pari, do të bëjmë fjalë rreth emërzimit ose formimit ose emërzimit të vendbanimeve pandajshtesore e pastaj rreth fjalëformimit të vendbanimeve, qoftë me ndajshtesa, qoftë me kompozim a në mënyrë perifrastike.

## I. FORMËZIMET PA NDAJSHTESA

Prej 1471 emrave të shënuar në Regjistër nja 270 shembuj ose 18.35% të tyre janë emra pandajshtesorë, të cilët prej nënfushave përkatëse të ndryshme semantike vijnë në Regjistër në të njëjtën trajtë. Mirëpo, ç'është e vërteta, që edhe këto emërtime, ashtu si emërtimet me ndajshtesa dhe ato me kompozim, pasi nuk vijnë nga një fushë e njëjtë semantike del e nevojshme të konstatohen edhe fushat ose nënfushat përkatëse semantike prej nga imponohen, andaj praktikisht shembujt e tillë mund t'i ndajmë në: emra të përgjithshëm konkretë dhe emra të përgjithshëm abstraktë.

### a) Emra të përgjithshëm konkretë të formëzuar si vendbanime

Në bazë të kuptimisë emrat e përgjithshëm të formëzuar si vendbanime mund të merendohen:

1) mikrotoponimet e shfaqura si pamje të konfiguracionit gjeografik (relievor), si: *Spat, Pllajë, Thep, Fushë, Shkrep, Grykë, Vërrin, Vneshtë, Ashtë, Shullan, Klysyre, Lug, Sukë, Qyshk;*

2) objektet monumentale me vlerë që nëkuptojnë vendin ku ndodhen: *Kullë, Gjytet, Trojë, Kala, Kështjellë, Pojatë, Manastir, Teqe;*

3) emra të përgjithshëm të bimëve (fitonime) që nënkuptohet vendi ku rriten: *Qarr, Fier, Rrepë, Dardhë, Lis, Ulëz;*

4) emrat e përgjithshëm kafshësh (zoonime), nënkuptohet vendi ku rriten apo gjenden, por edhe me simbolikë të caktuar: *Petrit, Shkabë, Devë(!), Dren, Bec, Gjeraqinë, Skifter, Korb;*

5) emrat e përgjithshëm ujrash (hidronime), nënkuptohet vendi ku ndodhen burimet e cekura: *Gurrë, Lken (liqen), Bajë;*

6) emrat e përgjithshëm të sendeve: *Altar, Tryezë, Kosh,* nënkuptohet vendi ku ndodhen, po që kanë patjetër edhe ndonjë simbolikë semantike.

**b) Emra të përgjithshëm abstraktë të formëzuar si vendbanime nga:**

- 1) emra të fenomeneve të natyrës e të tjerë si: *Rreze, Plojë*;
- 2) emra njerëzish a tipare të tij (të përgjithshëm e të përvetshëm), si *Goden, Bujar, Kusar, Kastriot, Beleg, Gash, Krasniq, Sop, Berishë, Kelmend, Kastrat; Besim, Përparim* etj. si dhe tre emra të gjinisë femërore (simatronime): *Vashë, Ajete, Norë*, që mbartin në vete simbolikë të dalluar me vlerë historike-atdhetare a ndonjë tjetër.

Për ne nuk dalin aq të pranueshme emërtimet pandajshitesa që ishin përzgjedhur si të përshtatshme, nga Komisioni shtetëror i Mbretnisë shqiptare ose ai i Mbretnisë Italo-shqiptare në vitet përkatësisht 1938, 1942.

Në të vërtetë në Listën e vitit 1938 ndeshim mbi 60 emërtime që sipas komisionit përkatës dilnin të përshtatshme, për ne të diskutueshme, si. p.sh. *Begata, Kulaçi, Prona, Hardhija, Vrima, Luani, Gjashta*.

Por, gjithsesi, jo të qortueshëm dalin shembujt si: *Shkoza, Fshati, Floriri, Kodra, Ura, Kështjella, Shkëmbi, Lisi, Gryka, Shreptima, Liria* etj.

Po ashtu të paqortueshëm dalin emrat e tillë përkatës që disa përsëriten edhe edhe në burimin e tretë *Emra gjeografikë të RPSH-së, si Kreshhtë, Thupra, Rreshka, Bjeshka, Shkambi, Flaka, Sheshi, Purteka, Fatosi* etj. madje edhe disa shembuj që në Burimin e tretë përsëriten në rajone të ndryshme, si *Dardhë-a*, 5 raste, *Shtuf-i e Prush-i* nga 2 raste, **Dushk-u** 3, ndërsa *Kuç* në 6 raste etj.

Me thënë të drejtën, si veçori e përgjithshme lidhur me emërtimet e mësipërme nuk dalin aq çështje të hapura drejt-fjalëfomuese, ngase të gjitha këta emra që më përpara, siç u tha, *dalnin të formuar në nënfushën përkatëse semantike* dhe së andejmi, për nevojë oikonimie transferohen (janë transferuar) si emërtime të vendbanimeve, por sa del i qëlluar a i plotëfuqishëm dhe sa i qëndron arsyes emri i caktuar, si nga ana e brendshme ashtu dhe ajo e jashtme, për t'i dalë zot konceptit të ri që synohet të mbulohet me emëtimin përkatës në funksion vendbanimi, është çështje tjetër. Ky fakt mund të jetë vjegë për diskutim, por për ne është me rëndësi kapshmëria e logjikës (sintakso-morfologjike e stilistike), që gjithsesi emërtimet pa ndajshitesa duhen pasur mbështetje në ligjësitë formëzuese e fjalëfomuese të sistemit emëror të shqipes.

Diskutimi rreth përshtatshmërisë apo mbështetshmërisë së emërtimeve të caktuar si emërtim vendbanimi do të dalë gjithsesi më i kapshëm pasi të trajtohen formimet e vendbanimeve sipas mënyrave të tjera, qoftë me ndajshesim, qoftë me kompozim a me togfjalësha që do të bëhet fjalë ose do të fillojmë me i trajtue tash fill, por ia vlen të spikasim të vërtetën, që duhet të zgjojë interes të veçantë edhe **raporti i shkallshmërisë kuptimore të tyre** që përmbledhtas do të jepet në fund të kësaj analize.



## II. EMËRTIMET E VENDBANIMEVE ME PRAPASHTESIM

Emërtimet e vendbanimeve nga **Regjistri (2015)** të formuara me prapashtesim zënë vendin kryesor nga numri i përgjithshëm. Sipas prapashtesave a fundoreve përkatëse të tyre emrat e vendbanimeve për lehtësi studimi (paraqitjeje) na u imponua t'i ndajmë në këto pesë grupe:

së pari, emërtimet me prapashtesat e huaja që shumica prej tyre sot ndjehen si të imponuara bashkë me emrat e vendbanimeve: *-ica, -(v)iqi, -ovci (ofc/i -oc/i), -ova, -eva, -ava(?)*, me origjinë sllave; *-ot, -os* me origjinë greke dhe *-(a)li/a, -(a)xhi/, -ije*, me prejardhje turke;

së dyti, emërtimet me prapashtesat e përvetësuara a të dëshmuara shqipe nga nënfusha e (mikro)toponimisë: *ishtë, -inë, -nik, -ore e -tore*;

së treti, prapashtesat e shfrytëzuara në emërtime oikonimesh, por të specifikuar për veprimtari të nënfushave të tjera semantike të njeriut,

a) sipas patronimisë - *aj*,

b) etnonimisë -*as, (j)an, -ak* dhe

c) sipas mjeshtërisë a profesionit *-(ë)s, -ar, -tar, -or*;

së katërti, prapashtesat e shfrytëzuara në vendbanime, por të specifikuar për koncepte të tjera si:

a) emërtimet me prapashtesat e emrave të gjësendeve a të mjeteve konkrete: *-ore, -(ë)s/e, -ar/e, -ues/e, -je* etj.,

b) emërtime me prapashtesat e emrave të nocioneve abstrakte : *-i, -im, -ojë* dhe

c) emërtimet me prapashtesat e emrave të natyrës emocionale (përkdheljeje, zvogëlimi etj.): *-osh, -ush/ë, -oz* dhe *-th* e *-zë/-ëz*;

së pesti, emërtimet me prapashtesa a siprapashtesa të emrave me prirje specifikimi, vetëm ose kryesisht për vendbanime, si: **1)-ajë, 2) -isht, 3) -sh/-ç, -ash e -esh, 4) -et e -at, 5) -arë, 6)-(i)anë dhe 7) -(i)on/ë.**

## **A. FORMIMET ME FUNDORËT A PRAPASHTESAT E HUAJA TË IMONUARA**

Fundoret a prapashtesat më të dalluara të gjuhëve të huaja të imponuara që më së shumti kishin vërshuar emërtimet e vendbanimeve në gjuhën tonë janë:

a) ato me origjinë sllave (që ende ngulfatin formimet në shqipe):-  
ICA, -(V)IQI, -OVCI, -EVCI, -OVA, -EVA, -AVA(?);

b) ato me origjinë greke -OS e -(J)OT dhe

c) turke: -(a)XHIIa e -(a)LIIa, -IJE/a.

Në Listën e vitit 1938 ishin në proces për ndryshim një numër i konsiderueshëm i shembujve të papërshtatshëm me prapashtesat sllave, si vijon: me -ICA 21, me -OVA 21, me -IQ 4, eva 2, -AVEC 10 dhe me ava 1. Është interesant se të gjithë shembujt janë dhënë sipas gjendjes shqiptimore nga masa shqipfolëse, andaj disa shembuj janë aq të deformuar sa vështrië se mund të dihet origjina e tyre sllave (bullgare apo serbe).

Sidoqoftë, ne në vazhdim do të ballafaqohemi me shembuj për secilen formant veç e v/eç, duke theksuar ekzistencën e tyre në emërtimet përkatëse, si këtu te ne, si në Shqipëri, po me theks në përpjekjen e Komisionit për *t'u liruar* nga shembuj më karakteristike të kësaj natyre.

### **a) Emërtimet me formantet me origjinë sllave**

#### **1. Emërtimet me -icë/-ica**

Me fundore-prapashtesën -ICË (-ICA) sipas Regjistrit te ne dalin 140 emërtime, ndonëse ky fenomen në përdorim të përditshëm në shqipe del detyrimisht i diskutueshëm, prej tyre vetëm 14 shënohen në Regjistër, ashtu, të paprekura fare, madje as nga pikëpamja e shquarsisë. Nja 23 shembuj dalin pjesërisht të modifikuar, ndërsa rreth 100 janë ndryshuar rrënjësisht. Zgjojnë interes disa oikonime, të cilat u zëvendësuan tërësisht si p.sh:

*Gollubica (Kodranesh), Kovaçica (Trimor), Grobanica (Fushëlum), Gllavica (Kronas), Luzhnica (Ulëz)* etj,

Këtu, siç po shihet asnjë rast nuk ka të bëjë me kalkëzim ose përshtatje, siç janë edhe këto raste që gjithashtu zgjojnë interes, për të cilat Komisioni sigurisht i ka pasur sqarimet përkatëse, si:

*Banjica/ Bajëz, Burinca/ Burimzë, Balinca /Balaj, Gjergjica/ Gjergjaj, Llashtica/ Llashtizë, Breznica/ Brezni, Shtarica /Shtarrë, Rudica /Radesh* etj.

pastaj edhe disa barsvlerës të diskutueshëm si:

*Pashkaj për Paskalica, Gashaj (!) për Gushica, Krasniqaj(!) për Dumnica* etj,

përkatësisht:

*Drinas për Vërmicë, Kronas për Gllavicë, kompozita Gurëkrypas për Tërnavicë; Vitmir për Vërtomicë, Shegëz për Kozaricë.*

Në toponiminë e Shqipërisë si oikonime dalin në përdorim afro 100 emra me -ICË fundore, madje disa ende ruajnë formën transparente sllave, dhe kjo tregon për ndikimin sllav edhe atje. Vetëm në Qarkun e Korçës janë afro 20 emërtime të tilla me -ICË fundore. Po i cek vetëm disa shembuj për ne të nënkuptueshëm me ngjyresë pejorative, si:

*Babicë, Bradvicë, Grabovicë, Kërpicë, Sericë, Cërkovicë, Greshicë, Karicë, Rapavicë, Lapardhicë, Lomnicë, Guzhnicë* etj.

Është e çuditshme se si nuk janë vërejtur ose janë lejuar deri tani emërtimet e tilla që Korça “lule e shqiptarisë dhe e dijenisë...” nuk ka hije aspak me i konzervue edhe më, apo jo?!

## 2. Emërtimet me -v/iqi

Edhe emërtimet me fundorin a prapashtesën -(v)IQI që në variantin në funksion kapin shifrën afro 70 sosh, sipas Regjistrimit del i zëvendësuar një numër mjaft i konsiderueshëm me këtë formant, mbi dy të tretat nga numri i përgjithshëm. Në të vërtetë, kanë mbetur edhe afro 20 shembuj (katunde) ortografikisht të paprekura që i përkasin momentalisht popullatës me shumicë serbishtfolëse. Mirëpo, janë edhe dy-tre fshatra, të cilët ndonëse i takojnë popullatës dominuese shqipfolëse, për ndonjë arsye, kanë mbetur po me këtë formant fundor të pandryshuar, si:

*Jasiqi, Shahiqi e Kopiliqi.*

Edhe te ky grup me v/iqi bien në sy përshtatjet që arsyet i di Komisioni, si p.sh:

*Laçiqi/ Laç, Isniqi/ Isnik, Papiqi /Papaj, Stançiqi/ Stanaj, Korbiliqi/ Korbaj, Babiqi /Babaj, Kodraliqi/ Kodrinë, Pëpiqi /Pepaj, Raushiqi/ Raush, Llazoviqi /Llazaj, Sopaniqi /Sopaj, Vraniqi/Vranik, Dranashqi Dranash etj.*

Pastaj ngjallin kërsërinë edhe zgjidhjet e diskutueshme si:

*Pjetërshi për Pjetërqi, Vitushë për Vitushiqi, Kështjellas për Zatriqi, Bjeshkas për Plitkoviqi etj.*

Ndonëse ndonjë studiues formantin -iqi e nxjerrë me origjinë latine -icius e jo sllave-**v/iq/i**, mund të themi se, sotpërsot sidomos te ne, dhe përgjithësisht në gjuhën tonë, trajta -v/iqi, del formant jo i favorizuar, madje edhe iritues, nëse dikush tenton ta fusë në përdorim për ndonjë emërtim të ri.

Sidoqoftë, sipas Listës së vitit 1938, i shtrohen procesit të ndryshimit këto emërtime me -IQI fundore:

*Viskiqi, Nikoliqi, Kokodhiqi, Bogiqi dhe Bozhiqi.*

Së këtejmi, gjithsesi në favor të kriterit të marrë nga Komisioni i Prishtinës për ndryshimin e emërtimeve me këtë formant del edhe fakti se në Shqipëri nuk ndeshim oikonime të shumta me këtë formant. Gjithsej, në FEGJ (2002) hasëm afro 10 shembuj. Këtu po i shënojmë vetëm këta tre-katër:

*Kakakarriqi (Lezhë), Gëziqi (Mirditë), Kardhiqi (Korçë), Finiqi (Sarandë) etj.*

Mbase edhe kjo shtrirje në rrethe të ndryshme dëshmon që trajtat me -iqi, që dilnin të shumuara te ne, sidomos gjatë pushtimit dhe sundimit të viseve tona nga serbët pas Luftës I Botërore, kishin qenë të pranishme më herët edhe në Shqipëri.

### **3. Emërtimet me -ovac/-ovci**

Me fundorin a prapashtesën -OVAC/OVCI, në Regjistër ndeshim afro 100 raste, por që në versionin shqip në funksion në shumicën e rasteve ky formant del i reduktuar në formën -OC (ose në ndonjë rast edhe në variantin e ndërmjetëm -OFC). Pothuajse të gjitha rastet me -OC (-OFC) në Regjistër në versionin e propozuar dalin të ndryshuara. Kanë mbetur të pandryshuara përveç fshatrave Popovci dhe Seoci (me papullatë me shumicë serbishtfolëse).edhe këta, si:

*Prekoci, Gurakoci, Preoci, Domaroci, Vërboci, Gllogoci, Miganoci, Dragoci, Rajnoci, Drenoci, Brekoci, Ramoci, Beroci, Drajkoci, Graboci, Hajnoci, Gjinoci.*

Siç po shihet Komisioni ka përkrahur me vend mendimin e gjuhëtarëve Sh. Berani, Z. Munishi dhe M. Halimi (të shprehur në Onomastikën e Kosovës) për të mbështetur trajtën popullore shqipe -OC në vend të asaj -OVAC/-OVCI të serbishtes, madje, duke e rrafshuar në mjaft raste edhe formën e mesme -OFC që ende mund të ndeshet në ndonjë shqiptim popullor. Nuk di arsyen pse, sipas Regjistrimit, bën përjashtim vetëm rasti Strofc Strofci?

Por, sidoqoftë, mendojmë se edhe disa trajta me -OC mund të rishikohen.

Te ky grup emërtimesh del një çështje tjetër e diskutueshme që kërkon sqarim, pse Komisioni ka lejuar që në disa raste të zëvendësohet vetëm fundori C me N ose me S dhe asgjë tjetër, si p.sh.:

*Lladroc LladroN, Davidoc DavidoN, pastaj Brestovc BrestoS, Sanoc SanoS, Likofc LikoS, Butoc ButoS, VarigocVarigoS.*

Sidoqoftë, rreth kësaj çështjeje do të bëhet fjalë në një tjetër vend po në këtë punim, sepse mendojmë se një veprim i tillë del i diskutueshëm, andaj kërkon sqarim.

Edhe disa nga trajtat e propozuara, për mendimin tonë, lënë vend për diskutim si p.sh.

*Drenësh (Drenoci), Shalës (Shalinoci), Lugas (Rubovci), Hodanaj (Hodonoci), Zogaj (Zhegoci), Nikosh (Nikoci), Drenas (Gllogoci)* etj.

Në Shqipëri nuk ndeshim pothuajse asnjë emër fshati me këtë formant fundor, pos rastit Bardhoc (Kukës) edhe ky mbi fjalë-temën e qartë fjalëformuese burimore, që lë përshtypjen se është zhvillim i brendshëm i shqipes, edhe pse më 1938 i shtrohet ndryshimi i fundores C në SH: *Bardhosh*.

#### **4. Emërtimet me -evac/-evci**

Me fundorin a prapashtesën - EVAC/-EVCI që në variantin në shqipe del kryesisht -EC /I (- EFC/I!) në Regjistrim dalin mbi 30 emra vendbanimesh, prej të cilëve 11 kanë mbetur të paprekur, nëse e konsiderojmë si gjë normale shndërrimin e formantit -EVAC/EVCI në -EFC, në shqipe, si p.sh.:

*Turmiqefc, Bolefc, Carefc, Vërshefc.*

Sidoqoftë, mendojmë se edhe te këto raste, nëse mbetet në funksion versioni shqip duhet të parapëlqehet rrudhja në -EC si te shumica e shembujve të tjerë, ku është evoluar trajta e ndërmjetme *-efc në -EC*.

Po shtojmë edhe këtë se edhe te ky grup emërtime, në disa raste, vihet re ndryshimi i C-së fundore në –S, si p. sh.:

*NisheS për Nishec, DashëS për Dashec, ShtërpëS për Shtërpçë, RrënSë për Rrancë,*

që për mendimin tonë kërkojnë sqarim të posaçëm, ngase nuk duket se është zgjidhje e bindshme. Sidoqoftë, bien në sy edhe këto përshtatje, si:

*Tygjec për Tugjec, Biçaj Biçeci, Radesh Radasheci*

si dhe ndryshimet:

*Dritan/ Dobrasheci, Grykas /Tërdeci, Dardhesh /Krusheci e Qafëmal/ Zajçeci*

si dhe mbetja e trajtës së mëparshme te shembujt:

*Rahovec (serb. Orahovac), Bec, Marec, Tupec etj.*

Në Shqipëri, ndeshim afro 30 emra vendbanimesh më -EC fundore. Më tepër në rrethinën e Korçës:

*(Kalanec, Rrëmbec, Brazdavec, Bullgarec, Dolanec, Donjanec, Çerenec),*

por edhe të shpërndarë gjithandej edhe në vise të tjera:

*Shishtavec (Kukës), Gradec (Shkodër), Zvërnec (Vlorë), Kostrec (Permet), Staravec, Kojavec (Dibër), qyteti Pogradec etj.*

Gjithsesi ky formant me origjinë bullgare -ovec që te ne në shqipe e ka të fituar konkurrencën kundrejt formantit –o/vac të serbishtes, te shembujt:

*Rahovec (Orahovac), Kushavec (Kushevac), Lipovec (Lipovac), Lubovec (Ljubovac),*

por që mbase nuk duhet përkrahur në emërtime të reja, prandaj Komisioni ka vepruar drejt, kur për shumicën e rasteve ka lejuar zëvendësimin e këtij formanti, përkatësisht ka bërë ndryshimin e tërë emrit, duke e emërtuar me emër të ri. Kështu ishte vepruar edhe në Listën e vitit 1938, ku me sa pamë në atë burim me përjashtim të disa shembuj të mbetur pikërisht me –e(v)ci fundore, afro 30 shembuj të kësaj natyre nga numri i përgjithshëm janë zëvendësuar me barasvlerës të rinj.

## 5. Emërtimet me –EVO/-EVA

Me fundoren -EVO/-EVA (shq. –evë) që në Listën e vitit 1938 dalluam këta dy shembuj Boçeva, Kokreva, në Regjistrin e Komisionit në versionin e parë të botuar në *Rilindje* ndeshim afro 30 emra vendbanimesh me këtë formant, mirëpo gjysma prej tyre janë ndryshuar në versionin e dytë, ndërsa pjesa tjetër ka mbetur po me këtë fundore. Zgjon interes fakti se

me këtë fundore në Shqipëri sipas Fjalorit 2002 nuk ndeshim emërtime vendbanimesh, pos nja 5-6 rasteve si:

*Steblevë (Dibër), Cërnalevë (Kukës), Hashtevë (Gjirokastër)* etj.

Mesa dimë edhe rastet që kanë mbetur me -EVË te ne ka kërkesa për t'u ndërruar, qoftë formantin -evë, qoftë duke e ndryshuar (zëvendësuar) tërë fjala.

Edhe për këtë grup bie në sy *përshtatja Krushe* (për *Krushevë* mbase më mirë *KrushË-A* se sa *KrushE KrushJA?!*), por zgjojnë interes sidomos zëvendësimet e reja si:

*Besianë/ Podujeva, Firajë/ Firiqeva, Dukat/ Dugajeva, Dukas /Siqeva, Qëndresë/ Gllareva, Blerim/ Vasileva, Labi /Llapçeva, Prronjas /Lybiçeva, Shqiponjas/ Radisheva.*

Duhet parë lidhur me këtë edhe një fakt tjetër, meqë fjala *EV* në turqishte ka kuptimin *shtëpi*, venbanim, duhet parë e konstatuar, ka pasur ndikim, apo jo, kjo dukuri në ndonjë emërtim? Në të vërtetë, nga shëmbujt që konsultuam nuk vërehet ndikimi i fjalës turke -EVË (shtëpi) madje as si gjymtyrë kompozite, në funksion siprapashtese tek ndonjë shembull tjetër.

## 6. Emërtimet me -ovo/-ova

Edhe me prapashtesën serbe -OVO/-OVA (shq. -OVË fundore) në Regjistër ndeshim nja 40 emërtime, prej tyre mbeten të paprekura 15 sosh, ndërsa të tjerat kanë pësuar, qoftë ndryshim rrënjësor, qoftë të pjesërishtëm. Edhe te ky nëngrup, vërejmë përshtatje ose ndryshime përkatëse, si:

*Stagovë StagoNë, Çeskova ÇeskAJ, Kurillovë KurillË.*

Gjithashtu zgjojnë interes edhe barasvlerësit e rinj zëvendësues si:

*Micsokol /Slivova, Kështjellas/ Popova, Arbanë/ Dushanova.*

Në Shqipëri ndeshet një numër mjaft i madh vendbanimeve me këtë formant, me sa pamë dilnin afro 50 sosh. Mbase para se të rishikohet qëndrueshmëria e tyre është mirë të konstatohet se pos prapashtesës sllave -OVË a mos ka pasur farë ndikimi, (siç po thuhet) edhe fjalë-siprapashtesë e turqishtës -OVË me kuptim: *arë, pasuri e patundshme*, siç, në të vërtetë, mund të shpjegohet, qoftë rasti i emrit ***punove-a*** (arë pune) në Shqipëri (FGJSSH) si dhe rasti ***Gjakovë***, i cili në serbishte del Gjakovica, rast ky që shkon në dobi të gojëdhanës se fjala Gjakovë vjen nga ***Jak+ovë*** = Jak + arë (pasuria e Jakut), por që përkon edhe me serbishten Jakovo (imanje) që do të thotë: *pasuri e Jakut*. Në Listën e vitit 1938 ishin në process ndryshimi mbi 20 raste me këtë formant fundor.

Sidoqoftë, edhe formanti -OVO duket si mish i huaj në emërtimet përkatëse të vendbanimeve në gjuhën shqipe.

## 7. Emërtimet -avo/-ava

Me fundoren -AVO/-AVA sipas Regjistrit del një numër i vogël i emërtimeve të vendbanimeve të ne. Me formantin -AVË të ne ndeshim këto katër raste:

*Batllavë, Tërnavë, Kosavë dhe Dubravë.*

Prej këtyre, vetëm për Batllava sipas Regjistrit nuk propozohet ndryshim, për të tjerat po. Kështu *Tërnavë* mori pagëzimin e ri *Shpat, Kosava Ulinë*, ndërsa *Dubrava*, me që si emër ndodhet në tri komuna të ndryshme ka marrë po tre barasvlerës të ndryshëm: *Drejanë, Lisnajë, Dushkajë*.

Edhe në Shqipëri nuk ndeshim numër aq të madh emërtimeve të vendbanimeve me këtë formant, pos rasteve, si:

*Gllavë (Tepelenë, Gravë (Sarandë), Saravë (Lushnje), Moravë (Durrës), Kukucavë, Karavë, (Vlorë), Çerravë (Pogradec); Zhavar (Fier), Parav (Pukë),*

por bie në sy se me këtë fundore ndeshim disa emra që emërtojnë mikrotopinime (mal, majë (mali), kullosë, kodër, përrua, pyll ), si:

*Bruzhllavë, Gojdivë, Kokogllavë, Kosniravë, Mutravë, Toporavë Saravë, Erravë, Malavë, pastaj: Dunav/ec, Mutrav/ec, Shishtav/ec,*

e ndonjë tjetër.

Sidoqoftë, me këtë formant fundor as në Kosovë as në Shqipëri nuk ka numër të madh vendbanimesh, por nuk është edhe krejt pa to.

## Shënim

Studiuesi Nezir Myrta, në një punim të tij konstaton se si disa studiues serbë konstatonin si fakt se prapashtesa -OV, -OVA dhe -AV /-AVA janë me preardhje thrakase, të cilat sipas tyre njëherazi janë prapashtesa të paraardhësve të shqiptarëve dhe kjo dëshmon prejradhjen gjuhësore thrakase, jo ilire të tyre(!), mirëpo, siç shpjegojnë studiuesit bashkëkohorë, thrakasit ishin vetëm një fis në kuadër të iliro-pellazgëve.

Sidoqoftë, konstatimet e mësipërme për këto dy prapashtesa a fundore sa kanë të bëjnë me gjurmë të kësaj dukurie apo jo, ia vlen të studiohen. Ndërkaq, ne, lidhur me foljet me prapashtesën - AVË në gjuhën



shqipe, kemi shkruar një punim të veçantë, botuar te portali *zemra shqiptare.net*, përmbledhur në vëllimin *Çështje të shqipes standarde lidhur me 28 tema të diskutueshme III*, ku ky formant në raportin ndërndikues shqip/serbisht trajtohet mjaft në hollësi.

## **b) Emërtimet me formantet me origjinë greke e turke**

### **Emërtimet me prapashtesat -OS e –OT**

Janë dy formante, -OS dhe –OT, që i quajnë me origjinë greke, por në raste nga ndonjë studiues shihen edhe si gjurmë ilirishte.

Sidoqoftë, me këto formante të përvetësuara ndeshet edhe ndonjë emërtim venbanimi në shqipe.

#### **a. Emërtimet me -OS**

Kështu me prapashtesën –OS, te ne, nuk ndeshet asnjë emërtim vendbanimi në funksion, kurse tash, sipas variantit të propozuar nga Komisioni, për çudi, dalin nja gjashtë emërtime të tilla, si:

*Talinos për Talinoc, Grabos për Graboc, Hanros për Hanroc, Butos për Butoc, Sanos për Samoc dhe Brestos për Brestoc.*

Prapashtesa a fundorja –OS, del në zëvendësim të formantit OC të trajtave në funksion. S’do mend se ky formant te shembujt e mësipërm ka dalë nga -OVAC/OVCI e serbishtes, por nuk di arsyen pse Komisioni trajtave të tilla u dha ngjyrë si të formantit grek -os? Kjo dukuri jep shkas jo vetëm me u diskutue, por mbase edhe me u korrigjue, apo jo? Përshtatja në shqipe vetëm me ndërrimin e fundores C me S, për mendimin tim, del veprim ndoshta jo i qëndrueshëm, edhe për vetë faktin se fundi i fundit në vetë shqipen kemi një dukuri tjetër, kur -S-ja fundore del në -C, siç janë formëzuar mjaft emra të sendeve konkrete, si p.sh.: *shpojçë (shpojsë), ballcë (ballës), përparcë (përparëse)* etj. shembuj këta, që dalin të normuar në shqipen standarde. Madje përveç kësaj edhe vetë rasti Bardhoc, mjafton sa për të vënë në ballë kritike veprimin e Komisionit për këtë pikë. Lidhur me këtë përkrah vërejtjen me vend të dr. Zenun Gjocajt, i cili për disa raste të ngjashme si kjo, siç është spikatur edhe në punimin tonë, veç tjerash thekson:

... Nuk do të arsyetonte standardizimi një ndryshim sekondar fonetik, me një të hequr ose të shtuar të një tingulli, sepse me këtë nuk ndryshon semantika e emrit...(Shih, Rilindja, 5 janar 2001, f. 15).

Dihet se me fundoren ose prapashtesën -OS në Shqipëri dalin disa emërtime toponimesh si:

*Bagos (Kavajë), Mnos (Peqin), Patos (Fier), Klos (Mallakastër, Mat),*

por ky numër nuk është i madh aq sa të mund të ndikonte asociacionisht edhe ketëj, që fshatrave tona t'u vëmë *bishta* të tillë, pa kurrfarë nevoje.

## **b. Emërtimet me –OT**

Edhe fundoren -(J)OT në oikonime e konsiderojnë formant me origjinë greke, por që s'është pa gjurmë edhe në ilirishte. Te ne nuk ndeshim emra vendbanimesh në numer të madh me këtë formant, megjithatë sipas Regjistrit ndeshim këto raste:

*Ruhot (Pejë), Kllokot (Viti) dhe Sopot (Gjakovë).*

Edhe në Shqipëri ndeshim disa emra me këtë formant si:

*Labinot (Elbasan), Obot (Shkodër), Leminot (Korçë) Skaravot (Kolonjë), Sopot (Elbasan) ose Mal-Milot (Kurbini),*

gjithsesi në numër joaq të madh sa të ndikonte në sistem që të arsyetohej dalja e formantit -OT si model për emërtime të reja oikonimesh, apo jo?

Sidoqoftë, nuk përjashtohen ndërndikime fjalësh në raportin shqip/greqisht, por sa i përket ndikimit të formanteve të greqishtes me –OS e -OT, siç e pamë në realitet nuk del numër i madh i shembujve.

## **2) Emërtimet me prapashtesat -A/XHI, A/LI dhe –IJE/A**

Emërtimet e vendbanimeve në gjuhën tonë me formantet me origjinë turke me -(A)XHI, -(A)LI (-LLI dhe –IJE/A, sipas Regjistrit nuk paraqesin kurrfarë pranije të dukshme, megjithatë nuk janë dhe pa gjurmë fare. Sidoqoftë, po i trajtojmë rastet veç e veç.

### **a. Emërtimet me -(a)XHI**

Në Regjistrin në fjalë me -(A)XHI, ndeshim vetëm rastin *Llugaxhi*, ndërkaq edhe në Shqipëri ndeshim:

*Kullaxhi-u (Mirditë), Lugaxhi (ELbasan), Sukaxhi-a (Le), por hasëm edhe Prongji-a(!) (Gjirokatër) si dhe trajtën Hallvaxhias. (emër lagjeje Berat dhe sot një fshat i bashkuar Lushnjë).*

Bie në sy edhe trajta *Dallxhi* (përrua, Krujë).

Sidoqoftë, emërtimet me  $-(a)XHI$  si oikonime në gjuhën tonë janë në numër simbolik.

### **b. Emërtimet me $-(a)LI$ ( $-LLI$ )**

Në Regjistrin në shqyrtim me prapashtesën ose fundoren  $-(A)LI$  ndeshim vetëm rastin: *Kodrali*, jo të tjerë, prandaj del i saktë konstatimi i R. Doçit se “*në tërë Kosovën toponime me prejardhje orientale ka krejt pak*” (Bota sot, 8.3.2001 f. 19). Mirëpo, ç’është e vërteta, sipas FEGJ (2002), përveç emërtimeve:

*Çaushli-a, ish-fshat sot Shqitas (Korçë) dhe Mem/ël –li (në tri rrethe: Elbasan, Tepelenë dhe Korçë),*

kjo prapashtesë turke ka shtrirje sidomos në trajtën me  $-(a)LLI$ , si:

*Grecalli-a, Gjakolli-a, Senemelli-a, Kurtalli-a, Kavaklli, Mujalli –a Shëndelli-a, Pashalli-a.*

Konstatojmë, edhe pse për nga numri formimet me këtë prapashtesë-fundore nuk delin në numër aq të madh, megjithatë ndikimi i gjuhës turke, në të dyja këto variante, nuk del krejt pa gjurmë, apo jo?

### **c. Emërtimet me $-I$ ose $-IJE/A$**

Në gjuhën tone dalin edhe disa emra me fundoren-prapashtesën  $-I$ , përkatësusht  $-IJE$  që përzihen me fjalë të tjera shqipe, po me këtë fundore, por janë disa shembuj emra fshatrash që kanë prapashtesë arabo-turke ( $-ije$ ), si: *Hasmallije, Fliballije*. Më poshtë, pak më në hollësi po i cekim diçsa raste, si:

1)  $-I$ , si: *Gri-a, Kurtalli-a, Kovaklli-a, Tapi-a, Ashkëmi-a Memëli-a pastaj Revani, Papuçi, Sini-a, Salari, Shëndëlli* etj.

2)  $-IJE$  si: *Olije (Guri i Olijës), Bozanxhije, Çestije, Brekije, Fliballije, Xherije, Çizmeliye, Pallçije, Rabije, Ramije, Nahije, Ruzhdije, Rrancije, Vasije-t, Sulejmaniye, Muradije (lagje Vlorë), pastaj Kakavije Ngrançije, Korije, Drenie Kavanie, Grançie*, e ndonjë tjetër.

Sidoqoftë, për ne këtu vlen konstatimi se gjurmë të fjalëve të përvetësuara nga turqishtja ose nëpërmjet saj me këto fundore janë të dukshme, por nuk shprehin prirje shumimi, ashtu si edhe emërtimet me prapashitesat e ashtuquajtura greke –OS e -OT.

## **B. EMËRTIME VENDBANIMESH ME PRAPASHTESAT E PËRVETËSUARA MBI BAZË ORONIMESH**

Në traditën e gjuhës shqipe janë formuar mjaft emra gjeografikë (vendesh) të përgjithshëm e të përveçëm me prapashtesat: -ISHTË, -N/IK dhe -INË, por që janë shfrytëzuar mjaft dendur edhe për formimin e vendbanimeve. Për emërtimin e ndonjë koncepti po nga fusha e toponimisë, por të një karakteri që s'ka të bëjë aq me vendbanime të mirëfillta dalin edhe formimet me formantet -ORE dhe -TORE. Dukurinë e tillë apo rastet me formantet e sapocekura, po i trajtojmë në vazhdim.

### **1) Emërtimet me -ISHTË**

Në burimet tona normative ceken prapashtesat variante: *-ishte*, *-ishtë* dhe *-isht*. Në emërtimet e vendbanimeve sipas Regjistrit del më e përdorur trajta *-ishtë*, por edhe ajo *-isht*, për të cilën do të bëhet fjalë veçan më poshtë, në nëntitullin tjetër përkatës. Me prapashtesën -ISHTË zakonisht emërtohen oronime, vendi ku ka shumë objekte-gjëra, sipas llojit të cekur në temën prodhuese (motivuese), mirëpo kjo prapashtesë, siç u tha, është shfrytëzuar edhe për emërtimin e ndonjë vendbanimi. Në Shqipëri, edhe sipas Listës së vitit 1938 edhe aktualisht me sa pamë, dalin mbi 10 oikonime me *-ishtë* (*ishte*)fundore, ndërsa në Kosovë, sipas Regjistrit të Komisionit, dalin dyfish më shumë, afro 20 sosh. Shumica e rasteve kanë temë të qartë motivuese, p.sh.:

*Dardhishtë, Gurishtë, Fierishtë, Ujnishtë, Qarrishtë, Malishtë, Ranishtë, Blinishtë, Lajthishtë, Arrishtë, Landishtë, Pemishtë* etj.

Sipas burimit 2002 mbizotërojnë emërtimet jooikonime me formantin – ISHTË, ngase aty shihet njëfarë oponence me trajtën –ISHT.

Meqë kjo prapashtesë (-ISHTË) në mjaft raste dilte dhe del e barasvlershme me trajtën -ISHTE të gjuhën serbe, ka studiues që të dytën e quajtën formant me origjinë sllave, por ka edhe të tjerë, që pa mohuar

ndërndikimet, variantet *-ishte/ishtë/isht* i konsiderojnë si reflekse të ilirishtes në shqipe.

Sidoqoftë, për mendimin tonë trajta me *-ishte* që ka sot për sot njëfarë sifryme serbishteje, sepse në atë gjuhë në këtë formë ka përdorim të gjerë, nuk del fare e nevojshme të përdoret në gjuhën tonë të sotme letrare, kur nocionet gjegjëse i mbulon plotësisht, qoftë trajta *ishtë*, qoftë ajo *-isht* apo ndonjë formant tjetër barasvlerës, prandaj, për mendimin tonë, nuk është dashur fare të figurojë trajta *-ishte* as në gramatika, as në burime të tjera normative si trajtë e favorizuar. Kështu më duken të tepërta rastet oronime: *fidanishte e punishte*, por edhe edhe: *egjërishte, farishte, fasulishte, gështenjishte, plepishte*, që figurojnë krahas atyre me *-ishtë* në *Fjalorin e shqipes së sotme*.

Sidoqoftë, për ne është me interes të dihet fakti se trajta *-ishtë* del si formant i përvetësuar për emërtimin e oronimeve në shqipe, por edhe për disa oikonime, pa marrë parasysh faktin se për mbulimin e dy koncepteve paraqet si pengesë homonimia e trajtave. Pikërisht, për shkak të fenomenit të homonimisë, mund të dalin çështje që lypin sqarim. Edhe në Shqipëri për oikonime del e përdorur prapashtesa *-ishtë*, por në raport me variantin *-ISHT* përdorimi i saj është pesë herë më i vogël. Kjo çështje do të sqarohet më saktësisht, kur të bëhet fjalë për emërtimet e venbanimeve me formantin *-isht*, si formant me pruirje spe cifikimi, në nëntitullin përkatës, po në këtë punim.

## 2) Emërtimet me **-(N)IK**

Formimet e vendbanimeve me prapashtesën *-NIK (-IK)* dalin të dëshmuara mjaft herët. Xhuvani Çabej shënojnë këta emra të hershëm topikë me *-IK* fundor:

*Belik, Cërrik, Koplik, Leskovik dhe me -NIK: Dushnik (Berat), Lunik (Elbasan), Sojnik (Vërçë), Ujanik (Skrapar).*

Edhe R. Mulaku shënon si raste të hershme toponimet:

*Kasnik (Elbasan), Krashnik (Berat), Ujanik (Gjirokastrë).*

Në Regjistër të Prishtinës, dalin të shënuar me *-IK/-NIK* fundore nja 25 raste. Bien në sy tri raste kur emrat e mëparshëm me *-IQ* gjejnë zgjidhje në shqipe me këtë formant si p.sh.:

*Bardhanik (Bardhaniqi), Trakanik (Trakaniqi) dhe Barbanik (Barbaniqi),*

fakt ky që dëshmon për përvetësimin ose favorizimin e këtij formanti nga Komisioni. Si raste të përvetësimit të këtij formanti në gjuhën tone, po i cek edhe shembujt: *Besnik* e *Fisnik* që si emra mode kanë formëzuar oikonime përkatëse si Kosovë ashtu më parë edhe në Shqipëri.

Në Listën e vitit 1938 ndeshim këto emërtime me -IK fundore: *Toranik, Ravnik, Kreshniku, Kamniku, Dersniku, Ziboniku.*

Sipas Regjistrimit të Komisionit të Prishtinës, zgjojnë interes edhe rastet me -N/IK të dala nga përshtatja, si:

*KunAvik për Kunovik, Pusnik për Pustenik, Kryenik për Kërvenik, Rreznik për Reznik, Vajnik për Vojnik.*

Edhe pse bien në sy edhe nja 7 raste të ndryshimit (zëvendësimit) të formave me -NIK fundor si p.sh.:

*Gjyrgjeviku i Madh (Martiras), Gjyrgjeviku i Vogël (Elezaj), Brestoviku (Gurinë), Brezheniku (Lagja Dardania), Tërsteniku (Trefis), Kozniku (Pyllnajë), Tërsteniku (Mollkuqi),*

nga shembujt e mësipërm si dhe rastet që janë nja 15 sosh, në mos qofshin më shumë, në Shqipëri (edhe te ne) si:

*Besnik (Sarandë) Sojnik (Gramsh), Ujanik (Sarandë)* etj, dëshmojnë se ky formant del i përvetësuar në shqipe, pra, edhe për formimin e disa vendbanimeve.

Ndërkaq, ndonëse sipas R. Doçit të *Halnik* (për Hajnoc) ka gjurmë ilirishte, për shkak të interferencës së saj me sllavishten, siç thonë disa studiues, s'di sa mund të arsyetohet favorizimi i emërtimeve të reja me këtë formant, edhe pse në burimin 2002 (Shqipëri) ndeshim mbi 30 shembuj (jo të gjithë oikonimikë) me këtë fundore, kur, siç do të shohim, ofrohen formante të tjera më të specifikuar për destinim oikonimie, apo jo?

### 3) Emërtimet me -INË/ -IN

Me prapashtesën INË dëshmohen mjaft herët në gjuhën tonë disa toponime dhe patronime. Xhuvani - Çabej përmendin:

*Babinë, Jagodinë, Lalinë, Malinë, Rogozhinë,*

ndërsa R. Mulaku shënon rastet: *Fundinë, Dedinë, Sutinë,* ndërkaq si patronime shënon: *Hutinë* e *Trashinë.*

Sipas Regjistrimit, formimet me këtë formant janë në numër të konsiderueshëm. Në funksion, dalin afro 30 shembuj. Prej tyre mbesin të paprekura nja 14 emërtime të vjetra si: *Prishtinë, Muzeqinë* etj., ndërsa 11

raste me -INË fundore, sipas Regjistrit të Prishtinës, dalin të ndryshuara, pothuajse tërësisht.

Zgjon interes fakti se nja 16 emërtime të reja janë përftuar mbi fjalë-tema të shqipes, prej tyre 3 zëvendësojnë format me fundore të njëjtë si p.sh:

*Gjërçina (Dragaçinë), Tumelina (Tumiqinë), Gjelbina (Sllatinë),* ndërsa 13 të tjera zëvendësojnë barasvlerës me formante të tjera.

Krahaso:

*Çelinë (Jelloci), Vraninë (Vranishta), Çeltinë (Novalani), Terinë (Torina), Gurinë (Brestoviku), Kodrinë (Kodradiqi), Thatinë (Svërka), Shpatinë (Gërncari), Kuqlinë (Kuçica), Ulinë (Kosava), Rrezinë (Zagërma), Trinë ((Tirinca), Butinë (Dobrusha).*

Në Shqipëri ndeshim mbi 20 emërtime me këtë formant fundor, si p.sh.:

*Sllatinë, Zavalinë, Babinë (Tropojë), Kosinë (Permet) Vrinë (Sarandë) etj.*

Ndonëse disa studiues këtë formant e konsiderojnë me origjinë sllave, por që ka gjurmë ilire, ne për shkak të gjerësisë së përdorimit në nënfusha të tjera semantike, e quajtm vetëm si prapashtesë të përvetësuar për emërtimin e vendbanimeve.

Në Listën e vitit 1938 ceken a fro 20 shembuj, shumica prej tyre mund të rekomandohen si trajta të drejta, të përshtatshme edhe sot.

Është me interes të ceket raporti i kësaj trajte me variantin -IN që del i identifikuar në mjaft emërtime të vjetra si:

*Bulin, Demastin, Scodrin, Parthin, Patin, Fangin, Bregasin, Shkumbin,*

të cekura nga M. Domi si dhe *Burrin* për Burica të cekur nga R. Doçi. Në burimin 2002 ndeshim disa emra me -IN fundore, si *Peqin, Marin* etj. Në të vërtetë, prof. R. Doçi, megjithatë i propozon edhe këto trajta të reja me -INË fundore:

*Bakçinë, Klinçinë, Gurthinë, Barainë, Gurçinë.*

Sidoqoftë, ky formant del dyvariantësh -INË/ dhe -IN, prandaj ka mundësi manipulimi me të dyja këto forma, por për emërtime të reja oikonimesh nuk paraqet model fjalëformues, apo jo?!

#### **4) Emërtimet me -ORE e -TORE**

Prapashtesat -ORE dhe -TORE i kanë të përcaktuara nënfushat e veta semantike edhe në kuadër të emërtimeve onomastike, por jo të vendbanimeve.



Kështu ndërsa prapashtesa -TORE (e krahasueshme me formantin e latinishjtes *-torem*) del e specializuar për emërtimet e vendshërbesave, tipi: *vëgëltore, tjerretore, mishtore* etj. për emërtimin e vendbanimeve nuk del prodhimtare.

Ndërkaq, prapashtesa -ORE, e cila është më e ngarkuar për emërtimin e sendeve a të mjeteve të punës, përdoret edhe për emërtime vendi, por të një tipi të veçantë. Emrat e tillë kanë sinonimi me prapashtesat: *-ishtë* e *-najë*, si p. sh.:

*tepore (tepishtë), ullishtore (ullishtë), groshnore (groshnajë), tepore (tepishtë), grunore (grunajë e grunishtë),*

por gjithsesi me koncept të zvogëlimit në krahasim me formimet me *-ishtë* e *-najë*. Në të vërtetë në Listën e vititi 1938 janë përfshirë disa emra që për sot më fort kemi të bëjmë me vendshërbesa ose mikrotoponime se oikonime, si:

*Theknore, Farkëtorja, Shulorja, Pjeshkorja, Verore, Dimnor*  
e ndonjë tjetër.

Sidoqoftë, kjo prapashtesë nuk del e parapëlqyeshme për emërtime vendbanimesh, prandaj edhe rasti *Brezore* (nga Regjistri i Prishtinës), si emërtim fshati s' di sa mund të konsiderohet si rast i mbështetur, kur kemi mundësi të tjera më të pëlqyeshme fjalëformuese për konceptin e kërkuar të vendbanimit?

## Sipërfundim

Për këtë grup emërtimesh mund të jepet si vërejtje e përgjithshme se ndërsa prapashtesat *-ishtë*, *-(n)ik* dhe *-inë/-in* dilnin në barasvlerësi të krahasueshme me prapashtesat pothuajse identike të serbishtes me formë të ngjashme, prapashtesat *-ore* dhe *-tore* duket se janë kryesisht zhvillim i brendshëm i gjuhës sonë, pa hyrë në interferenca të hershme paraletrare që mund të ketë pasur shqipja me gjuhë të tjera të vjetra në kontakt.

## **C. EMËRTIMET MBI BAZË TË EMRAVE ME PRAPASHTESAT E PËRVETËSUARA PËR KONCEPTE NGA VEPRIMTARIA E NJERIUT**

Emrat sipas veprimtarisë së njeriut, që do të thotë se kanë të bëjnë me botën komunikative e veprimtare të tij sipas prapashtesave përkatëse më të përdorura a të specifikuara i ndajmë:

së pari, në emra që emërtojnë patronime (mbiemra familjarë, ofiqe e llagape), ku, sidomos në kohën tonë, del më e spikatur (e specializuar) prapashtesa **-AJ**,

së dyti emërtimet e njerëzve sipas prejardhjes a vendbanimit me prapashtesat më të njohura: **-AS, -J/AN, -AK** dhe

së treti, emërtimet e njerëzve sipas profesionit a veprimtarisë që ushtrojnë me prapashtesat më të specifikuara: **-(ë)S, -AR e -TAR, -OR(!)**.

### **1) Emërtimet me -AJ**

Për emërtimin e patronimeve (emrave familjarë) përdoren disa prapashtesa, por ajo më e dallueshmja që është lidhur arbitrarisht edhe me formimin e emrave të vendbanimit është formanti **-aj**. Madje kjo prapashtesë sipas Regjistrit në shqyrtim del prapashtesa më e shfrytëzuar në krahasim me të gjitha sishoqet e veta. Gjithsej, sipas Regjistrit (2005), janë 120 raste të zgjidhura(!) me këtë formant që në krahasim me totalin, kundrejt numrit të përgjithshëm të emërtimeve në atë burim, arrin 8.02%. Dihet, siç është konstatuar nga studiuesit, se ky është formant autokton i shqipes, ndonëse nxit interferencë me prapashtesën latine *-anius*, përkatësisht *-agni* (shqipto: *anji*) të italishtes.

Ç'është e vërteta, do të ishte me interes për gjuhësinë tonë që formanti i latinishtes *-an/ius* (it. *anji* \**anjë*) të studiohet në raport me formantin patronimik të shqipes, jo aq me: *anj* (*-aj*), por sidomos me formantet oikonimike: *-ajë* dhe *-anë*. Sidoqoftë, formanti *-aj* në shqipenm e

sotme del i specializuar në radhë të parë për formimin e patronimeve, së këtejmi me një proces ndërlidhës ka kaluar apo mund të kalojë ose të arsyetohet në *raste të veçanta* edhe në emërtime të vendbanimeve. Pikërisht, *rast të veçantë* quajmë procesin e *kalimit*, kur një patronim më -aj mund të formëzohet si emër vendbanimi, andaj kjo dukuri ka nevojë të sqarohet. Sipas rregullit, emri a mbiemri (ofiqi) i caktuar (është fjala për antroponim) pa prapashtesën -AJ duhet së pari, me marrë cilësinë e mbiemrit të familjes së ngushtë (ndërkëmbyeshëm me fundoren e njëjësit emrit të shquar përkatës: i, u, a / ja, ndërkohë të familjes së gjerë dhe vetëm pastaj me zgjerimin e familjes, me të zotëruarit e cilësisë së patronimit të mirëfilltë dhe së andejmi sipas rrethanave të caktuara mund të kalojë si koncept edhe për emërtimin e një vendbanimi, të një lagjeje a të një katundi, ku banuesit me të njëjtin patronim i japin atë emër vendbanimit apo fshatit të ri, zakonisht në rast shpërnguljeje e sforcim ngulitjeje, sidomos kur vendbanimi përkatës deri atëherë ishte i paemërtuar. Kështu, b.f. emri vetjak *Bardh* ose *Ukë* që mund të kalojë njëherë si mbiemër i familjes së ngushtë *Bardhi* ose *Uka*, nga shumimi i familjes mund të cilësohet po ai emër si patronim *Bardha(!)* a *Uka*, përkatësisht *Bardhaj* ose *Ukaj* dhe së këtejmi, siç u tha lagja a katundi mund ta marrë emrin *Bardhi* ose *Bardhaj*, *Uka* ose *Ukaj*.

Pra, po e theksojmë në mënyrë të veçantë, ky është ai sirregull konspektor që arsyeton formimin, më drejt formëzimin e vendbanimit përkatës me -AJ fundore, e jo të bëhen formime me analogji, pa kriter fare.

E theksova mbase me tepri procesin e formëzimit nga emri vetjak (antroponimi) deri te formëzimi si emër familjar (patronim) e së andejmi tek emri i vendbanimit (oikonim), dhe kjo m'u duk e nevojshme të ndalem një çikë më shumë në këtë çështje, sepse pikërisht në këtë pikë dalin të diskutueshme shumica e emërtimeve me -aj të shënuara në Regjistrin e Prishtinës (2005) si emërtime vendbanimesh, madje jo vetëm aty, por edhe në të gjitha burimet e tjera kushtuar kësaj teme. Ishte punë jo e mirë pse logjika e tillë e procesit, siç u cek prej nesh, nuk është respektuar nga asnjë komision më përpara në Shqipri, e saë andejmi as nga Komisioni i Prishtinës i burimit 2005, pasi në mbi 100 raste mungon pikërisht baza paraprake me -aj e emrit familjar (patronimit).

Mbase për një lëshim të tillë a mosrespektim të këtij procesi, që bie ndesh edhe me kriterin e parimit: *toponime të burimit patronimik*, të cekur edhe nga të tjerë dhe nga vetë ai Komisioni, nuk mund të fajësohet askush, sepse për këtë do të kenë ndikuar faktorë objektivë e subjektivë që nuk kanë

mujtë me u anashkalue pa ndonjë studim të mirëfilltë kritikë si ky yni. Pra s'mund të fajësohet askush as Komisioni i Prishtinës, sepse:

Së pari, tradita ishte e tillë, ngase më parë në Shqipëri, sipas Listës së vitit 1938 ishin afro 90 emërtime fshatrash të krijuar më –AJ, që konsideroheshin si emërtime të ashtuquajtura të përshtatshme për implementim. Mirëpo, megjithatë me sa pamë, afro 10 shembuj ekzistues të mëprashëm me -AJ prej tyre, pikërisht për shkak të papërshtatshmërisë së temës ishin ndryshuar me trajta të tjera.

Së dyti, jo vetëm nga ajo traditë e mëhershme, por edhe në Shqipërinë e sotme mesa pamë nga Fjalori (2002) dalin mbi 150 shembuj më –AJ, që aktualisht janë në funksion aktiv vendbanimi.

Së treti, në Kosovë, gjatë Luftës II Botërore qenë formuar dy emra qytetesh, pikërisht me këtë formant –AJ: **Ferizaj** dhe **Skënderaj** dhe për parregullsinë(!) e përdorimit të formantit –AJ në këto raste askush nuk ka reaguar, sepse motivi jashtëgjuhësor ishte më favorizues se ai i brendshmi, siç u cek më sipër prej nesh. Në të vërtetë, emri familjar Ferizi, ka ekzistuar, por jo si patronim Ferizaj, ndërsa për rastin Skënderaj, motivi kryesor ishte emri i lavdishëm Skënder (Skënderbeu!). Pra edhe pse mungonte tradita e oikonimeve me prapashtesën –AJ, këta dy shembuj mund të kenë shëbyer si shembuj model (!), apo jo?!

Së katërti, ka ndodhur mbase edhe keqkuptim ose ngatërresë konceptesh në raportin patronim/oikonim, ngase, është e vërtetë se pas Luftës I Botërore, që në KLSH në Shkodër, e përgjithësisht në Shqipëri formanti –AJ rekomandohej për emërtime patronimesh dhe së këtejmi pas Luftës II Botërore, sidomos te ne si zgjidhje ndaj barasvlerësve patronimikë të serbishtes me *bishtat* e dhunshëm –*v/iqi* që i pati vënë përpara administrata serbe(1912-1941) të përforcuara në kohën e Krlevinës SKS, pothuajse një shumicë e konsiderueshme e familjeve shqiptare si zgjidhje barasvlerëse për heqjen a neutralizimin e formantit të huaj iritues, gjatë regjistrimit të parë, pas *Çlirimit(!)(pas LDB)*, me sugjerimin e disa intelektualëve udhëheqës shqiptarë të kohës, si Zekiria Rexha etj., zgjodhën me të drejtë si zgjidhje-rekomandim pikërisht prapashtesën –aj, si zëvendësim barasvlerës të përshtatshëm patronimik. Mirëpo edhe pse këtu pati teprime, jo vetëm në fushën e patronimeve, ngase në raste, kjo u bë më tepër nga nevoja e jashtme se ajo e brendshme e gjuhës sonë, sepse te rastet e tipit në vend Hoxha për Hoxhiq doli Hoxhaj, në vende Kastrati për Kastratoviq - KataratAJ, Gashi – Gashiqi GashAJ, e kështu me radhë, por

edhe pse jo njëkohësisht, është interesant se kjo prapashtesë në këtë periudhë nuk del e përdorur pothuaj fare për oikonime të reja (përveç rasteve Ferizaj e Skënderaj, porshumë më vonë (pas Çlirimit), në kohën tonë, arbitrarisht, fare pa kontroll, kaloi në përdorim enorm edhe në fushën e emërtimeve të vendbanimeve (!!!!).

Së pesti, për një invazion të emërtimeve të vendbanimeve me –AJ edhe te ne mund të ketë ndikuar fakti që asnjëherë deri tashti kjo temë në gjuhësinë tonë nuk është trajtuar teorikisht në gjerësinë e thellësinë e duhur, prandaj edhe nga mosnjohja e rregullave të formimit me prapashtesim të vendbanimeve në shqipe kanë ndodhur teprime, siç është edhe rasti i përdorimit enorm të prapashtesës –AJ në oikonimi edhe në Regjistrin e Prishtinës, pas Çlirimit (1999) edhe pse në këtë fushë semantike nuk del i speciafikuar ky formant. Kështu pa gjykuar pasojat që mund të ketë shtylla bazike e strukturës fjalëformuese e gjuhës sonë, formanti *-aj* u ngarkua edhe edhe në një fushë krejt tjetër semantike kontaminuese që deri atëherë te ne nuk i takonte.

Së gjashti, për një numër enorm të emërtimeve iokonimike me –AJ, mbase është menduar që emërtimet e vendbanimeve duke qenë kategoria me qëndrueshme afatgjate e sistemit emëror, ashtu si edhe qëndrueshmëria historike e aktuale e prapashtesës –AJ, ashtu si edhe në Shqipri është menduar se homonimia kantaminuese: *patronimi//oikonimi*, nga vetë konteksti nuk do të jetë aq e qortueshme, ngase vetë konteksti do ta bëjë këtë dallim, apo jo?! Fundi i fundit mbase është menduar se kjo homonimi do të jetë sigurisht më e pranueshme dhe më e lehtëzgjidhshme me mjete vendëse sesa se me i lënë emërtimet me prapashtesat e huaja, apo jo?!

Sido që të jetë, kemi mendimin se po t'i kishin qenë të njohura kriteret e sotme me argumentat që u cekën ose do të cekën e përsqarohen edhe më poshtë, sigurisht hartuesit e mëparshëm si dhe Komisioni i Prishtinës, së paku do të ishin hamendur apo do ta kishin shtuar kujdesin për mos me lejue numër kaq enorm homonimesh me prapashtesën -AJ.

Po cilët ishin ose janë ata argumenta si randesë kuptimore? Si përgjigje po e marrim patronimin DEMAJ, i cili gjithsesi është i pranishëm dhe i njohur në realitetin tonë gjuhësor. Ky formant ndeshet aktualisht në konkurrencë të shumfishtë me formante të tjera barasvlerëse brenda vetë nënfushës kuptimore të patronimisë, si:

e para, me të ashtuquajturën prapashtesë zero (d. m.th. me formantet shquese të emrit), si p.sh. DemI/ (nga Dem-), DemiU ose DemiA (si AliU a AliA); DemA (nga Demë) ose Demai (sikurse Thoma ThomaI);

e dyta me prapashtesat e tjera të mirëfillta të patronimeve të gjuhës sonë si p.sh.: DemAÇI, DemAKU, DemUSHI, DemJANI, DemOCI, DemÇI, DemSHI, DemARAKU, DemÇORRI etj. dhe

e treta, që është edhe më me shumë interes, me prapashtesat zakonisht të imponuara ose të përvetësuara nga gjuhët e huaja, si b.f: DemOLLI, DemÇOLLI, DemALLARI, Dem(A)LLIU, DemOSi, DemIÇI, DemiSHI, DemiSHA, DemOVI, DemOVSKI, DemoVIQI, DemOVITI e ndonjë tjetër, prapashtesa këto, të cilat në parim mund të zëvendësohen fatlumisht, me prapashtesën –AJ, pa lënë keq asgjë. Sidoqoftë, kësaj dukurie ia kushtojmë edhe sqarimin përmbyllës si më poshtë.

### **Sipërmbyllje ose sqarim i domodoshëm**

Edhe pse mund të themi se për emërtime të reja (si trajtë përfaqësuese) forma me –AJ, si p.sh **Demaj** subjektivisht e ka të fituar konkurrencën, kur kemi parasysh tërë këtë ndërlikueshmëri konkurrencte me formantet e tjera rivale, të cilat faktikisht ende veprojnë, atëherë mund të themi me plotgojë që spostimi i funksionit të këtij formanti në një fushë krejt tjetër semantike: **ngarkesa me konceptin iokonimik**, siç ndodhi pa nevojë të domosdoshme, sigurisht do të dëmtonte ose e ka dëmtuar vërtet shumë atë luftë konkurrencte ndaj rivalëve të sapopërmendur dhe njëherazi do ta dëmtonte me siguri edhe modelin tashmë të përvijëzuar e të qëndrueshëm në kuadër strukturës përkatëse standarde emërformuese për nënfushën e caktuar semantike, të arritur aksiomatikisht në kohën tonë jo pa histori përdorimi dhe gjithsesi, jo pa nevojë.

E dyta, është me interes të dihet dhe të dallohet nevoja e brendshme e gjuhës nga ajo e jashtmjaja imponuese rreth përdorimit të formantit -AJ. Këtu e shohim të nevojshme të sqarojmë paksa këtë ndërlikje me shembuj konkretë. Sa për ilustrim po cek mbiemrat familjarë të tipit:

*Hoxha, Gashi, Bajraktari, Kastrati, Krasniqi, Sopi, Shala* etj.

Është e vërtetë se emrat e tillë nuk përdoren si antroponime, pra nuk u vëmë pasardhësve tanë emra të tillë vetjakë, siç veprohet b.f. me emrat Bardh a Ukë, Agim... etj., të cilët përtërihen, prandaj kur përtërihet emri familjar (ndër breza), atëherë normalisht mundet me marrë formantin **-aj**, në shenjë dallimi familjar për nevoja të brendshme të gjuhës, nevojë kjo që nuk del te

rastet e emrave jovetjakë: *Hoxhë, Bajraktar, Krasniq, Gash* etj. Mirëpo, shtrohet pyetja, vallë si shpjegohet kjo dukuri, pse ndodh që në realitetin tonë gjuhësor të ndeshim emra antroponimikë e jo antroponimikë, me –AJ fundore të tipit Hoxhaj a Gashaj? Çfarë nevoje i lindi ata?

Sigurisht kjo dukuri, që paksa u cek më parë prej nesh, ia vlen të sqarohet edhe më. Në rastet e tilla del qartë imponimi nga nevoja e jashtme e gjuhës, ngase ajo e brendshmja mungon, gjithsesi nuk motivon. Pra, është e vërtetë, se sunduesit e huaj, me administratat e tyre imponuan formantet speciale të gjuhëve të veta edhe mbi patronimet e tilla, kështu dolën formantet shtuese -OLLI (turke), -(V)IQI (serbe) -OV/SKI (bullgaro-maqedone) etj.

Kjo, pra, është arsyeja që edhe te familjet shqiptare, patën dalë format si: b.f.: *Hoxholli, Hoxhallari, Hoxheviqi, Hoxhovski* ose *Gasholli, Gashiqi, Gashovi* a *Gashevi* etj. dhe së këndejmi shqipërimi në përkthim bukval nga –olli, iqi etj. u reflektua bashkë me prapashtesën speciale patronimike shqipe: –AJ: Kështu nga *N. Hoxholli* ose *N. Hoxheviqi* doli Hoxha + AJ –N. **Hoxhaj**, nga *N. Gashiqi*, doli N. Gashi +AJ N. Gash/i/AJ, **N. Gashaj**, e kështu me radhë. Dhe me rastin e rikthimit të mbiemrit në shqipe fundorja -AJ mbeti si barasvlerës i përdorshëm për të mbuluar hapësirën që mbulonin (në përkthim) formantet e imponuara nga gjuhët e huaja.

Së këtejmi, format e tilla me -AJ nga patronimet e tilla, jashtë strukture vetjake të shqipes), aty-këtu në raste kanë mbetur të reflektuara edhe si emërtime vendbanimi. Gjithsesi, është për çdo kritikë që në jetën tonë të re oikonimike të ndërfiten emërtime të reja vendbanimesh, siç është vepruar pa dashje nga hartuesit në Shqipri e Kosovë e kudo, si: **Gashaj, Hoxhaj**, madje për analogji **Krasniqaj** (!!!!) etj.

E treta, edhe një fakt tjetër duhet pasur parasysh në këtë kontekst. Mbarë treva jonë i ka takuar apo jo, sferës ku kishte traditë formimi i patronimeve më -AJ e së këtejmi dhe i oikonimeve me prapashtesën –AJ?! Lidhur me këtë përkundër dëshirës sonë që të ndeshim gjurma të kësaj dukurie rreth oikonimeve, e vërteta dëshmon ndryshe. A. Kelmendi, b.f. për emërtimin që del në Regjistër në trajtën: *Bogët* (serb. Boge (Bogiç) e propozon trajtën Bogaj) dhe shton sqarimin që emërtimi Bogë i Malësisë së Kelmendit në Rugovë merr prapashtesën -AJ, andaj duhej shënuar e shqiptuar **Bogaj**, ndërsa Nuhi Vinca konstaton se në zonën e Strugës nuk është e njohur prapashtesa -AJ as në patronime, d.m.th. si prapashtesë shumësie, megjithatë sot për sot, por edhe më parë por tash të shumuara,

ndeshim jo pak patronime, por edhe vendbanime me prapashtesën –AJ, gjithandej mbarë trojeve shqiptare.

E katërta, po e përmend edhe një fakt tjetër, ndërlidhur me raste historike të gjuhës sonë. Siç dihet nga historia ndeshim emrat patronimesh të vjetra me fundorin -A ose -I, siç janë familjet e dëgjuara: Gropa (Zaharia Gropa), Balsha (Gjergj Balsha), Topia (Tanush Topia), Bushati (Mahmut Pashë Bushati), Boçari (Mirko Boçari) etj., pastaj edhe emërtime të tjera si Zoga, Vata, Bleta, Koxha, Pula etj. Është e vërtetë që në kohën tonë emërtimet e familjeve të tilla pothuaj normalisht i shënojmë me -AJ fundore si p.sh. familja Gropaj, Balshaj, Topiaj, Boçaraj, Bushataj, mirëpo kjo nuk na jep të drejtë që edhe emërtimin e fshatit (vendbanimit) përkatës ta emërtojmë paraprakisht me -AJ, si p.sh Bushataj (Bushati) ose Vataj (Vata), Bletaj (Bleta), Koxhaj (Koxha), siç kanë bërë komisionet përkatëse, sepse dihet mirëfilli që emri i fshatit edhe sot e kësaj dite në realitet del vetëm me fundoren -A ose I, dhe për ta ndryshuar atë me -AJ fundor s’kemi kurrfarë nevojë as të brendshme as të jashtme, ngase familjet e tilla nuk ekzistojnë me po atë emërtm, apo jo?!

Në kuadër të kësaj, për mos me nxitue po kujtojmë edhe një fakt tjetër që e sjell dr. Rexhep Doçi (shih: *Bota sot*, 8.I.2001, f. 19). Ai konstaton se mjaft fshatra mesjetarë dokumentohen parësisht në formën -A fundore, p.sh:

*Bala, Zoga, Bardh-Zoga, Duka, Floka, Shpata, Bala, Plaka, Riza, Alba etj.,*

prandaj edhe nga kjo anë na bëhet me dije se prapashtesa -AJ nuk vinte si trajtë e domosdoshme për emërtimin e vendbanimeve përkatëse as në të kaluarën, *por parësisht ajo dilte e implementuar për patronime.*

E pesta, edhe diçka duhet pasur parasysh. Kemi raste kur prapashtesa -aj, sidomos në kohën tonë, del në stilin bisedor dhe përdoret gjithsesi në koncept të shumësisë a të emrit kolektiv si b.f. Isha te hoxht a hoxhajt, te bajraktart a të bajraktarajt, forma këto të lejueshme në stilin përkatës thjeshtligjërues, por edhe kjo dukuri nuk na jep të drejtë që në aspektin e stilit zyrtar ta ndërrojmë menjëhershëm emërtimin e patronimit ose të emërtimit të rastësishëm të familjes së gjerë me -AJ fundore në oikonom zyrtar me –AJ fundore. Këtë gjë as që duhet menduar. Kështu themi, kur kemi parasysh faktin që elementi -aj nuk i takon botës së oikonimeve drejtpërdrejt (Hoxha, Bajraktari), por në radhë të parë i takon fushës së patronimeve pa prekur në emërtimin gjeografik, siç u cek disa here edhe në këtë punim.



E gjashta, është shumë me interes që në këtë kontekst të trajtohet raporti i prapashtesës patronimformuese -AJ me trajtën -AJË toponimformuese. Prapashtesa -ajë, siç do të vërtetohet më poshtë, konsiderohet me të drejtë si prapashtesë e vjetër (anase) e gjuhës sonë, e pëdorur parësorisht për toponime. Prandaj në këtë kontekst duhet parë sa ka elemente kontaminimi në mes të dy formave -AJ e -AJË. Sidomos kjo duhet parë në të shënuarit e emrave përkatës në shqyrtim, siç mund të jenë rastet Zotaj a Zotajë, Zogaj a Zogajë etj.

Fundja njëfarë interference shihet edhe në dukurinë e shqiptimit popullor të emrave të qyteteve Skënderaj Skënderaj/Ë!, Ferizaaj Ferizaj/Ë!, ngase shqiptimi del sikurse Firaaj/Firajë, Lisaaj/Lisajë etj., ndonëse zyrtarisht e normativisht është bërë e bëhet presion në shqiptimin patronimik me -AJ. Kjo tregon ngulitjen e prapashtesës -AJË shumë më parë në gjuhën tonë popullore me prirje specifikimi për emërtime toponimesh, mirëpo lidhur me këtë, do të bëhet fjalë paksa më hollësisht në një vend tjetër po në këtë punim, kur do të merret në trajtim grupi i fundit i formanteve me prirje specifikimi për emërtimin e vendbanimeve në gjuhën shqipe.

E shtata, është e vërtetë se në tekstin e versionit të parë, që paraqitej nga Komisioni (2000), pos rasteve Ferizaj e Skënderaj nuk ndeshet numër i madh i vendbanimeve më -AJ fundor, kurse në versionin e dytë të propozuar të Komisionit dalin mbi 100 shembuj me këtë formant, d.m.th. pa pasur fare si mbështetje emërtimin paraprak të patronimit(!!?) dhe kjo bie në kundërshtim, siç u tha më sipër, edhe me vetë parimin e *burimit patronimik* të theksuar nga Komisioni në fjalë (2005) lidhur me përdorimin e formatit -AJ.

Fundja, meqë në të kaluarën nuk është bërë diferencim ndërvariant -aj/-ajë (sepse një shqiptimi i tillë -*aa*j' vërehej më fort vetëm te ne gegët ndoshta për arsye sepse -Ë-ja në këto vise nuk del aq e shqiptueshme dhe dallimi bëhet vetëm nga shqiptimi i dyfishtë i zanores fundore paroksite. Pra, ndoshta ky fakt i rastësishëm mund të ketë qenë për dikë arsye për ngatërrimin e këtyre varianteve, siç u cekën më sipër rastet Zotaj e Zotajë-a, Zogaj e Zogajë-a etj.?!)

Gjithsesi, në rast rishqyrtimi, Komisioni duhet t'i rishikojë të gjitha rastet me -aj, siç janë edhe këto të propozuara nga R. Doçi:

Perka/ Perkaj, Suka Sukaj, Bërrça Bërrçaj, Naka Nakaj,  
por patjetër duhet t'ikorrigojë paluhatje ato të tipit:

*Krasniqaj (Burim, Vushtrri), Haxhizekaj (Pejë), Berishaj (Prizren),*

*Gashaj (Viti) etj.,*

sepse, siç u tha, tashti ka pushuar ai ndikimi i jashtëm, ndërsa për nevoja të brendshme formimet e tilla të vendbanimeve me –AJ, dalin fare të panevojshme.

Po përfundojmë me bindje se si të kishin qenë të njohur argumentat e sipërpërmendur, me siguri si në Shqipëri ashtu edhe te ne nuk do të lejohej një numër kaq i madh enorm homonimik i vendbanimeve të formohej me formantin -AJ pa pasur paraprakisht bazë mbështetëse patronimie.

Sidoqoftë, edhe lidhur me këtë standardologët dhe institucionet tona duhet ta thonë e konstatojnë atë që i duhet më së miri shkencës dhe gjuhës sonë.

## **2) Emërtimet me prapashtesat etnonime: -AS, -AN, -AK**

Ndër prapashtesat më prodhimitare etnonime që shërbejnë edhe për emërtimin e vendbanimeve janë: formantet: *-as, -an* dhe *-ak*.

### **a) Emërtime me AS**

Komisioni i Prishtinës, sipas Regjistrit (2005), propozoi edhe një numër enorm të emërtimeve të vendbanimeve me prapashtesën -AS, deri sa e futi edhe në kuadër të parimit a të metodës së punës konstatimin e diskutueshëm, gjoja formanti **-AS** *përdoret për toponizimin e shumë apelativave* dhe për këtë, edhe pse pa të drejtë lejimi konstruktiv fjalëformues, pati këto tri mbështetje të paqortueshme:

1) Ky element fjalëformues ndeshet i dokumentuar në toponime antike të truallit iliro-shqiptar;

2) nga studiuesit tanë ceket si mjet i përdorshëm për këtë destinim, ngase me të, edhe pse arbitrarisht, janë formuar emra topikë prej emrash dhe

3) në Shqipëri, sipas Listës së vitit 1938 ndeshen afro 20 shembuj, ndërsa edhe aktualisht në Shqipëri, të shtrira gjithandej, janë aktivë në këtë funksion afro 50 emërtime vendbanimesh të formuara me këtë formant, si p.sh.:

*Lumas (Berat), Dermenas (Fier), Prrenjas, Lenias (Gramsh), Mollas (Elbasan), Mamurras (Krujë), Liqenas, Kallmas, Lekas, Miras (Korçë), Prrenjas (Librazhd), Remas (Lushnjë), Valias (Tiranë), Piqeras (Sarandë), Zogas (Skrapar) etj.*

Për sa u shprehëm më sipër, na duhet të sqarojmë, ndonëse nuk i mohojmë edhe ne tri pikëmbështetjet e sipërpëmendura, atëherë, pse e thamë si vërejtje: *një përdorim të tillë enorm dhe mbështetjen e tillë gjithashtu si parim i diskutueshëm arbitrar?* Këtë do të përpiqemi ta shpjegojmë më poshtë:

Së pari, themi kështu, sepse ky formant (ndonëse i dokumentuar që nga antika), sipas gjendjes së shqipes së sotme, del i specializuar pa mëdyshje parësisht, jo për fushën e toponimisë, por për emërtimin e njërëzve sipas vendbanimit a prejardhjes.

Së dyti, është e vërtetë se edhe Xhuvani Çabej konstaton se me prapashtesën -AS janë formuar *emra topikë prej emrash*, si p.sh.:

*Dukas, Çelnikas, Ferras, Fikas, Lekas, Misras, Vidhas*, por më poshtë po ata shpjegojnë që disa nga emrat topikë me -as, si *Fikas, Gropas, Misras, Thanas, Vidhas, pas gjasë janë emra kolektivë*, d.m.th., që baza fillestare e formimeve të toponimeve del gjithsesi tek emërtimet e njërëzve dhe lidhet me veprimtarinë a botën e tij të markuar me formantin -AS e jo nga toponimet, prandaj edhe ky fakt i jep të drejtë konstatimit tonë.

Së treti, prania e emrave toponimikë në Shqipëri me -AS fundore nuk duhet të na habitë, sepse edhe atje mund të jenë bërë teprime ose zgjidhje analoge, pa kriter, pa i njohur mirë ligjet e brendshme të strukturës emërformuese globale të gjuhës shqipe që kishin të bënin me strukturën e modeleve fjalëformuese në kuadër të sistemit emëror të shqipes standarde sipas nënfushave përkatëse semantike.

Së katërti, ky formant shumë i përdorur për emërtimin e etnonimeve, për emërtime vendbanimesh nuk kishte shtrirje dhe as që ishte prodhimtar në të gjitha trevat shqipfolëse. Si argument po sjellim faktin që prof. Sulejman Drini nuk e shënon fare këtë formant si prapashtesë të mundshme toponimformuese, që do të thotë se në kohëhapësirën tonë deri atëherë (në vitet e '70-a të shekullit të kaluar), kur u shqyrtua çështja e onomastikës së Kosovës, **nuk ishte përftuar, te ne e më gjerë, asnjë emër toponimik me këtë formant-prapashtesë.**

Së pesti, bazuar në gjendjen e sotme të strukturës emërformuese të modeleve në fuqi me formimet e tilla arbitrare ne i nxjerrim problem vetes pa kurrfarë nevojë, pasi pajisjen e impiantit makinerik për prodhimin serik të mjetit të gatshëm gjuhësor e fusin pa nevojë në destinime të tjera dhe kështu e çorientojmë modelin e prodhimit serik të gjuhës sonë të krijuar aksiomatikisht për mrekulli gjatë një procesi jo të pakët kohor.

Së gjashti është e vërtetë që sipas rregullit dalja e vendbanimeve me formantin -AS do të arsyetohej me ekzistimin paraprak të etnonimit përkatës (apelativit), nga i cili sikurse veprohej me emrat e patronimeve me -AJ do të emërtohej edhe qendra përkatëse e vendbanimit, zhvillim ky që mungon te shumica e rasteve të propozuara të vendbanimeve me -AS në të gjitha burimet përkatëse që konsultuam, qoftë nga hartuesit e burimeve të tjera, qoftë nga Komisioni i Prishtinës.

Së shtati, pas vërejtje-konstatimeve të mësipërme, shtrohet pyetja si të veprohet, pra, b.f. në emërtimin e banorit të **vendbanimit**, i cili, pra arbitrarisht do të jetë emërtuar me prapashtesën -AS?! Konkretisht, si të formohet emërtimi i banorit të vendbanimit të pagëzuar bie fjala tek emrat: dren DrenAS, mal MalAS ose dardhë DardhAS?!

Natyrisht, sipas rregullit emërtimi i banorit për emrin oikonimik *Dren del drenas*, për *Mal malas*, ndërsa për *Dardhë del dardhas*, pra zgjidhje e rregullt që mundëson vetë modeli i prodhimi serik, por tani tek emrat e tillë të formuar pra jashtë kriterit normal: **Drenas, Malas, Dardhas** atëherë shtrohet pyetja si domosdo si të emërtohet banori? Sigurisht edhe në këto raste edhe pse jo normale do të gjindej një zgjidhje! Por tashti jo si zgjidhje e rregullt me mundësi të prodhimit serik, ngase me këtë dublifikim homonimik prapashtese, siç e thamë, krijohen pa nevojë vështirësi të ligjshme kuptimore brenda strukturës ligjërimore, sepse koncepti i ofrueshëm i banorit me -AS, këtu ngulfatet nga një koncept tjetër oikonimik, apo jo!?

Me fjalë të tjera me një veprim të tillë jashtë modeli të ravijëzuar, po përsërisim, i krijojmë vetes vështirësi pa nevojë. Por, megjithatë duhet gjetur zgjidhje për formimin e banorit a të prejardhjes nga këto vendbanime.

Më poshtë po i përmendim disa nga prapashtesat e mundshme të etnonimit (banorit) që na ofrohen si zgjidhje jashtë modelit të ravijëzuar për *Drenas, Malas e Dardhas*:

a) me disa prapashtesat të tjera, si:

1. drenasjan, drenasak, drenarak, drenasar...(**drenas!**)

ose

2. malasjan, malasak, malasar, malasrak...(**malas!**)

ose

3. dardhasjan, dardhasak, dardhasar, dadharak... (**dardhas!**).

b) Mbase edhe me prapashtesën dyjare homonike -AS *drenas* a *malas* a *dardhas* (pra, homonim arbitrar me emrin e vendbanimit);

c) ose duke e hequr fare prapashtesën -AS: nga tema motivuese, si *drenjan* a *maljan* a *dardhjan* (!), siç veprohet zakonisht jo me emërtim oikonimesh, po me e emërtimet e thjeshta njërrrokëshe të rekomandueshme banori, *tipi lumjan*, *matjan*, *plavjan* etj., por jo aq me ato shumërrrokëshe etj.

Sidoqoftë, çështja e emërtimit të banorit del problemore jo e ofruar si model

Në të vërtetë, po të emërtohej vendbanimi përkatës i vendbanimit me çfarëdo trajte a mënyre tjetër të pranueshme të rekomandueshme pa -AS fundore (që këtu momentalisht po i shënojmë në 8 versione, si p.sh:

1) Dren a Mal a Dardhë, përkatësisht:

2) Drenesh Malesh, Dradhesh,;

3) Drenian/ë Malianë Dardhianë,;

4) Drenajë, Malajë, Dardhajë,

5) Drenishë a Drenisht, Malishtë a Malisht, Dardhishtë a Dardhisht,;

6) Drenushë a Drenush, Malush a Malushë, Dardhush Dardhushë,

7) Drenet, Malet, Dardhet;

8) Drenion/ë, Malionë, Dardionë ...etj.,

atëherë emri i banorit vetvetiu do të formohej me -AS ose me -JAN, si p.sh.

Dren- drenjan a drenas, Mal- malas, Dardhë- dardhas  
përkatësisht,

Drenushë-drenushas, Malushë-malushas, Dardhushë- dardhushas ...,  
e kështu me radhë.

Dhe me të vërtetë zgjidhja në raportin *oikonim / emërtim banori*, do të ishte gjithsesi fort e natyrshme dhe tepër e lehtë, ngase këtë model e ka të formuar gjuha jonë aksiomativisht, andaj është mëkat që ne, këtë rregull, për mungesë koncepti, mos ta respektojmë, në shqipen e sotme standarde, apo jo!?

Sidoqë të jetë, para se të propozohet ose të miratohet ndonjë emërtim i ri i vendbanimit me -AS fundor patjetër duhet pasur parasysh edhe rrjedhojat dëmtuese që dalin në kuadër të strukturën fjalëformuese të shqipes.

Nuk do të ishte punë e urtë që pa nevojë t'u bihet ndesh modeleve a prirjeve tashmë të përvijëzuara fjalëformuese, siç ndodh b.f. me oikonimet me **-aj** e **-as** fundore. Dhe pikërisht rreth kësaj dukurie tash fill do të vazhdojmë të bëjmë fjalë më hollësisht, përkatësisht e kemi fjalën kur

emërtimi i etnonim/patronimit ndërlidhur me emërtimin e vendbanimi të caktuar.

### **Raporti: etnonim-patronim/ vendbanim me prapashtesat -AJ dhe -AS:**

Që në fillim e shohim të arsyeshme të përsërisim faktin se të gjithë studiuesit e pohojnë se prapashtesa **-AS** në shqipe del si formant i specializuar për formimin e emrave në fushën e etnonimisë, ndërsa prapashtesa **-AJ** del e specializuar për formimin e emrave në fushën e patronimisë, megjithatë, të shfaqurit e emrave oikonimikë në Shqipëri me këto formante nuk duhet të na habisë aspak, ngase studimet komplekse krahasuese nga kjo fushë e emërformimit, kanë munguar deri tashti. Mungonin ose janë bërë publike relativisht vonë, prandaj (me përjashtim të disa profesionistëve) mund të ndeshen kuadro në masë, të cilët ende nuk i njohin ose nuk i kanë përvetësuar e kuptuar si duhet rregullat e tilla formëzuese e fjalëformues, të cilat lypset zbatuar e respektuar rigorozisht.

Që formantet **-as** dhe **-aj** dalin të paqëndrueshme, si fjalë-temë motivuese në kuadër të një emri në cilësinë e vendbanimit, po japim disa shembuj që i volëm nga **Shtojca** speciale e *Fjalorit të shqipes së sotme* (1984) lidhur me formimin e emrave etnonimikë, d.m.th. kur emri përkatës i njeriut sipas banimit a prejardhjes del mjaft i ndërlidhur, si:

a) Si emërtime të vendbanimeve me **-AJ** janë shënuar nja 19 shembujt përfaqësues dhe pothuajse në shumicën e rasteve formanti **-AJ** del i zhdukshëm (i pamotivueshëm) me rastin e formimit të banorit me prapashtesën përkatëse etnonimformuese. Krahaso: *Bicaj bicjan*, *Gegaj gegas*, *Lekbibaj lekbibas*, *Marisaj marcjot*, *Sinanaj sinanjot*, *Varfaj varfar/jot*, *Gjinaj gjinas* etj. Vetëm të rasti *Ferizaj ferizajas*, ruhet formanti **-aj** si pjesë përbërëse emrit oikonimik temë-fjalëformues.

Edhe nga kjo pikëpamje shihet se oikonimet me **-AJ**, nuk kanë një formë të lehtë orietuese lidhur me emërtimin e banorit sikurse del rregullit b.f. duke respektuar emrin e vendbanimit si fjalëkuptimplote temëprodhuese, sikurse janë shembujt e rregullt: *Bletajë bletajas*, *Prishtinë prishtinas*, *Shkup shkupjan*; *Drenisht drenishtas*, *Malion malionas*, *Dardharë dardharas* etj.

b) Edhe lidhur me emrat oikonimikë përfaqësues më **-AS** del e njëjta dukuri. Ja disa shembuj: **Dukas dukarak**, **Fikas fikasin**, **Lekas lakasak**, **Luaras luarasas**, **Mamuras mamursak**, **Përrenjas përrenjak**, **Valias**

valiz/**ak** etj. Pra, prej 17 shembujve përfaqësues vetëm tre dalin identikë (homonimë) me emrin e vendbanimit, ndërsa të tjerët ndyshojnë, duke marrë formante të ndryshme, pa kriter, madje shumica dalin si raste të vetmuara, të diskutueshme. Vetëm te fshati *Luaras* formanti etnonimformues dublifkohet *luarasas*.

Të vihet re që tek të gjithë shembujt e tjerë prapashtesa -AS zhduket dhe formanti që emërton banorin i vihet rrënjës që nuk e motivon oikonimin e caktuar, ngase nuk shënohet forma e plotë e emrit përkatës, koncept që mbart emri i vendbanimit, i cili sipas rregullit duhej të motivonte emërtimin e banorit, apo jo?!

Edhe nga kjo pikëpamje shihet se emërtimi i banorit nuk ka rregullsi zgjidhjeje si b.f. te rastet që mund të jenë të rregullta, kur emri i fshatit shërben si temë fjalëfomuese, sipas skemës trerubrikashe.

#### Skema trirubrikashe

Emri i fshatit	emërtim banori	emërtim patronimi
1	2	3
<b>Bicë-a,</b> <b>Gjin/I,</b> Dardhë-a	<b>bicas</b> ose <b>bicjan</b> <b>gjinas,</b> <b>dardhas</b>	<b>Bicaj,</b> <b>Gjinaj</b> <b>Dardhaj</b> etj.

Edhe studiuesi Jusuf Shpuza në librin e tij *Vëzhgime për emrat familjarë të shqiptarëve*, Shkodër 1998, na ndihmon për ta kuptuar çështjen më mirë. Ai pasi konstaton se etnonimet shërbejnë *si shtrat për lindjen e patronimeve*, por edhe *toponimet shërbejnë si gurrë e pasur për patronime*, shpjegon se *si rregull etnonimet vijnë gjithmonë nga emrat topikë*, me përjashtim të emrave të ujrave, secili nga llojet e emrave të vendeve mund të shërbejë për krijimin e etnonimit dhe kjo realizohet me prapashtesat etnonimformuese **-AS**, **-AR** e **-AK**, ndërsa, siç thekson ai, prapashtesat **-AS**, **-AR** e **-AN** as që *duhen konsideruar si prapashtesa patronimike*, prandaj, do të shtonim ne: **nuk duhet të jenë të pëlqyeshme as si bazë mbështetëse edhe për emërtimet e vendbanimeve mbi bazë patronimie**. Me fjalë të tjera vetëm banorët e fshatit përkatës pa prapashtesën **-AS** ose **-AJ** në rast shpërnguljeje mund të kenë formuar emrin e fshatit me **-AS** ose me **-AJ** dhe kjo ka ndodhur në raste të rralla, prandaj ne shprehim rezervë, për formimet homonime me analogji dhe pa kontroll fare.

E shënuam kontaktimin e mësipërm për të tërhequr vëmendjen se të gjitha këto prapashtesa, sidomos **-AS**, **-AR**, **-AN** si dhe **-AJ** mund të paraqiten si raste për formimin e vendbanimeve, por nuk i takojnë parësorisht kësaj nënfushe semantike. Sa për ta kuptuar një fakt të tillë besoj se mjaftojnë konstatimet që u paraqitën më sipër.

Sidoqoftë, mendojmë se edhe formimet me **-AS**, si edhe ato me **-AJ**, sidomos në raste të reja, siç janë edhe propozimet e tri-katër burimeve të konsultuara, lypsen rishikuar. Aq më parë aq më mirë. Ndërkaq për emërtimet e rrënjësura që s'mund t'i ndryshojmë, *i bartshim me shëndet për mot e jetë*, por këtu është çështja të vihet rregull sa është e mundur në ato segmente të strukturës fjalëformuese, të cilat vetë jeta i ka rrafshuar dhe dalin si modele fort të qëlluara, andaj edhe studiuesit e sidomos standardologët ose gramatikanët tanë duhet ta kënë tashmë të njohur dhe ta respektojnë e rekomandojnë këtë strukturë fjalëformuese, e cila atavikisht del e formëzuar, apo jo?!

### **b) Emërtimet me –AN (-J/AN ose -I/AN)**

Me prapashtesën AN gjithashtu janë formuar e formohen në shqipe emërtime të njerëzve sipas vendbanimit a prejardhjes.

Krahaso:

*Shkodër shkodran, Dibër dibran, Pejë pejan, Tropojë tropojan Itali italian etj.,*

përkatësisht me **–JAN** (njërokëshat):

*Kukës kuksjan Shkup shkupjan, Lumë lumjan, Ashtë ashtjan, Prespë prespjan, Zhur zhurjan, Shalë shaljan, Zog zogian, etj.*

por me këtë formant formohen edhe emërtime të njerëzve sipas profesionit, madje për raste të caktuara, siç janë emërtimet nga ndërkombëtarizmat (shumërokësh) me **-IK(ë)** fundore, tipi *matematikan, fonetikan, onomastikan* etj., ku ky formant pothuajse, del me cilësinë e prapashtesës së specifikuar.

Mirëpo, çështë e vërteta, ky formant ka shtrirje mjaft të gjerë edhe në fushën e formimit të emrave toponimikë, pikërisht për nënfushën e oikonimeve. Sipas Listës së vitit 1938 dalin afro 40 shembuj me **–AN** fundore, ndërkaq sipas *Regjistrit* të Komisionit të Prishtinës (2005), te ne, dalin në funksion afro 70 raste. Prej tyre afro tridhjetë janë ndryshuar në versionin e propozuar nga Komisioni. Ç'është e vërteta, ndonëse ky formant (**-AN**) është identik me atë të serbishtes, edhe pse në atë gjuhë i shtohet



zakonisht një –e fundore, që përdoret për të njëjtin destinim, krahaso: *Deçan/Deçane, Zveçan/Zveçane, Reçan/ Reçane, Leshan- Lešane* etj., në Regjistër ndeshim të propozuar disa emra të rinj të emërtimeve të vendbanimeve po me këtë formant si:

*Babushan, Lisan, Bardhoshan, Bardhan, Plakan, Ilirian, Urban, Gugullan*

që nuk duken të pambështetur. Në Shqipëri ndeshim afro 90 emërtime vendbanimesh me -AN fundore. Si duket, formimet e tilla i takojnë traditës së hershme të formimit të oikonimeve me këtë formant në gjuhën tonë. Janë disa raste që identifikohet emri i antroponimit që del i formëzuar si oikonim si p.sh. *Bogdan, Marjan*, por te disa shembuj të tjerë prapashtesa **-an** ose **-tan** del qartë si element fjalëformues, si:

*Vreshtan, Bishan, Qyrkan, Tregtan, Hajdaran, Gjinan, Reçan, Reshtan* etj.

Prof. Rexhep Doçi i pranon ose i propozon disa emërtime të reja me këtë formant fundor si:

*Mikan, Peran, Orlan, Rajan, Melçan, Baran, Gllogjan , madje edhe Plakan e Zototan*

Është e vërtetë se disa emërtime me –AN (-jan) për veshin e dikujt tingëllojnë sllavisht si:

*Pojan, Poroçan, Odriçan, Lozhan, Grabjan* etj.

Edhe pse shpjegimi etimologjik i këtij formanti ndërlidhet interferencisht me formantin latin -ANUS dhese në gjuhën sllave (serbe) trajtat e tilla sllavizohen zakonisht me shtimin e një –E fundore, përsëri mund të thuhet që ky fakt dëshmon për ndërndikimin ose *simbiozën* e shqipes që në lashtëni me gjuhën sllave në formimet e tilla.

Gjithsesi mendoj se kjo trajtë e formantit duhet dalluar nga trajta tjetër **-JAN** (zhurjan, grabjan), ngase trajta e dytë –JAN, edhe pse ndeshim ndonjë oikonim si: *Pllanjan, Borovjan, Dhuvjan, Drovjan, Derjan*, fundorja e tillë del zakonisht si një formant i specifikuar për emërtim banorësh, si dhe ato me -I/AN (ku **i**-ja nistore del kryesisht si formë e ndikimit të huaj ose si ndryshim i j-së shqipe për mos ngatërresë lexim-shqiptimi në shqipe të NJ-së) që do të jenë objekt analize veçan në vijim, sepse formantet -JAN e -ANË si afikse autoktone nuk dalin të ndërlikuara me formante të huaja, sikurse –AN dhe -IAN.

### c) Emërtimet me –AK

Edhe prapashtesa -AK është etnonimformuese. Në Listën e vitit 1938 ceken 5 emërtime, tri prej tyre kërkohen të zëvendësohen: *Karakullaku, Zemblaku, Kularaku*, ndërsa kërkohet aktivizimi i dy shembujve zë rinj që konsiderohen si emërtime të pështatshme: **Muzaraku** dhe **Zeza**. Ndërkaq sipas Regjistrimit të Komisionit të Prishtinës dalin në funksion afro 20 shembuj vendbanimesh me –AK fundore. Prej tyre, sipas versionit të propozuar, 11 shembuj mbesin të pandryshuar të tjerët pësojnë ndryshime. Kështu përveç shembujve nga tradita:

*Bablak, Bunjak, Çitak, Vitak, Raçak, Leshak, Halabak*

bien në sy edhe tre shembuj të formuar mbi fjalë-tema shqipe që tingëllojnë freskët, si: *Gurak, Mirak e Rrafshak*.

Edhe te shembujt e tillë si duket ka ndikim reciprok i emërimit të etnonimit dhe ai i toponimit të ri që dalin si homonime për nga shkrimi e shqiptimi, por në kontekst ata dallohen qartë edhe nga shkronja e madhe, karakteristike e emrit të përveçëm.

Në Shqipëri del një numër jo i madh i emrave të vendbanimeve me -AK fundor, si b. f.:

*Bidanak e Zhablak (Durrës), Persnak (Berat), Dushkarak (Vlorë)  
Kamarak (Permet), Çifllak (Konispol, Çipllakë (Fier), e ndonjë tjetër,*

por që nuk paraqesin model të qëndrueshëm. Sidoqoftë, rastet e reja të ne si dhe ato në funksion në Shqipëri tregojnë se formimet me këtë formant janë gjithsesi të pranishme dhe si raste janë të pranueshme. Dr. Rexhep Doçi, propozon trajtën *Hodak* për *Hodec*, duke e cilësuar formantin -ak si *prapashtesë ilire-shqipe*.

Mirtëpo pasi dihet fakti se ky formant del në interefrencë me atë të burimirt sllav, sipas lëndës që trajtuam kjo prapashtesë hyn në kuadër të prapashtesave të përvetësuar jo aq e rekomandueshme në gjuhën tonë, qoftë për formimin e patronimeve, qoftë të oikonimeve.

Sidoqoftë, duhet pasur parasysh faktin se prapashtesa **-ak** sikurse **-as** e **-an**, ndonëse dalin të specifikuar më tepër për nënfusha të tjera semantike, në raste si të veçanta dalin të përdorura si të paqortueshme edhe në nënfushën e emërtimeve të vendbanimeve.

## Ç. EMËRTIMET ME PRAPASHTESAT E SPECIFIKUARA PËR EMRAT E NJERËZVE SIPAS PROFESIONIT

Si prapashtesa të specifikuara për nënfushën e emrave sipas mjeshtërisë a profesionit do të trajtohen formimet me formantet -ËS, -TAR e -AR si shumë prodhimtare dhe -OR joprodhimtare në atë fushë. Të shohim tashti sa është manipuluar me prapashtesat e tilla në emërtimin e vendbanimeve përgjithësisht dhe në veçanti sipas *Regjistrit të Prishtinës* (2005).

### a) Emërtimet me -Ë/S

Prapashtesa -ËS del e specializuar për emërtimin e emrave të njerëzve sipas profesionit, sidomos mbi bazë foljore, por edhe mbi bazë emërore (ndonëse më pak), prandaj edhe në emërtimin e vendbanimeve del e kursyer. Në Regjistrin e vitit 1938, pa përfshirë qytetet ndeshim vetëm këta dy shembuj: **Kudhësi dhe Shalësi**, madje edhe në Regjistrin e Komisionit (2005), ndeshim pak oikonime me -ËS. Në të vërtetë, ndeshim dy raste *Shalës* e *Shterpës*. Edhe në Shqipërinë e sotme emrat më -ËS janë të pakët për nga numri, por zgjojnë interes disa emra qytetesh e fshatrash të njohur si:

*Kukës, Durrës, Gjerbës, Babës, Shalës (Kolonjë, Elbasan, Durrës),  
Kudhës (Himarë),*

e ndonjë tjetër, por që tashti nuk paraqesin model. Po e veçoj emërtimin *Shalës* si rast, që te ne njihet një fshat me emër fisi **Shalë** (serb. Sedlare), ndërkaq emri i banorit del *shaljan*, sepse *shalës* asociacionon mjeshtërinë e shalpunuesve (shaltarëve).

Kështu, pra me trajtën **shalës**, nëse kemi për bazë specifikimin e prapashtesës -ËS, më tepër kuptojmë veprimtarët e dalluar nga emërtimi i fshatit apo fisit, ngase emërtimi i banorit më natyrshëm, bëhet në trajtën *shaljan* për këtë tip temëprodhues, siç u cek më sipër, apo jo?

Është e vërtetë se ky formant –ËS del mjaft aktiv edhe në formimin e mjeteve të punës, mirëpo emërtimet e njerëzve sipas profesionit, përkatësisht të veprimtarisë së tyre mbizotërojnë, andaj përzgjedhja e formantit –ËS, për vendbanime nuk është e këshillueshme, sidomos në rastet kur formon homonimi të vrazhdë.

## **b) Emërtimet me -TAR e -AR**

Në monografinë rreth emërtimit të njerëzve sipas profesionit funksioni i këtyre dy prapashtesa –TAR e –AR (veç e veç) është trajtuar mjaft në hollësi, andaj edhe këtu po i përmendim veçmas, por vështuar nga pikëpamja e oikonimformimit.

### **1) Emërtimet me -TAR**

Që në fillim po cek se prapashtesa -TAR, e cila për nga prejardhja është e krahasueshme me formantin *-tara* të hititishtes dhe *-dar* të persishtes, por që mund të jetë edhe një -T+Ar e burimit vendës) del e specifikuar për emërtimet e njerëzve sipas profesionit, por për dallim nga prapashtesa –ËS, jo aq mbi temë foljore *mihtar, ngrohtar, rendtar*, por mbi temë emërore, si: *qymyrtar, samartar, këpuctar, lavërtar, tregtar* etj. Gjithsesi nuk del e përdorshme për emërtimin e vendbanimeve. E ndeshim vetëm te rasti *Leshtar*, sipas Regjistrimit (2005). Kështu ndeshet edhe në serbishte si *Leštari*. Edhe në Shqipërinë e sotme nuk bien në sy emërtime të vendbanimeve me këtë formant.

### **2) Emërtimet me –AR**

Për emërtimin e vendbanimeve prapashtesa -AR del më e angazhuar se ajo -TAR, por edhe kjo jo në numër aq të madh. Edhe prapashtesa -AR del e specifikuar për fusha të tjera semantike, siç është nënfusha e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit të disa zejeve të trashëguara, madje për ndonjë nënfushë tjetër del pa konkurrencë, siç është tipi: *kështjellar, vendar: dhenar, lopar* etj., por në raste të tjera kur del në konkurrencë ose në përdorim paralel ajo qëndron nën hije në krahasim me prapashtesën –TAR, si emërtim profesioni, ku kjo e fundit -tar del më e parapëlqyer, si: *djathtar, këmishtar, gjiztar, gjahtar, artar, ortar* etj.

Prapashtesa –AR del e angazhuar edhe për emërtimin gjësendeve konkrete a të mjeteve të punës dhe sidomos për etnonime si *gjakovar*, *pogradecar* etj. Megjithatë, në Regjistrin në shqyrtim (2005) ndeshim nja 8 emërtime të propozuara oikonimike me këtë prapashtesë, si p.sh.:

*Lumar, Rrezar, Bletar, Drenar, Luftar, pastaj Capar, Delmar, Vneshtar, Druar.*

Për mendimin tonë për të gjitha këto (hiq emërtimet e ngulitura), kur kemi parasysh specifikimin e këtij formanti në fusha të tjera semantike, më mirë do të ishte të propozohet ndonjë afiks tjetër ose ndonjë mënyrë tjetër e fjalëformimit për rastet e sipërpërmendura.

Në Listen e vitit 1938, me –AR fundore, ndeshim vetëm këta shembuj: *Zezar', Pendar-i, Mesar-i...*

Edhe në Shqipërinë e sotme ndeshim emërtime fshatrash me këtë formant fundor që arrin numri afro 30 sosh, por edhe ky fakt nuk duhet të jetë motivues për formimin e emërtimeve të reja me formantin -ar. E ndeshim shumë të përdorur për etnonime edhe në gjuhën serbe, por edhe në për ndonjë oikonim edhe në atë gjuhë.

Po shtojmë edhe këtë se edhe çifti i formantit -AR në femërore - **ARE** nuk del prodhimtar për nënfushën semantike në shqyrtim. Në Regjistrin e Prishtinës ndeshëm vetëm rastin *Brezare* e asnjë tjetër, mirëpo formanti **-are** del në konstaminim me formën **-arë**. Jemi dëshmitarë se në shumicën e rasteve ngatërrohet shqiptimi i vendbanimit me prapashtesën përkatëse fundore: **-ar**, **-arë** e **-are** (p.sh. Llukar Llukare dhe Llukarë ose Shpatar Shpatare Shpatarë. Te trajtat e fundit *Llukarë Shpatarë-ARË* del si një formant i veçantë që ngjason me gjymtyrët të kompozitës të tipit Fush+arë, d.m.th. si ara në Fushë: **Fusharë** ose ara e Llukës mund të zërthehet **Llukarë**, ashtu si **Shpatarë**, ara te Shpati (në Shpat) etj. Edhe shembulli *Shisharka* e serbishtes që në shqipe del **Shisharë**, me **-ARË** fundore flet për këtë prirje. Kjo çështje këtu vetëm sa po ceket jo pa arsye, sepse sipas Regjistrit dalin të shënuara disa raste me -AR fundore, por që asociojnë zberthimin me siprapshtesën -ARË, po kjo dukuri do të diskutohet më gjerësisht në fund të këtij nëntitulli, kur bëhet fjalë për prapashtesat e grupit të fundit, me prirje specifiki.

Sido që të jetë, kur kemi parasysh ngarkesën e madhe të prapashtesave -TAR e -AR në nënfusha të tjera semantike, na merr mendja se nuk ka nevojë të propozohen emërtime të reja vendbanimesh me këto formante, prandaj edhe propozimet e R. Doçit:

**Shpatar, Bolar, Dumar, Gërçar,**

jo se nuk janë të qëlluara, por për hir të specifikimit të strukturës përkatëse fjalëformuese lypset rishikuar, ngase për emërtime të tilla dalin më të specifikuar ose më të përshtatshme disa prapashtesa të tjera.

### c) Emërtimet me -OR

Formimet me prapashtesën -OR (që për një kategori emrash e mbiemrash konsiderohet me të drejtë e burimit vendës) më fort u takojnë nënfushave të tjera semantike dhe nuk janë prodhimtare në fushën e toponimisë. Kështu themi se prapashtesa -OR del shumë aktive dhe prodhimtare në formimin e mbiemrave, por edhe të sendeve konkrete a të mjeteve të punës, prandaj prania e tyre në nënfushën e emërtimeve të vendbanimit duhet konsideruar si rastësi.

Nga kjo që u tha del se shembujt e propozuar sipas Regjistrit, sado atraktivë që duken, nuk ia vlen të favorizohen. Si mbështetje për këtë që thamë është fakti se është e vërtetë se trajtat e propozuara:

*Rrezor, Pleqnor, Lisor, Trimor*

nuk i ndeshim në FGJSSH, madje as si emra të përgjithshëm. Fjalën *rrezor* e ndeshim vetëm si mbiemër. Ndërkaq nga tema *pleq-* del emri i veprimtarit: **pleqnar**, jo *pleqnor*, nga tema *lis-* nuk ndeshim as mbiemër me -or *lisor*, po ashtu nuk ndeshim as *trimor*, por *trimshor* dhe *trimosh*, prandaj del i drejtë konstatimi se edhe për tipin e emërtimeve në shqyrtim ky formant nuk duhet konsideruar si prodhimtar. Po e theksojmë edhe këtë fakt, me interes për kulturë të përgjithshme, se ky formant (-OR) nuk del prodhimtar as për formimin e njerëzve sipas profesionit. Sidoqoftë, është e vërtetë se te ne ndeshim disa emërtime të vjetra oikonimesh si *Nishor, Mramor* që tashmë kanë mbetur si raste të vetmuara ashtu si edhe rastet në Shqipëri: *Damnor, Lefteror Thartor e Neshor*. Pra as në Shqipëri nuk ndeshim shumë shembuj me këtë formant fundor, pos dy rasteve të sapocekura, prandaj këto fakte komisionet përkatëse, tashpërtash dhe tashembas duhet t'i kenë parasysh.

Gjithsesi është me interes të ceket edhe fakti tjetër lidhur me këtë. Është fjala se edhe toponimet e vjetra të identifikuar me -OR fundor si *Pyllor* e *Mashkullor* që i cek R. Mulaku, sot ashtu nuk i ndeshim dot. *Pyllor* nuk figuron fare, ndërsa *Mashkullor* del në trajtën **Mashkullorë**, pra me -ORË fundore e jo me -OR. Madje mund të konstatojmë që në Listën e vitit 1938, pothuaj nuk propozohet asnjë shembull i përshtatshëm me -OR.

Me fjalë të tjera, kur dihet angazhimi shumë i madh i formantit -OR në nënfusha të tjera semantike mendojmë se formimet për tipin e emrave të oikonimeve me këtë prapashtesë duhet kursyer ose e thenë me fjalë të tjera assesi nuk duhet me i favorizue.

## D. FORMIMET MBI BAZË NGA VEPRIMTARITË E TJERA SEMANTIKE ME PRAPASHTESAT PËRKATËSE TË PËRVETËSUARA

Këtu, si veprimtari të tjera, do të përfshihen tri nënfusha semantike:

1. nënfusha e emërtimeve të sendeve a të mjeteve të punës,
2. nënfusha e nocioneve abstrakte dhe
3. nënfusha e nocioneve emocionuese (përkëdhëlëse a zvogëluese).

### 1) Emërtimet nën ndikimin e sendeve apo të mjeteve të punës

Në formimin e sendeve konkrete prapashtesat përkatëse më prodhimtare janë: **-se, -ore, -are, -zë**, përkatësisht **-ës, -or -ue/s /-ës/or, -ue/se, -aç** (Shih N. Veselaj, *Çështje të shqipes standarde I Prishtinë* 1997, f.67-68), të cilat kanë karakter polisemantik, sepse dalin të angazhuara edhe në nënfusha të tjera semantike, prandaj është vështirë të dallohet hisja që mund të ketë emri i mjetit konkret me prapashtesimin përkatës në formëzimin e oikonimit të caktuar. Në nëntitullin e mëparshëm pamë se edhe mbi fjalë-tema të mjeteve konkrete (emrave pa ndajshesë) kishin mbështetje disa formëzime vendbanimesh, si: *Kosh, Strall, Trinë, Thupër* etj., që në një farë mënyre lidheshin me vendin e caktuar. Madje edhe po të formohej ndonjë fjalë e prejardhur mbi këtë bazë, ato vetvetiu më lehtësisht do të kuptohen si formime që u takojnë fushave të tjera semantike, siç është nënfusha e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit ose semantika e nënfushës së emrave emocionalë etj.

Krahaso: *Kosh koshore, Trinë trinëz, Strall strallc, Kudhë kudhëz, kudhës, Pallë pallush, pallosh* etj.

Po e cek kalimthi një sugjerim jo të qortueshëm që vjen sipas etimologjisë popullore lidhur me oikonimin Palluzhë. Nuk është largmendsh interpretimi që fshati Palluzhë (serb, Poluže pol+uže) sipas shqiptimit shqip të ketë për mbështetje pikërisht fjalë-mjetin *pallë-a* (shpatë) që pastaj i është shtuar prapashtesa -ushë, përkatësisht -UZHË (me SH-në e sforcuar në ZH), dhe



kështu ka pasur semantikë mbase më kuptimplote seç mund të kuptohen sot emrat *pallush pallosh*, që do të thotë një njeri “*babaxhan*” që *loz(te) mirë me shpata!* Pra, si po shihet edhe këtu shpjegimi me asociacion doli në nënfushën e emërimit të njerëzve sipas veprimtarisë së tyre. Rreth sugjerimit në fjalë shih edhe mendimin e shprehur nga Mr. Hasan Dulaj, në gazetën Rilindja, më 28 prill 2000, f. 19.

Sidoqoftë, mund të konstatohet se nga emrat mjeteve pa ndajshtesë me simbolikë të veçantë mund të formëzohet emërtimi i vendbanimit, ndërsa nga emrat me ndajshtesa jo aq, ngase formimet e tillë orientojnë drejt nënfushave të tjera semantike, varësisht nga specifikimi kuptimor që ka prapashtesa në strukturën përkatëse ligjërimore.

## **2) Emërtimet nën ndikimin e emrave nga fusha e nocioneve abstrakte**

Edhe nga emrat abstraktë me prapashtesat përkatëse të specifikuara për këtë destinim, siç janë prapashtesat -I, -SI, -SHMËRI nuk formëzohen zakonisht emërtime vendbanimesh. Madje as që mund të bëhet fjalë për ndonjë model të kapshëm që lidhet drejtpërdrejt me këto dy nënfusha semantike në këtë mënyrë drejtpëdrejt. Mirëpo ka raste të ndikimit të tërthortë, siç janë edhe format ndërmjetëse të emrave të njerëzve sipas veprimtarisë së tyre e të tjerë, siç e pamë te rastet e propozuara *Pleqnor*, *Trimor* etj., që lidhen me emrat abstraktë *pleqni*, *trimëri*. Ndonëse emrat e tillë mund të paraqesin simbolikë mjaft të fortë, megjithatë ajo simbolikë oikonimike mund të shprehet zakonisht me mënyra a prapashtesa të tjera më të specifikuara.

Gjithsesi në transferimin e semantikës e ka hisen e vet edhe emri bazë i kuptimit. Dihet se emrat abstraktë, pos me prapashtesat: -I, -SI, -SHMËRI, -RI, formohen edhe në mënyra të tjera, siç janë emrat prejfoljorë me -IM, -ESË, -OJË e ndonjë tjetër.

### **a) Emërtimet me -I**

Sipas lëndës së shtruar në *Regjistër* dhe përgjithësisht del e nevojshme të sqarohet formimi i emrave toponimikë me prapashtesën -I ashtu si dhe i llojeve të ndryshme të emrave të ashtuquajtur “të modës”.

Është e vërtetë se me prapashtesën -i (e cila konsiderohet me origjinë indoeuropiane (-ijë), si në Shqipëri, si te ne, ndeshim disa raste të emërtimeve të vendbanimeve, ndonëse këtu tashti në kontekst dalin si emra konkretë gjeografikë dhe pak kanë lidhje me konceptin abstrakt. Ne trajtuam formantin **-i** në këtë grup, vetëm për arsye se kështu del i regjistruar në burimet tona normative.

Në Regjistër ndeshim ndonjë oikonim me -I fundore, por kjo zakonisht ka ardhur nga asimilimi ose ndërndikimi i fundoreve barasvlerëse -inje e -ina të serbishtes, siç janë rastet:

*Vllahi (Vlahinje), Viti (Vitinje), Sopi (Sopina)*, por ndeshim edhe emra të rinj, si *Labi* (për Llapçevë) *Livadhi* (Petrovosellë) etj., por edhe ndonjë tjetër me -I fundore si huazim nga turqishtja, si p.sh.: *Sazli, Azizi*. Edhe në Shqipëri ndeshin disa emra me -I fundore si:

*Dhermi, Peshkëpi, Vërri, Peshkopi, Komësi, Dangëlli, Kutali, Solari*. Sidoqoftë, prapashtesa -I, ndonëse nuk paraqet ndonjë model të veçantë, ku do të nënkuptohej edhe motivimi semantik i nënfushës që mbulohet, ajo del si formant identifikues prapashtesor për emërtimin e disa vendbanimeve.

## **b) Emërtimet me emra të ndryshëm abstraktë dhe nga emra vetjakë (të modës)**

Këtu si më karakteristike shënuam disa shembuj me prapashtesat: **im**, me fundore të tjera dhe me **-ojë**.

### **1. Shembuj me -IM**

Si emra të modes kanë hyrë në kuadër të emrave të vendbanimeve mjaft emra prejfoljorë me prapashtesat përkatëse, ndër ta dallohet emrat me prapashtesën ose fundoren -IM.

Në Listën e vitit 1938 ndeshim këto emërtime fshatrash. *Shpëtim, Dëfrim, Burimi* ndërsa në burimet e mëvonshme edhe: *Agim, Afrim, Betim, Blerim, Çlirim, Burbullim, Përparim, Trim, Besim, Kushtrim, Kujtim, Lulëzim, Kujtim, Ndriçim* etj.

### **2. Shembuj me fundore të tjera**

Në Listën e vitit 1938 ndeshim shembuj të kësaj natyre: *Fitore, Kunorë, Liria Arta, Verore, Shqiponja*.

Së këtejmi mund të themi se që nga periudha e **Pavarësisë** dhe e **Çlirimit** për këtë destinim janë përdorur edhe emra me fundore të tjera për motivim të ngjashëm, si:

*Liria, Bleran, Drita, Fitore (në Shqipëri), në Kosovë: Qëndresa, Fortesa, etj.*

Dhe për të gjithë këta shembuj vlen konstatimi, edhe pse nuk krijojnë model, assesi nuk mund të quhen të qortueshëm, përkundrazi.

### 3. Shembuj me -OJË

Ndër shembuj prejfoljorë *si të modës* si më sipër i futëm pak si me zor edhe emërtimet toponimike me prapashtesa –OJË. Ne, shembujt e tillë po i trajtojmë si pikë më vete, edhe në Listën e vitit 1938 ndeshim emërtimin Trojë, ndërsa në Regjistër (2005) ndeshëm vetëm emërtimin e vendbanimit **Burojë**. Këtë e bëmë, për arsye se kjo fundore-prapashtesë del e specifikuar që nga tradita e lashtë për tipin e prejpjesorëve pandajshtesorë të foljeve me -Oj, ngase njëherazi ky formant fsheh prirjen në vetvete për të mbuluar një fushë të veçantë semantike që ka të bëjë pikërisht me vendin e caktuar të cekur në temën fjalëformuese. Krahaso, tipi Trojë (vend trojesh), **Burojë** (vend burimesh), por që gjithsesi si venbanim nënkupton nënkupton motvimin nga trualli, burimi etj.. Madje edhe nga shembujt e tjerë të ngjashëm nga mënyra fjalëformuese mbulohet kuptimësi e ngjashme si **Blerojë** (vend blerimi), **Peshkojë** (vend peshkimi) **Lëmojë** (vend i lëmuet), **Pushojë** (vend pushimi) etj.

Në burimet iokonimike ndeshëm këta shembuj me –OJË fundore:

*Bahullojë, Betojë, Bellojë, Brojë, Barbullojë, Drojë, Osojë, Usojë, Mllojë, Merkojë, Sopojë, etj.*

Gjithsesi kjo dukuri mbetet të ndiqet. Sidomos zgjon interes qëndrueshmëria e trajtës –OJË në emërtimet e përpunuara (deformuara) sllave në gojën e shqipfolësve nga *polje* në **p/ojë**, por edhe të greqishtes *polis* siç janë trajtat:

*Voskopojë, Trojë, Tropojë, Velipojë, Topojë, Postopojë, Rasnopojë, Konstantinopojë etj.,*

d.m.th. nga trajta *polje* (fushë) përkatësisht *polis* (qytet -vendbanim) që në shqipe në sistemin ligjërimor janë futur në trajtë-fundoren -*ojë*, e cila, sigurisht më parë që në protoshqipe duhet të këtë qenë prapashtesë ose

mbaresë e konsoliduar dhe në rastet e sapocekura –**OJË**, del e përfocuar përfocuar me shndërrimin e l-së – J, apo jo?!

Kur është fjala tek emërtimi *Velipojë* (sll. \*Veliko polje - fushë e gjerë, e madhe), fjalë kjo që përdoret si emërtim vendi edhe në Vermosh, ashtu edhe në krahinëzen bregdetare të Shkodrës. Por edhe gjatë sikrahinës si tillë gjithandej rreth bregdetit shkodran kur ka shtrirje përdorimi në disa lokalitete, si:

1. emërtim krahinëze,
2. emërtim fshati,
3. emërtim qendre banimi,
4. si emërtim Zharraku (rezervati gjuetie) si dhe
- 5, si emërtim plazhi,

andaj a s'është më mirë, më shqip, që emërtimi i tillë të zbutet sadopak shprehimisht, sidomos andej nga qytetëza bregdetare me sinonimin **Pushojë**, përkatësisht **Det/pushoja e Shkodrës**.

Kështu mund të jetë e arsyeshme në stilin e caktuar, apo jo, shprehja, si:

*Shkodra duhet të krenohet me **Detpushojën e vet** (kupto: **plazhin dhe qytezën bregdetare**. Synimi është që **Pushoja (det-pushoja shkodrane)** ta zëvendësojë së paku një pjesë të kuptimit *Velipojë*.*

Madje:

*Fjala **Det-pushojë** ka mundësi me dalë si antonim i togut: **mal-pushojë Malpushoja shkodrane në Theth**, apo jo?*

Ky është vetëm një sugjerim, jo i pa pranueshëm për një shprehje a stil të veçantë dhe si fakt i tillë cyt faktorët për zgjidhje edhe më të mira e më të përshtatshme riterminologjike. Gjithsesi, le të vlerësohet sugjerimi që *pushimorja bregdetare* mund të zëvendësohet fare natyrshëm, apo jo, me barasvlerësin **Det-Pushoja Shkodrane**?!

Si përfundim, pra, nga emrat e përgjithshëm abstraktë, përkatësisht emrat vetjakë të njerëzve e të tjerë në bazë kryesisht prejpjesorë me prapashtesën –IM e që shprehin ndonjë simbolike të posaçme mund të formëzohen si emra të vendbanimeve, por lidhur me këtë nuk del ndonjë model përthithës që mund të përgjithësohet, pos formimeve me -OJË fundore, siç doli edhe emërtimi emocionues kuptimor **Pushojë** (bregdetare) ose Pushojë (malore) **shkodrane**, i theksuar prej nesh.

### 3) Emërtimet me prapashtesat emocionuese (përkëdhelëse a zvogëluese)

Si prapashtesa të natyrës emocionuese-zvogëluese më të shfrytëzuara për emërtimin vendbanimeve janë: **-USH/-USHË, -OSH, -OZ dhe -TH, -ZË/-ËZ.**

#### a) Emërtimet me **-ush/-ushë**

Me prapashtesën **-USH -USHË** në Regjistër (2005) dalin pak emra të vendbanimeve. Me prapashtesën **-USH** doli emri **Drenush**, ndërsa me **-USHË**:

*Kajushë, Mirushë, Pagarushë, Batushë, Gotovushë, Opterushë, Tanushë.*

Edhe në Shqipëri dalin emra fshtarash me **USH** fundore, si:

*Bubullush, Melgush, Gapush e Lakelush, Lekdush, Gajush, Vojush,*  
por edhe me **-USHË**: *Vlushë, Leminushë.*

Në Listën e vitit 1938 ndeshëm këta dy shembuj vendbanimesh:  
*Bardhushe dhe Grindushë.*

Megjithë ngjyrimin përkëdhelës ose jo, që mund të marrë emri i caktuar me këtë formant, nuk mund të thuhet se kjo prapashtesë del e rezervuar për emërtimin vendbanimeve në shqipe, ndonëse nuk përjashtohet prirja.

#### b) Emërtimet me **-osh**

Me formantin **-OSH**, e cila del në interferencë edhe me shembuj të ngjashëm nga sllavishtja, por që R. Doçi të shembulli **Dashinosh** (për **Dashinoc**) e quan më të drejtë prapashtesë popullore shqipe, dalin emërtimet e mbështetura nga tradita:

*Mirosh, Dumosh, Kmetosh, Bukosh, Dobrosh,*

pra në numër modest. Në Listën e vitit 1938 ndeshëm këta dy shembuj: *Mirosh-i dhe Bardhosh-i*.

Në Shqipëri aktualisht ndeshëm fshatrat: *Vërmosh, Ktosh (Shkodër)* dhe malin *Tarabosh*. Për mendimin tonë, del i motivueshëm vetëm emri *Mirosh*, prandaj edhe lidhur me këtë formant vlen konstatimi i mësipërm që u dha për prapashtesën -USH /USHË.

### c) Emërtimet me -OZ

E futëm në këtë grup si fundore emocionuese ose jo edhe trajtë-fundoren –OZ, me të cilën nuk dalin shumë shembujt, megjithatë është e pranishme në disa oikonime, siç janë fshatrat:

*Kakokoz* (dy fshatra), *Gjorgjioz, Karkanjioz, Kollovoz, Çartalloz*

Po i shënojmë edhe toponimet: *Gramoz* (mal) dhe *Ranivoz* (gropë).

Meqë shembujt e tillë i ndeshim në viset jugore, kemi të bëjmë me sforcimin e fundores së prapashtesës -OS në -OZ, apo kemi të bëjmë me ndonjë teetimologji tjetër lypset gjurmuar.

Sidoqoftë, edhe kjo fundore-prapashtesë nuk tregon prirje shumimi për emërtimin e oikonimeve në gjuhën shqipe

### ç) Emërtimet me prapashtesat zvogëluese –TH dhe –ZË/-ËZ

#### 1) Emërtimet me –TH

Me prapashtesën zvogëluese –TH, në Regjistrin 2005 të Prishtinës nuk e ndeshim asnjë emërtim vendbanimi përveç Kryth (Pejë), ndërsa nga burimet në Shqipëri përveç këtyre 3 shembujve:

*Gjemth-i, Balldreth-i dhe Lajkth-i*

ndeshim edhe këto toponime me –TH fundore:

*Ukth, Armeth, Arth, Valth, Fikth, Frankth, Greth, Kryezjarrth, Theth, Lusarth, Liqeth, Vrith, Malth, Melth, Shqath. Xath, Rmath.*

Edhe pse kjo fundore (si prapashtesë zvogëluese) në fakt nuk paraqet domosdo diçka të vogël, kjo mund të shfrytëzohet, në raste të caktuara, si me thënë, emocionalisht si simbolikë e paqortueshme edhe si prapashtesë oikonimformuese, sikurse simotra e vet: -ZË/-ËZ,.

## 2) Emërtimet me -ZË/-ËZ

Jo vetëm ndaj prapashtesës zvogëluese –TH, por edhe në krahasim me prapashtesat e tjera zvogëluese-emocionuese të sipërcekura, formimet me prapashtesën -ZË/ËZ, dalin në numër më të madh.

Në Listën e vitit 1938 ndeshim afro 40 shembuj me –ZË fundore. Kështu përveç shembujve nga tradita si *Bulçizë, Qytetzë, Varreza, Lajthizë, Pemëz etj.*, ndeshëm edhe një shumicë shembujsh përkëdhelës ose emocionues të rij, si

*Njomëza, Pemëza, Lajthiza, Manëza, Vereriza, Ujza, Mollëza, Gurrëza, Rrethujëza, Hijëza, Çukëza, Vashëza, Dafinëza, Pjeshkëza etj.*

Edhe në Listën e vitit 1942 ndeshëm disa emërtime me këtë formant:

*Gjyteza, Mireza, Bardhëza, Koshëz, Kosëza.*

Po në mbështetje të fundores –ZË ose –ËZ së temës fjalëformuese, siç e pamë prapashtesa në trajtën –ZË/-ËZ del mjaft e shfrytëzuar për emërtimin e vendbanimeve edhe në Shqipërinë e sotme, siç dëshmojnë edhe shembujt:

*Shqëz (Berat), Marinëz (Fier), Shtepëz (Gjirokastër), Lojz, Dimëz, Dejëz, Klinëz, Shegëz, Kështjellëz, Ulëz, Bajëz, Balëz, Dyz?, Lugëz, Urëz, Ulëz, Mollëz. Gurëz, Dimëz, Dejëz, Klinëz, Kështjellëz, Lumëz, Shegëz, Flerëz, Ulëz (Mat), Arrëz, Mirëz, Shalëz, Manëz etj.*

Ja edhe disa shembuj me variantin –ZË, gjithandej:

*Burimzë (Durrës); Gabrrizë, Firzë, Orizë, Shupenzë, Qafrezë, Fierzë (Mirditë), Vilzë, Mezezë (Tiranë), Shëmrizë (Gramsh), Shezë, Gjergjizë, Rranzë, Ujz, Gjytezë etj.*

Ç'është e vërteta, edhe në Kosovë del e shfrytëzuar kjo prapashtesë. Sipas Regjistrimit të Komisionit (2005), ndeshëm aty jo shumë shembuj, por shumica prej tyre dalin të mbështetur sa i përket temës së qartë fjalëformuese.

Sidoqoftë, për mendimin tonë trajtat: *Gmizë, Shtarzë, Vernez, Zojz, Shkozë*, që dalin në Kosovë kërkojnë sqarim, ashtu si edhe disa emërtime me këtë formant, të cilat i lejoi Komisioni i Prishtinës (2005), duke e kthyer C-në fundore të fjalës në Z, si p.sh. *Smolizë për Smolicë, Hërtizë për Hërticë, Lashtizë për Lashticë*, por që, mesa pamë, nuk dalin në versionin e fundit:

Në këtë regjistër- dokument 2005, përveç trajtave me variantin –ËZ: *Arrëz, Baltëz, Gurëz, Thanëz*, ndeshim më shumë shembuj me variantin –ZË, si:

*Bajzë, Burimzë, Fierzë, Grykzë, Gjytezë, Lajthizë, Mirzë, Manzë, Ujzë.*

Kjo prapashtesë përdoret në numër të konsiderueshëm edhe për emërtimin e sendeve ose të mjeteve konkrete të punës dhe domosdo disa nga sendet e emërtuara teknike nuk paraqesin diçka të vogël ose emocionuese. Kjo vlen edhe për emërtimet e oikonimeve.

Sidoqoftë, të gjithë shembujt e vendbanimeve me prapashtesën – ZË/-ËZ të mirëfilltë dalin të paqortueshëm.

### **Sipërfundim**

Siç u pa nga vështrimi i mësipërm i këtij nëntitulli prapashtesat e emrave të mjeteve të punës si dhe ato të emrave abstraktë drejtpërdrejt nuk shihet se kanë ndikim në formimin e emërtimeve të vendbanimeve, por simbolika e emrit të caktuar, në mënyrë të tërthortë del motivuese.

Në këtë kontekst vlen të ceket prapashtesa -I, e cila del e identifikuar si prapashtesë që zgjidh mjaft raste nga fusha e oikonimisë, por nga ana e motivimit nuk mund të thuhet se paraqet model prodhimit, ashtu si edhe shembujt prejjesorë, me prapashtesat –IM, -OJË etj.

Gjithashtu për formimin e vendbanimeve përdoren edhe emrat me prapashtesat zvogëluese si *-ush/-ushë, -osh* dhe *-TH* e *-ZË*, ndër të cilat prapashtesa *-ZË*, në dy-tri versionet: *-Z -ËZ*, e *ZË*, ka përdorim të konsiderueshëm.



## **Dh. EMËRTIMET ME PRAPASHTESAT E SIPRAPASHTESAT PËRKATËSE ME PRIRJE SPECIFIKIMI PËR EMËRTIMIN E VENDBANIMEVE**

### **H y r j e**

Një formant për të marrë cilësimin e një prapashtese a siprapashtese të specifikuar apo të specializuar në një gjuhë të caktuar duhet t'i plotësojë disa kushte, që veç nevojës së domosdoshme, si më kryesore po përmendim këto kritere:

1) me qenë e burimit vendës ose të jetë e përvetësuar ligjërisht nga nevoja në kohëhapësirën përkatëse;

2) me pasë moshë relativisht të vjetër në përdorim;

3) me qenë mundësisht sa më monosemantike që i përgjigjet konceptit të nënfushës kuptimore që mbulon ose priret të mbulojë;

4) me pasë të përcaktuar qartë nënfushën semantike që mbulon a priret të mbulojë në kuadër të strukturës fjalëformuese brenda sistemit të shqipes globale, e cila i përket standardizimit;

5) me pasë stimulim ose të jetë e motivuar nga nevoja që ndihmon modelin e përvijuar për nënfushën e caktuar semantike;

6) me pasë stimul të brendshëm dhe të jashtëm gjuhësor, ku nënkuptohet kundërvënia me prapashtesat simotra në kuadër të strukturave të brendshme fjalëformuese në kuadër të sistemit, por të ketë edhe barasvlerësi konceptore të tejdukshme me formantet përkatëse të gjuhëve të tjera;

7) me qenë me perspektivë të parashikueshme që t'i shërbejë së ardhshmes si dhe t'i përgjigjet ekonomimit të gjuhës dhe

8) me qenë zgjidhja sa më ekonomike në krahasim me përvijëzimet e modeleve fjalëformuese në gjuhë, me prirje patentore si *prodhim serik*, ashtu si veprohet me prodhimin e pajisjeve speciale makinerike brenda impianteve përkatëse të prodhimit të produkteve, ku implementohet

prodhimi serik i veglave, mjeteve ose pajisjeve apo të pjesëve e nënpjesëve të specifikuara teknike-teknologjike që përmbushin nevojat në ekonomi duke ekspozuar mallra e pajisje konsumi pa mund shumë edhe me sasi e cilësi të lartë, sepse edhe në gjuhë vetë modeli a modelet fjalëformuese krijojnë lehtësi për përmbushjen sistemore të nevojave sipas të tipeve e nëntipeve të mjeteve të ligjërimit.

Ng analiza e materialit në shqyrtim doli se si prapashtesa e siprapashtesa përkatëse me prirje specifikimi të burimit vendës pak a shumë sipas kriterëve të sapocekura në shqipe, më shumë ose më pak për këtë veprim-zbatim dallohen ose identifikohen këto 7 formante:

**1)-AJË, 2)- ISHT, 3) -SH/-Ç,-ASH/ e -ESH,  
4)-ET e -AT, 5) -ARË, 6) –I/ANË, 7) –IONË.**

Po sa i plotësojnë vërtet kriteret e sipërcekura rreth *prodhimit serik* ose të një *prodhimi të veçantë*, të mjeteve gjuhësore formantet e tilla, do të arrihet njëfarë bindjeje pasi të njihemi me fakte konkrete që do t'i paraqitim gjatë analizës rreth përdorimit të formanteve në fjalë brenda emërtimeve në shqyrtim. Por, çështë e drejta, vetë jeta ligjërimore është ajo që e plason dhe e bën të kuptueshme ose jo, të vërtetën, por në këtë plan del i domosdoshëm të kuptuarit dhe përçafimi e njëherazi edhe propagandimi i mbarë nga ana e gjuhëtarëve, intelektualëve dhe standardologëve tanë, që mund t'u bëhen rezultateve pozitive konkrete të arritura apo të vërtetuara me analiza laboratorike e digjitale bashkëkohore, apo jo?!

Sidoqoftë, ja në vijim disa nga arsyet e përpjekjes sonë jo aq sugjeruese e as shterruese për shtatë formantet ose grupformantet e sipërcekura, veç e veç.

## **1) Emërtimet me -AJË**

### **a) Identifikimi**

Kur bëme fjalë për formimet me prapashtesën –AJ e cekëm shqiptimin popullor për emërtimet Ferizaaj/ë, Skënderaaj/ë dhe theksuam se një shqiptim i tillë vetvetiu dëshmon se në sistemin ligjërimor të folësve të trevave tona e më gjerë, për këtë tip emërtime, d.m.th. të toponimeve ka ekzistuar më përpara dhe që ekziston edhe sot formanti –AJË (\*AAJ'), i deferencuar me shqiptim e me koncept si dhe gramatikisht me ndërrim gjinie, ndaj formantit –AJ. Gjithsesi del e domosdoshme të dallohet openenca që del e shprehur në mes të këtyre dy formanteve *emërformuese* -

*aj/-ajë*, ndryshim ky, i cili nuk është dalluar, qoftë nga përdoruesit, qoftë edhe nga studiuesit e caktuar.

Sidoqoftë, po i kthehemi faktologjisë, me prapashtesën -AJË, e cila që nga Gazulli e sidomos nga Xhuvani-Çabej del e identifikuar si prapashtesë me kuptim toponimi.

Sipas Regjistrimit të Prishtinës (2005) dalin të formëzuara me këtë formant nja 10 emërtime cilësore të tjetërsuara vendbanimi, si:

*Lugajë, Grunajë, Firajë, Lis(n)ajë, Bletajë, Bungajë, Dushkajë, Borajë, Romajë.*

Ç'është e vërteta, kur kemi parasysh disa rrethana që lidhen me nevoja anësore e të brendshme të gjuhës, mendoj se mënyra e formëzimit sipas trajtave të lartëshënuara me këtë formant, mund dhe duhet të konsiderohet si një zgjidhje model që zgjon interes dhe meriton mbështetje parimore edhe për shembuj të tjerë të rij potencialë të kësaj nënfushe semantike.

Dihet se për t'u fituar dhe favorizuar një model në fjalëformim duhet t'i plotësojë së paku disa nga kriteret që u cekën pak më sipër. Shtrohet pyetja: I plotëson, apo jo, këto kushte formanti në fjalë? Fundi i fundit, për këtë vendos vetëdija e folësve, kuptimi metaforizues dhe, gjithsesi, nevoja që kushtëzon formimin përkatës, por ne, tash fill, do të cekim përmbledhtas disa argumenta në favor.

Së pari, studiuesit kanë mendimin se ky formant gjithsesi del i rrënjosur shumë herët në gjuhën tonë dhe ka edhe origjinë anase, ndonëse ceket njëfarë koincidence me formanti -anius të latinishtes.

Së dyti, kuptimi strumbullar që mbulon është ai i nocionit toponimik, të vendit që tregon një shumësi gjerash që cekën në fjalë-temën përkatëse fjalëformuese, madje edhe si vendbanim metaforikisht del i tjetërsuar.

Së treti, madje edhe nëse kalon në nënfusha të tjera, gjithnjë e bart me vete konceptin e shumësisë dhe vendin e caktuar në kohë - hapësirën përkatëse, qoftë edhe në mënyrë të imagjinuar (metaforizuar), lidhur me kuptimësinë e temës prodhuese.

Së katërti, ka sinonimi koncepti me prapashtesat **-inë**, **-ik** dhe **-ishtë** (simotra këto të përvetësuara për emra vendi), po në raste të caktuara del me fizionomi monosemantike gjithsesi më të qartë se ato.

## b) Raporti me simotrën -NAJË

Në të vërtetë, siç do të shohim në vazhdim, formanti -AJË, paraqitet edhe më me perspektivë monosemantike se sinonimiket e tjera: *-inë*, *-ik* dhe *-ishtë*, sepse ato dalin më të angazhuara për emrat e përgjithshëm mikrotopinimikë dhe për nocione të tilla, madje vërehet se kur është fjala për pasqyrimin e nënfushës së mikrotoponimisë prapashtesa **-ajë** ua lëshon vendin, jo vetëm atyre, por edhe prapashtesës simotër -NAJË, *Lisnajë*, e cila në burimet e caktuara ceket e pandarë nga ajo -AJË, prandaj rreth raportit -AJË/-NAJË, po i themi dy fjalë:

Së pari, është me interes të përmendet fakti se si te Xhuvani-Çabej ashtu edhe në FHSHS për konceptin e shumësisë fitonimike në më shumë shembuj jepen me formantin -NAJË se me **-AJË**, si p. sh.:

*kurpnajë, lisnajë, lullnajë, buhnajë,*

përkatësisht:

*arnajë, gurnajë, groshnajë, gjethnajë, pishnajë, rrugënajë, sheshnajë, shkurnajë vathnajë, fushnajë,*

ndërsa emrat *me kuptim vendi* jepen më shumë me -AJË, si p.sh.:

*Bungajë, Lugajë, Mollakajë (Gurajë), Rrethajë, Qarrajë, Dushkajë,*

përkatësisht:

*Lëmajë, Grykajë, Krenajë, Rrëkajë, Imshtajë, Çurkajë, Fierajë, Blinajë, Drunajë, Bështajë.*

Së dyti, sa për kërshtëri, por edhe për të argumentuar këtë që e thamë (lidhur me kundërvënien **-ajë /-najë**), po përmend faktin se në FSHS (1984) dalin mbi 30 emra me këtë formant, qoftë si emra të përgjithshëm, qoftë të formëzuar edhe si të përveçëm. Te shembujt e konsultuar mbizotëron trajta me -najë, element ky që asociacionon konceptin e shumësit të një emri të natyrës fitonomike, mirëpo kur është fjala te emërtimet me nocion vendbanimi, gjithsesi më tepër mbizotëron formanti **-AJË** edhe pse si koncept strumbullar mbetet po ai, d.m.th një shumësi a tërësi e shprehur paksa në temën motivuese fjalëformuese, për që përqendrohet në një vendhapësirë të caktuar, siç është oikonimi, siç u cek më sipër.

Me fjalë të tjera kuptimësia strumbullare e formimeve me **-ajë** mbetet vendi i caktuar, qoftë edhe me perceptim imagjinar, duke kaluar caqet që lidhen vetëm me fitonimi, mundësi kjo që nuk e ka b.f. prapashtesa *-najë*, e cila lidhet kryekëput me shumësin konkret të fitonimeve ose të

gjësendeve të tjera të cekura në temën përkatëse fjalëformuese të karakterit mikrotoponimik, sa për ilustrim po cek nja dy raste të mundshme: Lisajë (fshati)/ lisnajë a Lisnajë (oronimi), Lulajë (fshati)/ lulnajë a Lulnajë (kopshti i luleve) etj.

### c) Raporti -AJ/-AJË

Edhe pse ky raport është cekur paksa edhe më përpara, serioziteti i çështjes na shtyn me vazhdue edhe më tej analizën e kësaj teme në raportin -AJË/NAJË. Së këtejmi po theksojmë:

Së pari, në këtë kontekst imponohet çështja e sqarimit që ka të bëjë me raportin e formantit -AJ ndaj atij -AJ, sepse nga pikëpamja shkrimore në mjediset ku nuk shqiptohet qartë -Ë-ja, këto dy formante asociacionojnë ngjashmëri, andaj në të kaluarën në gjuhën e shkrimit mund të ketë pasur ngatërresa apo pa qartësi, ashtu si edhe tashti te ndonjë gjuhëtar i papërvojë! Si rrjedhojë nga ky formalizëm mund të ketë rënë në grackë, pra, i mashtuar nga ngjashmëria edhe ndonjë *ekspert*. Sidoqoftë, këto dy formante, varësisht nga konteksti ose nga burimi a gjendje që ofrohen kanë si kundërvënie jo vetëm gjininë, por edhe fushat e ndryshme semantike që mbulojnë. Trajta me -AJ, siç e pamë më sipër, dilte parësisht e specifikuar për emërtime patronimike, ndërsa kjo e gjinisë femërore -AJË parësisht del me kuptim toponimik (oikonimik).

Të gjithë argumentat flasin se emrat me **-ajë** me kuptim toponimik janë shfaqur në gjuhën tone, në mos qoftë më herët po aq herët sa edhe patronimet me -AJ. Lidhur me këtë nuk e kemi mbështetje vetëm shembëllin *Nikajë*, si emër vendbanimi ilir dhe *Nika Nikaj* si patronim aktual, por edhe fakte të tjera, siç janë emrat e përgjithshëm mikrotoponimikë që i ndeshim qysh herët anëmbanë truallit shqipfolës, por edhe sot e gjithë ditën. Të kujtojmë b.f. shembujt: ograjë (vendkullotë), krenajë (majëmali), pllajë (rrafnaltë) etj.

Së dyti, kjo vërtetohet edhe nga rastet e vendbanimeve në funksion te ne, me -ajë fundore si:

*Shoshajë, Bllagajë, Cerajë, Kobajë, Ivajë, Semajë, Rozhajë, Romajë, Kobajë, Devajë, Firajë, Blinajë*

si dhe ato në Shqipëri:

*Kavajë, Grykë-Çajë, Lapërdhajë, Visarajë, Zajë, Ndërmajë, Poligajë, Rrunqajë, Shtëpajë* e ndonjë tjetër.

Edhe pse kjo temë nuk del e studiuar sa duhet vetë ekzistimi i një diferencimi në mes të formanteve të tilla në sistemin ligjerimor të shqipfolësit e trevave të ndryshme, qoftë mbi fjalëtema jo përherë me prejardhje shqipe, por sigurisht të përvetësuara prej saj, dëshmon ngulitje të hershme të dy formanteve veç e veç, madje dallohet qartë destinim i tyre, sidomos ai i parapashtesës –AJË, pikërisht në nënfushën e emërtimit të vendbanimit. Gjithashtu edhe shqiptimi nga vendësit i oikonimeve si Ferizaj/ë (FerizAAj') e Skënderaj/ë (SkënderAAj'), përkundër atij zyrtar me -AJ *Skënderaj*, *Ferizaj*, siç rekomandohet edhe administrativisht etj, mund të dëshmojë atë që u tha më sipër, që ky formant (-ajë) ishte i ravijëzuar për konceptin e toponimit në fjalë shumë më herët se aktualisht në sistemin ligjerimor të gjuhës sonë globale, po ashtu sikurse edhe ai -AJ, i cili siç dihet qysh moti shqiptimisht edhe shkrimisht dilte i specifikuar për fushën semantike të patronimisë e jo të toponimisë. Krahaso raportin Shosh/i Shoshaj (patronim), ndërkaq Shoshajë-a (oikonim), e kështu me radhë.

Së treti, është me interes të ceket këtu interpretimi që i bën prof. Imri Badallaj emrit të fshatit Kobajë të Prizrenit. Ky në këtë fjalë sheh një përngjitime nga këto dy elemente: *baj + kob (bëjë kob) që nëpërmes të metatezës së elementit nominal me atë verbal u përftua konglutinimi kob+baj nga baj+kob Kobajë*, e së ketjmi, pra, doli emërtimi i fshatit **Kobajë**. Për mendimin tim pikërisht formanti –ajë (ekzistues) tashmë i jep fjalës kuptimin e vendbanimit, sepse ky formant edhe më përpara ka qenë i pranishëm po për këtë destinim në ligjërimin tradicional të shqipfolësve, prandaj edhe u formëzua toponimi si më sipër. Kjo dëshmohet e sforcohet edhe me shembullin **Romajë** (në shqipe) ndaj trajtës *Romune* të serbishtes.

Së katërti, në Listën e vitit 1938, ndeshëm këta tre shembuj të rekomanduar: **Dushkaja**, **Brezdaja dhe Rrushnaja**, mirëpo ndeshëm edhe këta shembuj në trajtën e pashquar me -NJ fundore:

*Bukuranj*, *Rosanjë*, *Dardhanj*, *Qershajn'*, *Radanj'*, *Karaflanj'*, madje edhe *Miellaj'*, të cilat për mendimin tim, kur kemi parasysh sistemin e shqipes, si emërtime vendbanimesh më mirë do të zinin vend komod si oikonime standarde zyrtare në trajtën me –AJË, sikurse shembujt: *Dushkajë-a*, *Brezdajë-a*, *Rrushajë-a*.

Sidoqoftë, ky formant që ishte i favorizuar më përpara mund dhe duhet të favorizohet me të drejtë edhe sot e gjithë ditën si prapashtesë e specifikuar për emërtimin e vendbanimeve edhe në kundërvënie me prapashtesën -AJ, të cilën mund ta zëvendësojë në shumë ose në të gjitha rastet, kur momentalisht, këtë e lejon konteksti, kur emri patronimik (i

njeriut) nuk del i motivueshëm aq tepër si destinim vendbanimi. Pra, prapashtesa –AJË, siç po përpigemi ta sqarojmë më mirë, mbulon nënfushën semantike, që lidhet me një shumësi gjerash, mjetesh a konceptesh, që strumbullakisht i përgjigjen simbolikisht nocionit të një vendbanimi të caktuar, siç janë rastet në Regjistër të Komisionit më –AJ, po që vendi e lypë me dale me –AJË, si b.f.:

*Jo Zotaj, po **Zotajë** (kodër (tumë) e ikonave), jo Zogaj po **Zogajë** (vend zogjsh), ashtu si edhe **Bletajë** (vend bletësh), si dhe **Bërr(k)ajë** (kullotë berresh), **Rrungajë** (vend përrockash të rrëmbyeshme), e kështu me radhë.*

Gjithsesi një dukuri e tillë kërkon gjurmim e trajtim të mëtejshëm.

## 2) Emërtimet me –ISHT

Në burimet tona të deritashme gjuhësore normative prapashtesa - ISHT del nën hije të variantit -ISHTË, përkatësisht -ISHTE.

Nga studiuesit Xhuvani-Çabej trajta *-ishtë* del parësore, por ceken edhe *-ishte* edhe *-isht*. Në gramatikën normative të shqipes (1979) si dhe në doracakun normativ *Gjuha letrare shqipe për të gjithë*, për çudi (!), së pari del e shënuar forma *-ishte* e në kllapa *ishtë*, në një punim të N. Veselajt *Çështje të shqipes standarde...* (1997), ku bëhet fjalë për vendshërbesat, më me përparësi del forma **-ishtë** e në kllapa ajo e pafavorizuara -ISHTE.

Ndërkaq Komisioni ynë (2005) ndonëse gjatë punës nuk e favorizon aq formantin **-isht**, megjithatë, është e para herë që ky Komision këtë formant e cek veçan, destinuar oikonimeve, madje e vë në radhë para variantit **-ishtë**. Pikërisht këtë fakt e ndeshim në *Sqarimin* paraparak që jep Komisioni lidhur me emërtimet në shqyrtim. Fakti i sapocekur për ne ka rëndësi dhe zgjon interes të posaçëm, ngase për të parën herë formanti - ISHT del i identifikuar si prapashtesë e specifikuar për emërtimin e vendbanimeve. Së këtëjmi, pra një mëvetësi e tillë e këtij formanti vërtetohet qartë praktikisht vetëm në nënfushën e oikonimisë, karakteristikë kjo që e mbart çdo formant i specifikuar. Në Shqipëri, siç është konstatuar edhe më përpara, dalin mbi 60 emra fshatrash e qytetesh (si emra të përveçëm oikonimikë) me këtë formant (**-ISHT**), kundrejt formantit *-ishtë* që po për këtë destinim, del i përdorur vetëm në afro 20 raste, ngase kjo (*-ishtë*), siç u tha, del e favorizuar kryesisht për emërtimin e oronimeve.

Në Kosovë, sipas Regjistrimit, raporti i këtyre dy prapashtesave del paksa ndryshe, 7 me 20 në favor të formimeve me -ishtë, por kur kemi parasysh faktin, siç u cek më sipër se në Shqipëri ndeshim 4-5 herë më shumë emra oikonimesh me -isht se me -ishtë, dhe se në këtë kontekst shihet qartë njëfarë kundërvënie në mes të këtyre dy formanteve, sepse prapashtesa *-ishtë* mbetet e specifikuar për emërtimet si emra të përgjithshëm dhe të përveçëm oronimikë, kurse **-isht** mbetet ose priret me u specifikue më tepër për oikonime, andaj marrim guxim të shprehemi që *formanti -isht meriton ta quajmë prapashtesë me prirje specifiki, vetëm për emërtimin e vendbanimeve*, por edhe të kërkojmë nga hartuesit si dhe komisionet përkatëse që këtë fakt ta kenë parasysh me rastin e rishikimit të emërtimeve të propozuara.

Sa i përket vjetërsisë së formave në fjalë mund të themi se formanti **-isht**, në mos qoftë më i vjetër, ka po atë moshë që e ka edhe ai **-ishtë**, pa marrë parasysh ndërkëmbimin a përkimin që kanë me prapashtesën **-ište** (ishte) ngjashëm si sllavisht.

Për momentin ka rëndësi fakti se që të dyja variantet e shqipes **-isht** dhe **-ishtë** dalin të motivueshme nga vetë zhvillimi i brendshëm i shqipes që argumentohet edhe me ndarjen pakashumë të nënfushave semantike që mbulojnë në kuadër të emrave toponimikë, siç u theksua pak më sipër. Po përsërisim:

a) prapashtesa *-ishtë* mbetet parësore për emërtimin e mikrotoponimeve, qoftë si emra të përveçëm, qoftë si të përgjithshëm si p.sh. blinishtë Blinishtë, ndërsa

b) prapashtesa *-isht*, del më e përcaktuar vetëm për emërtimin e vendbanimeve (fshatrave) si p.sh Blinisht etj. që do të thotë vetëm si emër i përveçëm, oikonim i desemantizuar nga koncepti i oronimisë.

Sidoqoftë, prirja e sapo konstatuar që emrat e përgjithshëm të mbesin më **-ISHTË**, si dhe ata të përveçëm të vendeve me kuptimësi fitonimike, ndërsa ata të vendbanimit më **-ISHT**, vetëm për emërtimin e vendbanimeve, duhet të kihet në konsideratë.

### 3) Emërtimet me **-SH/Ç**, **-ASH** e **-ESH**

Për arsye praktike shembujt me këto prapashtesa sinonimike (*-sh/-ç*, *-ash* e *-esh*) fare shkurtimisht po i trajtojmë veç e veç.



### a) Emërtimet me -SH/-Ç

Me prapashtesën a fundoren -SH, në Regjistër të Prishtinës dalin disa vendbanime, si: *Ballsh, Voksh, Boksh*, madje edhe *Dush e Raush*.

Edhe në Shqipëri ndeshim ndonjë rast me formantin -SH/-Ç fundore si Gramsh, Zallç, Laç, e ndonjë tjetër.

Kur është fjala te kundërvënja -SH/-Ç ma merr mendja se se SH-ja duhet me pasë më shumë përparësi në formimet e reja, sepse elementi Ç, më tepër anon të shprehë nocione pejorative, mirëpo, kur kemi të bëjmë me emërtime të vjetra, që sipas R. Doçit formantit -Ç ka më shumë përparësi. Autori, kur propozon trajtat e emërtimeve: *Valç, Draç(e), Melç(an), Klinç(inë)* shpjegon se -Ç-ja në protoshqipe vjen nga prapashtesa e vjetër i.e. -K e së këtejmi (nga ç-ja a c-ja) vjen prapashtesa e zvoglimit e gjinisë mashkullore -TH e kohës sonë.

Sidoqoftë, edhe kjo çështje kërkon hulumtim më të përimtuar, por për temën tone del e rëndësishme e vërteta, që me këtë formant qysh herët kohësisht dalin të emërtuara disa oikonime të qëndrueshme të shqipes.

### b) Emërtimet me -ASH

Me prapashtesën -ASH, të cilën R. Doçi e quan zhvillim i prapashtesës ilire \*-as, dalin disa emërtime si:

*Gërdash, Bradash e Mirash, ashtu si edhe Bardhash, Barmash, Kalimash, Bushkash,*

gjithsesi në numër të vogël, të kufizuar. Ky formant ka njëfarë opozicioni me formantin -ESH, i cili del më prodhimtar për këtë nënfushë semantike.

Formanti -ASH afrohet më shumë me formantin -SH, madje në rastet kur -A-ja mund të jetë e paqëndrueshme, për arsye të shqiptimit të patheksuar, atëherë ndodh shumimi i emrave me -SH fundore në krahasim me -ASH.

### c) Emërtimet me prapashtesën -ESH

Prapashtesën -ESH për emërtimin e vendbanimeve del më prodhimtare në krahasim me dy të parat : -sh/-ç dhe -ash.

Shikuar nga aspekti i sotëm sinkronik pa hyrë në prejardhjen e këtij formanti, për mendimin tone, lidhur me këtë shumësi shembujsh, dalin tri çështje, që ndihmojnë si hyrje në përgjigje:

së pari, kemi të bëjmë me faktin se me këtë formant ndeshim që herët emra përkatës vendbanimi, siç është rasti Arbnesht-i, Barbesh e të tjerë, së dyti, shihet qartë se mbaresa e shumësit të rasës vendore –ESH tek emrat e caktuar vendbanimi del me fizionomi të qartë shkrimore dhe

së treti, vetë fakti i të dalët të prapashtesës së specifikuar femërore në sistem në matronime me -ESHË, i ndihmon formantit *-esh* që ta ruajë ekzistencën edhe në kundërvënien me: formantin e gjinisë femërore *-eshë*, por edhe në raport me formantet *-ASH* e *-SH*.

Është e vërtetë se formimet me formantin *-ESH* i ndeshim gjithandej anembanë trevave shqipfolëse, sidomos në Shqipëri si:

*Bramesh (Kolonjë), Bushmesh (Krujë), Zgërdhesh (Krujë), Laktesh (Pogradec), Radesh (Skrapar), Branesh (Elbasan), Martanesh (Dibër), Petresh (El.), Gërbllesh, Gjinesh (Tr.) Gizavesh (Lb), etj.*

që kalojnë njëzetëshin, ndërsa në Kosovë përveç aikonimeve: *Partesh, Ponesh, Makresh* ndeshim edhe toponimet: *Golesh, Barbesh* etj.

Nga Komisioni i Kosovës shihet një gjallërim i formimeve me këtë prapashtesë, për çka dëshmojnë emërtimet e reja të propozuara oikonimike si:

*Arbënesh, (Serbobrani në Burim) Vranesh (Vraniqi në Gjakovë), Rudesh (Rudica në Klinë), dhe Kodranesh (Gollubica në Malas).*

Zgjon interes fakti se vetë studiuesi R. Doçi propozon këto emërtime plus me *-ESH*:

*Bradesh (për Bratilloç), Kortesh (Korenica), Manesh (Manishinca) Dranesh (Drenoci), Tygjesh (Tygjeci), Turjesh (Turniçeci).*

Me fjalë të tjera, ky formant i ka të gjitha parakushtet për t'u specifikuar si prapashtesë e posaçme për formimin e vendbanimeve analogjikisht, e sidomos del i motivueshëm, për të gjithë emrat gjeografikë që shumësin e pashquar e bëjnë më –E fundore.

## **S q a r i m**

Ç'është e vërteta, mbaresën e shumësit më –E, nuk e cekëm rastësisht, ngase, pa hyrë në përhollësi etimologjike, duke u mbështetur në gjendjen e sotme si kriter për përzgjedhjen e formantit *-SH/ASH* apo *-ESH* në mjaft raste si zgjidhje pragmatike, pa u hamendur shumë, ofrohet pikërisht fundorja e rrjedhore së shumësit të emrave përkatës, sepse vetëm kjo mënyrë sotpërsot mund të motivojë. Krahaso, këta shembuj si mostër:

faqe faqesh (apelativ): Faqesh-Faqeshi (oikonim), gole golesh Golesh (oronim) Golesh/i (oikonim); ballë ballësh a ballash (apelativ) Ballsh (oikonim), Kolë (antroponim) Kolesh a Kolash Kolsh (oikonime).

Po i cek arbitrarisht edhe dy shembuj të mundshëm: lis lisash (apelativ) *Lisash-i* (oikonim, përkatësisht **mal male** (oronim) ***Malesh/i*** (oikonim)).

Sidoqoftë, si përfundim mund të konstatojmë se pa mohuar ndërndikimet e formanteve të caktuara që ndriçohen etimologjikisht, në gjendjen e sotme vetëm në këtë mënyrë mund të gjendet ndonjë arsye motivimi, përndryshe emërtimet me formantet: *-sh/-ç/ -ash* dhe *-esh* i pret pasivizimi, prandaj edhe faktet e sapocekura prej nesh Komisioni duhet t'i ketë parasysh, sidomos kur është fjala për emërtime të reja nga fusha e vendbanimeve me –ESH fundore.

#### 4) Emërtimet me -ET e -AT

Në realitetin tonë gjuhësor ndeshim emërtime vendbanimesh edhe me prapashtesën -ET edhe me prapashtesën -AT, të cilat në njëfarë mënyre, shikuar nga gjendja e sotme e gjuhës mund të ndeshen në një farë oponente njëra me tjetrën, andaj shembujt e tillë siç do të dëshmohet nga analiza e mëposhtme, po i trajtojmë veç e veç.

##### a) Emërtimet me -ET

Me prapashtesën -ET (e cila shpjegohet në interreferencë me formantin *-etum* të burimit latino-roman) në Regjistër dolën këto emërtime:

*Qarret (Rashkoci, Qarrakoci), Arrnjet, Shkozet (Graboci), Dafonet (Vranidolli) Shkorret (Skarrabishta) Kashtanet (Kashtanjeva).*

Në Shqipëri ndeshim afro 10 shembuj, ndër të cilët edhe:

*Mullet, Farret, Kallmet, Përmet, Kashnet, Qerret, Shkopet, Bullgajet, Parret, etj.*

Edhe ky formant është identifikuar si prapashtesë oikonimformuese nga tradita, mirëpo aspekti i motivimit pa hyrë në analizë historike etimologjike, nuk del i qartë.

## b) Emërtimet me -AT

Edhe prapashtesa -AT, e cila shpjegohet në interferencë me formantin latin -*atum*, del e identifikuar si formant oikonimformues në disa shembuj. Krahaso trajtat:

*Flamurat, Martirat, Arllat, Dukat, Ngucat, Kastrat, Progonat, Bushat etj.*

si dhe me trajtat e propozuara nga R. Doçi:

*Korat, Orlat, Fushat, Barbat, Manushat, Berrat/in.*

Me këtë formant ndeshim shembuj të shpërndarë gjithandej në Shqipëri, afro 50 shembuj, si:

*Qesarat, Progonat (Tepelenë), Dukat (Vlorë), Vllahat, Minat (Sarandë), Ruhata (Shkodër), Qestarat, Dhoksat (Gjirokastër), Ballagat (Lushnjë), Osnat (Pogradec).*

Ndonëse te ne ndeshim vetëm dy emërtime me -ATË fundore: Pojatë dhe Busavatë, mund të themi se fundorja -ATË, e cila del e përdorur për emërtimin e disa vendshërbesave si p.sh. gjykatë, gjyshatë, themelatë, fortifikatë, nuk del e specifikuar për emërtime oikonimesh.

## Sipërfundim

Edhe lidhur me formimet me prapashtesën -AT, ashtu siç u tha për ato me -ET, motivimi në gjendjen e sotme të gjuhës sonë sipas temës fjalëformuese del i paqartë. Së këtejmi, si konstatim i përgjithshëm për të dyja këto formante -ET dhe -AT del se po të heqim njohjen etimologjike që mbetet privilegjë e studiuesve, në gjendjen e sotme, asnjë nënfushë semantike nuk motivon daljen e emrave me këto dy prapashtesa. Mirëpo po të gjykojmë asociacionisht për parapëlqimin a përzgjedhjen të njërit a të tjetrit formant mund të mbështetemi në prapashtesën trajtëformuese a fundoren e shumësit të emnoses të emrit përkatës me -AT ose -ET. Le të krahasohen shembujt përkatësisht:

a) me -ET : *qarr/e Qarret Qarreti, shkop/e Shkopet Shkopeti etj.*

b) me -AT: *luzë luzat Luzat Luzati, lis lisat Lisat Lisati, flamur flamurat Flamurat Flamurati.*

Pra, shumësi mund të asociacionojë në përzgjedhjen e formantit përkatës -ET ose -AT, prandaj themi se rasti Qarrat /\*Qarret-i, që ka dalë si rast në Regjistër duhet të korrigjohet në Qarret *Qarreti* \*Qerret, ndërsa tipat

që e bëjnë shumësin me -A e ruajnë –A-në fundore si b.f. fushë fusha *Fushat-i, lis lisi Lisat-i.*

### Sqarim plotësues

Po vazhdojmë sqarimin se interpretimi si më sipër aspak nuk mohon ndikimin eventual të formanteve të caktuara nga gjuhë të huaja që fillimisht do të kenë pasur hise në lindjen e formës përkatëse të prapashtesës së sotme në gjuhën tonë. Por nuk mohohet as e drejta që në shqipen e sotme të mos formohen emra të vendbanimeve edhe me formantet: -SH/-Ç,-ASH e -ESH, përkatësisht -ET e -AT, ndonëse sot nuk dalin të motivuar qartësisht.

### 5) Emërtimet me –ARË

Formanti **-arë** që në funksion prapashtese del i cekur që nga Gazulli. Ndërkaq nga Xhuvani -Çabej nuk trajtohet fare, mirëpo identifikimi i këtij formanti në fushën e toponimastikës dëshmohet qartë si në emërtime të vjetra ashtu edhe në të reja. Kështu dr. Rexhep Doçi si emërtime të fshatrave të identifikuar që në mesjetë ndër të tjerë përmend edhe shembujt **Dushkarë dhe Lisar'(ije)**, d.m.th. me formatin **-arë** të shprehur qartë. Në Regjistrin e Komisionit në shqyrtim ndeshet emri **Fusharë** për Napolje (Pejë), mirëpo ky formant edhe më mirë del i identifikuar në funksion siprashtese te mjaft shembujt të oikonimeve që janë në përdorim e sipër në Shqipëri, si:

*Dusharë, Varvarë, Karbunarë, Maqellarë, Gjinaqarë, Tunarë, Arëbarë, Lularë, Lumarë, pastaj Hoxharë, Tomarë, Spatharë, Nikollarë, Burgarë, Himarë, Bardharë, Pançarë, Popinarë, Funarë, Erëbarë, Spatharë etj.*

që gjithsej arrin numri në afro 20. Edhe te ne ndeshim një dukuri të tillë, madje numri i tillë nuk është edhe aq i pavërejtshëm, si:

*Shosharë, Hosharë, Tugjarë, Magjarë, Llukarë, Tullarë, Merdarë, Shikarë etj.*

Në anën tjetër te ne ndeshen jo rastësisht të shënuara me -AR fundor disa oikonime, edhe pse shumica e emërtimeve të tilla shqiptohen me -ARË fundore. Na merr mendja se nëse kjo mënyrë fjalëformimi del e vetëdijësuar, atëherë në gjuhën tonë do të praktikohet një mënyrë shumë e lehtë oikonimformuese me prapashtesën –ARË se me -AR, sepse prapashtesa **-ARË** do të shërbente si zgjidhje a si model i përkapshëm i

motivuar për të mbuluar një nënfushë të caktuar shumë të kërkuar dhe të nevojshme në kuadër të emërtimeve të vendbanimeve, siç është nocioni: vendi që emërton një pasuri të patundshme, siç është në të vërtetë nocioni i emrit **arë**, si tokë buke.

Zgjon interes zbërthimi fjalëformues i tipit të emrave me **-ARË**, siç është shembëlli *Fusharë*, e cila shpjegohet lehtë: *ara në fushë, ara e fushës* ose *ara te Fusha*, si dhe ai *Lumarë, ara te lumi, ara buzëlumi* etj., mirëpo ndërkohë kjo gjymtyrë kompozite ka kaluar në përngjitje, përkatësisht tashti në funksion siprapashtese dhe si e tillë shërben a mund të shërbejë si model në formëzimin e vendbanimit përkatës që paksa fsheh dhe ruan në nëntekst konceptin e pronës a të pronësisë së temës fjalëformuese. Me fjalë të tjera, zbërthimi që jepet për *Fusha* +-, b.f. *ara te fusha a ara në fushë ose ara e fushës ose për Lumë* + -..., do të motivonte që të lindin në këtë mënyrë edhe një sërë emërtime vendbanimesh si:

**Rrafsharë** -*ara te Rrafshi, ara në Rrafsh*; **Tumarë** -*ara te Tuma*, pastaj do të jenë më të shndritshme edhe raste e sipërcekura si:

*Gjin(aq)arë* (ara e Gjinit, *Dusharë* ara e Dushit, *Tunarë* ara e Tunit, *Zgatarë*, ara e gjatë (e z/gjatë), *Begarë* - ara e Begut, *Sheharë* -ara e Shehut, *Lugarë* (ara te Lugu), *Shpatarë* (ara te Shpati), *Bregarë* (ara te Bregu) etj

që është zgjidhje shumë më e kapshme se sa me prapashtesën patronimike – AJ ose -AS: *Begaj!*, *Bregas!* e një mori emrash të diskutueshme me **-aj** e **-as** (!) që janë dhënë në Regjistër.

Gjithsesi, e dimë se ka edhe interpretime të tjera, nëse kjo mënyrë vetëdijësohet, për çka mendoj se i plotëson të gjitha kriteret si nga ana e brendshme e gjuhës ashtu si edhe nga ajo jashtme e saj, atëherë do të ri/fitonim një siprapashtesë speciale me perpektivë të qartë, për emërtimin e toponimeve që lidhen paksa me pronën që zakonisht është **arë** ose emërtohej me *-arë* fundore, siç po ceket disa herë prej nesh. E cekëm më sipër kushtin e jashtëm, të cilin paksa dua ta sqaroj edhe më:

*Të rikujtohet rasti i emrit të qytetit Gjakovë nga Jak+ovë, kur -OVA sqarohej si arë, përkatësisht ov- pronë ose plaçkë në turqishte në njërën anë dhe -ova si formant i sllavishtes që shpreh pasurinë e patundshme (arën, pasurinë). Prandaj supozohet që edhe të rasti në shqyrtim mund të ketë qenë në shqipe: **Ara e Jakut Jakarë** (Jakova: arë-ova), sikurse te rastet që tashti nënkuptohen qartë *Hoxhara, ara e Hoxhës, Nikollarë* (ara e Nikollës) etj.*

Me një favorizim të tillë të qëllimshëm të siprapashtesës **-arë** që na zbulohet fare qartë nga analiza, atëherë do të arsyetohej edhe më mirë pasivizimi i tashëm i emërtimeve të venbanimeve me formantet si *-ar, -are, -tar, -tare*, përkatësisht *-aj e -as* e të ndonjë tjetër, të cilat nuk u favorizuan teorikisht edhe në punimin tonë. Lind pyetja po çka e pengon pranimin pa rezervë të një mënyrë të tillë fjalëformimi me **-ARË**?

Për mendimin tonë janë dy çështje që mund ta pengojnë ende këtë zgjidhje- favorizim:

e para, ky formant nuk është trajtuar për këtë destinim deri më tash, veçan, nga gramatikanët tanë dhe

e dyta, edhe formimi kompozitor i tipit të tillë është konsideruar jo aq me të drejtë se gjoja bie ndesh me natyrën e gjuhës shqipe.

Po sqarojmë edhe pak. Lidhur me çështjen e parë është e vërtetë se është e para herë, me sa dimë, që ky formant trajtohet në këtë punim paksa me seriozitetin që meriton, prandaj edhe rezerva ndaj interpretimit që mund t' i bëhet, mund të jetë ende e ndjeshme. Ndërkaq sa i përket çështjes së dytë mendojmë se në parim nuk qëndron rreziku se me një përqafim të tillë do të lëndohej natyra e gjuhës sonë. Ja, përse themi kështu:

Së pari formime me gjymtyrën **-ARË** në funksion si një siprapashtese speciale përveç rastit Fusharë dhe shembujve të tjerë, që idisa sollëm pak si me zori, më sipër, ndeshim edhe në burime të tjera, siç është *Kryearë* (arë kryesore ose kryet e arës) që e gjen studiuesi A. Zymberi në Zym të Hasit të Prizrenit, pastaj edhe emërtimin **punarë** (*arë pune*) që e ka shënuar si shembull S. Drini në punimin e tij të cituar në këtë punim. Le të krahasohet fjalë-termi *Punarë* (arë pune) me fjalë-trajtën **punove** (*turq, ove -arë ose tokë pune*) të regjistruar në FGJSSH (1981).

Së dyti, formimet e këtij tipi kompozitash nuk paraqiten si nevojë e ditës, por ato janë më të hershme, të kujtojmë veç rastit *Dushkarë*, edhe emrin Bardhyl (Ylli i Bardhit ose ylli i bardhë, pastaj tipin *atdhe, mëmëdhe* (dheu i mëmës) etj., të lindura këto nga nevoja dhe të pranuar fort natyrshëm edhe në gjuhën tonë të sotme letrare (standarde). Prandaj përkimi i mënyrës së tillë formale fjalëformuese me gjuhët e tjera, siç janë turqishtja, greqishtja, serbishtja, italishtja e ku ta dimë, nuk duhet të na brengosë fare, sepse ne e kishim një mënyrë ose një model të tillë emërformues në gjuhën tonë edhe më përpara, siç dëshmojnë shumica e shembujve të mësipërm, të cilët edhe aktualisht janë aktivë.

Së treti, vetëm në burimin *Onomastika e Kosovës* studiuesit përmendin mbi 100 raste ku fjala e parë toponimit togfjalësh del fjalë *arë* ...

(Ara e gjatë, Ara e Hoxhës, Ara te Fusha etj.), ndërsa në realitetin tonë gjuhësor emërtimet e tilla janë me qinda e qinda, për mos me thanë me mundësi formimi pa kufi, prandaj kur kemi parasysh prirjen a nevojën e gjuhës së administratës që togfjalëshat e tillë të njëfjalëzohen, atëherë njëfjalëzimi me metatezë i togut që bëhet fare lehtë duke e hedhë gjymtyrën **-arë** në fund të fjalës së përbërë dhe kjo mund të aryetohet ose të pranohet si diçka normale, apo jo? S'është nevoja t'i përsërisim shembujt e sipërshënuar siç ishte: *Ara e Llukës - Llukarë, ara e Hoxhës - Hoxharë*, apo shembulli *Hani i Elezit - Elez-han (krijim i gjallë popullor)* etj. për të përligjur këtë model që e thamë.

Sidoqoftë, duke e pasur për bazë nevojën e njëfjalëzimit të togfjalëshit përkatës të nënfushës së caktuara semantike si dhe mënyrën e kapshme të modelit fjalëformues në kuadër të nënsistemit fjalëformues emëror të kompozitave në gjuhën tonë besoj se një mënyrë e tillë do të hasë në mirëkuptim edhe nga standardologët tanë dhe gjithsesi do të jetë e pranueshme edhe për masën.

Gjithsesi mendojmë se argumentat e shtruar apo të zbuluar nga analiza jonë, jo vetëm Komisioni i Prishtinës, por edhe kudrot përkatëse profesionalë gjithandej trojeve shqiptare, gjithsesi duhet t'i kenë në konsideratë, apo jo?

## 6) Emërtimet me **-ANË**

Disa emërtime të vendbanimeve në Regjistër (2005), por edhe në burime të tjera i ndeshim me *formantin -anë -(i/an/ë)*.

Shembujt ekzistues si:

*Ulpianë, Arbanë, Tumanë, Oskanë, Tiranë, Dardanë, Boranë, Turanë, Kobanë, Artanë, Besianë, Bedërianë, Boranë, Medianë, Bresanë, Drejanë, Roganë, Albanë, Bresanë, Gentianë, Ulkianë, Beranë, Berzanë, Thumanë, Rrëzanë, Rrezanë, Mujanë, Piranë* etj,

na kujtojnë mënyrën e formimit të emrave në kohën antike në njerën anë, por njëherazi, duke pasur parasysh faktin se fundorja **-anë** koïncidon edhe në kohën tonë me fjalën *anë ana* (drejtim, vend-hapësirë të caktuar), atëherë vetvetiu na bën të nënkuptojmë se kemi të bëjmë me një kriter me vlerë tejet të madhe oikonimformuese që na vjen si dhuratë, paksa e fshehur nga lashtësia por e krahasueshme dhe shumë dobishjellëse për kohën tonë.

Është momenti që ndihmon mrekullisht për plotësimin e nevojës që shtrohet aktualisht edhe për emërtimin e vendbanimeve. Pra, me një



përqafim të tillë të formantit **-ANË/-ANA**, si morfemë fjalëformuese për emërtimin e vendbanimeve në mënyrë të tillë emërformuese i japim edhe moshë vjetërsie, por njëherazi edhe motivim të rinuar bashkëkohor.

Me fjalë të tjera prapashtesa **-ANË- ANA** ka të gjitha mundësitë që vërtet të specifikohet si një prapashtesë e specializuar, vetëm për emërtimin e vendbanimeve të tipit që rumbullaksojnë konceptin e një ane që zë një qendërvendbanimi. Pra, emërtimet e tilla, po përsërisim: kanë motivim transparent nga dy burime: nga e kaluara antike, ku gjithsesi e ka hisen edhe gjuha jonë (pellazgo-ilirie a protoshqipja), por në anën tjetër edhe shqipja e kohës sonë, siç janë propozimet fort të qëlluara nga Komisioni siç është tipi:

**Rrezanë** (ana e rrezes), **Boranë** (ana e borës, simbolika e bardhësisë), **Tumanë** (ana e tumave) etj.

Na është e ditur se koncepti i vendbanimit me emër-formantin **-ANË** ndryshon nga koncepti që u zu në gojë për formantin **-AJË**, dhe **-ARË** ngase me fjalën **-ANË** përfshihet një hapësirë më e gjerë, nga ajo që mbulohet me formantin **-AJË**, përkatësisht **-ARË**, por me një ndërlidhje semantike të përqendruar në një një vend: **vendbanim** që i jep atij edhe konceptin e tabanit të lashtësisë, por edhe të realitetit të tashëm, apo jo?!

Studiuesi Gjon Keka asociacionisht na ndihmon duke i sjellë disa trajta më të vjetra me **-ANA** fundore të disa vendbanimeve të sotme, si:

Kaçaniku – **Cesiana**, Prishtina – **Trisciana**, Kruja – **Clodiana**, **Kumani** – **Cumanciana**, **Justiniana Secunda** – **Ulpiana**, Tyranus – **Tirana** etj.

Kur është çështja se cilën variantë duhet parapëlqyer **-ANË** apo **-AN** që ndeshen në emërtime të vjetra, mendoj se pa mëdyshje, për vendbanime duhet parapëlqyer formën me **-ANË/-ANA** fundore. Arsyeja është e thjeshtë, sepse këtë e motivon vetë fjala **-anë** me kuptim të sotëm, në njërën anë dhe fakti tjetër se zakonisht me trajtat me **-AN** fundore emërtohen antroponimet (emrat vetjakë të njerëzve) që zakonisht shënohen në gjininë përfaqësuese mashkullore. Krahaso, tipin: **Dardan, Ilirian, Adrian, Alban, Gurian** (antroponime), në njërën anë me trajtat **Dardanë-a, Ilirianë-a, Adrianë-a, Albanë-a, Gurianë-a** (oikonime), në anën tjetër. Në raste të tilla kuptimi strumbullar vjen nga oikonomi si b.f. **Dardanë-a**, ndërsa trajta dardan dardanët (banorë) kurse **Dardan-i** m. e **Dardanë-a** f., si antroponime, nuk motivohen nga **ana**, por nga koncepti i plotë simbolik i oikonimit, andaj ngjashmëria Dardana (oikonim) me Dardanë-a (matronim) nuk paraqet kurrfarë homonimie të vrazhdë.

Gjithsesi Komisioni si dhe studuesit në të ardhshmen duhet ta kenë parasysh këtë formant dhe ta përdorin për të gjitha ato raste, të cilave ka nevojë t'u jepet atributi i vendbanimit të vjetër, siç ishte *Ulpiana*, *Remesiana* etj. dhe që shtrihet në një vend-hapësirë të caktuar që sot motivohet me zbërthimin me fjalë-formantin **-anë** me koncept të një siprapashtese speciale oikonimformuese.

## 7) Emërtimet me **-I/ONË-A**

Një ndër formantet më atraktive që del për rikonsumin freskues brenda gjuhës sonë, qoftë për emërtimin e antroponimeve, qoftë të oikonimeve është prapashtesa **-ion**, përkatësisht **-i/onë**, të cilën Komisioni e qet në dritë në disa shembuj që i merr nga toponimet e vjetra të kohës antike, por të përfuara edhe në kohën tonë, si p.sh:

a) Me ION: *Kodrion*, *Laberion*, *Lladron*, *Drilon*, *Labion*, *Demastion*, *Ilirion*, *Davidon*, *Stridon* etj.

b) Me **-I/ONË**: *Syrigonë*, *Dodonë*, *Lavrigonë Stagonë*, *Albonë*.

Me fjalë të tjera, edhe me formantin **-I/ON** /-(I)ONË, ashtu si edhe me **-i/anë/-an**, ndeshim disa emërtime vendbanimesh që datojnë që nga koha antike, atje ku e ka hisen e vet ndërndikuese, siç u cek me të drejtë, gjuha *pellazgo-iliro-dardane*, përkatësisht *protoshqipja*.

Këtu më poshtë po i paraqit me qëllim disa raste antroponimesh, qoftë të ndërtuara, qoftë të rindërtuara si oikonime nga **-on** në **-i/onë** (në kllapa).

Krahaso:

*Antigon* (*Antigonë*) *Arbanon* (*Arbanonë*), *Medeon* (*Medeonë*), *Pogon* (*Pogonë*), *Parason* (*Parasonë*), *Agron* (*Agronë!*),

*pastaj*:

*Kodrion* (*Kodrionë*), *Laberion* (*Laberionë*), *Lladron* (*Lladronë*), *Damastion* (*Demastionë*), *Brysakion* (*Brysakionë*), *Albon* (*Albonë*), *Drilon* (*Drilonë*), *Ilirion* (*Ilirionë*), *Davidon* (*Davidonë*), *Pelion* (*Pelionë*)...

Së këtëjmi, veç këtyre që paksa momentalisht ende nuk i kap mirë veshi sa mendja, , dalin të shënuara si oikonime të mirëfillta edhe shembuj të tjerë vetëm me fundoren **i/onë** / **I/ONA**, **si**:

*Shkodrionë-a*, *Syrigonë-a*, *Dodonë-a*, *Livragonë-a*, *Stagonë-a*, *Labionë-a*, *Pellagonë-a* (nga *Pellagon/ia*), *madje edhe: Pasarionë-a*,

*Latronë-a (nga latron latronët), Progonë-a (nga Progon), Aulonë-a (Vlora e Vjetër) etj.*

Po i shtoj edhe dy raste që i cek dr. Rexhep Doçi si oikonime të vjetra: *Gurbikonë-a (Gurbikon)* dhe *Gurasonë-a (Gurason)*, të cilat i shpjegon nga rrënja e fjalës shqipe *gur-* plus prapashtesa-iON/ë (Shih: Bota sot, 8.I.2001, f. 19).

Kur kemi parasysh nevojën për emërtime të kësaj natyre, më duhet të japim sqarimin pse u parapëlqye ose duhet parapëlqyer forma me **-i/onë-i/ona** e jo ajo me *-i/on* fundore për ndërtimin a rindërtimin emrave të vendbanimeve?

Ne e bëmë këtë parapëlqim, sepse vërejmë një kundërvënie të dalluar lehtë ndërgjinisore e kuptimore ndërmjet këtyre dy varianteve: **-I/ON** ndaj **I/ONË-a**, sepse edhe në këto raste del oponentica : trajta me **-on** del e parapëlqye për emërtime antroponimie, ndërsa prapashtesa **-i/onë-i/ona** për toponime, pra kemi të bëjmë për dy fusha të ndryshme semantike. Pse u veprua kështu, dihet arsyeja, sepse emërtimet e njerëzve (antroponimet) zakonisht formohen me prapashtesën mashkullore **-ON**, gjini përfaqësuese kjo e emrit vetjak, ndërsa emërtimet e venbanimeve të këtij tipi, siç u tha, priren të shënohen në gjininë përfaqësuese gramatikore femërore, madje në trajtën e shquar zakonisht me **-A** fundore. Edhe pse këtë rregull nuk e kemi ndeshur të konstatuar askund në burimet tona gramatikore, një e vërtetë e tillë nuk është vështirë të argumentohet. Të kujtohen emërtimet e antroponimeve (emrave vetjakë të modës (bashkëkohorë)) që kanë përhapje të gjerë, me formantin **-ON** (natyrisht edhe ne këtu po i paraqesim vetëm me gjini përfaqësuese mashkullore), si p sh:

*Agon, Driton, Miron, Gëzon, Lumnon, Faton, Valon, Florion, Liridon, Edon, Egzon etj.*

që njëherazi kanë mbështetje në disa emra të traditës historike me **-ON**, si :

*Baton, Gripon, Gjon, Anton, Ton, Don, Progon, Erion, Non, Lon, Kron etj.,*

por vijnë edhe si shkak i konsumimit të modës (bashkëkohësisë) me emrat me **-IM** fundor. Pikërisht në këtë kontekst zgjojnë interes të posaçëm edhe emërtimet e modës (shumë të pëlqyeshme aktualisht si antroponime) me formantin **-JON**, si:

*Budjon, Shpirtjon, Besjon, Fatjon etj*

Sigurisht lidhur me këtë dukuri të ndërndikuar të formanteve **-on** për emrat antroponimikë, ndaj **formantit i/onë** si formant oikonimik (me dallim gjinie

gramatikore përkatëse) ka nevojë të njihet opinioni i gjerë më mirë, por në mënyrë të veçantë njerëzit e *zanatit*, **standardologët tanë**, në mënyrë që, jo vetëm të pranohet (zartarizohet) një formant i ri oikonimformues (-i/onë), por që edhe modelet e caktuara të jenë sa më të kapshme dhe të kuptueshme dhe me implementim obligues.

Sidoqoftë, me përqafimin e formimit të emërtimeve në shqyrtim në mënyrë të vetëdijshme, d.m.th. të antroponimeve me **-on** fundor si dhe të vendbanimeve me **-(j)onë** fundore gjuha jonë do të fitonte e përfitonte shumë. Me prapashtesën **-(I)ONË** emrit të vendbanimit njëherësh, po e rritheksojmë, i jepen dy veçori:

a) ngjyrimi i lashtësisë dhe

b) ngjyresa e bashkëkohësisë.

Po themi të *bashkëkohësisë* (modernes), sepse në kohën tonë, në fushën e stilistikës, sidomos në poezi, kam vërejtur se është krejt normale që vendi më i dashur i poetit (kupto: popullit) atdheu, të quhet:

*Mëmëjonë/a, Nanëjona, Shpirtjonë/a, Zemërxonë/a, Fatjonë/a,*

*Dëshirjonë/a, Lumjonë/a, Lirijonë/a, Albjona, Valjonë/a* e ngjashëm,

ku gjymtyra *-jonë/-jona* (e jona) këtu poetikisht kontaminohet me formantin e vjetër **-i/onë (yni)**, duke na u paraqitur tashti, një siprapshtesë të specifikuar për emërtimin e oikonimeve të kohës se re.

Gjithsesi rreth trajtës shkrimore *i/ona* ndaj *-jonë-a* lypset një sqarim nga pikëpamja ortografike, apo jo?

Është e vërtetë, që në shkrimet e vjetra latine, madje edhe italiane këtë fundor e ndeshim në mjaft raste me *-ion/a*, por zakonisht **-I-ja** shqiptohet si një **J** e shqipes, sepse ky graf mungon në alfabetet përkatëse. Fundja, kjo është pengesë e vogël në asociacion. Fundi i fundit, kush nuk do të dëshironte që çupkës a mbesës së vet të mos i vërë një emër të tillë të modës çupëjona, mbesëjona! e jo më venbanimit, kur emri bazë temë fjalëformues plotësohet me trajtën e përemrit pronor, *-jonë/jona* (veta e parë, pronari shumë, prona njëjës e gjinisë femërore me kundërvënien *-ynë* për gjininë mashkullore, kundërvënie kjo që në mjaft të folme dhe në fushën e poezisë nuk del e ndëprerë aq rigorozisht, si p.sh. *lirijona Liri(j)ona, besëjona Bes/ë(i)jona* në njërën anë dhe *shpirtjona Shpirtjona, fatjona. Fatjona*, nga ana tjetër, apo jo?!

Krahaso: *Liridon /Liridona ose /Lirijona Lirijon...*

Sidoqoftë, shikuar siç thuhet si tekst, nëntekst e kontekst me përqafimin e kësaj prirjeje, d.m.th. me formimin ose me përcaktimin e

antroponimeve bashkëkohore me -(i)ON/(i)ONI fundor, si dhe oikonimet me -I/ONË/IONA (-JONË/ -JONA), gjuha jonë do të kishte shumë dobi.

Ç'është e vërteta, këtë dukuri sapo e ka vërejtur, dhe e ka vënë në sprovë, mjaft ndjeshëm e mjeshtërisht Komisioni i Prishtinës (2005), prandaj në punën e vet secili komision mund ta shfrytëzojë pa druajtje, sidomos, kur, pikërisht, po këtë e kërkon dhe e arsyeton natyra e një emërtimi të ri, zakonisht edhe mbi bazë antroponimi.

Si përfundim, për mendimin tonë (po përsërisim) për emërtime vendbanimesh në vend të prapashtesave të diskutueshme me -AS ose me -AJ (sidomos kur oikojnimi del mbi bazë antroponimi ose me simbolikë të kësaj natyre), gjithsesi, ndër të tjera si prapashtesa të paqortueshme ose të specifikuar, duhet të vihet në veprim edhe prapashtesa **-i/onë ose jonë**, për arsye që u cekën më sipër.

Sigurisht, duke u mbështetur këtë prirje për mendimin tonë disa shembuj të propozuar nga Komisionet me prapashtesa të tjera, më për zemër do të na vinte emërtimi **Besëjona** se *Besijana*, **Liri(j)ona** se *Liriana*, **Iliriona** se *Iliriana*, por le t'j kon bkirrojnë: **Malioni** apo **Maliana**, **Dreniana** ose **Dren-jona** **Dreniona** apo **Drenasi (!)** etj. etj.

Le të mendohet pra, për modelin që po na ofrohet me -ONA, -JONA/IONA, i cili tashmë ka dalë në ridritë dhe sa do të shndëritë në nënfushën kuptimore të ligjëritimit shqip tash menjëherë e në të ardhmen, sigurisht varet prej nesh sa do ta shfrytëzojmë këtë mënyrë fjalformimi për konsolidim të mbarë, por pritet që mendim-rekomandimin ta thonë me kompetencë, ata që e kanë për detyrë e ata janë standardologët tanë, apo jo?

Sido që të jetë, prapashtesa **-(j)onë**, siç u argumentua më sipër, i plotëson të gjitha kushtet, që në burimet tona të sotme e të nesërme normative të zërë vendin e merituar në kuadër të mozaikut të formanteve përkatëse të strukturës emërformuese, me specifikë të veçantë për emërtimin e vendbanimeve.

## **Përmbyllje rreth prapashtesave me prirje specifikimi lidhur me nënfushat semantike ose profilimet që mbulojnë**

Në këtë përmbyllje, pa u ndalur në pesë nënkrerët A, B, C, Ç dhe D të kreut (II) të emërtimeve të vendbanimeve në gjuhën shqipe me prapashtesim, ku konstatoam jo pak formime të ngulitura nga tradita si dhe

gjithsesi krijime të paqortueshme, edhe pse afikset përkase dilnin të specifikuar parësorisht për nënfusha të tjera semantike, po i rikujtojmë kalimthi nënfushat semantike të emërtimeve të vendbanimeve të cilat mbulohej me emrat e formuar me prapashtesat përkatëse me prirje specifikimi (specializimi), siç u trajtuan më sipër duke i cekur edhe formantet simotra oponente, të cilat njëherazi ndihmojnë idenë për përcaktimin dhe të të kuptuarët më mirë të rëndësisë rreth specifikimit përkatës:

1) Me prapashtesën -AJË mbulohet koncepti që nënkupton shumësi sendesh e konceptesh që cekën në temën prodhuese dhe shkon në kundërvënien me prapashtesën -AJ, e cila mbetet e specializuar për emërtimit e patronime në gjuhën shqipe;

2) Nënfusha semantike e prapashtesës -ISHT del e diferencuar si oponente nga simotra, varianti -ishtë, kështu që prapashtesa -ISHTË mbetet kryesisht për emërtimin e mikrotoponimeve (oronimeve), ndërsa prapashtesa -ISHT del e specifikuar kryesisht për vendbanime (oikonime rurale e urbane).

3) Motivimi i prapashtesave variante -SH/-Ç, -ASH, -ESH në gjendjen e sotme asociacionisht shpjegohet edhe në bazë të mbaresës së rrjedhës së shumësit që merr emër-tema përkatëse, prandaj nëse duam ta formëzojmë emrin e caktuar me ndonjërin nga formantet në fjalë e konsultojmë mbaresën fundore të shumësit të emrit përkatës dhe pozicionohemi për përzgjedhjen e formantit -SH/-Ç apo -ASH ose -ESH. Mirëpo formanti i fundit -ESH përveç motivimit nga shumësi me -ESH fundore, ka edhe njëfarë mbështetje nga emrat iokonimikë të traditës, siç është rasti Arbesh, Partesh, Martanesh, Barbesh etj., por edhe nga ndërndikimi oponent me prapashtesën femërore -eshë, që përdoret për emërtimin e disa matronimeve.

4) Edhe të prapashtesat -ET dhe -AT në gjendjen e sotme asociacionisht, sa për orientim përzgjedhjeje, mund të shërbejnë mbarësia e shumësit të emrit në emnore në trajtën e shquar si p.sh. qarr qarri qarre qarret (apelativ) Qerret Qerreti (oikonim), përkatësisht lis-i Lis (antroponim) lisi lisa lisat (apelativ) Lisat Lisati (oikonim).

5) Emërtimet me siprapashtesa -ARË, përveç që vijnë nga tradita, mbulojnë hapësirë të kufizuar (arën) që zërthehet me metatezë dhe nënkupton një pasuri të patundshme. Motivi del nga lidhja organike e kësaj gjymtyre me gjymtyrën tjetër, përkatësisht me fjalë-temën prodhuese

fjalëformuese. Gjithsesi duhet parë përkimi dhe dallimi i nënfushave semantike që mbulojnë formantet -ARË, -AR dhe -ARE.

6) Siprapashtesa ose fundorja *-anë* asesi nuk duhet ngatërruara me prapashtesën -AN, ngase kjo vjen nga tradita e lashtë e emrave të vendbanimeve (antike), por që në kohën tonë ka gjetur koincidence motivimi nga fjala *anë* (vend që nënkupton hapësirë më të gjerë se fjala *arë*), por që në oikonimi, fusha e kuptimisë përkatëse lidhet organikisht me gjymtyrën tjetër, përkatësisht me fjalë-temën prodhuese fjalëformuese. Prandaj ky formant mund të aktivizohet për emërtime të reja me mjaft lehtësi, duke pasur parasysh kuptimin e emër-fjalës ANË të koncentruar në një vend të konceptuar si emërtim vendbanimi.

7) Prapashtesa a fundori i burimit antik *-on, -i/ona*, me të cilën ndeshim të emërtuara edhe vendbanime të lashta (ilire, protoshqiptare) që vjen e motivuar (stilistikisht) edhe në kohën tonë, u vihet zakonisht emrave të njerëzve ose atyre abstraktë që simbolizojnë diçka të ngjashme. Shikuar në tekst, nëntekst e kontekst, emërtimet e tilla të modës me këto dy variante, kanë njëfarë oponente të lehtë me emrat antroponimikë me -ON fundore, me të cilët ndërndikohet. Ndonëse, motivimi nga fjalë-formanti **-jonë** del paksa më i errët se të rastet me **-arë** e me **-anë**, por shikuar nga ana tjetër shihet një motivim i qartë kontaminues i ndërsjellë me konceptim e afrisë a të simpatisë ndaj emrave intimë familjarë a të imagjinuar. Krahaso: Liriona (lirijona), Lumjona (lumjona) ose Liridona (liridona), Kodriona (kodërjona), Labiona (labjona) etj.

Pra edhe ky formant në formim e sipër, por me perspektivë të qartë ka gjetur, priret të gjejë ose duhet të mbështete në mënyrë që ta gëzojë vendin e vet në kuadër të mozaikut të formanteve të tjera në kuadër të strukturës së prapashtesave të shqipes në nënfushën e emërtimeve të vendbanimeve dhe kjo e ardhme e formantit të tillë varet nga të kuptuarit, përkujdesja dhe kultivimi ynë.

Me fjalë të tjera të gjitha këto formante mund të dalin, apo jo, të mjaftueshme për mbulimin e nocioneve të vendbanimeve, le të vlerësohet, ndonëse nuk përjashtohen as formantet e tjera që u cekën në këtë punim si të paqortueshme. Por sidoqoftë, po riktheqojmë se duhet ta kemi të qartë se assesi nuk bën të lihen anash formimet e ngulitura, qoftë pa ndajshesa, qoftë me ndajshesa ose me kompozim a në mënyrë perifrastike. Së këtejmi, besojmë se nuk bëjmë keq kur kërkojmë që hartuesit e regjistrave të

emërtimeve të venbanimeve, patjetër duhet t'i kenë në konsideratë dhe t'i shfrytëzojnë prapashtesat e siprapashtesat e specifikuara për nenfushën përkatëse semantike, të burimit vendës, siç u trajtuan në këtë punim, apo jo?



### III. FORMIMET E VENDBANIMEVE ME KOMPOZIM E NË MËNYRË PERIFRASTIKE

#### H y r j e

Në nëntitullin e mësipër formantet *-arë*, *-anë* dhe *-(j)onë*) i trajtuam me të drejtë paksa edhe në cilësinë e siprapashtesës speciale për arsye se qoftë tërthorazi, qoftë drejtpërdrejtë fundoret e fjalëve përkatëse: **-arë**, **-anë**, **-jonë**, i ndjenin si prapashtesa speciale, e jo si gjymtyra të mirëfillta të kompozitave përkatëse. Duam të themi se prapashtesa speciale si dhe gjymtyra përcaktuese e kompozitës, në mjaft raste funksionalisht janë të afërta, por motivimi rastësor gjithsesi del më qartë në fjalë të përbërë ose tek ato të përngjitura a të shprehura me togfjalësha, sesa tek emërtimet me prapashtesa a siprapashtesa, mirëpo kur kemi parasysh *prodhimin serik* nga ana tjetër, prapashtesa speciale, kur kalon në model-shprehi luan rol me të madh në procesin prodhues.

Sidoqoftë, del e nevojshme të studiohet edhe mënyra fjalëformuese e emërtimeve të vendbanimeve edhe nga mënyra e formimeve me kompozim dhe në mënyrë perifrastike, me togfjalësha.

Formimet me kompozim, me përngjitje a me togfjalësha që i hetojmë në Regjistër të Prishtinës mund t'i merendojmë në tri grupe:

- a) formimet e emërtimeve me kompozita të mirëfillta,
- b) formimet me togfjalësha, tipi emër + përcaktuesi përkatës dhe
- c) formime me togfjalësha të tipave të tjerë.

#### **a) Emërtimet kompozita të mirëfillta**

Kompozitat, në funksion emërtime vendbanimesh. t'i quaj me rezervë *të mirëfillta*, që në Regjistër të Prishtinës, janë mbi 100, i dallojmë disa tipa a nëntipa. Ne këtu i merendum në dy grupe, duke i dalluar sipas gjymtyrorëve emërformues:

1) Kur gjymtyra e parë del në funksion siparashese tipi:

*Temali, Telisi, Nëpërbishti, Nëngurra, Messukash-i* etj.

Në Shqipëri të ktij nëntipi janë emërtimet:

*Temali, Temani, Ndërfushas, Nënshenjë, Ndërshemi, Nëngurra,* e ndonjë tjetër, ku zbërthimi bëhet si tek emrat e përngjitur te+mali, te +mani, d.m.th. (*fshati*) *te mali, te mani, te nën gurra,* e kështu me radhë.

2) Kur gjymtyra e caktuar e kompozitës përcakton tjetrën, ku dallojmë 5 nëngrupe:

a) kur gjymtyra e dytë si mbiemër del përcaktuese:

*Lugthat, Gurkuq, Gurmadh, Kodërbardh, Fushmir, Zallkuq, Jetëmir, Vermir, Gurbardh, Vitmir, Lugmir, Ujmir, Kruebardh, Lumkuq, Bregzi, Mollkuq, Gunbardh* etj.,

që zbërthehet: lugu i thatë, Lugthat-i, guri i kuq Gurkuq-i etj.

b) kur gjymtyra e dytë emër del përcaktuese për gjymtyrën tjetër po emër, si:

*Ballëdrin, Fushë-Pejë, Fushë-Kosovë, Bajëllap, Kryelum, Qafëmal, Gurshkabë, Fushëlot, Lulgjak, Kruembret, Pusat, Kodërflamur, Rrasujë, Fushëmollë, Lugdrin, Kryedren, Buzëmal, Buzëlum, Tumilir, Analum, Fushibër, Gurelez; Babaj-Bokës Fshatiuçëkë,*

që zbërthehet po ashtu: balli i drenit (Ballëdrin-i), pusi i atit (Pusat-i), Fusha e Pejës (Fushë-Pejë-a) etj.;

c) kur gjymtyra e parë emër njeriu shërben si përcaktues i mbiemrit (patronim) p.sh.:

*Nikuçaj, Nushpal, Llazdrelaj, Preklukaj, Hasanprishtinë, Micsokol, Pjetërshan, Haxhizekë, Mullaidriz,* e ndonjë tjetër, që zbërthehet. Nush+Pali Nushpal-i, Mulla + Idrizi Mullaidrizi etj.

ç) kur gjymtyra e dytë emër njeriu përcakton ofiqin, si p.sh.:

*Shëngjon, Shëngjergj, Shpal, Shmëri, Shënrrrok,*

që zbërthehet Gjoni i shenjtë (Shëngjon-i), Maria e shenjtë (Shmëri-a), Kuklibeg (begu i Kuklit), Qylagë (aga i Qylit) etj.;

d) kur gjymtyra e dytë emër përcakton gjymtyrën tjetër emër, p.sh.:

*Rrezanë, Fusharë, Zall-Reç, Bardhaj-Reç, Elez-Han* etj.

Shembuj këta që zbërthehen metatezisht:

ana e rrezes (Rrezanë-a), ara e Fushës (Fusharë-a), Reçi i Bardhajve (Bardhaj-Reç-i), Hani i Elezit (Elez-han-i) etj.,

sikurse tipi:

atdhe, mëmëdhë, udhëkryq, post-komandant, Bardhyl (ylli i bardhë) etj.

Edhe lidhur me këtë mënyrë fjalëformimi dalin çështje të diskutueshme.

Sidoqoftë, siç mund të shihet nga shembujt e mësipër, më tepër ndeshim emërtime, kur gjymtyra e parë sipas radhës del emër konkret, si:

gur: *Gurbardh, Gurkuq, Gurmadh* etj.;

lug: *Lugthatë, Lugdrin, Lugmir* etj.,

por janë shfrytëzuar edhe emrat si:

qafë-, buzë-, krye-, fushë-, kodër-, shën- (i shenjtë) etj.

Ndërkaq si emërtime me gjymtyrën e dytë sipas radhës në funksion siprapashtese dalin më të përdorur mbiemrat: -bardh(ë), -mir(ë), -kuq:

*Kodërbardh, Lumbardh, Lismir, Ujmir, Gurkuq, Kodërkuq.*

Në mënyrë të veçantë vihet re bashkëngjitja e emrave dhe e mbiemrave historikë të tipit:

*Hasanprishtinë, Mullazekë, Micsokol* etj,

punë kjo që nuk më duket e pambështetur, ndonëse paraqet risi në drejtshkrmin e rasteve të këtilla në praktikën tonë të deritashme drejtshkrimore, andaj kërkon edhe sqarime shtesë për opinionin.

## **b) Emërtimet togfjalësha:**

### **1) Emërtime me çiftat togfjalësh me epitetin: e epërme /e poshtme ose i epërm/ i poshtëm**

Në Regjistër nja 44 shembuj të vendbanimeve dalin emër + epiteti përkatës (e epërme/ e poshtme), si:

*Miradia e Epërme, Miradia e Poshtme, Livadhia E/P, Llapashtica E/P, Albona E/P, Kastrati E/P, Karmioni E/P, Shpati E/P, Qarrabregu E/P, Qëndresa E/P, Stralli E/P, Zabeli E/P, Nerodimja E/P, Shë(n)rroku E/P, Livoçi E/P, Bitia E/P, Shllakoci E/P, Jasenoviku E/P, Gushterica E/P, Gushterica E/P.*

Nga tradita në Shqipri në vend: **i epërm** ose **e epërme** përveç i epër/ e epër ndeshim: i (e) *sipër*, i *sipërm* ose e *sipërme*.

Sidoqoftë, ne përkrahim qëndrimin e Komisionit të Prishtinës:

Gjinia mashkullore.: *N. i Sipërm /N. i Poshtëm.*

Gjinia femërore: *N. e Sipërme/ N. e Poshtme.*

Por në Kosovë edhe në Regjistrin e fundit zyrtar në fuqi (burimi VI), nën ndikimin e barasvlerësve të serbishtes: **Donja/e/i** ose **Gornja/e/i** në

vend *i poshtëm/e poshtme* ndeshim: *i/e ulët* ose në vend */e epërme* ndeshim *i/e lartë*, raste tejet të paqëndrueshme për ne, prandaj faktorët nomëzues të gjuhës sonë standarde gjithsesi duhet t'i korrigjojnë lajthitjet e tilla.

## **2) Emërtime me çiftat me togfjalësh me epitetin: *e madhe/e vogël* ose *i madh/i vogël***

Sipas mënyrës emër + epiteti: *i madh/i vogël* ose ose *e madhe/ e vogël* në Regjistër të Prishtinës dalin nja 9 raste, si:

*Rropotova e Madhe/ Rropotova e Vogël, Bardhi i Madh/ Bardhi i Vogël, Albana M/V, Alba M/V, Kolludra M/V, Kçiqi M/V, Rudari M/V, Shtupeqi M/V, Mirashi M/V;*

## **3) Emërtime me mungesë çifti**

Si çifta të *cunguar*, pra pa çiftin paralel, dalin disa shembuj, si p.sh:

*Burimi (Obria/? Stërnaci/? Budriga/) i Poshtëm/?, Livadhi e Epërme, Zveçani i Vogël/; Driloni i Madh/ Vokshi i Ri/? dhe Kaçaniku i Vjetër/).*

Rastet e tilla duhet të sqarohen ose, aty ku jepet mundësia, të thjeshtësohen apo jo?

## **c) Emërtime me togfjalësha të tjerë**

Në Regjistër ndeshim edhe togfjalësha të tjerë si p.sh.:

*Prroi i Kostës, Baja e Mitrovicës, Prroni i Bajës, Lugu i Banit, Prroi i Jankut, Hani i Elezit .*

Që të gjithë këta shembuj që këtu vetëm po konstatohen, për ndonjë arsye a tjetër mund të jenë të diskutueshëm, por jo për mënyrën e formimit togfjalësh të tyre si parim.

#### **IV. RAPORTI I SHKALLSHMËRISË KUPTIMORE SIPAS MËNYRAVE TË FJALËFORMIMIT TË VENDBANIMEVE NË SHQIPE**

Nga krejt kjo që u trajtua deri këtu mund nxjerrim përfundimin që për shkak se kjo çështje, me gjerësinë e hollësitë e duhura, mesa jemi në dijeni, nuk është trajtuar deri më tash si temë më vete, andaj në këtë punim para opinionit dolën çështje që më parë ishin të panjohura, mbase edhe njiheshin nga ndonjë studiues, por në mënyrë të pjesërishme, prandaj rreth kësaj teme mund të ketë mbetur ende edhe ndonjë paqartësi ose ndonjë segmnet e trajtuar jo sa duhet.

Sigurisht në punimet e ardhshme kjo temë do të jetë edhe më e rrahur, edhe më e njohur e si rrjedhojë do të nxirren edhe rezultate të reja ose do të përfordohen ato që këtu sapo e kanë marrë formën e konstatimit ose të rekomandimit. Por, megjithatë, janë disa gjëra që nga analiza dalin të domosdoshme për t'u ditur, të cilat me rastin e rishikimit të qëndrueshmërisë së emërtimeve të vendbanimeve, komisionet përkatëse duhet t'i kenë në konsideratë, ngase këto janë mënyra që i ndeshim të formuara jo vetëm emërtimet e vendbanimeve në funksion, por edhe ato të propozuarat, ashtu si edhe ato të mundshmet në perspektivë.

Kështu, për hir vendi dhe me dëshirë që mos t'i përsërisim gjërat, këtu në formë përmbyllëse, me qëllim që çështja të dalë edhe sa më e qartë, do të paraqit skemën e shkallshmërisë së kuptimësisë së emërtimeve në fjalë në këto tri rubrika, ku mund t'i dallojmë shembujt:

1) me anë të emrave bazë pa ndajshesë, **apelativa, emra të përgjithshëm,**

2) me anë prapashtesash të përvetësuar e të tjera si, etnonime, oronime e oikonime, **emra të përgjithshëm e të përveçëm** dhe

3) me anë të prapashtesave të specifikuar dhe me kompozim, shembuj vendbanimesh, **vetëm si emra të përveçëm.**

## Skema e shkallshmërisë kuptimore

Po japim, sa për ilustrim, nga dy shembuj për secilën pikë:

I	II	III
apelativa	etnonime, oronime e oikonime	vendbanime
1) dardhë blin	Dardhë, dardhishtë Blin, blinishtë;	Dardharë, Dardhanë, Dardhisht; Blinisht, Blinajë, Lulblin;
2) mal fushë	Mal, malishtë, Fushë, fushore, fushnajë	Malisht, Malesh, Malet-i, Temal, Malionë; Fusharë, Fushajë, Fushlot, Fushibër;
3) lis fier	Lis, lisiinë, lisanjë Fier fierinë, fierishtë	Lisanjë, Lis(i)anë, Telis, Lismir; Firajë, Fiershpat, Erëfier;
4) gurrë kodër	Gurrë, gurrojë, Gurrëz, Gurras! Kodër, kodrinë, Kodrizë, Kodrishë	Gurrajë, Gurrianë, Gurrmir; Kodrionë, Kodërbardh;
5) dren zog(ë)	Dren, drenak, drenush Zogë zogëz Drenush; Zogëz, Zogjishtë, Zogaj.	Drenesh, Drenisht, Drenat, Drenshenjt, Drenionë; Drenianë; Bridren; Zogajë, Zogianë, Zogzanë, Zogionë!;
6) Gjin dukë	gjinash Dukas Gjinash Dukaj	Gjinarë, Gjinat, Gjinionë Dukat, Dukarë, Dukanë;
7) Drin lumë	Drini, drinas Lum lumas Drinaj Lumas, Lumaj	Nisdri, Anadrin, Drinisht; Lumarë, Lumesh, Fatlum, Lumionë.

Të vihet re se në rubrikën e parë emri përkatës i vendbanimit del i formëzuar nga emri i përgjithshëm i shënuar me shkronjë të vogël, me përjashtim të shembujve: Drin e Gjin.

Në rubrikën e dytë del edhe emri i përgjithshëm dhe ai i përveçëm i oronimit, por edhe emri i vendbanimit homonim i formëzuar nga emri i përveçëm i oronimit.

Ndërkaq në rubrikën e tretë dalin të shënuar vetëm emrat e mundshëm (të përveçëm) të vendbanimeve.

Të vihet re gjithashtu se në rubrikën e dytë dalin a mund të dalin edhe emrat e formuar jo të qortueshëm me prapashtesat e përvetësuarat si *-ishtë*, *-ik* e *-inë* si dhe të tjerat, si: *as*, *-(j)an*, *-ak*, *-ës*, *-tar*, *-ar*, *-or* e *-i*, *-ush*, *-osh* e *-zë/ëz*. Gjithsesi, në rubrikën e tretë janë përfaqësuar disa shembuj të formëzuar a të mundshëm të formuar me prapashtesat e siprapashtesat e parapëlqyera si të specifikuara, vetëm për emërtimin e vendbanimeve, kështuqë nga vetë format e mundshme të paraqitura në skemë (rubrika e tretë) me formantin e specifikuar kuptohet se kemi të bëjmë me një emër të përveçëm në funksion të një vendbanimi.

Njohja e tillë sistemore do të ndihmonte shumë që së paku sa për emërtim, në ndërmarrje të reja emërtimesh hartuesit sa për orientim të gjejnë dhe të zgjedhin modelin përkatës që u përpoqëm ta vëmë në pah dhe ta ofrojmë si të arrirë në këtë punim. Këtë analizë mendojmë se duhet me pasë parasysh gjithkush e sidomos standaologët, kështu që sa herë të paraqitet nevoja për rishikimin a ristandardizimin e emërtimeve të vendbanimeve në viset e caktuara të truallit shqipfolës, duhet të konsultohen rreth zgjidhjeve të ofruara, apo jo?

Sidoqoftë, shpresojmë se përpjekja jonë ose rezultatet e këtij punimi do t'u shërbejnë, pra në radhë të parë studiuesve për hulumtime edhe më të thella në këtë drejtim, sepse kjo rrugë hulumtuese, kemi bindjen, që do të na çojë jo vetëm drejt njohjes më të mirë të strukturës fjalëformuese të gjuhës sonë standarde në lëmin e toponimisë, më saktë të vendbanimeve, por edhe do të na shpie drejt zgjidhjes së çështjeve kyçe, kur kemi të bëjmë me formëzimin e drejt-fjalëformimin emërtimeve të reja të kësaj dhe të nënfusha të tjera semantike. Pra studimisht të jemi më të gatshëm në çdo rast sa herë që paraqitet e nevojshme, siç ndodhi te ne, në Kosovë, kur momentalisht në rend shqyrtimi u morën afro 1500 emërtime vendbanimesh dhe kur dihet fakti se probleme të kësaj natyre ndeshim në të gjitha viset shqipfolëse, si brenda, si jashtë Shqipërisë së sotme administrative, apo jo?

## Përfundimi i pjesës së dytë

Çështja e emërtimeve të vendbanimeve të ne, nën përkujdesjen e Komisionit Qendror për Standardizimin e Vendbanimeve të Kosovës, edhe pse tash, pothuaj mbi 10 vjet ka pushuar së vepruari pa fajin e tij, ishte në tryezën e diskutimeve intensive, 2-5 vjet që nga viti 1999-2001 dhe në verifikim deri në vitin 2004, ndërsa si çështje problemore ka ekzistuar edhe më përpara, madje ekziston edhe sot. Popullit tonë sa herë që i dhënë mundësia të frymojë pak si lirshëm kombëtarisht me mençuri e ka ngre edhe këtë çështje, çështjen e toponimisë me prejradhje të huaj, ngase bashkë me sundimin e zaptuesve, sidomos të atij serb dëshironte që të flakte tejpertej edhe emërtimet e imponuara prej tij mbi këtë bazë, të cilat aq më keq pushtuesi i shfrytëzonte e po i shfrytëzon propagandisht pa pushuar si element i *së drejtës së tyre historike* për të mbajtur nën gllabërim viset tona shqiptare në pambarim. Mirëpo pas Luftës të fundit Çlirimtare (UÇK), u krijuan kushtet që kjo çështje të trajtohet në mënyrë paksa më të organizuar dhe pa diktaturvejimi mbi kokë nga të huajt. Kështu nën përkujdesjen e Komisionit të sapocekur, pas ca konsultimeve me komisionet e komunave dhe me qarqe të tjera intelektuale profesionale, në muajin mars të vitit 2000 në gazetën *Rilindja* u botua në formë propozimi **Regjistri i emërimeve të vendbanimeve të Kosovës** dhe po ky tekst paksa më i kompletuar u ribotua po në gazetën *Rilindja më 28 prill 2000*. Ndonëse materiali ende ndodhej në diskutim, përkatësisht versioni i përmirësuar ishte në *përfundim e sipër*, ne si pretekst për të trajtuar temën **Çështje të formëzimit dhe të fjalëformimit të emërtimeve të vendbanimeve në shqip** (me theks në emërtimet e propozuara në Kosovë) morëm pikërisht **Regjistrin** e botuar më 28 prill 2000, të cilin e trajtuam në punimin tonë të botuar në gazetën *Rilindja* (2001 në 11 vazhdime). Së këtijmi, pikërisht përmbajtjen e atij punim tashti, sadopak të përplotësuar, po e parafrazojmë në vijim në disa pika:

Së pari, bëme krahasimin e emërtimeve në funksion sipas dy versioneve serbisht e shqip. Nuk është fjala vetëm për ndonjë dublifikim



emërtimi, të tipit. *Uroshevac /Ferizaj*, por edhe për deformime të tjera të ndryshme shkrimo-shqiptimore që vinin edhe për shkak të natyrës të ndryshme strukturore që kanë gjuhët e ndryshme në kontakt, të cilat duhej pasur parasysh për ndryshim, si p.sh.:

*Crkvena Vodica/Caravada, Dobar Dub /Dobërdup; Ojnovce /Hajnoc, Movljane/Muhlan; Shurlane/Shurdhan, Vitine/Viti, Retimlje/ Reti; Broçna/Brojë, Romuna/Romajë; Bubavac/Bubavec, Muzhiçane/ Muzeqinë, Shisharka/Shesharë, Shalinovica/ Shalinoc, Goraçevo /Gajrak etj.*

Përveç ndryshimeve të të dy gjymtyrëve të shembullit të parë, të vihen re ndryshimet e fundoreve të shembujt e tjerë: - du/**b**-du/**p**, -ovce - **oc**, -vlj/ane -**hl/an**, -ane -**an**, -ine - **i**, -imlje -**i**, -oçna -**ojë**, -una - **ajë**, ac - **ec**, ane - **inë**, -arka - **arë**, -ovica - **oc**, açevo - **ak**.

Së dyti, në të vërtetë, çka është për lavdi, Komisioni, me vetinisativë e pa të arsyeshme që punës t'i qasej edhe më thellë, më gjerë e më mirë. Ai pasi hartoi parimet dhe metodën e punës lëndën e trajtoi, duke bërë rishikimin pothuajse të tërë materialit. Në këtë kontekst pranoi edhe sugjerimin që mjaft vendbanime të riemërtohen. Kështu çështja e modifikimeve dhe të krijimeve të reja mori përmasa të konsiderueshme. Sipas përqindjes emërtimet e reja (më 2001) arrinin në 43.84 për qind në krahasim me numrin e përgjithshëm të vendbanimeve, por kur kemi parasysh karakteristikat e veçanta të natyrës së gjuhës shqipe në raport me atë të serbishtes emërtimet e tilla u prekën, pothuajse të gjitha qindpërqind.parimet dhe burimet mbështetëse të Komisioni.

Së treti, paraqitën pasqyrën e numrit të vendbanimeve në Regjistër të rishqyrtuara ose të propozuara sipas komunave.

Së katërti, i hymë analizës në bazë të analizës me theks nga pikëpamja fjalëformuese të prejardhjes përveç që konstatuam por edhe seleksionuam matrialin rreth formimit të emërtimeve të vendbanimeve në gjuhën shqipe emërtime sipas këtyre tri mënyrave të njohura: 1) Formimet pa ndajshtesa, 2) Fortmimet me ndajshtesa (prapashtesa) dhe 3) Formimet me kompozim a togfjalësha dhe disa nga kontatimet tona nga analiza që bëmë po i paraqitim përmbledhtas më poshtë, po në tri pika.

## I.

Nga pikëpamja fjalëformuese emërtimet pa ndajshtesa nuk paraqesin çështje problemore. E diskutueshëm mund të dalë vetëm çështja sa është vlera e fuqisë simbolike e emrit përkatës për t'u formëzuar e implementuar si emërtim vendbanimi. Sidoqoftë, së pari vështruam emra të përgjithshëmkon kretë të fomëzuar si vendbanime dhe së dyti, emrat e përgjithshëm abstraktë po ashtu të fomëzuar si vendbanime.

## II.

Te formimet me ndajshtesa ose prapashtesim që në këtë rrafsh emërtimesh të konsultuara zënë përqindje më të madhe se dy mënyrat e tjera, dalin çështje më të ndërlikuara, por edhe mjaft transparente, ku morëm në trajtim dhe analizuam shembuj të formuar me këto 6 grupe parashtesash:

a) Shembuj me formante prapashtesore të burimit të huaj:

1) sllav si *-ica*, (*v*)*iqi*, *-ovci*, *-ovi*, *-eva*, *-ava*,

2) grek: *os*, *-ot*

3) turk: *-a/xhi*, *-a/li* dhe *-i/je*

Gjithsesi formimet e vendbanimeve me prapashtesa të huaja, edhe pse një numër i konsiderueshëm i tyre mbeti i paprekur nga Komisioni, lënë vend për doskutim.

b) Prapashtesat e përvetësuara: *-ishtë*, *-n/ik* dhe *-inë*, të cilat në radhë të parë dalin të destinuara për emërtimin e toponimeve të karakterit oronimik, mirëpo u përvetësuan edhe disa emërtime vendbanimesh, si:

*Gurishtë*, *Qarrishtë*; *Sojnik*, *Bardhanik*; *Çelinë*, *Çeltinë*, *Rrezinë* etj.

c) Për formimin e emërtimeve të vendbanimeve u shfrytëzuan edhe prapashtesa të tjera të përvetësuara për koncepte etnonimie, siç janë

1) emrat e patronimeve me **-AJ**,

2) shembuj me prapashtesat etnonime: **-as**, **-an** dhe **-ak**.

Nga nga analiza u tërhoq vërejtje për përdorimin tej mase së lejuar të prapashtesave *-aj*, si dhe ajo *-as*, ngase që të dyja këto dalin të specializuara për nënfusha të tjera semantike, e para për emërtimin e patronimeve, ndërsa e dyta për emërtimin e etnonimeve. Ndonëse edhe prapashtesat *-an* dhe *-ak* dalin të angazhuara edhe për nënfusha të tjera kuptimore, prandaj disa raste me të drejtë janë propozuar nga Komisioni për t'u zëvendësuar me forma të tjera. Ç'është e vërteta, disa emërtime të reja me këto formante dalin mjaft të mbështetura, si p.sh: *Bardhan*, *Babushan*, *Lisan*, përkatësisht *Leshak*, *Gurak*, *Mirak* etj. ato që shërbejnë për emërtimet e njerëzve sipas profesionit.

ç) E enjëjta vërejtje bëhet edhe për formimet me formantet e specifikuar për formimin e njerëzve sipas profesioni, me **--(ë)s, -ar e tar,** dhe **-or.** - edhe pse nuk qortohen emërtimet e vendbanimeve tashmë të ngulitura me formantin -ës, si Durrës, Kukës etj., nuk rekomandohen formimet e vendbanimeve me tri formantet e tjera.

d) Edhe emërtimet mbi bazë të veprimtarive të tjera siç janë.

1) emërtimet nën ndikimjin e emrave të sendeve konkrete e të punës, si *-se, -ore, -are, , -ue/sor, ues/or, -zë* etj.

2) emërtimet nga fusha e abstraksionit ose e modë me *-im, -esë, -ojë* - etj. dhe

3) emërtimet me prapashtesat emocionale e zvogëluese, si: *ush/ushë, -osh, -oz* përkatësisht: *-th e -zë/-ëz*

Prej nënfushës semantike të emrave të mjeteve të punës dhe të nënfushës se nocioneve abstrakte mund të themi se nuk dallohet ndonjë prapashtesë e posaçme si model që del e shfrytëzuar për emërtime të vendbanimevesh, kur është fjala te nocionet abstrakte të modës, edhe pse prapashtesat **-IM** dhe **-OJË** zgjojnë interes të veçantë. Gjithashtu dallohet prapashjtësia **-i**, e cila del si mjet i përshtatshëm konsumues për mjaft shembuj, por nuk mund thuhet se formimet me këtë formant shërbejnë si një model që mbulon ndonjë prifilim të caktuar në fushën semantike të oikonimisë. Ndërkaq, në emërtimin e vendbanimeve përdoren edhe prapashtesat e fushës emocionale (zvogëluese), siç janë: **-ush/-ushë, -osh, -oz** dhe sidomos **-th e -zë/ëz**, mirëpo edhe te këto raste nuk mund të bëhet fjalë për ndonjë model, por mund të flitet më tepër për zgjidhje të rastit, edhe pse prapashtesa **-ZË/-ËZ**, sa i përket shumësisë së përdorimit bën dallim në krahasim me të tjerat.

dh) Nga analiza dolën disa prapashtesa a siprapashtesa me prirje specifikimi për emërtimet e vendbanimeve, siç janë prapashtesat: **-ajë, -isht, sh/ash e -esh, et e at** dhe siprapashtesat **-arë, -anë e -i/onë**, të cilat zgjojnë interes të posaçëm. Kështu prapashtesat **-AJË, -ISHT, -ESH** e të tjera si **-AT, -ET** që motivohen zakonisht nga kundërvënja me prapashtesa të tjera simotra. Sidoqoftë, motivimi del më i qartë te formimet me siprapashtesat **-arë** (pasuri e patundshme), **-anë** (hapësirë e kufizuar gjeografike dhe **-i/onë**, e cila kontanimisht simbolikisht ndërlihd prapashtesën e vjetër oikonimike **i/ona** me formantin **-on** karakteristik antroponimik, përkatësisht të përemrit

-*jonë-a* të sferës, si me thënë, më fort poetike joshëse pronësore, por që ka zënë vend edhe në emërtimet oikonomike.

Gjithsesi, sipas analizës së raportit të shkallës së kuptueshmërisë formimet drejtpërdrejt nga apelativat pa ndajshesa shpesh dalin me simbolikë më të qartë se formimet me prapashtesat e specifikuar për nënfusha të tjera semantike, siç janë formimet me *-aj, -as, -najë, -an, -inë, -ishtë ; -ar, -or, -ush, -osh* etj., kurse formimet me prapashtesat si *-ajë, -isht, -esh, -et, -at* dhe me siprapashtesat *-arë, -anë* dhe *-i/onë* dalin më të pranueshme se të gjitha të tjerat dhe potencialisht paraqesin modele që ia vlen të vlerësohen, përligjen e shfrytëzohen, sot e gjithë ditën e në perspektivë, sidomos në rastet sa herë del e nevojshme të krijohen emërtime të reja vendbanimesh.

Së këtëjmi, prapashtesat e siprapashtesat e identifikuar më sipër mbeten të vlerësohen, sa kanë mbështetje dhe sa i plotësojnë, apo jo, të gjitha kriteret për t'u cilësuar e shfrytëzuar edhe më për emërtime të reja të vendbanimeve të trojeve tona.

### III.

Edhe formimet me sikompozim zënë vend të rëndësishëm në formimin e vendbanimeve në shqipe. Përveç mënyrës së formimeve me siprapashtesa (me përngjitje) si:

*Temali, Telisi, Temani, Nëngurra, Ndërfushas* etj.

dallohen formimet me kompozita të mirëfillta, të cilat dalin në pesë nëngrupe tipi:

*Gurkuq, Ujmir; Pusat, Buzëmal, Fusharë; Micsokol, Preklucaj, Shëngjon, Qylagë; Rrezanë, Fusharë, Zall-Reç* etj.

Më atraktiv dalin nëntipet e fundit: **Rrezanë, Fusharë, Besionë** që zbërthehen sikurse tipi i kompozitave *atdhe, mëmëdhe*. Gjithsesi rastet me *-anë e -arë e -i/onë* fundore paraqiten formalisht edhe në funksion të siprapashtesave të specializuara për formimin e vendbanimeve, siç u trajtuan më sipër në këtë punim.

Sidoqoftë, nga kjo analizë dalin mjaft risime, por edhe mbesin ende mjaft gjëra të diskutueshme, ndonëse sa për orientim se si duhet vepruar sot e në të ardhshmen punimi pretendon të ketë vlerë, apo jo?

Gjithsesi, mendojmë që pesha e lëndës së trajtuar në këtë vepër nuk është aq e lehtë sa të vlerësohet ose të përçmohet pa u vënë në peshojat e studiueve të institucioneve tona më të larta shkencore, apo jo?



## **PËRMBYLLJE OSE CILAT JANË DISA NGA RISIMET KRYESORE SFIDUESE FJALËFORMUESE NGA KJO VEPËR**

Meqë një temë e tillë **ÇËSHTJE TË SHQIPES STANDARDE RRETH VENDBANIMEVE**, me sa dimë, deri më tash në gjuhën tonë nuk del e aq studiuar, andaj vetë titulli i riformuluar i kësaj përmbylljeje provokon.

Ne, që në parathënie tërhoqëm vëmendjen dhe shpjeguam motivin që na dha shkas për të zgjeruar interesimin tonë studimor rreth emërtimeve të kësaj natyre, andaj shfrytëzuam materialin e grumbulluar si dhe sidomos emërtimet e propozuara nga *Komisioni Qendror për standardizimin e emërvendeve të Kosovës*, në fillimvitet e shekullit tonë, dhe kështu iu përveshëm studimit të kësaj lënde në rrafshin sinkronik në shkallë të shqipes globale, përkatësisht në suazat e gjedheve formëzuese e fjalëformuese të tyre, në kuadër të sistemit të përgjithshëm emërformues të shqipes së sotme. Përpjekja jonë e parë për trajtimin e kësaj teme që botuar në gazetën Rilindja (2001) në 11 vazhdime, por që këtu po atë përpjekje paksa të rishikuar e dhamë si pjesë të dytë.

Në të vërtetë, punimi ynë në këtë vepër me titull **Çështje të shqipes standarde rreth vendbanimeve** del më i plotë, ngase i është shtuar pjesa e parë me titull “**Çështje problemore të imponuara aktuale rreth formëzimit të vendbanimeve në gjuhën shqipe**” dhe me pjesën e dytë me titull: “**Çështje rreth formëzimit dhe fjalëformimit të emërtimeve të vendbanimeve në gjuhën shqipe – me theks emërtimet e propozuara në Kosovë**”, ku, siç u tha është punimi i vitit 2001, por pak a shumë i përpunuar.

Sidoqoftë, në të dy pjesët prezantohet material i dokumentueshëm aktual me plot risime, i cili edhe mund të përpunohet edhe më në hollësi e thellësi, qoftë përmbajtjesisht, qoftë stilistikisht.

Ne, këtu po shënojmë diçka nga të të dyja pjesët e kësaj lënda, veç e veç që na merr mendja se ia vlen të rikthekohet ose të rikujtohet. Tash po fillojmë me të dhëna nga *Pjesa e parë* dhe pastaj edhe nga *Pjesa e dytë*.

### a) Nga pjesa e parë

Pjesën e parë me titull: *Çështje problemore rreth formëzimit të imponuara nga traditat të vendbanimeve në gjuhën shqipe për hir të përmbajtjes e ndamë në dy nënpjesë:*

(I) Në nënpjesën e parë paraqitem konstatime rreth oikonimeve nga tri vatra gjalluese aktuale:

1. Konstatime problemore nga Kosova,
2. Konstatime problemore nga Shqipria dhe
3. Konstatime gjithandej nga Trojet e tjera shqiptare.

Siç u konstatua, ndërsa në Kosovë, fill pas Çlirimit, në vitet e para të këtij shekulli është bërë një përpjekje institucionale për zbutjen ose zgjidhjen, përkatësisht për standardizimin e emërtimeve të vendbanimeve, në Shqipri në këtë periudhë pati vetëm fjalë dhe asnjë ndërmarrje konkrete institucionale, përkundrazi pati ndonjë korigjim ose rikthim i disa emrav e të mëparshëm të vendbanimeve të pakicës maqedone (!), ndërsa në trojet shqiptare gjithandej jashtë këtyre dy shteteve shqiptare, duke shfrytëzuar lirinë e të shprehurit, më tepër ka thirrje e sugjerime por edhe paraqitje problemesh të kësaj natyre dhe asgjë më shumë.

Me fjalë të tjera në botën shqiptare çështja e emërtimeve të vendbanimeve mbetet çështje e hapur dhe mjerisht mund të thuhet se ende është në fazën e konstatimeve pa ndonjë ndërmarrje sado të vogël institucionale të sukseshme për zgjidhje konkrete të saj.

(II) Në nënpjesën e dytë, sollën 6 burime–dokumenta, ku dalin të shënuara oikonimet, nga trevat e gjallimit të shqiptarëve:

- a) qoftë në Shqipëri),
- b) qoftë në Kosovë ose
- c) gjithandej Trojeve të tjera shqiptare.

Në vijim për secilin nga burim-dokumentat, veç e veç, sipas përparësisë së publikimit kohor, po japim ndonjë veçori me interes.

1) Dokument-prova e parë ka titullin *Lista për ndryshimin e disa emërtimeve të vendbanimeve e të papërshtatshme në Shqipni 1938*. Një ndërmarrje e tillë nga Qeveria e atëhershme e Mbretnisë shqiptare lypset



përsëndetur, por ç'është e vërteta, ajo nuk mundi të implementohej për shkak të Luftës së Dytë Botërore. Thamë *lypset përshëndetur* sepse qëllimi ishte që populli ynë, administrata shqipe të çlirohej nga pushtimi shpirtëror që kishte mbetur nga emërtimet e vendbanimeve me përmbajtje të gjuhëve të huaja, zakonisht sllave e greke. Kështu Qeveria e Mbretit Zog në mënyrë të organizuar institucionalisht, edhe pse pak me vonesë, sipas nesh, por ndoshta vetëm atëherë e ndjente veten se ishin pjekur kushtet e brendshme e të jashtme konsoliduese, ndërmoi atë punë të mbarë për të *ndryshue të gjitha emërtimet e papërshtatshme të mbetura nga regjimet e mëparshme sllave e greke*, por mjerisht në Shqipërinë e pas LDB nuk u vazhdua më tej.

Ne edhe pse nuk e patëm në dorë tërë materialin, aq sa e patëm e kemi konsultuar, sidomos nga aspekti formëzues e fjalëformues.

2) Është interesant që dy vjet pas okupimit të Shqipërisë nga Italia fashiste, përkatësisht pas themelimit të ashtuquajturës *Mbretëria Italo-Shqiptare* dhe bashkangjijtes së disa viseve shqiptare asaj Mbretërie, siç ishte Kosova me pjesë të Maqedonisë e të Malit të Zi, Qeveria e asaj Mbretërie në vitin 1942 hartoi dokumentin: *Lista e toponimeve (sllave) në territoret e lirue me shqiptare me shqipërimet e propozuara*, mirëpo edhe kjo fushatë institucionale për ndryshimin e emërtimeve sllave në tokat e lirue mbeti gjithashtu vetëm si përpjekje, sepse po ato vise pas Luftës II Botërore sërish mbeten nën okupim po nga shteti i mëparshëm, tash Jugosllavisë II.

3) Siç dihet në Shqipëri, pas LDB regjimi komunist 1944-1992 lidhur me ndryshimin e vendbanimeve vazhdoi kryesisht me shfuqëzimin e vendimit nga Qeveria e Zogut rreth ndërrimit të emërtimeve të vendbanimeve mbi bazë sllave, ngase tash kjo Qeveri fillimisht ishte e lidhur ngushtë me Qeverinë Jugosllave, e cila, siç u cek, i rifuti nën sundim të gjitha ato "*Toka të Lirue*", për të cilat qe propozuar shqipërimi i emërtimeve përkatëse sllave.

Ç'është e vërteta nga sa u tha nuk do të thotë se në Shtetin shqiptar 1944-1992 nuk janë bërë fare ndryshime të emërtimeve vendbanimesh, ngase, siç shihet nga dokument-prova e tretë me *titull Fjalor i emrave gjeografikë të RSH* (2002 në Shqipëri ne periudhën e sundimit komunist qenë ndryshuar zyrtarisht mbi 200 emërtime vendbanimesh, por ato ndryshime ishin bërë më tepër nga aspekti politik klasor. Lypset theksuar se emërtimet e tilla, pos ndonjë rasti, gati të gjitha mbetën në përdorim normal. Dhe ky fakt, flet për një konsolidim të administratës shtetërore shqiptare gjatë atij regjimi, apo jo?

4) Dokument-prova që na motivoi më tepër për t'u marrë me trajtimin e kësaj çështjeje është *Regjistri i standardizuar i emërvendeve të Kosovës* ose *Regjistri i Komisionit Qendror për standardizimin e venbanimeve të Kosovës*, ku për të parën herë, në mënyrë institucionale u tentua për ndryshimet e domosdoshme në raport shqipe/sllavisht, por edhe kjo ndërmarrje për arsye të gjendjes jostabile politike, përkatësisht meqë Kosova gjendej, siç gjendet edhe sot, pothuaj, nën survejimin ndërkombëtar, Regjistri i tillë as që u v u në rend dite me u diskutue nga organet kompetente vendimmarrëse të Kosovës, mirëpo kjo nuk do të thotë se një punë e tillë ka mbetur si një ndërmarrje e dështuar, si një punë Sizifi për Komisionin, apo jo?!

5) Ne, edhe pse sipas Regjisrit të Komisionit Qendror (nën pikën 4) e patëm konsultuar edhe versionin serbisht zyrtar të emërtimeve zyrtare të asokohshëm të Kosovës, megjithatë, pasi serbishtja mbeti gjuhë zyrtare në Kosovë edhe pas Luftës së fundit (UÇK) 1999, e morëm në trajtim edhe versionin tjetër më të ri të ndryshuar nga organizmat e shtetit të Serbisë së sotme, me titull *Okruzi, gradovi i sela Kosova i Metohije (Qarqet, qytetet dhe fshatrat e KM-së)*, botim i Beogradit, /internet/ 2015. Nga ky dokument lidhur me temën tonë hetuam disa ndryshime, siç ishte ndarja e vendbanimeve sipas qarqeve, pastaj, vërejtëm edhe disa ndryshime gjuhësore-drejtskrimore në vetë tekstin e serbishtes. Veneruam edhe disa çështje të tjera sidomos në raportin shqip/serbisht, të cilat duhen pasur parasysh në trajtimet e sotme dhe vijuese.

6) Vetë natyra e trajtimit të çështjes na imponoi që të konsultonim edhe dokumentin aktual zyrtar **Regjistrin e Emërtimeve të Vendbanimeve të Kosovës** sipas ndarjes së re administrative të Kosovës, duke konstatuar risimet e ndryshimet rreth ndarjes në qarqe, komuna (të reja) dhe risistemimin e fshatrave nëpër komuna etj. Me sa pamë ky Regjistër, i cili nuk përkon as me Regjistrin e Komisionit (2004), as me atë të versionit serbisht 2001-2015, është hartuar në tri gjuhë: *shqip serbisht anglisht*. Ne dhamë konstatimet tona edhe lidhur me këtë regjistër trigjuhësh që ende është në fuqi, dhe pse ka mjaft gjëra të diskutueshme.

Nga përmbyllja e dy nënpjesve të pjesës së parë del se krejt lënda e trajtuar në këtë pjesë të këtij punimi u bë me qëllim që të njihet opinioni shqiptar e më gjerë me çështjet e hapura nga kjo fushë dhe si përfundim konstatuam që popullsia shqiptare përherë ka ndierë nevojë dhe ka bërë përpjekje për të zëvendësuar emërtimet me prejardhje të huaj me emra më të përshtatshëm, por institucionalisht një ndërmarrje e tillë përherë ka dështuar,

për arsye objektive, madje edhe subjektive. Me thënë të drejtën, siç kanë dështuar përpjekjet e deritashme është drojë që ky dështim të vazhdojë si në Kosovë, ashtu edhe në Shqipëri tash më tepër për shkaqe subjektive, sepse si duket edhe Kosova e mbase edhe Shqipëriaë jo pse ende përfaqësohen me organe të shkrufta, jo aq të zonja shtetëtoe, por edhe për mungesë të sistemit studimor, nga orgsanizmat në institucionet tona përkatëse, apo jo?!

Është e vërtetë që organet ekzekutive shtetëtoe në Shqipëri e Kosovë, në këto dy shtete deklarativisht të pavarura përherë ndejnë rrezik politik nga vetvetja. dhe për shkak të ndihmës së pamjaftueshme shkencore nga institucioneve kulturore të pavarura përkatëse shtetëtoe, të cilat nuk po mund të konsolidohen dot, për të shëruar vendin edhe nga për shumë gjëra të tjera, por nga çështje, ku bën pjesë edhe problematika e emërtimeve toponimike me prejardhje të huaj. Është e vërtetë se pikërisht shtetet fqinje për këtë pikë dalin më të konsoliduara, ngase Serbia, Greqia, deri edhe Mali i Zi e Maqedonia, këtë çështje e kanë rregulluar më herët, që nga arritja e pavarësisë së tyre. Ndërkaq, gjejnë shkas që emërtimet ende të pandryshuara në trojet shqiptare t'i shfrytëzojnë për të mbajtur gjallë oreksin për gllabërimin e tokave tona dhe për një ekspansion të tillë, sidomos Serbia e Greqia po e intesifikojnë propagandën makiaveliste (naçërtiniane e megaliideane), me theks për të drejtën gjoja historike ndaj këtyre trojeve, duke shfrytëzuar pikërisht emërtimet e tilla dhe si duket po i survejojnë edhe elementët e popullsisve minoritare si dhe të pakënaqurit vendës brenda tokave të shtetit përkatës shqiptar për moslejimin e ndryshimit të emërtimeve të tilla. Prandaj edhe në këtë situatë ka zëra nga qytetarët minoritarë e shqiptarë të tjerë të frustruar në një rën anë që *s'lejojnë* ndryshimet e tilla *historike*, por në anën tjetër ka zëra gjithnjë në rritje banorësh e intelektualësh, të cilët shprehen gjithnjë e më haptas kërkesën për ndryshime ose zëvendësimin e tyre domodo, si masë e vetëmbrojtjes kombëtare për mos me u lënë vend orekseve grabitçare të huaja.

Dhe së këtejmi, siç del nga shumica e diskutuesve dhe reaguesve shqiptarë mendohet se me kthimin e emërtimeve të vjetra shqipe ose me krijimin e emërtimeve të reja më të përshtatshme do të ndihmohej çështja e konsolidimit të pushtetit të vet popullor shqiptar dhe njëherazi do të vinte duke u zbehur oreksi i qarqeve pushtuese nga fqinjët (serbë e grekë), oreks ky që edhe do të shuhej tërësisht, prandaj në këtë kontekst ne shfrytëzuam aktualisht disa nga reagimet me kërkesat në rritje bashkë me propozimet konkrete, duke i vlerësuar pozitivisht si nga pikëpamja përmbajtësore e më fort nga ajo formëzuese-fjalëformuese, andaj edhe shtruam nevojën e një

analize të tillë të gjedheve emërformuese të strukturës të formimit të vndbanimeve në gjuhën shqipe, siç do të trajtohet më në hollësi në pjesën e dytë të kësaj vepre.

## **b) Nga pjesa e dytë**

Pjesa e dytë e veprës edhe pse i kushtohet më fort fjalëformimit të vndbanimeve, duke respektuar analizën fillimishte të vitit 2001 edhe këtu përmbajtja fillon me analizë të veprës së Komisionit Qendror botuar në gazetën Rilindja, me titull: *“Regjistër i vndbanimeve të propozuara 2000”*, punim ky që e pata botuar me 2001 në 11 vazhdime, mirëpo tash i rilexuar dhe i pajisur sadokudo edhe me të dhëna të reja, qoftë të marra nga përvoja por edhe nga dokument-materialet e trajtuara në nënpjesën e dytë të pjesës së parë, andaj këtu vazhdohet me sforcimin e punimit të njëjtë të vitit 2001, duke shpresuar që kjo punë e përforcuar do të vlerësohet nga opinioni dhe studiuesit si një ndihmesë jona në vazhdë të të kuptuarit dhe të zgjidhjes së këtij problemi.

Në të vërtetë, përpjekja jonë kryesore si atëherë edhe tash, është për të nxjerrë të pah prirjet ose modelet më të përkapshme fjalëformuese të emërtimeve të vndbanimeve në gjuhën shqipe. Dhe për të arritur në një rezultat të tillë, morëm nëpërdur temat prodhuese dhe të gjitha afikset kryesore emërformuese të shqipes dhe përveç dallimit të afikseve të specifikuar vumë re edhe mënyrën fjalëformuese të emërtimeve në shqyrtim në fjalë të përbëra dhe në mënyrë perifrastike.

Sidoqë të jetë, ne jemi përpjekur që punën ta kryejmë me përkushtim. Është e vërtetë se fillim e mbarim punimin e përshkojnë risime, të cilat besojmë se do t’u shërbejnë studiuesve të sotëm dhe të ardhshëm që kjo çështje rreth emërtimeve oikonomike në proces e sipër, jo vetëm të njihet më mirë, por edhe të trajtohet e të zgjidhet në mënyrë sa më profesionale pragmatikisht e shkencërisht.

Dhe kështu, pastaj vazhduam me trajtimin e formimeve me prapashtesa të caktuara gjithsesi të pranishme në gjuhën tonë.

Ç’është e drejta, ne përveç formimeve me pandashtesim dhe me kompozim vend më të madh u dhamë formimeve të vndbanimeve me prapashtesim:

1) Në emërtimet me origjinë sllave trajtuam rastet me 7 prapashtesa përkatëse: a) *-ica, ,viqi,, -ovac/-ovci, -ovo/-ova evo/-eva e avo/-ava*, b) me origjinë greke: *-ot e –os* dhe c) me prejardhje turke: *-a/xhi, a/li e –ije*, duke konstatuar, se pothuaj, të gjitha këto dalin të diskutueshme për gjuhën tonë.

2) me prapashtesa vendëse, të përvetësuara edhe për këtë nënfushë semantike, edhe pse nuk rekomandohen aq, por edhe nuk qortohen, ku u trajtuam 5 prapashesat e kësaj natyre: *–ishtë, -nik, -inë* dhe *-ore e -tore*;

3) me prapashtesat e përvetësuara për koncepte nga veprimtaria e njeriut, të patronimeve me *–aj* dhe etnonimeve me : *–as, -an, -ak*;

4) me prapashtesat e specifikuar për emërtimin e njerëzve sipas profesioneve: *–ës, -tar e –ar* dhe *–or*;

5) me prapashtesat e specifikuar për veprimtari të tjera semantike si:

a) për emërtimin e veglave dhe mjeteve të punës si: *–se, ue/s, -ore, -zë, -ar, -are etj.*

b) për emërtimin e koncepteve abstrakte vetjakë (të modës) me *–I, –IM etj.* dhe *-OJË* të emrave prejpjesorë,

c) me prapashtesat emocionale e zvogëluese: *ush/ushë, -osh, -OZ* dhe *–TH e –ëz/zë*,

6) me prapashtesat e siprapashtesat me prirje specifike (specializimi) për nënfushën e emërtimit të vendbanimeve: me *–AJË, –ISHT, –SH/-ASH e –ESH, –ET e –AT; –ARË, -ANË* dhe *-i/ONË*.

Po shtojmë edhe këtë që në të ardhmen gjithsesi, me rastin e rishqyrtimit të çështjes së emërtimit të vendbanimeve duhet të jetë i dëgjuar dhe i respektuar edhe zëri i masës së gjerë, sidomos i vetë banorëve të vetëdijësuar rreth përfundimeve të emërvendeve përkatëse, ashtu si edhe arsyetimi përkatës, qoftë nga specialistët (anëtarët e komisioneve të studimeve të tjerë), qoftë nga organizmat zyrtarë shtetërorë, të cilët duhet të jenë në nivel të detyrës.

Me fjalë të tjera mendimet rreth propozimeve përkatëse **për ndryshim ose jo të emërtimit përkatës**, gjithsesi duhet të jenë të hamonizuara me propozimet e fshatrave, të bashkësive e këshillave komunale, në njërin anë, si dhe natyrisht edhe me mendimin e Komisionit Qendror, në anën tjetër, i cili përfundimisht do të bashkëpunojë me organizmat kompetentë vendimmarrës në shkallë shteti, por më madhore duhet të jetë interesi i shtetit dhe sidomos i institucioneve të bashkësisë shoqërore kombëtare e mbarëkombëtare.



## Rezyme ose komenti ynë përmbyllës

Në këtë përmbyllje-rezyme fillimisht po sjellim një pjesë teksti nga ballina:

*...Mosndryshimi i një numri enorm të emërtimeve të vendbanimeve në trojet aktuale e historike shqiptare me prejardhje të huaj disa të mbetura që nga lashtësia (kryesisht të imponuara me intrigancë nga pushtuesit sllavë e grekë) konsiderohet:*

- 1) si një shenjë e kulturës së lashtë toleruese shqiptare,
- 2) si një mentalitet përulësie kohësisht i thadruar thellë në shprehi,
- 3) si një moszotësi zgjidhjeje konceptore të institucioneve tona të deritashme të larta kombëtare shtetërore.

apo

- 4) si një reflektim i stërmoshuar i shndërruar kohësisht në funksion të një vlere normale simbioze tashmë të patjetërsueshme toponimike?

*Krejt këto katër versione dhe ndonjë tjetër përftuese le të vlerësohen e komentohen. Ne, në këtë vepër “Çështje të shqipes standarde rreth vendbanimeve”, jemi përpjekur, jo aq që këtë problematikë t’ia bëjmë sa më transparente opinionit ose të sfidojmë për zgjidhje institucionet tona kompetente studimore e vendimmarrëse, sa ta trajtojmë lëndën, sa më gjithanshëm e në hollësi nga ana e fjalëformimit.*

*Sidoqoftë, lexim e meditim, me tolerancë, duresë e shpresë të trashëguar!*

Sigurisht, lexuesi i vëmendshëm tashmë i ka të ravijëzuara përshtypjet, por ndër to edhe mund t’i kenë mbetur edhe gjëra jo plotësisht të qarta, ngase ashtu shprehjet e tilla natyra e lëndës na i ka imponuar. Sidoqoftë, ja tashti do të themi diçka çfarë kuptojmë me shprehjen meditative përfundimtare nga ballina:

*... me duresë e shpresë të trashëguar?!*

Po sqarojmë:

E para, fjala “**duresë**” këtu është përdorur me kuptimësi të termit teknik: “*kufi i lejueshëm i shmangies nga normat teknike për përgatitjen e diçkaje*” (FGJSH 2006, f. 223), dhe

E dyta, togfjalëshi “**shpresë e trashëguar**” do të thotë, **jo shpresë e vrarë nga mosbesimi**, edhe pse kemi të bëjmë me një **duresë** (të trashëguar jo me dëshirë) **rreth zgjidhjes** që sipas kuptimit terminologjik, nuk lejohet, assesi me kalue në **rutinë**, me pritje të mbështjellë si një lëmsh durimi me **fije të këputura dyshimi, apo jo?!**

Sido që të jetë, ne në punimin tonë nuk shprehim aq zhgënjim, ngase kemi bindje të plotë se populli ynë, gjuha shqipe, prej se e mbaj mend, kurr nuk ishte në gjendje më të mirë se sot dhe i mëshoj të vërtetës se momentalisht është dhe do të jetë në përparim të pandalshëm dhe si rrjedhojë kemi bindje se gjatë gjysmës së parë të këtij shekulli, që po kalojmë në këtë fill mijëvjeçari, kombi dhe gjuha jonë do ta marrë veten plotësisht, edhe pse duket aktualisht se ka hutesa e keqkuptime, qoftë nga mosdija e trashëguar apo mosnjohja punë e prijësve të qarqeve përgjegjëse të kombit.

Sidoqoftë, parashikohet që tash e mbrapa me pasë jo vetëm ecje më të mbarë kombëtare, por edhe kurorëzim idealesh, me mundësi për të zgjidhur të gjitha çështjet madhore edhe ato paksa të deritashme të ngecura, siç është edhe konsolidimi i brendshëm i zhvillimit global i kombit dhe gjuhës dhe në këtë kuadër edhe konsolidimi dhe përmirësimi standardit kombëtar, ku veç tjerash edhe çështja e emërformimit në përgjithësi si dhe ajo e emërtimeve të vendbanimeve nga pikëpamja formëzuese e fjalëformuese në veçanti do të gjejë zgjidhje në shkallë globale. Dhe vërtet, kjo nuk do të jetë utopi, nëse punohet me ndërgjegje dhe pa u lodhur, duke besuar në ambientin e ofruar që sipas fjalës popullore tashmë *vera na ka ardhë kah dera*, nëse vërtetë dimë ta gëzojmë duke vazhduar punën me mirëkuptim e vullnet të palëkundur pa e shuar dritën e ngrohësinë çdostinore që po na ofrohet brenda nënqiellit e kohëhapësirës tash jomohuese të historisë të kombit tonë.

Së këndejmi, ne, në këtë vepër konstatojmë se emërtimet e vendbanimeve si çështje e shqipes standarde ishte dhe mbetet çështje e hapur, edhe pse jo njësoj, në të gjitha trojet shqiptare. Më lehtëzgjidhje mendohet se ka, së paku në Shqipri e Kosovë, çka mosveprimi në këtë drejtim na sjell zhgënjim. Por krahas zhgënjimit aktual gëzon fakti se kur është fjala sidomos tek emërtimet e trashëguara të imponuara, kryesisht me



prejardhje sllave e greke, shihet një lëvizje e drejtë premtuese jo vetëm nga masa, por edhe studiuesit e punëtorët shoqëroro-politikë, të cilët gjithnjë e më shumë janë duke u njohur shkencërisht me këtë problematikë shumë të mprehtë kombëtare dhe jo pak të ndërlikuar, ngase vetë njohja me problemin është kushti i parë themelor edhe për gjetjen e marrjen e masave për zgjidhjen e tij në atmosferën e *ditëveverës* që na u shfaq freskueshëm dhe që ende po qëndron në verandën e shtëpisë sonë gjuhësore apo në shtratin jetësor të përbashkët të të folmeve tona pa vijë të zezë kufindarëse. Kjo është shpresë e besim për arritje qëllimi.

Ç'është e vërteta, sot për sot, mesa pamë, për zgjidhjen e emërtimeve të papërshtatshme të trashëguara nga e kaluara të karakterit politik në dy shtetet t'i quajmë të pavarura shqiptare Shqipëri e Kosovë, për arsye e specifika të ndryshme ka mbetur ende çështje e hapur, por që ka baza për zgjidhje reale logjike nga faktorët tanë përkatës, pa fërkime të mëdha politike.

Nga trajtimi që iu bë kësaj teme në këtë vepër kuptohet se nga individë të caktuar, lidhur me këtë problematikë janë shprehur opsione të ndryshme, ndër të cilat po dallojmë:

E para, edhe pse shprehen mendime mbase edhe me tendencë, që çështja e emërtimeve të tilla sllave e greke mos të hapet fare, ngase ato janë emërtime të trashëguara nga lashtësia që tashmë disa a shumica mund të konsiderohen si pjesë e fondit aktiv të fjalësit të gjuhës sonë (!), mirëpo edhe nëse duam të heshtim, kjo çështje s'mund të mbahet në hije ose si e paqenë, sepse janë faktorë jo të këndshëm të jashtën e të brendshëm ata që po e ngacmojnë vazhdimisht këtë plagë të trashëguar, andaj si të tilla emërtimet në fjalë po imponohen gjithnjë e më me ngacmime patologjike, ngase numri i konsiderueshëm i tyre në jetën reale po keqpërdoret nga të huajt, siç është keqpërdorur edhe më përpara, madje e shoqëruar me një propagandë të fuqishme makiaveliste ekspansioniste antishqiptare. Së këtejmi, kërkohet herë-herë madje edhe euforikisht që ato emërtime të flakën masivisht, duke i zëvendësuar menjëhershëmrisht me fjalë të përshtatshme shqipe. Dhe si mbështetje ceket e vërteta se kështu kanë vepruar edhe shtetet e tjera fill pas mëvetësisë së tyre, qoftë nga pushtuesit, qoftë nga sundimi kolonial ose nga vetëdija e arrirë iluministe shtetërore e kombëtare e tyre.

E dyta, meqë kjo temë assesi nuk mund të konsiderohet e mbyllur, atëherë në shkallë shtetërore dhe kombëtare, patjetër kjo lëndë lypset trajtuar me seriozitetin e duhur, pa bujë, pa eufori, pa politizime të parakohshme. Gjithsesi paraprakisht para se të vendoset diçka lypset vlerësuar si ana politiko-shoqërore, por edhe ajo gjuhësore fjalëformuese, sepse kjo çështje, e dyta, në gjendjen e sotme në kuadër të problemit global të gjuhës shqipe patjetër kërkon ta ketë hisen e vet. Duhet ta kemi të qartë se ky problem nuk prek aspektin individual, grupor lokal, sa prek anën politiko-shoqërore, ndërshtetërore, kombëtare e ndërkombëtare, po aq sa prek, sipas nesh, edhe në anën gjuhësore.

E treta, ndonjë zgjidhje e veçantë as që paraqet farë problemi. Kështu ndonjë emërtim i tillë tejet i papështatshëm, si e drejtë universale, mund të ndryshohet në bazë të propozimit të organizmit të pushtetit lokal (komunal), natyrisht pas lejes që jepet nga pushteti qendror, dhe kjo vetëm nëse situata dhe rrethanat pilitike lejojnë, pa politizime të nxehta, apo jo?

E katërta, nëse shteti ndjehet politikisht i stabilizuar në çdo pikëpamje, atëherë nuk e ka vështirë që edhe këtë çështje ta zgjidhë pa shkaktuar kurrfarë rrjedhoshash, por rendi kërkon që kjo zgjidhje të bëhet pas studimit të gjithanshëm duke përfshirë edhe aspektin formëzues e fjalëformues gjuhësor. Gjithsesi duhet vepruar me rreptësi shkencore, objektivitet, panshmëri e paluhatshmëri pa e cenuar të drejtën e askujt, por patjetër duhet përgënjeshtuar maskat e propagandës makieveliste e megaliaideiste, që në rutinë, pa të drejtë, me tendencë propagandistike jopaqësore po e ndyjnë atmosferën e mirëkuptimit midis popujve liridashës, apo jo?

Në të vërtetë, ne repektojmë të gjitha këto opsione dhe të tjera, sedomos kur kanë për mbështetje elemente të qëndrueshme. Gjithsesi duhet të nxiren dhe vlerësohen anët pozitive nga përpjekjet e caktuara të deritashme nga e kaluara e historisë sonë, qoftë nga individët, qoftë nga grupet a komisionet e caktuara që dihen, në shkallë shoqërore a shtetërore, duke filluar nga KLSH (1917), ku bëhet fjalë për emrat e fshatrave të Grykës së Madhe dhe Grykës së Vogël (Dibër), pastaj nga Qeveria shqiptare e vitit 1937-1938, ku u zëvendësuan por nuk zbatuan për shkaqe objektive shumica e emrave të papërshtatshëm në tërë territorin Shqipërinë Londineze, nga Komisioni qeveritar i MISH, i vitit 1942, ku bëhet fjalë për shqipërimin e emrave sllavë nga viset shqiptare që iu ribashkuan Shqipërisë (amë), pastaj duhet hulumtuar edhe rreth punës së komisioneve të qeverisë komuniste në Shqipëri (1944-1992), ku domosdo do të kenë ekzistuar komisione, ngase

ndryshimi i qindra emërtimeve të vendbanimeve mbase nuk do të jetë bërë pa ndonjë plan-program të caktuar nga organizmat përkatës shtetërore të asaj periudhe, prandaj presim nga studiuesit, sidomos nga Shqipëria që në bazë të dokumentacionit ekzistues dhe kujtesës së gjallë të zbardhet si duhet edhe kjo periudhë ndryshimesh. Por në mënyrë të veçantë përshëndesim punën e Komisionit të Prishtinës 1999-2005, madje besojmë se edhe në të gjitha trevat shqiptare në vendet fqinje ku jetojnë shqiptarët autoktonë kjo çështje jo vetëm do të jetë diskutuar e trajtuar nga individë, grupe ose komisione intelektualësh, por mund të jenë bërë studime si dhe do të jenë dhënë edhe propozime për ndryshime (Maqedoni, Preshevë e Mal të Zi), apo jo?!

Së këtejmi, po vazhdojmë të shprehim opinionin tonë që ka të bëjë me çështje të fjalëformimit të kësaj fushe semantike, temë kjo që siç e pamë nuk ka mbetur pa u trajtuar nga individë e komisione, por me shikue realisht nuk kemi hasur në punime të veçanta nergut për këtë temë. Ne, momentalisht e riansyetojmë opininon tonë me faktin se pasi është e mundur ose priten ndryshime të ndryshimit të emrave të papërshtatshëm, duke filluar nga pushteti lokal e më gjerë në atë rajonal e më lartë në të gjitha trojet shqiptare, atëherë domosdo studiuesit duhet ta shfrytëzojnë këtë fazë vakuumi dhe ta bëjnë atë që është e mundshme dhe duhet ta bëjnë: **të çohet më tej studimi i përshtatshmërisë fjalëformuese të të gjitha llojeve të emërvendeve në Shqipëri e Kosovë si dhe në trevat e tjera shqiptare.** Pra studimi duhet bërë jo vetëm nga aspekti etimologjik e historik, por me theks të veçantë edhe në aspektin formëzues fjalëformues. Kjo punë në plan kombëtar është veprim i mundshëm dhe në asnjë mënyrë sot për sot nuk mund të quhet i pengueshëm, andaj duhet me u zbatue nga kuadri i specializuar akademik, i cili duhet të jetë i përgatitur për t'u ballafaquar me zgjidhjen fjalëformuese të këtij problemi kaq të madh brendagjuhësor me interes kombëtar e ndërkombëtar.

Në këtë drejtim, siç mund të shihet nga përmbajtja e kësaj vepre, jemi përpjekur ta japim ndihmesën tonë. Po a mjafton kjo? Përgjigjja është: **jo.** Duhet kuptuar se kjo çështje nuk është punë individësh po institucionesh studimore e shoqërore politike shtetërore, edhe pse roli i individëve, nismat e mbara nuk duhet përçmuar.

E shohim të asyeshme që në këtë rezyme të rikujtojmë risimet nga studimet e veçanta tona të cekura në hyrje të pjesës së parë të kësaj vepre, ku veç tjerash u ngulmua rreth respektimit të specifikimit ose specializimit të afikseve (prapashtesave autoktone) për disa nënfusha përkatëse

semantike, brenda strukturës emërformuese në kuadër të sistemit fjalëformues të gjuhës shqipe, si b.f.:

- 1) **-tar, -ar, -ës** dhe **-an** (*huazimet me -ik/ë fundore*)– të specifikuar për emërtimin e njerëzve sipas profesionit a veprimtarisë,
- 2) **-as, -j/an** - pothuaj të specializuara për emërtimin e njerëzve sipas vendbanimit a prejardhjes,
- 3) **-or, -ore, -(ë)s, (ë)se, -cë, -urina** etj. - shumë praktike për emërtimin e gjë-sendeve ose të mjeteve konkrete të punës,
- 4) **-tore** – me prirje specializimi për emërtimin e vendshërbesave, lokaleve të punës etj.
- 5) **-i, -si, -shmëri, të + pjesore +t-** praktikisht shquhen në përdorim për nocione abstrakte.
- 6) **-aj** – e specializuar kryesisht, për emërtimin e patronimeve,
- 7) **-atore, -eshë** dhe **-e** - praktikisht të njohura për emërtimin e grave sipas veprimtarisë etj., ndërkaq po shtojmë edhe
- 8) **-ajë, -isht, -sh/-ç, -ash, esh; -et, -at; -arë, -anë, -i/onë** – me prirje specializimi për formimin e vendbanimeve, ndihmesë që del si rezultat i këtij pinimi.

Po përsërisim, pra, strukturës fjalëformuese me prapashtesat e specifikuar të sistemit emëror të gjuhës shqipe ia shtuam një pajisje të re, pajisjen me teknologji digjitale me komponentet (formantet) për prodhimin serik të emërtimeve të vendbanimeve. Me fjalë të tjera: *nga teknologjia fjalëformuese makinerike i shqipes konstatuam si shtesë edhe një pajisje speciale plus me copëza veglërie të specifikuar për prodhimin serik të kampionave të caktuar gjuhësorë rreth emërtimit të vendbanimeve, apo jo?*

Ne, këtë mënyrë fjalëformimi duke nxjerrë në pah afikset e specifikuar me prirje specializimi e quajmë tejet të domosdoshme dhe të dobishme për zhvillimin, pasurimin dhe konsolidimin jo vetëm të gjuhës sonë të shkruar, por edhe të asaj të folur dhe në veçanti, e konsiderojmë begati për standardin, andaj kërkojmë nga inteketualët tanë, gramatikanët, mësuesit, e nga kush jo, që këto rregulla t'i vlerësojnë, t'i respektojnë vetë dhe të kërkojnë nga të tjerët t'i përqafojnë e zbatojnë, kur ua imponon konteksti.

Sidoqoftë, t'i kthehemi së fundi problemit të pazgjidhur të zëvendësimit të emërtimeve të vendbanimeve të huaja sllave e greke e të tjera, që janë të pranishme në toponiminë e trojeve shqiptare. Gjithsesi duke

e pasur parasysh gjendjen e sotme, në veçanti gjendjen gjuhësore fjalëformuese, deri tash jo aq të gatuar sa duhet, edhe pse nuk i shohim të qortueshme propozimet për ndryshimin masiv të emërtimeve të tilla të huaja të papërshtatshme

Mirëpo tash për tash, nuk e shohim se është më kryesorja e punës që me nxitim euforikisht pa ekspertizë të bëhet zëvendësimi me çdo kusht i tyre me ndonjë trajtë çfarëdo vetëm të jetë shqipe, apo jo, ngase, tekembramja, shikuar nga një aspekt tjetër asnjë zëvendësim me ngutje e pa kohë nuk mund të jetë aq i rëndësishëm sa ka rëndësi shpjegimi me kompetencë shkencore i të vërtetës historike, me të cilën vërtetohet se disa nga mbetjet e tilla fosilizuese janë, si me thënë, formime thjeshtë shqipe ose të përbashkëta ndërgjuhësore, ngase edhe shpjegimi i së vërtetës shkencore simbiozore të përbashkëta shqiptaro-sllave (serbe) a shqiptaro-greke e anasjelltas, i emërtimeve me fakte të qëndrueshme pa ndërje fare kompleks inferioriteti, atyre, **makiavelistëve** e **mageliaideistëve** ekspansionistë që mendojnë se gjoja emërtimet e tilla janë krijesa të pastra vetëm të gjuhëve të tyre, u kthehet bumerangë mbi kokat e tyre ende të droguara nga nacionalizmi i konsumuar e shovenizmi i trashëguar i ushqyer me gënjeshtër, sepse vetë ndryshim-shqiptimi i emrave të tillë i ndryshuar në gojën e shqiptarëve gjatë një periudhe të gjatë tregon mjaft qartë këtë bashkëjetësim krijues, apo jo?!

Së fundi me këtë që e thamë, njëherazi nuk përjashtohet përpjekja me seriozitetin e duhur që edhe zgjidhja terminologjike me terma të rij të bëhet ndërkohë sipas fuqizimit normal të anës formale gjuhësore, duke u mbështetur në gjetjen e ligjeve specifikuere fjalëformuese të shqipes nga profesionistët, siç u përpoqëm të bëjmë edhe ne.

Së këtëjmi, vështruar nga ana formëzuese dhe fjalëformuese sipas dokumentacionit pas konsultimit të materialit jopak voluminoz të grumbulluar të emërtimeve të tilla në kohëhapësirë, të cilët (shembujt nga materiali) u përpoqëm edhe me i seleksionue e studiue sipas kriterëve të caktuara, andaj, ftojmë intelektualët tanë në radhë të parë studiuesit e standardologët e pjekur, që duke pasur parasysh aktualitetin dhe të ardhmen të ndihmojnë me dijeni praktike e teorike, me organizime simpoziumesh e tubime të tjera. që edhe zgjidhja e kësaj çështjeje të emërvendeve të ecën mbarë dhe të kurorëzohet me sukses.

Me fjalë të tjera, vetëm pas përgatitjeve solide edhe rreth **formëzimit dhe fjalëformimit të emërtimeve të vendbanimeve në gjuhën shqipe**, varësisht nga ngritja e rrethit përkatës mund të kërkohen ose

propozohen edhe ndryshimet e emërtimeve konkrete dhe që një shumicë prej tyre gjithsesi duhet t'i shtrohen ri/vlerësimit, qoftë edhe procesit të zëvendësimit me emra më të pranueshëm dhe kjo të bëhet gjithnjë me synim e miratim në shkallë kombëtare shtetërore me ekspertiza akademike, d.m.th., me mbështetje mbi bazë shkencore, pa mohuar asgjë pozitive.

Siç u konstatua edhe në pjesën e parë të këtij punimi shqiptarëve, sa herë që u është dhënë mundësia kanë bërë përpjekje për zgjidhjen e kësaj problematike, siç u faktua me 5 dokumentat paksa të trajtuar në atë pjesë.

Në të vërtetë po të kishim pasur ose po të kishim një shtet të stabilizuar dhe po të kishim një shoqëri të bashkuar të fortë e të ngritur kombëtarisht e ekonomikisht as që do të ishte aq nevojë e domosdoshme me insistue për hapjen e çështjes së ndryshimit euforik të të gjitha emërtimeve të huaja toponimike të imponuara më parë me kaq ndjeshmëri në gjuhën tonë, madje as ato sllave e as greke, por mjerisht atë mundësi nuk e kemi pasur dhe momentalisht nuk e kemi, madje as ndihmë mirëkuptimi nga pikëpamja shkencore pragmatike nuk kemi as nga kuadri u huaji konstruktiv shkencor, as nga serbët e as nga grekët, përkundrazi disa qarqe shtetërore-akademike të tyre, duke shfrytëzuar emërtimet nga lashtësia, por edhe të mëvonshme, në vazhdimësi propagandisht po mprehin oreksin ndaj trojeve tona, duke e ushqyer atë oreks gjoja me të drejtën e tyre historike, që gjithnjë e më shumë këto fakte, mjerisht, po i shprehin si me i pasë vërtetë tapi. Ndërsa, qeveritë tona, fatkeqësisht duke e lënë në heshtje mbrotjen shkencore-historike të trojeve tona aktuale e historike shqiptare, po tregojnë shumë dobësi, dhe jo vetëm po ua shtojnë orekset armiqve dhe të hutuarve, por që është e keqja edhe më e madhe sa që një propagandë e tillë duke u lënë në heshtje pa përgjigje, po prek në mentalitetin e njerëzve tanë, që deri në brendi të vetvetes po e ndjejnë një ndjenjë të tillë pushtimi, madje dikush edhe admirimi(!), andaj ky është ai fakti që duhet me u aktivizue organizmat e shtetit tonë që ta shërojnë atë ndjenjë që po e shprehin individë të frustruar përkatës të shoqërisë, madje edhe ndonjë nga asociacionet shoqërore politike që po deklarohet (politikisht) me tepri në mbrotje të së drejtës së pakicave, duke lënë nën hije shumicën, mbrotjen e interesit kombëtar, apo jo?! Me thënë të drejtën, ne mendojmë se sot për sot, përveç emrave pejorativë, nuk është nevoja të ngutemi në ndryshime masive allashqiptarçe, pa analizuar mirë gjendjen faktike dhe ndër të tjera pa e zotëruar, njohur e studiuar mënyrën e fjalëformimit të emërtimeve në fjalë në kuadër të strukturës së gjerë emërformuese të shqipes globale.

Fundi i fundit edhe pse insitojmë në respektimin e konstatimeve tona, megjithatë do t'i respektonim me kënaqësi ato trajta shkrimore të vendbanimeve, të cilat Komisioni i standardologëve do t'i rekomandojë si më të drejta.





## Literatura kryesore:

1. *Onomastika e Kosovës* (simpozium i mbajtur më 25-27 shkurt 1977), Prishtinë 1979.
2. *Prapashtesat e gjuhës shqipe* (Xhuvani-Çabej), shih A. Xhuvani, Vepra I, Tiranë 1980.
3. Fjalori enciklopedik shqiptar, Tiranë 1985
4. Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1980.
5. Fjalori i shqipes së sotme, Tiranë 1984.
6. Vëzhgime për emrat familjarë të shqiptarëve (Jusuf Shpuza), Shjkodër 1998.
7. Parashtesat e prapshtesat e gjuhës shqipe në shkrime të vjetra (shek. XV-XVIII) (Dr Ragip.Mulaku), Prishtinë, 1998
8. Çështje të shqipes standarde ...I (Dr. Nuhi Veselaj), Prishtinë 1997.
9. Struktura e formëzimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe (Dr. Nuhi Veselaj / tezë doktorate në dorëshkrim), Prishtinë 1992
10. Bilten (Pokrajinski zavod za statistiku, Prvi rezultati popisa stanovništva 1991 god..), Prishtinë 1991.
11. Çështje të toponimisë së Kosovës (parimet kryesore... të Komisionit të ishQPK), Rilindja (15 mars 2000 f. 12).
12. Regjistri i emrave të vendbanimeve të Kosovës, Rilindja (18 prill 2000)
13. Gjuha letrare shqipe për ët gjithë, Tiranë 1976.
14. Fonetika dhe gramatika e e gjuhës së sotme letrare shqipe II, Tiranë 1976.
15. Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I, II Tiranë 1972.
16. Standardizimi i toponimeve të Kosovës - çështje madhore kombëtare e ndërkombëtare (Dr. Rexhep Doçi, punim i botuar në 7 vazhdimë në gazetën *Bota sot*, Prishtinë, mars 2001).

17. Lista e ndyshit të disa toponimeve të papërshtatshme të Shqipërisë 1938, autor Fatos Daci, botuar në Albania press 2011.
18. Lista e toponimeve (sllave) në territoret e lirueshme shqiptare dhe shqipërimet e propozuara (1942) – nga autor Veli Haklaj, botim i gazetës shqipater marrë nga Forumi shqiptar...
19. Fjalor i emrave gjeografikë të Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2002.
20. Regjistri i standardizuar i emërvendeve të Kosovës, Era, Prishtinë 2005
21. Regjistri në versionin serbisht nën titullin Okruzi, gradovi i sela Kosova e Metohije, Beograd, internet 2015
22. Regjistri i gjendjes aktuale: Rajonet, qytetet dhe fshatrat e Kosovës, botuar nga *Gjigand* 2015
23. Janë shfrytëzuar wikipeditë përkatëse si dhe arftikuj e punime të caktuara nga portale interneti,
24. Begzad Baliu, Gjendja e toponimisë shqiptare në Ballkan, Era, Prishtinë 2004.
25. Shefki Sedjdiu, Çështje të toponimisë së Kosovës nga “Sprova etimologjike”, Era, Prishtinë 2002.
26. Tomor Osmani, Shekulli i Komisës Letrare Shqipe në Shkodër, Tiranë 2016.

## Të dhëna bio-bibliografike për autorin



### I.

**Nuhi (Muharrem) Veselaj** u lind në fshatin **Reçan të Therandës** (ish-Suharekë) më 20.08.1933. Shkollën fillore (me semimaturë) e kreu në Suharekë (1948), Shkollën normale (katërvjeçare) e mbaroi në Gjakovë, ku maturoi më 30.06.1952. Provimin shtetëror profesional e dha më 03. 09.1959 në Prizren. Shkollën e lartë, përkatësisht Shkollën I të Fakultetit Filozofik të Prishtinës – Dega e gjuhës dhe e letërsisë shqipe e kreu më 23.09.1963, ndërsa Fakultetin Filozofik të Prishtinës - Dega gjuhë dhe letërsi shqipe, më 23. 11. 1965.

Ndoqi studimet pasuniversitare dhe më 03. 04. 1980 mori gradën: *magjistër i shkencave filologjike*, ndërsa *tezën e doktoratës e mbrojti* më 24.12.1992.

Jeton në Prishtinë. Është anëtar i Shoqatës Mbarëkombëtare të Shkrimtarëve për Fëmijë dhe të Rinj me qendër në Tiranë si dhe anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës. Është Anëtar Nderi i SHAK “Elena Gjika Dora d’ Istria, Therandë.

Nuhiu qysh i ri, që nga viti 1951 ishte i organizuar në Lëvizjen për çlirimin dhe bashkimin e tokave shqiptare. Në vitin 1952 u burgos për veprimtari të tillë, por për moszbulim provash nga ai, u dënua vetëm 2 vjet. Pasi doli nga burgu, ndonëse, me vështirësi, arriti të ripunësohej në arsim që e kishte ideal veprimësie. Disa herë pati ndërprerje të dhunshme nga marrëdhënie e punës

(8 herë): Mushtisht (Suharekë) 1952, Suharekë 1956, Grejçec (Suharekë) 1957, Ferizaj 1962, Zllatar, Tankosiq (Ferizaj) 1963, Prishtinë 1972, 1973, kur për motive politike i ndalua puna në arsim e organizata shoqërore-shtetërore. Pas një kohe si i papunë u detyrua të punësohej në Ndërmarrjen për ndërtimin e rrugëve *Partizanski put* të Beogradit – dega në Prishtinë, prej nga kaloi në *Uzinën e amortizatorëve të Prishtinës*, përkthyes. Edhe prej andej më 1991 e larguan, andaj u detyrua me dalë në pension të parakohshëm.

Edhe pse, pothuajse ishte përherë nën mbikëqyrje ai përkundër pengesave e përndjekjeve, me punë të palodhshme dhe me qëndrim konstruktiv e parimor, arriti të korrë suksese, qoftë në jetën arsimore e shoqërore-politike, qoftë në veprimtarinë letrare e shkencore. Edhe gjatë Luftës së fundit, ai dhe familja e tij nuk ishin pasivë, përkundrazi kryen punë delikate e me rrezik. Në shtëpinë e tij në Prishtinë, muaj të tërë, gjetën strehim e shërim ushtarë të plagosur të UÇK-së. Është e vërtetë, se kur filluan bombardimet e NATO-s shtëpia e tij qe objekt sulmi me bombë nga paramilitarët serbë. Disa herë i është rafaluar servisi, garazhi si dhe muret e shtëpisë. Si mbarë popullata gjatë eksodit të madh edhe Nuhiu u detyrua të shkojë drejt Maqedonisë, mirëpo, në zonën neutrale në Gllloboçicë (në vend që të shfrytëzonte rastin për të vizituar vajzën në SHBA si dhe djalë e vajzë në Zvicër me familjet e tyre që s'i kishte parë me dekada, pasi, përkundër tentimeve, atij i qe ndaluar dalja jashtë Jugosllavisë, ky pasi e bekon djalin, me të cilin ishin bashkë, që t'i bashkohet UÇK-së, duke i hyrë rrezikut, kthehet në Prishtinë, ku ka dhënë ndihmesën e vet në mënyra të ndryshme deri në çastin kur çlirimtarët i priti dhe përshëndeti me ndonjë libër të tij, por edhe me një material modest buroteknik. Ndërkohë kreu me nder çdo angazhim që iu besua, por nuk u ekspozua në parti politike, më tepër u përqendrua në veprimtarinë krijuese.

## II.

**Nuhiu** është marrë me shkrime që në bankat e shkollës së mesme, po për arsye, që tashmë dihen, edhe për shkak të përmbajtjes, s'ka mundur të botojë të gjitha dorëshkrimet. Përveç prozë e poezi në revista e gazeta të ndryshme publikoi edhe punime shkencore nga fusha e gjuhësisë. Deri tashti botoi këto vepra:

## 1) Nga fusha e letërsisë:

1. Miklime (vjersha për fëmijë), Rilindja, Prishtinë 1967), (ribotim) 1997;
2. Rrezet e ylberta (vjersha për fëmijë), Rilindja, Prishtinë, 1971), (ribotim) 1997;
3. Me buzët në gaz (vjersha për fëmijë), Iliriku, Prishtinë 1997;
4. Fletë ditari rreth një motmotari (vjersha), Iliriku, Prishtinë) 1997;
5. Trimoshi (tregime për fëmijë dhe të rinj), Iliriku, Prishtinë 1997;
6. Cace e hope djaloshare (poezi), Iliriku, Prishtinë 1997;
7. Shfrime nëpër mjegullnajë (reflekse poetike e mendimore), Iliriku, Prishtinë 1997;
8. Mësime nëpër pësime (shfaqje teatrore), Iliriku, Prishtinë 1998
9. Gërricje në damarët e djalërisë (tregime), Rozafa, Prishtinë 1998;
10. Bulëza të përshenjura, (vjersha kushtuar stinës rinore), Rilindja, Prishtinë 2000;
11. Ther me pupël (vjersha humoristike), Rilindja, Prishtinë 2000.

## 2) Nga fusha e gjuhësisë:

1. Çështje të shqipes standarde në fushë të leksikut dhe të fjalëformimit I, Rilindja 1997;
2. Paskajorja, çështje e shqipes standarde, Dardania sacra, Prishtinë 2000;
3. Foljet më -O – në gjuhën shqipe, Dardania sacra, Prishtinë 2002;
4. Paskajorja dhe standardizimi i gjuhës shqipe, Prishtinë, 2006,
5. Rreth formëzimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe (tezë doktorate) MASHT e RK-së, Prishtinë 2014,
6. Rreth identitetit gjinisë asnjane në shqipen e sotme, Era, Prishtinë 2015,
7. Shumësi dhe shquarsia e emrave në shqipen standarde, Era, Prishtinë 2015,
8. Drejt standardizimit të gjuhës shqipe, Era, Prishtinë 2015,
9. Kontributi i Asdrenit në formimin e gjuhës letrare kombëtare shqipe, Era, Prishtinë 2015,
10. Çështje të shqipes standarde në fushë të normëzimit II, Era, Prishtinë 2015.

*Këto të pestat të gatitura për libërtim:*

11. Çështje të shqipes standarde rreth 28 temave të diskutueshme, III, Era, Prishtinë,

12. Çështje të shqipes standarde rreth emërimit të njerëzve sipas veprimtarisë IV, Era, Prishtinë,
13. Çështje të shqipes standarde rreth disa termave nga fusha e teknikës dhe e ekonomisë V, Era, Prishtinë,
14. Çështje të shqipes rreth vendbanimeve, VI, Era, Prishtinë,
15. Fjalor pune (poslovni rečnik) shqip –serbisht, me shtojcën serbokroatisht – shqip, për ndërmarrjet metal-përpunuese – me theks terminologjia tekniko-teknologjike, VII, Era Prishtinë,

Sidoqoftë, edhe pse në moshë të shtyrë ( ec në 84-shin) pritet që nga penda e këtij autori mjaft të frytshëm të shohin dritën e shtypit edhe vepra të tjera, qoftë nga fusha e gjuhësisë, qoftë nga ajo letrare-artistike, për libërtimin e të cilave qëndron në pritje mirëkuptimi nga institucionet dhe organizmat përkatës të qeverisë sonë, por edhe prej sponzorëve eventuale vullnetmirë.

Prishtinë, 2016